


ARTUR SHKURTI



BESA

libri i shenjtë

FEJA IME, E FËMIJËVE TË MI, DHE E BUJARËVE SHQIPTARË



udha e shkronjave

FALTORJA SHQIPTARE

Falenderoj Zotin që më caktoi mua ta bëj këtë punë dhe të nderoj shqiptarët kudo që janë duke e kthyer fenë e tyre nga një gjendje e gaztë, në të lëngët dhe më së fundi në gjendje të ngurtë me hartimin e Librit të Shenjtë “Besa” dhe me statutin e Faltores Shqiptare.

Artur Shkurti
bujar shqiptar

Shqipja në mbrëmje
në qiejt fluturoi
e lartazi shkoi.
Tue fluturuar lartaz nga qielli
dhe, para se të hynte, në hijen e natës
e çojti lart fletën e saj
dhe shkrojti
në qiellin me yj të ARBËRISË:
“BESA E SHQIPËRISË”.

Ibrahim Kodra [BN - 1]

BESA - ZBULESA E SHENJTË

feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë

Çdo njeri e ka një fjalë ku vë kryet.

(Frederik Reshpja)

“BESA” është Fjala ku dua të mbështet kryet unë,
fëmijët e mi dhe bujarët shqiptarë.

Libri i Shenjtë “BESA” është Zbulimi i Fesë së
Shqiptarëve, që ka për profet të vet Naim Frashërin
dhe për ndjekës të saj – bujarët shqiptarë.

Gjithë ç’jemi Shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Kemi të tërë një shpresë,
Një gjak, një gjuhë, një Besë.

(Naim Frashëri)

Leu dh’u la për trashëgim
- Me nderim e me qëndrim –
Besa jon’ e shentëruar.

(Lasgush Poradeci)

Shqiptarë ne na thonë,
bëjmë si ç’kemi zakonë,
O shokë ndë kemi Besë,
kush ka lindur dhe do vdesë,
Ndë u vra nga trimëria,
Namin e merr Shqipëria.

(popullore)

Dashuria, tungjatjeta,
midis çiftit të selitur
dhe me Besën ton’ të situr,
është e ëmbël shumë e shkreta,
është gosti nga qielli zbritur!

(Ali Asllani)

Vargjet e Pashko Vasës “E mos shikoni kisha e
xhamia / Feja e shqiptarit është shqiptaria” ishin
e para fjalë shkëndijë e fesë së re.

Vetë Pashko Vasa flet qartë për fenë tonë në këto
vargje:

Si atje n’empir të lartë,
ku Hyu qëndron gjithmonë,
këndojnë shpirtat me fletë
krejt himnin e fesë sonë,
t’mbarën i bien njerëzimit
me vepër t’lartë mirësie. (Pashko Vasa)

Naimi Frashëri u bë Profeti i vërtetë i kësaj feje.
Shumë shpejt, që në të gjallë të tij, ai mbledhi
aq dashuri nga shqiptarët sa nuk kishte mbledhur
asnjë njeri tjetër i mendimit. Kjo dashuri mbeti e
pashuar brez pas brezi.

“Shekujt vijnë e vitet shkojnë,
Naim, djemtë ligjërojnë.” (polifonia labe)

NAIMI është njeriu që Migjeni e kërkonte për
kombin tonë, edhe pse Migjeni lindi e vdiq pas
Naimit. Njeriu i Migjenit në të vërtetë nuk u lind,
por u rilind.

“Të lindet një njeri,
i madh si madhni,
dhe ndërgjegjet tona t’i ndezi në dashni,
për një ide të re, ideal bujar,
për një agim të lum e të drejtë kombtar.”



Me “BESËN” ne do të ngremë FALTORET SHQIPTARE, që janë bashkësitë e bujarëve shqiptarë që besojnë në Zot dhe besojnë se fjala e NAIMIT është frymëzim hyjnor i mjaftueshëm; që besojnë se copëra frymëzimi hyjnor shpërndahen si mjegull në shpirtrat e shqiptarëve në shekuj, një pjesë të të cilës e ka mbledhur ky libër shpalljesh aty ku burimi është më i sigurt se është i pastër (Ti me gojët e tyre fole...); që besojnë se duhet të japin Besën për të qenë Bujarë; dhe që besojnë se është koha e duhur për të patur faltoret tona dhe për t’i kthyer xhamitë e kishat në një kujtim historik.

Eja t’a ndrojmë ankimin
n’nji hymn uzdaje, eja
t’ndërtojm’ permbi gërmadha
faletoret e reja. (Ernest Koliqi)

Nuk është qëllimi ai që e bën luftën e shenjtë, por është lufta ajo që e bën qëllimin e shenjtë (Niçe).

Shenjtërinë e këtij libri e ka vendosur lufta e shqiptarëve për t’ju afruar Zotit në atë mënyrë që kombi i tyre të mos humbë në rrjedhën e historisë njerëzore.

S’duem me humbë në lojë të përgjaktë të historis njerëzore,

jo! jo! s’i duem humbjet prore –
duem ngadhnim!
ngadhnim ndërgegje dhe mendimi të lirë!
S’duem për hir
të kalbsinave të vjetra që kërkojnë “shejtnim”,
të zhytemi prap në pellgun e mjerimit
që të vajtojmë prap këngën e trishtimit,
kangën monotone, pa shpirt, të skllavnis –
të jem’ një thumb i ngulun ndër trutë e njerëzis.

(Migjeni)

E pra, ti, o perëndi, pse na le në dorë të djallit,
që na shtypi, na përtypi
nëpër nofulla të çakallit?

Po tani u bë ç’u bë, ti, o zot i këtij dheu,
s’mund të bësh asgjë,

t’i thuash kohës: prapa kthehu!,
edhe rri e bën sehir, bën sikur asgjë nuk di,
pra dhe neve jemi kundra,
duam një tjetër perëndi!

Duam një zot që do të mund
të na kap’ e të na tund,
të na tund e të na shkund,
vëllavrasjes t’i jap fund.

Perëndi, o perëndi, vi përpara zotris’ sate,
duke pasur përmbi supe
një vandak të rënd’ mëkate,
po mëshira hyjnore është e thell’ e është e gjërë
më e thellë nga gjith’ mëkatet
që ka vendi yn’ i tërë.

Po më fal për këto fjal’,

që guxova e i thashë, i rrëmbyer e i trembur,
mbasi gjuha më rreh dhëmbin,
atë dhëmb që më ka dhëmbur.

Vendi ynë që ka jetuar

herë me pushkë e her me shat,

s’mund të lihet tash e tutje

si një flet’ në degë të that’,

ai lipset që të rrojë, qoft’ me hir’ e qoft’ pa hirë,
dhe aty ku bie zjarri, bëhet lulja më e mirë.

(Ali Asllani)

Libri i shenjtë “BESA” vjen pas shekujsh reflektimi dhe fermentimi të idesë sonë fetare dhe kombëtare. Në çështjet fetare kombi ynë thua jse i provoi të tëra: paganizmin, krishterizmin, muslimanizmin, ateizmin shtetëror, konvertimet, varësinë dhe autoqefalinë. Mba jti respektin për profetët dhe ruajt i edhe dyshimin për ata që e sollën fjalën e tyre. Nga një stad në stadin tjetër, zhvillimet botërore patën një rol kryesor, por edhe shqiptarët nuk e lanë veten pasivë dhe bën më të mirën për kombin e tyre.



“Sot mund të flitet me krenari për “sintezën shqiptare” të feve monoteiste, çka duhet ruajtur jo vetëm si vlerë shqiptare, por edhe si vlerë europiane dhe botërore.” (Abdi Baleta)

Ne nuk kemi tagër t’u themi priftërinjve dhe hoxhallarëve të kujdesen për fatet e kombit shqiptar. Ata janë në “biznesin” e tyre. Kleri katolik ka për qendër Vatikanin dhe mungon organizimi kombëtar autoqefal si tek fetë e tjera, kleri ortodoks e kishte autoqefalinë dhe pranuan t’u shkelet me këmbë, muslimanizmin në Shqipëri më shumë e kanë mbrojtur laikët.

Naimi i porositi klerikët e krishterë dhe muslimanë dhe fjala ra shpesh në vesh të shurdhër:

Fet’ e besëtë t’i kemi
Po të ndarë të mos jemi,
Hoxh’ e xhami e dervishë,
Priftër’ e kllogjër’ e kishë
Nderë që kanë ta kenë,
Po të duan Mëmëdhenë,
Të duan njerëzinë,
Dhe të tërë Shqipërinë,
Mirësit’ e urtësitë
T’i kenë përpara dritë,
Të ken’ udhë njerëzinë,
dhe zot gjithë Perëndinë;
Me dritët të Perëndisë
T’i ndihinë Shqipërisë,
E të ngrenë Shqipëtarë
Të bëhet si ish më parë (Naim Frashëri)

Ju priftërë mjekrë-gjatë!
Q’u quan kombi uratë,
Uratë e Perëndisë,
Q’është drit’ e gjithësisë,
Mund të bëhi të pa-besë
Për të mirët të Moresë?

Mund të lini Perëndinë?
Dhe Krishtin’ e Shqipërinë?
Edhe i fali Moresë?
Q’është pa-fe e pa-besë.
Dhe ju hoxh’ e ju dervishë,
Mos shihni Xhami e Kishë,
Si Kisha është’ dhe Xhamija
Tekdo është Perëndia. (Naim Frashëri)

Fjalëve t’armiqve të egër kurrë mos u vini veshin,
Se ata duan gjithmonë, me intriga të urrejtshme,
Me çdo mjet ta bëjë fenë vegël të shkatërrimit tonë.
Ata duan të na ndajnë për të tyret interesa. (Naim Frashëri)

“BESA” është përpjekja për të kompaktësuar kombin shqiptar, këtë pjesë të njerëzimit, për t’iu kundërvënë më fuqishëm pasojave më negative të zhvillimeve të shoqërisë së sotme dhe të ardhshme njerëzore. Nuk mund të ketë bashkim e përparim njerëzor pa bashkime të forta e të shëndosha kombëtare, siç nuk mund të ketë kombe të shëndetshëm pa familje të shëndetshme. Vlerat e përbashkëta njerëzore fillimisht përvetësohen nga organizimet kombëtare dhe pastaj shkojnë në nivelin e njeriut. Rruga tjetër nga universalja direkt tek njeriu është e mundshme por është e pasigurt në masivizimin e saj, pasi çdo individ në radhë të parë u përket grupeve shoqërore të organizuara që janë kombet.

“BESA” në një kuptim është edhe mohim edhe pohim i feve ekzistuese. Është mohim i të gjitha feve tradicionale në truallin shqiptar, pasi del me përfytyrim të veçantë për Perëndinë, e cila i jep vendin e duhur njeriut, lutje të reja, me rite të reja të besimit dhe një kuptim të ri për hyjnoren në përgjithësi. Ajo mban prej të gjitha feve besimin në Zot, pikërisht sepse besimi në zot nuk është produkt i fesë, por feja është produkt i besimit në zot. Lidhja më e fuqishme me to është vetë historia jonë e harmonisë fetare.



Parimet e moralit fetar të shqiptarëve janë krejt të ndryshme me ato të korrupsionit politik, shoqëror dhe të degjenerimit social, si edhe krejt të ndryshme nga hipokrizia fetare e derisotme. Ndaj edukoni fëmijët me këtë libër, recitojuni atyre çdo ditë diçka dhe ja tek do të keni të tjera frymëzime dhe ja tek e keni tërmetin në themelet e së Keqes. Mos u interesoni se Si e Qysh do të bëhet e mundur që prej së ardhmes së fëmijëve tuaj do të zhduken retë e zeza të pesimizmit. Deduksionet që ata do të bëjnë janë të Pashmangshme dhe pas deduksioneve vjen Kauza dhe pastaj Veprimi. Nuk mund të mendohen mënyrat kaq të ndryshme, kaq me fantazi për ta shpërbërë nga themelet atë çka quhet “E KEQE” edhe pse ajo sot duket e konsoliduar në themelet e jetës shoqërore shqiptare, si një virus që ende nuk i është gjetur bari. “Isha e sigurt se ky ishte zëri i Zotit. Isha e sigurt se ai më thërriste mua. Mënyra se si më thirri nuk duhet të të preokupojë, se kjo është diçka midis Zotit dhe meje: ç’është me rëndësi, është se Zoti e thërret secilin në mënyrë të ndryshme. Ne nuk kemi ndonjë meritë. Ajo që është shumë me rëndësi është që t’i përgjigjemi me gëzim thirrjes së tij. Unë tani jam aq e sigurt sa ç’kam qenë në ato çaste të rënda dhe dramatike se kjo ishte punë e Zotit dhe jo e imja. Dhe, pasi që kjo ishte punë e Zotit, unë e dija se bota do të përfitonte” (Gonxhe Bojaxhi)

Na duhet një fe që të na kthejë atdheun, ose më mirë me thënë dashurinë për atdheun.

Flamuri kombtar nuk ka shka ban nder ne,

Po kje se dashtuni nuk kem p’r Atdhe!

(Gjergj Fishta)

Çifutët e kërkuan atdheun për qindra vjet duke qenë jashtë tij. Kurse ne e kërkojmë atdheun duke qenë brenda tij. Ose më mirë me thënë se po kërkojmë dashurinë e munguar për atdheun, duke patur një atdhe.

Kur ta gjejmë, atëherë do të shohim sa të largpamës dhe sa të verbër kemi qenë në histori.

Po kërkoj një Tokë të Re

Që duhet të jetë

Atdheu im.

Kjo Tokë e Re

Ekziston diku

O dheu im, por nuk është prej dheu.

(Lindita Arapi)

Nëse ne nuk bëjmë më të voglin mundim që “BESËN” ta kthejmë në realitet, atëherë çfarë pritet prej nesh? Veç një rrjedhje drejt fatit të paracaktuar?! Uji i lumit dihet se ku shkon. Veç se para se Drini të derdhet kot në det, ne i marrim energjinë dhe me të ndriçojmë shtëpitë e shqiptarëve. Atëherë të mos shkojnë kot breza të tërë shqiptarësh, pa bërë dritë në jetën e tyre.

Ej ti që mban trishtim,

Jo! Jo! Jo! Mos prit! Lufto!

Bëj dritë si një Naim,

Dhe jeto! (Alqi Boshnjaku)

“BESA” nuk është shpikje, por zbulim: zbulimi i shpirtit fetar dhe kombëtar shqiptar.

Lutjet sjellin Besën, Besa sjell Dashurinë, dhe Dashuria sjell Ndhimën reciproke. Kjo ide vjen prej bujares së famshme shqiptare Gonxhe Bojaxhi. Çfarë ndihme të ndërsjellë kërkojmë ne prej njëri-tjetrit? Ndhimën e shqiptarit për shqiptarin. Atëherë çfarë dashurie duhet të sjellë këtë pasojë, përveç se dashuria për kombin? Çfarë feje duhet të sjellë këtë dashuri përveçse një fe me tipare të theksuara kombëtare?

Përderisa bashkohemi në lutjet tona për të ardhmen e kombit tonë, nuk mund të mos bashkohemi në të njëjtën fe. Le t’u japim fëmijëve tanë “BESËN” që i bashkon dhe jo fe të tjera që i mbajnë ata përsëri të ndarë në vlera tek të cilat duhet të besojnë. Le t’i shmangemi përmes fesë sonë njëanshmërisë në vlerësimin e qytetërimeve lindore dhe perëndimore.



Le të vlerësojmë gjithçka ka arritur shoqëria njerëzore deri më sot.

Me “Besën” shmanget diskutimi për dyzimin e karakterit të shqiptarit në çështjet e besimit, që vihet re që nga koha e këngës kushtuar konvertimit në muslimanizëm të fisit të Gjolekajve:

Qishëz-o, moj qishëz-o,
të ma falçë fajin-o,
synë e djathtë e kam tek ti,
të mëngjërën në xhami. (Dukat, Vlorë)

Sikur të ushtrohet për shumë kohë që syri i djathtë të mbahet tek kisha dhe i majti te xhamia i bie që kombi të bëhet strabik dhe të mos fokusohet dot, si duhet, në të njëjtin objekt, dhe të mos ngrihet dot kurrë në këmbë.

Me çalue n’anë të djathtë, me çalue n’anë të majtë ...

Si paljaço i gjorë që kah t’ia mbajë s’di,
mbasi kambën e theu n’akrobaci –
jet’ e tij asht helm pa asnjë pikë mjaltë.

(Migjeni)

Ja, pse “BESA” është ajo që del nga shpirti i kombit shqiptar. “Besa” do t’i bëjë edhe më fetarë shqiptarët nga sa kanë qenë, pasi kjo është dhe një fe jashtëzakonisht e bukur dhe e mbrujtur shqipëtarisht. Sot shumica e shqiptarëve e shohin me dyshim angazhimin fetar të një personi, sidomos kur ai dëshiron të bëhet edhe klerik. “Çuditërisht” në vend se të thonë që i ka hyrë rrugës së Zotit, thonë “ka dalë nga rruga e Zotit”. Kjo deri diku shpjegohet me faktin se “rruga e Zotit” për shqiptarët duhet të ishte gjetiu. Rruga e Zotit është jo besimi për besim, besimi për të ngrënë e për të pirë, por besimi i cili jep i vlera të tilla shoqërisë që e bëjnë atë të ecë para. Nëse ka një fushë ku feja mund të bëjë mrekullira, kjo është jeta shoqërore. Feja nuk mund të na shërojë zemrën e sëmurë, por mund të na japë një doktor me besë që nuk i ngre çarkun e korrupsionit të tij pacientit tek dera e spitalit.

Me zbulimet e BESËS, unë mund t’ua besoj shpirtin e fëmijëve të mi pa frikë Naim Frashërit dhe bujarëve të tjerë shqiptarë që kanë shkruar këtë libër me dorën time. Tashmë unë nuk do të kem frikë se ata do të më dalin nga “rruga e Zotit”. Është krejt e shëndetshme që ato të shëtitin nëpër hapësirat e gjelbërta dhe të lulëzuara të Besës Shqiptare. Aty ato do të takojnë shpirtat e mrekullueshëm të shqiptarëve të gjallë e të vdekur, të shqiptarëve që jetojnë në atdhe dhe jashtë atdheut. “Besa” është një dritare e mjaftueshme për të parë të tërë botën dhe për të futur brenda të tërë dritën e kulturës së njerëzimit.

Seç më shtruan bukën,
dhe buka s’më haet,
një merak që kam
nga zemra s’më ndahet. (Përmet)

Shpresoj që kjo farë që po mbjell rrallë, të më mbijë plot.

Ne rrugën drejt e mbajtëm gjithë me ndjesë,
Të tretur shumë herë nga trishtimi;
Por mjaltë krejt na dukej hidhërimi
Kur shihnim se fjala jonë zinte Besë.

(Asdreni)

dhe të kthehet në realitet profecia e NAIMIT:

Në jan’ ata shqipëtarë,
që i njoh e i di unë,
bota po ka për të parë
këtu një të madhe punë!

Falenderoj Zotin që më caktoi mua ta bëj këtë punë dhe të nderoj shqiptarët kudo që janë duke e kthyer fenë e tyre nga një gjendje e gaztë, në të lëngët dhe më së fundi në gjendje të ngurtë me hartimin e Librit të Shenjtë “Besa” dhe me statutin e Faltores Shqiptare.

ARTUR SHKURTI

bujar shqiptar

drejtor i shkollës “Udha e shkronjave” (1997)

BESA



Si atje n'empir të lartë,
ku Hyu qëndron gjithmonë,
këndojnë shpirtrat me fletë
krejt himnin e fesë sonë,
t'mbarën i bien njerëzimit
me vepër t'lartë mirësie.

Pashko Vasa [BN - 2]



S'do dëgjoj veç gjuhën që më flet pa zë:

Naim Frashëri [BN - 3]

Kjo kupore e pafund që kemi sipër,
Këto shkronja, këto radhë dhe ky libër
Të atij fytyrën çfaqin gjith' këto,
Lexo veten, o njeri, këtu kërko!

Naim Frashëri [BN - 4]

Se je ti mëkëmbësi i tij në jetë;
Vendi prej nga del në shesh thesari i fshehtë;
Pikëz e të thellit det të gjallërisë;
Dhe një afsh nga shpirti i madh i Gjithësisë.

Naim Frashëri [BN - 5]

Për Krijuesin e përsosur flet çdo send.
Hirin e fytyrn'e tij shoh në çdo vend.

Naim Frashëri [BN - 6]

Besojmë Zotn' e vërtetë,
q'është gjithësija vetë,
pa atë s'ka vënt gjëkund,
ajy 'shtë kreji dhe fundi
më ç'do anë, që shikojmë,
fytyrën' e tij vështrojmë,
e tërë ç'është kjo jetë,
është'ay Zot' i vërtetë!

Naim Frashëri [BN - 7]

Luletë, që lulëzojnë,
bukurin' e tij tregojnë.
Ajy është trëndafil; ajy
vetë dhe bilbili.

Naim Frashëri [BN - 8]

Po kur desh Zot' i vërtetë,
të dil faqeza në jetë,
ahere bëri njerinë,
atje t'a gjesh Perëndinë!

Naim Frashëri [BN - 9]

Ç'sheh, është Zot' i vërtetë,
Ç'dëgjon, është zër' i tija,
Gjithë ç'ka e s'ka në jetë,
Është vetë Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 10]

Më çdo anë e kërkova,
Thashë: ku 'shtë Perëndija?
Po më pastaj e mësova,
Qënke ndaj mej' e s'e dija!

Naim Frashëri [BN - 11]

Kërkonja gjetkë ta gjeje
Zotn' e math e të vërtetë,
Ajy qënkej ndaj meje,
E paskështa unë vetë!

Naim Frashëri [BN - 12]

Pa s'vdes kurrë Perëndija.
Po kush vdes në jetë vallë?
Gjë s'vdes, sepse gjithësija
Është gjithnjë e gjallë.

Naim Frashëri [BN - 13]

Qeshë diell, ishnja hënë.
U bësh' uj' e balt' e erë,
Yll e zok e dash kam qenë
Pa dhe njeri shumë herë.

Naim Frashëri [BN - 14]



Sa det i math e i gjerë!
Edhe sa mijëra valë!
Sicil' atje do të bjerë,
Prapë soje do të dalë.

Naim Frashëri [BN - 15]

Paskëtaj, o shokë, kurrë
Mos kërkoni Perëndinë
Nëpër murë e nëpër gurë,
Po shihni mirë njerinë!

Naim Frashëri [BN - 21]

Mijëra shpirtëra ngrihen,
Bijen mijëra të tjera,
Vjen dimëri, lulet pshihen,
I nxjerr prapë në sheshtë vera.

Naim Frashëri [BN - 16]

Zëmr' e njeriut në jetë
Është vend' i Perëndisë,
Është atje Zot' i vërtetë,
Det' i math i gjithësisë.

Naim Frashëri [BN - 22]

Një'shtë, po ka gjyrë,
Duket sikur s'ka të ngjarë,
E sheh fytyrë – fytyrë,
Po' shtë i njëjt' e i pandarë.

Naim Frashëri [BN - 17]

Ay është gjithësija
Edhe udh' e Perëndisë,
Është vetëm njerëzija
Q'i duhetë njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 23]

Mos shiko ç'rrobë ka veshur,
Është brenda vet' i qetë,
Syr'i t'urtit e sheh ç'vëshur,
Veç atij s'ka gjë ndë jetë.

Naim Frashëri [BN - 18]

Hapësira e paanë është tempulli i Krijuesit.
Natyra gjith'anëmbanë është libri i shenjtë
Dhe shkronja të atij libri janë trupat qiellorë.
Ndërsa si meshtar në tempull është shkenca, që
njeriun e afron tek Perëndia, q'është gjithëçka në
botë.

Naim Frashëri [BN - 24]

Zoti është gjithësija,
Ay është gjithë ç'janë;
Po kush njeh vet'hen e tija,
S'e kërkon më tjetër anë.

Naim Frashëri [BN - 19]

E të madhit zot fytyrë është drita që shikojmë
Dhe njeriu është korë edhe shëmbëlles' e Zotit.
Zemra e tij e pastër është fron i Perëndisë
Edhe vetëdija e tij një gjykatës brenda vetes;
E shpërblen për çdo të mirë, e mundon për çdo
të keqe.

Naim Frashëri [BN - 25]

Ti je ç'është jet' e tërë,
Ti je vetë gjithësija,
Ti vetë njeri je bërë,
More fytyrën' e tija.

Naim Frashëri [BN - 20]

Çdo gjë që shohëm në këtë jetë,
Tregon fuqin' e Zotit vërtet.

Naim Frashëri [BN - 26]



Nuk sheh tjetër po veç dritë bukurie,
Vetëtimë e zjarr vështrimesh Perëndie.

Naim Frashëri [BN - 27]

I bukur është qielli dhe si i tillë,
neve na ndez me mall,
dhe plot besim ai synon po fill,
psherëtimë n'çdo zemër t'kallë.

Pashko Vasa [BN - 34]

Zot'i math e i vërtetë!
gjithësija je ti vetë!
më ç'do anë, që vërejmë,
fytyrënë tënde gjejmë.

Naim Frashëri [BN - 28]

Duket një port, ku fatin e zezuar
shkon zemra ta vendosë
për t'thithë pastaj një ajër më t'kulluar
ku dhimbja të jetë sosë.

Pa kur desh Zot' i vërtetë,
të çfaqej në këtë jetë,
nxori në jetë njerinë,
atje e gjen Perëndinë

Naim Frashëri [BN - 29]

Kështu mendja e njeriut, që shpresën hoqi
prej botës së padrejtë,
krijoi një emër që me ëndje e ndoqi
dhe atij iu mbërthye krejt;

Pashko Vasa [BN - 35]

Ç'do gjë që shohëm në jetë
na rrëfen Zotn' e vërtetë,
më ç'do anë, që shikojmë,
atë fytyrë vështrojmë.

Naim Frashëri [BN - 30]

edhe kur sos hareja e nis vajtimi
që dhimbjen na lajmon
vetëm në qiell ka shpresë, jo te njerëzimi
drejt tij, pra, fluturon.

Pashko Vasa [BN - 36]

Kush pandeh' të dil nga dheu
Gjithë ky rrëmet q'është sot,
Oh! përveç se i madhi Zot,
Që me dorë të ti e kreu.

Naim Frashëri [BN - 31]

Kështu çdo vdekatar, kur rëndë lëshohet
vetë dora e fatkeqësisë,
nga dheu dhe nga çdo e keqe e saj largohet
dhe udhën ai e nis.

Pashko Vasa [BN - 37]

Feja e kohës së sotme është vetëm njerëzimi.

Naim Frashëri [BN - 32]

Pashko Vasa [BN - 38]

Shpirt! o shpirt! ta dëgjonj zënë,
fjala jote poshtë s'bije,
bëhenë gjithë ç'ke thënë,
ky është zë Perëndijë!

Naim Frashëri [BN - 33]

mu drejt asaj lavdie që n'fëmijëri
lakmi nga djepi i mbeti,
pa ditur nse tej varrit çdo njeri
gjet' hiçin o diç gjeti.

Pashko Vasa [BN - 39]

Se është pasqyra e një tjetër jete
E kulluara e zemrës dliresi
Dhe një ditë do të shkelesh n'breg të detit
Të asaj bote që ka veç përjetësi.

Zef Serembe [BN - 40]

Në kullm,
Në thelb,
Në fund të vetes s'ate
Më mban, njeri;
Me tëmbëla nër duar
Kupto tashi çfardo dyshim që pate!

Në gjuhë shqype nanat t'ona
Shi prej djepit na kanë thanun,
Se asht një Zot, qi do t'a donna:
Njatë, qi jeten na ka dhanun.

Gjergj Fishta [BN - 41]

Unë jam mjalti, unë jam helmi,
Unë jam plaga dhe melhelmi,
Unë jam vdekja, unë jam jeta,
Unë jam shpresa, e vërteta.

Arben Duka [BN - 42]

Të flas me zë të fjalës së kulluar:
Kur ti shijon...
Kur ti përket...
Kur ti
Një lules s'heshtur erë-i merr në fletë:
Jam pemë...
flutur...
lule..., o njeri:
Je lëng...
Je pluhur...
J'er' e lules vetë...

Lasgush Poradeci [BN - 47]

Unë jam Ati, Biri, Nëna,
Unë jam Dielli dhe Hëna,
Unë jam gjumi, unë jam zgjimi,
Unë jam fundi dhe fillimi.

Arben Duka [BN - 43]

Unë jam zgjimi, unë jam gjumi,
Unë jam zjarri, unë jam lumi,
Unë jam brenga dhe gëzimi,
Unë jam fundi dhe fillimi.

Arben Duka [BN - 44]

Unë jam zog, unë jam qielli,
Unë jam rrezja, unë jam dielli,
Tek unë nis, tek unë mbaron,
Mjerë ai që s'më beson.

Arben Duka [BN - 45]

A sheh ku zbriti vera mi bregore?
Dëgjon në pyll këmborën q'oshëtiu?
Je fije bar,
Je tingëll prej këmbore:
Jam vera,
Jam këmbora vetvetiu.
Pra ndje tashi si ryn në det një vlak,
Kupto tashi si shket... fundet... humbet...
Heu! tej-së-tejmi deti zemërak
Nër vlak kullon!...
Njeri:
Je vlak!
Jam det!

Lasgush Poradeci [BN - 48]

Në harmoninë universale
pashë perfeksionin
dhe besova në krijuesin.

Kujtim Murati [BN - 49]



E prandaj, dyke filluar, ay Lart i shpije kryet
Dh'i ngreh sipër-e-më-sipër gjer sa qafa ment i thyet.
Asohere-e ndjej si dridhet me një zë pa shëmbëllim
Asohere-e ndjej si foli: Të jam falë, - o Zoti im!

Lasgush Poradeci [BN - 50]



Familja, që lutet së bashku, mbetet tok.
Fryt i lutjes është feja.
Fryt i besimit është dashuria.
Fryt i dashurisë është shërbimi i ndërsjelltë ...”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 51]



Falna, Zot i math, ne njerëzinë,
Edhe të mirat' e dashurinë,
Vëllazërinë, zemrën' e qruar,
Mëndjenë pa faj, shpirt të uruar,
Bëna të drejtë në këtë jetë,
T'urt'e të mirë dhe të vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 52]

Det i p'an' i mirësisë! q'emrin tënt s'e zë dot
n'goje,
Qysh e ngrehe gjithësinë pa lënë farë nevojë!

Naim Frashëri [BN - 53]

Fali njeriut urtësinë, mirësinë, njerëzinë,
Butësinë, miqësinë, dashuri, vëllazërinë;

Naim Frashëri [BN - 54]

Epu sheshevet lul'e bar, dhe pyjvet gjeth' e
fletë,
Resë shi, aravet bimë, e mos lërë gjë të metë,
Fali erë trëndelinës, manushaqes, trëndafilut,
Kalliut bukë, mizës pjesë, zogut ngrënie, zë
bilbilit,
E drurëve jepu pemë, dhe uratë bagëtisë,
Dërgo dhembj'e kujdes për to në zemërt të
njerëzisë

Naim Frashëri [BN - 55]

Epu pjergulls' e veshtit rrush dhe vozësë fali verë,
Mos e lërë pa të kurrë, kurrë thatë mos e lerë,
Fali diellit flak' e zjar, dhe hënës' yjet dritë
Edhe detit ujë e kripë, gjithësisë jet' e ditë.

Naim Frashëri [BN - 56]

Yjtë le të vinë rrotull dhe njerëzit të punojnë,
Të dëfrenj' e të gëzohen, dhe si vëllezër të
shkojnë.

Naim Frashëri [BN - 57]

Tregomu dhe Shqipëtarët udhën' e punës së
mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër, edhe fjeshtë
Shqipëtarë.

Naim Frashëri [BN - 58]

Falmi, falmi Shqipërisë, ditën' e bardh' e lirisë,
Udhën' e vëllazërisë, vahn' e gjithë mirësisë.

Naim Frashëri [BN - 59]

Nxir të vërtetë në shesht, paskëtaj të
mbretëronjë,
Errësira të përndahet, gënjeshtër të pushonjë.

Naim Frashëri [BN - 60]

Lutja për fëmijët

Zot'i math e i vërtetë!
N'atë sy kurrë mos shtjerë
Lotn' e hidhur e të shkretë,
Dhe mos e lërë të bjerë,

Naim Frashëri [BN - 61]

Po falu në buzët gazë,
Dhe në sythit bukurinë,
E rriti cazë-nga-cazë,
Duke dhënë urtësinë;

Naim Frashëri [BN - 62]

Epu jetëzën' e gjatë,
Edhe mos i lerë kurrë
Pa mëmëzë e pa atë,
Dhe në breng e të sëmurë,

Naim Frashëri [BN - 63]

S'munt t'i shoh të mallëngjyer,
A të varfër' e të mjerë!
Dhe të grisur' e të çqyer!
Kurrë, kurrë mos i lerë!

Naim Frashëri [BN - 64]

Falu gjithë mirësitë,
Të rrojnë me nder në jetë,
Të mësojnë dituritë,
Të bëhenë të vërtetë;

Naim Frashëri [BN - 65]

Të nderojnë mëmëdhenë,
Vjeftënë t'ia lartësojnë,
Mbi gjithë botët t'a ngrenë,
Si lule t'a zbukurojnë.

Naim Frashëri [BN - 66]

Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëshshin gjithëmon'armiqtë e tij!
Gaz përjetë paqin zotërit e tij!
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme pastë plot me lumturi!

Naim Frashëri [BN - 67]

Fali, fali Shqipërisë
gjithë' ke të mirësisë.
Edhe ju gjithë të mirët!
mos na lini n'errësirët!

Naim Frashëri [BN - 68]

Shqipërinë mos e lerë,
të prisetë e të bjerë,
po të jetë gjall për jetë,
gjithë ç'i duhet, t'a ketë,
të rronj' e të mbretëronjë,
të jetë lulez' e zonjë,
fali ti vetëz'uratë,
që të jetë jetë gjatë.

Naim Frashëri [BN - 69]

Zot i math e i vërtetë!
Që kreve ç'shohim në jetë,
Edhe të tjerë që janë
Pa funt e pa krye pa anë,
Edhe kudo je ti vetë,
Syri ynë tekdo shikon,
Që nga lint e gjer tek perndon,
Më çdo vënt të sheh fuqinë,
Urtësinë' e madhërinë,
Falna gjithë mirësitë,
Epna dituri e dritë,

Tregona udhën' e mirë,
Mos na lërë n'errësirë,
Dhurona gjithë të mirat,
Mërgona nga të pëshitrat.

Naim Frashëri [BN - 70]

Zot! falna vëllazërinë,
Dashurinë e miqësinë,
Epna dëshirë të msojmë,
E të mirat të punojmë,
Bëna të but' e të qetë,
E të urt' e të vërtetë,
Jetënë ta trashëgojmë.

Naim Frashëri [BN - 71]

Zot' i math e i vërtetë!
Edhe gjithë ju të Mirët!
Mos na lini keq' e shkretë,
N'arratit e n'errësirët.

Naim Frashëri [BN - 72]

Po falini Shqipërisë,
Fatbardhësin' e lirinë,
Gazë në vendit të zisë,
Edhe gjithë mirësinë.

Naim Frashëri [BN - 73]

Zot' i math e i vërtetë!
të qofshim falë për jetë,
mërgona nga marrëzitë,
nga të gjitha ligësitë.

Naim Frashëri [BN - 74]

Zot i math e i vërtetë!
Të qofshim falë për jetë!
Falna shënden' e fuqinë,
Miq' e gjithë njerëzinë,

Naim Frashëri [BN - 75]

Zot i math e i vërtetë!
Bëna të urt' e të mirë,
Epna në zemrë mëshirë.

Naim Frashëri [BN - 76]



Zot i math e i vërtetë!
Falna gjithë urtësitë,
Mirësit' e dituritë,

Naim Frashëri [BN - 77]

Zot i math e i vërtetë!
Mos na lërë n'errësitë,
Rrëfena udhën' e mirë
Dërgona në shpirtit dritë,
Të njohëmë mirësitë.

Naim Frashëri [BN - 78]

Zot i math e i vërtetë!
Mërgona nga ligësija,
Nga punërat e këqija,
Prej çdo farë marrëzije,
Që s'i ka njeriut hije,
Nga të ligatë vetija,
Që nuk i qas vetëdija.

Naim Frashëri [BN - 79]

Ndiej', o Zot, se nuk dinë
Se ç'bëjnë, janë mahnitur,
Rrahin të prishin shtëpinë;
Pun' e lig'edh' e mërzitur!

Naim Frashëri [BN - 80]

Zot i math e i vërtetë!
Bëna njerës të vërtetë,
Pa të keq' e pa të metë,
Të mos jemi fajëtorë,
Të liq, të mjerë, e të gjorë,
Të ndyerë e të pabesë,
Të mundurë e të pashpresë,
Nga të ligatë mërgona,
Në mirësit' afërona,
Mos na lërë në mundime,
Në s'mundje dhe në lëngime.

Naim Frashëri [BN - 81]

Falna Zot' i math! uratë,
Të mos bijem në mëkatë!

Me vëllazëri të shkojmë,
Jetënë ta trashëgojmë.
Nga çdo mënxyrë shpëtona,
Udhën e drejtë tregona.
Mos na lërë kurrë shkretë!
Zot i math e i vërtetë!

Naim Frashëri [BN - 82]

Ruana, Zot i vërtetë,
nga ç'do pun' q'ësht' e metë
hiqu ligësi e ndyrë,
në zëmërë mos na hyrë!

Naim Frashëri [BN - 83]

Zot'i math! O Zot' i mirë!
falna durim e mëshirë!

Naim Frashëri [BN - 84]

Zot'i math e i vërtetë!
bëna t'urtëth e të qetë,
falna gjithë mirësitë,
epna dituri e dritë,
dhe njerëzi e mëshirë,
mos na lërë n'errësitë,
afërona urtësinë,
e mërgona djallëzinë,
hiqna nga makutëritë,
dhe nga gjithë marrëzitë,
nga dëmi, nga lëkmimi,
e na shpjerë te gëzimi,
udhën' e drejtë rrëfena,
me kamjet t'ënde ushqena,
falna durime dhe shpresë,
urat'e shpëtim e ndjesë,
mos na turpëro në jetë,
Zot'i math e i vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 85]

Zot i math e i vërtetë
mos na lërë kurrë shkretë,

Naim Frashëri [BN - 86]

ti je Zot' i gjithësisë,
Perëndi e Shqipërisë,
urdhëri yt po të jetë
e po të duash ti vetë,
gjithë punët mbarohen,
gjëkundi nukë ndalohen.

Naim Frashëri [BN - 87]

Zot'i math! Zot'i vërtetë!
fali, fali Shqipërisë
gjithë ç'i duhet në jetë,
se je Mbret'i gjithësisë.

Naim Frashëri [BN - 88]

Shqipëtari trim me fletë,
si ka qënë, le të jetë,
të ketë gjith'urtësinë,
e ta dojë Shqipërinë,
të vdesë për Mëmëdhenë,

Naim Frashëri [BN - 89]

të jetë trim e i mirë,
po të mos jet' egërsirë,
të jet' i qytetëruar,
i ditur' e i mësuar,
t'i apë nder Shqipërisë
U bëftë e Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 90]

Epi Shqipëtarit dritë,
Zot' i vërtetë! të shohë,
Të marrë vesh mirësitë,
Të vërtetën ta njohë.

Naim Frashëri [BN - 91]

Fali njësin' e bashkimnë.
Trimërin' e urtësinë,
Zotërizën' e shpëtimnë,
Besën' e vëllazërinë.

Naim Frashëri [BN - 92]

Të jetë i papenguar,
Me ner në jetë të rronjë,

Po si Zot' i Zotëruar,
Vet' aji të mbretëronjë.

Naim Frashëri [BN - 93]

Engjëll i bukur, pa xbritmë,
dhe, me dritët të uruar,
shko përpara mej' e ndritmë,
të shoh gjithë ç'kanë shkuar.

Naim Frashëri [BN - 94]

Lutja e Skënderbeut

"Zot'i math i vërtetë!
Le të bënet ç'është thënë",
tha, "se unë s'rronj për jetë;
po më ki kujdes, Ti vetë,
shqipëtar' e Shqipërinë,
mos m'i lërë kurrë shkretë
se Ti e do mirësinë;
në dorë të huaj kurrë
Shqipërija të mos bjerë,
shqipëtari trim e burrë
të jet' e ta ketë nderë;
mbaje Shqipërinë zonjë,
të ketë gjithë të mirat,
të rronj' e të mbretëronjë,
të mos ta han'egërsirat,
fali lirinë ta ketë
edhe gjithë mirësitë,
të jetë m'emrë për jetë,
epi jet' e dit' e dritë!"

Naim Frashëri [BN - 95]

Lutja e mbretëreshës

"Zot'i math e i vërtetë!"
tha mbretëresha, "kam shpresë,
bëj si të duash, ti vetë,
se të kemi prurë besë".

Naim Frashëri [BN - 96]



O Zot i lum, qi vetem n'dorë Ti i ke
Shartet e popujve e mbretnive t'tana,
E gja pa hiri kurr Ty s't'ndodhë mbi dhe,
As nalt mbi qiellë, ku shndrisin dielli e hana,
Deh! Ti, i Pushtetshëm heret si ne e vona,
Shih e gjyko mbi gjith kto kobet t'ona.

Gjergj Fishta [BN - 97]

Nemi ato vite t'arta
që zemra i humbi shqimit,
nem ato ide të larta,
që feja i sjell njerëzimit.

Pashko Vasa [BN - 98]

nem' t'ëmbelat ndiesi,
nëm dashurinë tënde t'dëlirë,
nëm ndjenjat pa kufi
të zemrës sate aq të mirë;

Pashko Vasa [BN - 99]

Mëshirë o Zot, mos ki për mua
Në s'jam i ndershëm të rroj nuk dua.

Pano Taçi [BN - 100]

"Pranoje këtë flijim, o Zot,
Dëshmi e përbetimit që të dashuroj,
Ndihamoi gjallesës Tënde sot
Që emrin do ta madhëroj!"

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 101]

"Si shpërblim, Të lus o i Hirt',
O Ati ynë plot mirësi
Të më japësh vetëm atë shpirt
Atë shpirt që – veçse Ti e di".

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 102]

E gjeta dritën
atje ku terri më thoshte vdis
dhe nisa të shkruaj vargun e parë
në mure të qelisë.

Kujtim Murati [BN - 103]

Mos i largo nga unë sytë e dliirë
Më mbaj mua të zinë në tënden dorë
Se shumë e dëshiroj jetën e mirë
Dhe gjithë këngët e mia t'i bëj kurorë.

Zef Serembe [BN - 104]

Shëromi plagët që kam këtu në gji
Në shpirtin tim vendos ti qetësi,
Bëj që mbretëria e dashurisë të kthehet
Dhe çdo mëkatar si unë të prehet.
M'i pastro lotët në qerpikë tani,
Kthema zambakun që quhet pafajësi.

Zef Serembe [BN - 105]

Degjomë, Zot, në halle
Mos më lër Ti më, as në stuhi,
Ma dhuro paqen, të lartin mal,
Tani që brenga ma treti at rini.

Zef Serembe [BN - 106]

Të lus, o Lajmës qielluar!
O Frym' e Zotit, Vetë Zot!
Me hirin t'ënd të pashteruar
Që ka mburim përjetësije,
Hirplot, o Shpirt, nër gaze Ti-je.
Dhe nër mjerime je hirplot!

Lasgush Poradeci [BN - 107]

Më merr në krahët e tua
Si merr fëmijët nëna,
Që ballin të ma puthë
Edhe dielli, edhe hëna.

Të lutem, o perëndi,
për një simfoni
me tinguj t'argjendhtë
e akorde t'artë.

Migjeni [BN - 108]

**Lutja e nënës**

“Perëndi, lemë të gjallë,-
Të mund të rrit këtë djalë,
S’ka një javë që ka lerë.
Kush do ta marrë ta rrijë?
Jetimi që do të rrojë?
Kush do t’i apë të pijë?
Si unë kush do ta dojë?

Çajupi [BN - 109]

Zoti im, e s’ka më tjetër
Më largo nga çdo gënjeshtër,
Mos më bëj mbret me thesar,
As të varfër gjynahqar.

Arben Duka [BN - 114]

Po, po; Ti sod, o gurra e dashtnis shejte,
Lshoj fashë zemrat e njerzvet,
Vllaznoj popuj e mbreten,
E ban qi paqa vrik t’na ngushllojë jeten;

Gjergj Fishta [BN - 110]

Pse bota mbarë, atëherë, kah len e kah merr
dielli
ka me t’lavdue me t’ambla jone t’reja,
E ma e kerthnesët ka me lulzue prap Feja.

Gjergj Fishta [BN - 111]

Lusim, Atë, një fat më të mirë,
Na i shkri ëndrrat ngurosur në erë,
Kjo dritë që digjet është gjaku yt,
Dashuria, fryma Jote eterne ...

Timo Flloko [BN - 112]

Lem, pra lem se, deomos,
sot a nesër un’ do sos,
dhe do bëhem fije bari,
ose plis i një ugari,
ose fletë e një hardhie
do më ndukë një dhëmb dhie!

Ali Asllani [BN - 113]



Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qoft' i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar!

Naim Frashëri [BN - 115]



Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qoft' i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar!

Naim Frashëri [BN - 116]

Ti i dhe nder mirësisë,
dhe zëmërs' së mallëngjyer
në vajt e në mes të zisë
ngushëllim' i ke rrëfyer!

Naim Frashëri [BN - 117]

Zot, o Zot
Që më përkunde
Në ujëvara drite,
Kur më hodhe
Me një dorë
Me tjetrën më prite.

Arben Duka [BN - 118]

Rruga ime,
Thikë e pjerrët
S'shoh asgjë me sy
Ti në shtegun më të errët
Më ndez një qiri.

Arben Duka [BN - 119]

Zot, o Zot
Të dua unë
Përmbi çdo njeri
Se pa ty
Nuk do të kisha
Asnjë dashuri.

Arben Duka [BN - 120]

Dhe sa herë hapja sytë përsëri
Çdo çast gjithnjë ma shihje, Perëndi,
Ma njihje mendjen, të zjarrtën dëshirë
Që tek Ti seç e drejtonte zemra e dliërë
Dhe në dritën e qetë të mikes hënë
Me pëshpëritjen e flladit këngën plot trishtim
Që bilbili këndonte plot vajtim.
Me lot ta shprehja dhimbjen e pathënë.

Zef Serembe [BN - 121]

E nëse, Ti, Perëndi, na hedh vështrimin,
Zemra jonë shndërrohet në parajsë
Largohen njollat, del prapë shkëlqimi
Dhe me gas gjen njeriu lirinë e parë.

Zef Serembe [BN - 122]

Po, shpresa e ambël je për ne
Pse zemra e jote asht fort e mirë,
Sjelli syet t'ne e mos harro ket dhe
E të keshë edhe për ne mallë e dishirë.

Shkodër [BN - 123]

S'je vallë ti Pafundësia? S'lëviz vallë
me vullnetin tënd çdo qenie në gjithësi?
Prej Teje s'vjen çdo dhimbje? A s'ringjall
në gjokset tona gazin prapë ti?
E fjala jote paqe s'i premtan
atij që drejt teje sytë i ngre në mjerim?
Apo, o Zot, kërkon
në dëshpërim të shuhet
shkëndija jote që dergjet në mërgim?

Zef Serembe [BN - 124]

Ti mbret i Qiellit! Zot, Perëndi!
Ty të rrethojnë yjet e kupa e qiellit.
Rrezaton botë drite prej nga del
jetë e re që në gjithësi përhapet.

Zef Serembe [BN - 125]

Dritë e amshuar! Dije! Dashuri!
Nga zëri yt i fshehtë rrahin flatrat
Dhe luftohet e lind në mënyrë të paedukuar
Rendi më i bukur e kënga më e lumtur.

Zef Serembe [BN - 126]

I plotfuqishëm je ... E unë që rrethuar
nga brenga plot jetë e kam kaluar

fuqinë e mbretërisë sate ndjej
Porsi dyllë i shkrin Ti ata qiej.

Zef Serembe [BN - 127]

Qënia buron nga Ti e Ti s'do të vdesë,
prandaj i jep dashurinë e zemrën.

Zef Serembe [BN - 128]

Manë qiellore mbi njerëzoren brengë
Pa shih, Zot, të harmonishëmin
mendim që ndriti përmbi djepin tim
dhe unë me art të ri e zemër të re
të vizatoj ëndërroja çdo drithërim
që njeriu thellë fsheh
dhe këngët t'ia kushtoj
atij që vdekjen mposhti.

Zef Serembe [BN - 129]

Sa herë në heshtje, në të natës errësi,
ndërsa në qiellin lart yjet shkëlqenin
mendimi e zemra në gji
drejt shëmbëlltyrës sate fluturonin
n'ekstazë! Vërtitëshin gremina bukurie
Vepra të reja në dritë dliresie
lindnin dhe ndihej në pafundësi
si e humbiste buçimën çdo stuhi.

Zef Serembe [BN - 130]

Dhe sa herë hapja sytë përsëri
çdo çast gjithnjë ma shihje, o Perëndi,
ma njihje mendjen, të zjarrtën dëshirë
që tek ti seç drejtonte zemra e dliresie
dhe në dritën e qetë të mikes hënë
me pëshpëritjen e fladit, këngën plot trishtim
që bilbili këndonte plot vajtim
me lot te shprehja dhimbjen e përhirë.

Zef Serembe [BN - 131]



LUTJA E BUJARIT SHQIPTAR

Me zemrë shumë të qetë
lith duartë në kraharuar,
pa thotë: “Zot i vërtetë!
emri yt qoft’i lëvduar!”

(Naim Frashëri - BN - 761)

Gjatë lujtes kthehemi me fytyrë nga varri i Naim Frashërit në Tiranë, sytë i mbajmë nga qielli, me duar të kryqëzuara në gjoks dhe duke thënë “Zot i vërtetë, emri yt qoft’i lëvduar”.

Simbolika është ndërthurje e simboleve:

- Kthimi nga varri i Naim Frashërit nderon profetin e shqiptarëve.

- Fytyra nga qielli nderon Zotin.

- Duart kryqëzuar në formën e një shqiponje me dy kokë mbi zemër tregojnë shpirtin vetjak dhe kombëtaren.

- lutja ““Zot i vërtetë, emri yt qoft’i lëvduar”” është e profetit Naim Frashërit.

Për një BUJAR SHQIPTAR, praktikant i BESËS lutja është e detyrueshme të bëhet në ditët e agjërimit, në ditët e adhurimit që vijnë një ditë pas tyre, si edhe çdo ditë të mërkurë dhe të dielë, si edhe në ditët e përcaktuara familjarisht një herë në javë, tre herë në ditë, mëngjes, drekë dhe darkë, me zë të ulët ose pa zë, e para prej të cilave është lutja e mëposhtme e NAIM FRASHËRIT:

*Zot’ i math e i vërtetë!
emri yt qoft’i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Falna, Zot, i math ne njerëzinë,
Edhe të mirat’ e dashurinë,
Vëllazërinë, zemrën’ e qëruar,
Mëndjenë pa faj, shpirt të uruar,
Bëna të drejtë në këtë jetë,
T’urt’e të mirë dhe të vërtetë.*

(Naim Frashëri)

Lutja e dytë është për atdheun.

*Zot’ i math e i vërtetë!
emri yt qoft’i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithëmon’armiqtë e tij!
Gaz përjetë paçin zotërit e tij!*

(Naim Frashëri)

Lutja e tretë është personale dhe zgjidhet nga libri “BESA” ose formulohet sipas personit, por gjithnjë fillon me vargjet:

*Zot’ i math e i vërtetë!
emri yt qoft’i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar*

(Naim Frashëri)



O Zot, o Zot, përse,
nga lart çdo gjë duket njëlloj,
por kur zbret poshtë atje,
njerëzit ndryshe jetojnë.
Të lutem, ndihmoi, o Zot,
i solle të barabartë në këtë botë.

Alqi Boshnjaku [BN - 132]



Ah! o moj ti vdekij' e shkretë,
 ç'le një hidhërim për jetë!
 Njeriu me kaqë shpresë,
 qysh të bjerë e të vdesë?
 vallë si bëhetë fundi?
 kemi t'jatrë vënt gjëkund?
 a këtu kthehemi prapë?
 përgjigje kush munt të m'apë?

Naim Frashëri [BN - 133]

O til! që bëre njerinë,
 ç'e mundove ditë-zinë,
 pa s'i dhe gjë besa besë!
 veç një durim e një shpresë,
 nuk' e marr vesh si kove,
 e të gjorit j'a ngarkove!
 t'ja epnje drurit, e thantel!
 gur' e drasënë e çantel!

Naim Frashëri [BN - 134]

Po fuqi e gjë e shkretë
 çdo punë e muntkan në jetë
 dh'e drejta edh'e vërteta
 mbetkanë fare të shkreta,
 paska fuqi djallëzia,
 sa s'e muntka urtësija,
 të gjithë nuk e durojmë.

Naim Frashëri [BN - 135]

Si i kroit ujët shkojnë pa pushim
 Asnjë gjë nuk rron përjetë, ah, ç'mjerim!

Naim Frashëri [BN - 136]

I pikëlluari: Çdo përpjekje, çdo rropatje, është e
 kotë, Lum ai që s'e pa fare këtë botë!

Naim Frashëri [BN - 137]

Të mjerët ne! ahtet tona
 i ka ndrydhur fatkeqësia!
 T'mjerët ne! se neve shpirtin
 na e spastron rrept dhimsuria!

Pashko Vasa [BN - 138]

Lëviz, o Zot, kah unë ktheji sytë,
 se mirë e njoh un' zemrën tënde t'butë;
 pa mjete jam, jetoj i rrezikuar,
 e ti ma jep një ndihmë n'kët'trishtim.

Zef Serembe [BN - 139]

Pa asnjë gëzim, asnjë hov të dliirë,
 Jeta për tmerr tani po më thahet.
 Mos më braktis, pra, Ti, o Perëndi
 Në këtë botë të trishtuar pa lumturi.

Zef Serembe [BN - 140]

Ndihmomë, o Zot, sepse më kanë mbështjellë
 e po më çojnë në fund mjerimet,
 një dhimbje e egër dhe e thellë
 po ma tret lulen e rinisë sime
 dhe pres, shpresoj e kurrë s'lind agimi
 i faljes sate, i mëshirimit
 mbi këtë zemër të brengosur
 që lëngon e vuan në dhimbjen e pasosur.

Zef Serembe [BN - 141]

Çdo gjë u zhduk! Mandej Oqeanin
 përshkova i shtyrë nga mendimi i zi.
 Dhe ty t'u luta, Zot, po ti
 rënkimet tim larg i ndjeftë.

Zef Serembe [BN - 142]

Më le dhe rashë si guri i kotë në dhe.

Zef Serembe [BN - 143]



Bashkë me rrugën mua m'u zhduk çdo shpresë
dhe më rrethoi një natë pa agim
dhe kur m'u shqye kraharori
bota me qeshje e me tallje më mbuloi
Mbeta bashkë me hidhërimin
Të ëndërroj për kujtimin.

Zef Serembe [BN - 144]

Po Ti, o Perëndi, zgjohu e m'u afro,
më hidh një vështrim të dhëmbshur në këto
hidhërimë

Zef Serembe [BN - 145]

I ëmbël siç je Ti, kuptomë, nxito,
mos më gjyko se jam plot me gabime.

Zef Serembe [BN - 146]

Si bimë vetmitare në shkretëtirë,
si ujë përroi që nuk di të ndalet,
pa asnjë gëzim, asnjë hov të dliërë,
jeta për tmerr tani po më thahet.

Zef Serembe [BN - 147]

Mos më braktis, pra, Ti, o Perëndi
në këtë botë të trishtuar pa lumturi.

Zef Serembe [BN - 148]

Shëromi plagët që kam këtu në gji,
në shpirtin tim vendos Ti qetësi,
bëj që mbretëria e dashurisë të kthehet
dhe çdo mëkatar si unë të prehet.

Zef Serembe [BN - 149]

M'i pastro lotët në qerpikë tani,
kthema zambakun që quhet pafajësi.

Zef Serembe [BN - 150]

Sa errësi s'zhduk Dielli vallë,
kur ndriçon botën e detin e ndes flakë,
përtërihet gazi e dëgjon vallet
dhe bukuria në plotësi seç shfaqet.

Zef Serembe [BN - 151]

E nëse Ti, Perëndi, ma hedh vështrimin
zemra jonë shndërrohet në parajsë
largohen njollat, del prapë shkëlqimi
dhe me gaz gjen njeru lirinë e parë.

Zef Serembe [BN - 152]

Eja, pra, Zot, eja; në halle
mos më lërë Ti më, as në stuhi,
ma dhuro paqen e të senjtit mal,
tani që brenga ma treti at'rini.

Zef Serembe [BN - 153]

Në hijen e qeparizit natë për natë
këtë fat njerëzor do të vajtoj
dhe Ty, o Zot, uratën
mbi krahë dashurie do lartësoj.

Zef Serembe [BN - 154]

Dhe kur t'jem lodhur nga rruga e ulliri
hijen e vet të këndshme do më falë,
i mbushur plot me atë shkëlqim të artë
që kur kthehet sjell prilli
një këngë të re do Thur

Zef Serembe [BN - 155]

dhe do thuhet: Lavdi Emrit plot nur
Emrit të shenjtë të shpresës e ngushëllimit.

Zef Serembe [BN - 156]

Po më shkallmojnë, o Hyj,
flijime të njëpasnjëshme!

Agron Tufa [BN - 157]



Si m'u bë e zhbë rinia?
Haj e zeza jetë, haj.
Rri e qesh burgjet e mia
se nuk di të qaj.

Pano Taçi [BN - 158]

Më përbuzi dashuria,
haj e zeza jetë, haj.
Rri e qesh ndjenjat e mia
se nuk di të qaj.

Pano Taçi [BN - 159]

Se ç'heq, s'm'i mban pleqërija,
haj e zeza jetë, haj.
Rri e qesh brengat e mia
se nuk di të qaj.

Pano Taçi [BN - 160]

Më harroj dhe Perëndia,
haj e zeza jetë, haj.
Rri e qesh lutjet e mia
se nuk di të qaj.

Pano Taçi [BN - 161]

Bir, mos u mërzit
Ky është një privilegj i ëmbël,
Ti këtu do të gjesh njerinë.
Ja, që fati na caktoi pikërisht ne
të gatujmë me gjakun tonë lirinë.

Kujtim Murati [BN - 162]

Tufanët pastaj, na hodhën tutje.
Ne trokitëm ndër shtëpitë e zotit.
Shpresëhumbur thurëm nga një lutje.
Ndhimë i kërkuam, më të fortit...
Mbase Zoti do t'na dojë më shumë
Meqë... s'na ndihmoi që në fillim
Ne që nuk i derdhëm lotët lumë...
Por sakrifikuam gjithë rininë.

Mimoza Ahmeti [BN - 163]

Pse sytë e Nënës janë mbuluar.
Me lot?
Po ti pse vallë na ke harruar,
O Zot?..

Arben Duka [BN - 164]

Pse toka ime e bekuar,
Nuk çel?...
Pse dielli rri kaq i menduar,
Kur del?...

Arben Duka [BN - 165]

Në vend të këgëve veç krisma,
Dëgjo!...
Vajza të reja me vello zie..
Shikoj...
Fëmijë të vegjël rrinë të menduar,
Si pleq...
Po kush na ka ngatërruar,
Kaq keq?..

Arben Duka [BN - 166]

Zotin nga gjumi dua ta zgjoj,
Të hapi sytë, të na vështrojë.

Arben Duka [BN - 167]

Dua t'i lutem me përgjërëm,
Të na çlirojë nga ky mallkim.

Arben Duka [BN - 168]

Të mbjellim lulet e mirësisë,
Të ndezim zjarrin e dashurisë.

Arben Duka [BN - 169]

Si trëndafil të çeli jeta,
Nga mirësia dhe e vërteta.

Arben Duka [BN - 170]

Hedhim shikimin mbi detin blu,
një zë ndiejmë që na bekon,
atdheu është me ne këtu,
bashkë me ne po udhëton.

Alqi Boshnjaku [BN - 171]

O Zot, o Zot, përse,
nga lart çdo gjë duket njëlloj,
por kur zbret poshtë atje,
njerëzit ndryshe jetojnë.
Të lutem, ndihmoi, o Zot,
i solle të barabartë në këtë botë.

Alqi Boshnjaku [BN - 172]

Brigjet i puth i njëjti det,
retë dhurojnë të njëjtin shi,
tokën e ngroh i njëjti diell,
të njëjtin qiell kanë çati.

Alqi Boshnjaku [BN - 173]

Duam një zot që do të mund të na kap' e të na
tund,
të na tund e të na shkund, vëllavrasjes t'i jap
fund.

Ali Asllani [BN - 179]

O Zot, kujt t'i qahem?
Kush zemrën ma qetëson,
askush veç Teje
brengën nuk ma shëron.

Alqi Boshnjaku [BN - 174]

Perëndi, o perëndi, vi përpara zotris' sate,
duke pasur përmbi supe një vandak të rënd'
mëkate,

Ali Asllani [BN - 180]

Po shpresa ime nuk humb,
Se do të ketë një gjyq në fund,
Paskëtaj do hapen retë,
E mira shpallet si mbret.

Arben Duka [BN - 175]

po mëshira hyjnore është e thell' e është e gjërë
më e thellë nga gjith' mëkatet që ka vendi yn' i
tërë.

Ali Asllani [BN - 181]

E pra, ti, o perëndi, pse na le në dorë të djallit,
që na shtypi, na përtypi nëpër nofulla të
çakallit?

Ali Asllani [BN - 176]

Po më fal për këto fjal',
që guxova e i thashë, i rrëmbyer e i trembur,
mbasi gjuha më rreh dhëmbin, atë dhëmb që më
ka dhëmbur.

Ali Asllani [BN - 182]

Po tani u bë ç'u bë, ti, o zot i këtij dheu,
s'mund të bësh asgjë, t'i thuash kohës: prapa
kthehu!

Ali Asllani [BN - 177]

Vendi ynë që ka jetuar herë me pushkë e her me
shat,
s'mund të lihet tash e tutje si një flet' në dëgë të
that',

Ali Asllani [BN - 183]

edhe rri e bën sehir, bën sikur asgjë nuk di,
pra dhe neve jemi kundra, duam një tjetër
perëndi!

Ali Asllani [BN - 178]

ai lipset që të rrojë, qoft' me hir' e qoft' pa hirë,
dhe aty ku bie zjarri, bëhet lulja më e mirë.

Ali Asllani [BN - 184]



Të lindet një njeri
nga gjin' i dheut tonë të rim me lot të vakët,
nga thalb' i shpirtit tonë që shkrihet në dëshirë të flakët
për një gen të ri.

Të lindet një njeri!
Pa hyll në ball, por që me fjalë të pushton,
që të rrëmben qetsin e ban gjakun të të vlojë
rrkajë, e ban synin ligshin të zgjetojë,
që nëpër shekuj ndërgjegjen na tradhton.

Të dali një njeri!
Të mkambi një Kohë të Re!
Të krijojë një Epope!
Ndër lahuta tona të këndohet Jeta e Re ...

Migjeni [BN - 185]



Të gjithë kombet po dehen n'epopea të veta,
flakë e zjarrmit të tyne na i përzhiti ftyrat
dhe nëpër to një nga një po shtohen rrudhat,
e nën këmbë e mbi krye tinzë po na ikën jeta.

(Liri! – Po, liri dhe gaforrja gëzon,
por gaforre asht...
Liri, ku plogsi ndërgjegje gjallon,
jo, liri nuk asht!)

Të lindet një njeri
i madh si madhni
dhe ndërgjegjet tona t'i ndezi në dashni
për një ide të re, ideal bujar,
për një agim të lum e të drejtë kombtar.

Migjeni [BN - 186]



FJALËT E QIRIRIT

Në mest tuaj kam qëndruar,
E jam duke përvëlur,
Që t'u ap pakëzë dritë
Natën t'ua bënj ditë.

Naim Frashëri [BN - 187]

Do të tretem, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem,
Që t'u ndrinq mir' e të shihni,
Njëri-tjatrin të njihni.

Naim Frashëri [BN - 188]

Për ju do të rri të tretem,
Asnjë çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot,

Naim Frashëri [BN - 189]

Unë zjarrit nuk i ndruehem,
Dhe kurrë s'dua të shuhem,
Po të digjem me dëshirë,
Sa të munt t'ju ndrinq më mirë.

Naim Frashëri [BN - 190]

Kur më shihni që jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur,
Jam i gjall' e jam ndë jetë
Jam në dritë të vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 191]

Unë jam në shpirtit tuaj,
Mos më kini për të huaj.
M'është falurë durimi,
Andaj po digjem si trimi,

Naim Frashëri [BN - 192]

Se ma kënda t'u bënj mirë,
Të mos mbeti n'errësirë.

Naim Frashëri [BN - 193]

Jakëni rreth meje rrini.
Flisni, qeshni, hani, pini.

Naim Frashëri [BN - 194]

Në shpirtit kam dashurinë,
Po digjem për njerëzinë,

Naim Frashëri [BN - 195]

Lemëni të përvëlohem,
Nukë dua më të ftohem.

Naim Frashëri [BN - 196]

Dua ta djek trupn e shkretë
Për atë Zotn' e vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 197]

Me zjarr ta djek mushkërinë,
E të tretem për njerinë.

Naim Frashëri [BN - 198]

Bashkë me gëzimt të tija,
të vete te Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 199]

Unë dua njerëzinë,
Mirësin' e urtësinë.

Naim Frashëri [BN - 200]

Në bëni shokë me mua,
Në më doni si u dua,
Njëri – tjatrinë në doni,
Të paudhë mos punoni.

Naim Frashëri [BN - 201]

O zemëra fluturake,
Qasju pakë kësaj flake,
Mbase krahët t'i përvëlon,
Po dhe shpirtin ta shenjtëron.

Naim Frashëri [BN - 202]



Unë duke përvëlur,
Njerëzit i kam ndrituar.

Naim Frashëri [BN - 203]

Dua shumë fjalë t'u them,
Po trembem mos i bënj ujem.

Naim Frashëri [BN - 212]

Kam qenë mik me njerinë,
Andaj i di e më dinë:

Naim Frashëri [BN - 204]

E ku shkruhenë në kartë
Fjalët e gjuhës së Zjartë?

Naim Frashëri [BN - 213]

Gjithë tuajt i kam parë,
Mëm' e at' e fis' e farë,
Si tani gjith' i kam ndër mënt,
Që rrinë më këtë vent.

Naim Frashëri [BN - 205]

LUTJA PËR FËMIJËT

Lerini gjithë të vinë
Të vegjëlthitë ndaj meje
Se edhe vetë Perëndinë
Ndër ata donja ta gjeje,

Naim Frashëri [BN - 214]

Edhe sot nër ju ata shoh,
Se shpirtin e tyre ua njoh,
Dhe unë si ju kam ndruar,
E jam përzjer' e ndryshuar.

Naim Frashëri [BN - 206]

Janë ëngjëj të vërtetë,
Xbriturë nga Perëndija,
Posi luletë në jetë,
Q'u ngjajnë nga miturija,

Naim Frashëri [BN - 215]

Pa jam bërë shumë herë
Zjar e uj' e balt' e erë.

Naim Frashëri [BN - 207]

Jam një shkëndijë prej qielli,
Dhe një drudhëzë pej dielli.

Naim Frashëri [BN - 208]

Ah! mos i bëni të qajnë,
Kurrë të mos mallëngjehen,
Syt' unjur të mos i mbajnë,
Dhe të meken' e të ndehen;

Naim Frashëri [BN - 216]

Edhe ndër qiej fluturonj,
Edhe brenda në dhet qëndronj,

Naim Frashëri [BN - 209]

Po të qeshin të nxitojnë,
Të bredhin' e të gëzohen,
Të prëhen' e të këndojnë,
E kurrë të mos mejtohen,

Naim Frashëri [BN - 217]

Shumë herë fle në baltë,
Diku ndodhem dhe ne mjaltë;

Naim Frashëri [BN - 210]

Më vjen keq t'u mardhnjë dora,
E faqeza bukuroshe,
Kur bij' e shkreta dëbora,
Dhe këmbëza vogëloshë.

Naim Frashëri [BN - 218]

Bëhem qënq e kec i pirë,
Lul' e bar e gjeth i mbirë.

Naim Frashëri [BN - 211]



O foshnjazët' e uruar!
U kam mall' e dashurinë,
Më k'ënda t'u mbanj nër duar,
U dua si Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 219]

Zot'i math e i vërtetë!
N'atë sy kurrë mos shtjerë
Lotn' e hidhur e të shkretë,
Dhe mos e lërë të bjerë,

Naim Frashëri [BN - 220]

Po falu në buzët gazë,
Dhe në sythit bukurinë,
E rriti cazë-nga-cazë,
Duke dhënë urtësinë;

Naim Frashëri [BN - 221]

Epu jetëzën' e gjatë,
Edhe mos i lerë kurrë
Pa mëmëzë e pa atë,
Dhe në breng e të sëmurë,

Naim Frashëri [BN - 222]

S'munt t'i shoh të mallëngjyer,
A të varfër' e të mjerë!
Dhe të grisur' e të çqyer!
Kurrë, kurrë mos i lerë!

Naim Frashëri [BN - 223]

Falu gjithë mirësitë,
Të rrojnë me nder në jetë,
Të mësojnë dituritë,
Të bëhenë të vërtetë;

Naim Frashëri [BN - 224]

Të nderojnë mëmëdhenë,
Vjeftënë t'ia lartësojnë,
Mbi gjithë botët t'a ngrenë,
Si lule t'a zbukurojnë.

Naim Frashëri [BN - 225]

Edhe pse një hi si ti në dukje jam,
Një të madhe flakë, moj, në zemër kam.

Naim Frashëri [BN - 226]

Larg nga bota më gremisi, ah, kjo Rrotë,
Që të tretëm në mundime e në lotë,
Që një mall të ri të kem mbi mallin e vjetër
Pranë ndarjes të shijoj një ndarje tjetër.

Naim Frashëri [BN - 227]

Gjersa të vini'e të bjerë
Pik' e shpirtit tim si lumi
Në det të math e të gjerë;
Zëmrën time s'e zë gjumi.

Naim Frashëri [BN - 228]

Më dërgoi dhe tek ti Zoti,
Që të t'ap jetëz' e ditë,
Të të bije shpirt e dritë,
E të bëhesh si qëmoti.

Naim Frashëri [BN - 229]

Më s'më gjen këtu në botë,
po më kërkoi nd'atë jetë,
pranë Zotit të vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 230]

Urdhëro, Zot'i vërtetë!
e më dërgo tatëpjetë
ëngjëllinë krahzjartë,
fjalë-ëmb! e këmbëartë.

Ti me gojë të time fole,

Naim Frashëri [BN - 231]

Pranë Bundës, Moisiut,
Në atë bir'it Perëndisë,
Pranë Muhamet – Aliut,
Lëçin shpirt i Zotnisë!

Dushi Jorgobaba [BN - 232]

Në gji të çdo mëmëdhetari
të mund t'a përtëritte mallë
Dhe një të tërë varg dëshirash
Q'i thurri mendja jote-e rrallë,-

Lasgush Poradeci [BN - 238]

Ku psherëtin dëshir' e djugur,
Në shesh të kuq të Qerbelasë,
Mes trimërish shtërgjyshërishte
Të shoh tek po m'i bje xhurasë.

Lasgush Poradeci [BN - 233]

Me ç'zë të pastër lavdurimi
Do kish bekuar varfëritë!
Vaj' e një çasi-i këngës s'ate
Përjetësisht do dil në dritë!

Lasgush Poradeci [BN - 239]

E me të lum, me të përmallshmë
Të sjell në dritën e mejtimit
Ndaj fërfëllon si yll me flakë
Prej shkretëtirës së harimit:

Lasgush Poradeci [BN - 234]

Po t'u pat thënë short' e verbër
Të përvëlohesh nër padije:
Me mijë rreze shkrepëtimi
Mezi të ndritish po një fije ...

Lasgush Poradeci [BN - 240]

Qëndroj në tmerr zili' e botës
Se më s'u lodhe dyke ndritur,
Se më s'të treti prush'i vojtjes
Në kraharorin e zhuritur.

Lasgush Poradeci [BN - 235]

Dh'aher' i dehur prej durimit,
Në mall të math të këngës s'ate,
Kaq zilitar këpute zemre
Ç'më të paçmuarshmë ti pate.

Lasgush Poradeci [BN - 241]

Po ti me vrap të piraustit
Që fluturon në zjarr e flakë,
Therorësin' e vetëvetes
E pate dhimbjen më të pakë ...

Lasgush Poradeci [BN - 236]

Dh'u ngrite për në të vërtetën
Me fluturim të artit mjeshtër:
U drodh alltari jon' i lashtë
Sapo t'a ndjeu të shentën eshtër ...

Lasgush Poradeci [BN - 242]

O, sikur këng' e zemrës s'ate
Që ligjëroj aq më të kotë,
Që veç me fjalë dhembshurije
U pat dëgjuar përmbi botë,

Lasgush Poradeci [BN - 237]

Se ngashërim' e vjershës s'ate
Ish mall i fellë-e pa të ngjarë,
Posi një krua pastërsije
Këndimi yt nër ne pat rarë;

Lasgush Poradeci [BN - 243]



U pat tërhedhur shpirt' i kombit
N'atë vajtim aq të lënduar
Q'e thurri gjuha jote-e-zjarrtë,
Dhe balli yt i frymëzuar;

Lasgush Poradeci [BN - 245]

Se bukuritë-e vetes s'onë
Mendimi yt desh të na falë,
O! Fjal' e pikave qiriri,
E pika lotëvet o Fjalël!

Lasgush Poradeci [BN - 246]

Q'ahere dyke shpënë sytë
Nga Toskëri' e Gegërija,
Shpesh e më shpesh patm'ëndërruar
Si ndrin në famë Shqipëria.

Lasgush Poradeci [BN - 247]

Mes ligësish armiqërishte
Stolismë lulen e vullnetit ...
Sbuluam gur margaritari
Prej fundit thëthimtar të detit ...

Lasgush Poradeci [BN - 248]

E m'i çkëlqyer sesa djelli,
M'i lum se kohët që më s'janë
Filloi për ne ndryshim i motit
Me një të pritme të pa anë:

Lasgush Poradeci [BN - 249]

Ti! Fjalëtor i mallëngjyer!
Ti! Këng' e rritur ndaj selvisë!
Ti! O rapsod i lashtë i kombit,
Ti pate pjes-urgjin' e zisë!

Lasgush Poradeci [BN - 250]

A! po n'u trete prej mendimesh
Me tëmbra t'ulura nër duar:
Në ç'qjell të larg pat gjetur prehje
Kjo zemra jote- e përvëluar?

Lasgush Poradeci [BN - 251]

Nga fluturoi bilbil finoshi
Q'e fryri era posi fletë?
Ku vanë pendët e pëllumbit
Q'e shtiu në dhet mërgim' i shkretë?

Lasgush Poradeci [BN - 252]

Sikur të shoh, i tmerrshmë Frashër,
Tek po mban zi përgjithmonë,
Ti: më besniku trashëgonjës
I dashuris' së vendit t'onë.

Lasgush Poradeci [BN - 253]

Na vdiqe, Drit, na le o Vlla,
T'met' nat ç't'man, i lum' aj dheu!
Punt' ç'i nise, s't'shkuen vra m'vra,
N'bot t'njifen, t'i njëf Atdheu.

Shtjefën Gjeçovi [BN - 254]

Emn'i Jot, s'ka m'u harrue,
Sa koh t'ndrrohet gjithësia
T'gjith Shqyptart kan me t'bekue,
Se për Ty, Shqypnis i erdh dia.

Shtjefën Gjeçovi [BN - 255]

E kur t'vin koha ç'p'e presim...
Vorr' i Jot ngrehet n'pomendtar
Kto fjal, ktij, n'ball do t'ja njesim:
"NAIM FRASH'RI A KTU SHQYPTARI!"

Shtjefën Gjeçovi [BN - 256]

U ndritët shpirti në qiell
Edhe qoftë për ne ndihmë
U bëfshi Hënë e Diell
E ndritofshi Shqipërinë.

Petro Nini Luarasi [BN - 257]

Si ty o Vidhehem, e Mek' e Arabisë
Që kini lerë Muhamet, e Krisht të krishterisë
Është për mua Frashëri, vent i Perëndisë
Atje ku lerë Naim beu, zembr' e Shqipërisë!

Mihal Grameno [BN - 258]

Ay ish ëngjell rënë mi dhe për të ndritur kombinë
Edhe ta nzjerrë në liman, si Moisiu me shkopnë
Vëllazëri e dashuri, t'u apë e kërkojnë
Nga gjumi Shqipërinë, ta xgjojnë e lirojnë.

Mihal Grameno [BN - 259]

Të qofshim falë atje ku je, o engjell' i pavdekur
Ty që eshtrat kurrë-kush, s'të janë për të tretur!
Gëzo ti zemrën e dëfre se farën që ke hedhur
U rrenjos mirë e lulëzoi, një pemë fort të çelur.

Mihal Grameno [BN - 260]

Mi gjitha anët nuku dëgjon, përveç se muziqinë
Duke kënduar emrin tënd, ashtu si Perëndinë!
Se ti, o ëngjëll tinë na le, të njohëm kombësinë
Edhe të vdesëm me gëzim, për mëmë Shqipërinë.

Mihal Grameno [BN - 261]

Të lutem, o Balt' e Varrit,
Mos i rëndo, lehtësohu,
Bëji nder shqiptarit,
Dimër verë, lulëzohu.

M.A.Përmeti [M.Vejsiu] [BN - 262]

Ju mbi të kurrë mos shkëlmi
Se keq i vjen njerëzisë,
Rreth e rrotull lule çelni
Atij Shënjtorit Shqipërisë.

M.A.Përmeti [M.Vejsiu] [BN - 263]

Nuk di, është fshehtësira që kalon me fat në
duar;
Është njoll' e zez' e qiellit që lë pas një yll i
shuar;
Heshit' e këngës që pat qarë me një harmoni
divine:
Po nër bijt e Mëmës s'ate-yll i ndritur yll! me
zjarr!-
Vetëtim e harmonishmë që pushove nënë varr!

Lasgush Poradeci [BN - 264]

... Të përmbysim vetëdijen kur na fton mburim i
jetës?!

... Të mendojmë kaqe errët mun në mes të së
vërtetës?!

... Ta mjerojmë kuvendimin me kaq helm e kaqe
prishmë

Kur fillon t'ja thotë shqipja me një hir të
perëndishmë?!

Lasgush Poradeci [BN - 265]

Sepse hir të perëndishmë kish kuvendi yt, Naim,
Ajo këng' e tepërlumtur që më s'pati shëmbëllim;
Se mendimi yt kish flakën e kuptimit të kulluar,
Goja jote vjershëtore kish një zë të pastërtuar;

Lasgush Poradeci [BN - 266]

Po ti dridh-u,o! komb i lashtë, me-atë zemërën e
gjërë,
E në gaz të drithmës sate le të tundet bot' e tërë!
Le të ndritet Shqipëria nën bregor-e nër fushore
Si buçet me zë të thjeshtë frym' e gojës



stërgjyshore;
Si flet shqip'e lumturuar e bekon me gjithë bekimin
Vjazërinë- e virgjërinë ... – zemërimin ...-
renegimit

Lasgush Poradeci [BN - 267]

Gjuha: shpirti i shenjt' i kombit, që kalon dyke
kënduar!

Gjuha: zjarr ku djeg me dritë një mendim i
frymëzuar!

Gjuha: afsh' i gjall' i jetës! shpat' e ndritur e
lirisë!

Gjuha: yll' i vjershërisë! Gjuha: Verb' i Perëndisë!

Lasgush Poradeci [BN - 268]

Se guxove të na thuash me kalem të zi në kartë
Mall' e Math që të pat djegur: Fjalët e Gjuhës së
Zjarhtë.

Lasgush Poradeci [BN - 269]

Atëherë o i shenjtë dolle si Orpheu

O Naim! E guxove

Me notën shqip shqipen këndove

dëshmitar të janë qielli e dheu

E Zoti q'e ndëgjoi lutjen q'i drejtove.

Isuf Luzaj [BN - 270]

Një endje gas e mall të ri mbolle
Në fytyrë të bukur në kraharor prej molle
dashurija në çifte këngës s'ate u dhurua
Nën emrin e femrës Shqipërija u këndua
e melodi e shtrënjt
e një fyelli të shenjt
Shekujt do t'a kenë kujtim
Shpirt gjerë i pavdekur shënjt, o Naim!

Isuf Luzaj [BN - 271]

Ti je Kisha, je Xhamija,
O bashkim për njerëzinë,
Je i ardhur nga Perëndija
Një Profet për Shqipërinë.

Mediha Frashëri [BN - 272]

Një rreth ëngjëjsh kordhëtarë,
Ty mbi krye lart të ngritnë
Ishin burra Shqipëtarë
Tok me Ty në Qiej u ngjitnë.

Mediha Frashëri [BN - 273]

Na ke lënë gjurmën tënde,
Fjala jote nuk vdes kurrë,
Të kujtojnë këto vende
Për Ty qajnë gur e drurë.

Mediha Frashëri [BN - 274]

O Naim! na bije dritë ... mall të madh e
ngashërim

O Naim! m'u përcëllove nga një zjarr pa
shëmbëllim

O Naim! të shkoi të ritë, atje ku është tjetër natë

O Naim! të vështroj pyllit, ndaj vë veshin mbi
xhuratë

Kur mbaroi ... një regëtimë, i tha Zotit

Po të vim'

Si Bilbil zemër- copëtuat ... si një Bir

si një NAIM!

Syrja Minarolli [BN - 275]

Pra në botë

Me të plotë

Do të falemi, O Naim!

Fmijve tonë

Dhe ma vonë

Do t'ia lamë kët' trashëgim!

Mustafa Greblleshi [BN - 276]

Të falemi, o Dritë, o Yll i Perëndisë!
Që me veprat tua, i dhe shije jetës;
Të falemi, Naim, o Birë i Shqipërisë!
Mësonjës' i lart' i shkollës së vërtetës.

F.Vokopola [BN - 277]

Shpirti Yt' shprehja e frymës shenjtëruar.

Të falemi, Naim, o Yll' i Shqipërisë,
Kujtimi Yt' qoftë amëshimi i jetës,
Të falemi, o Dritë, Dritë e Kombësisë,
Qofshë pranë Zotit, burim i së vërtetës.

F.Vokopola [BN - 278]

Larg këtij dheu frym' e fundit t'u shpërnda dhe
shkoj në Qiell

Ibrahim Hasnaji [BN - 279]

Por qetsohu pse' n'Shqipni përmbi t'gjitha fjal' e
jote.

Thellë ka hy në fund t'ç' do shpirti qi ka emnin e
Arbnorit,

Tue fillu n'kërthi t'njomë, me mbarue në gjoks
t'malsorit

Pa dyshim do t'na udhëheqi sa t'ketë rruzlli stin'
e mote!

Ibrahim Hasnaji [BN - 280]

Thonë është grisur dorë e Naimit,
që si dorë e rrezes gris një errësirë,
atje lart në qiell, porsi yll i ndrirë
të shoh kryelartë, o shpirti Naimit!

Dhimitër Mino [BN - 281]

Nuk ndez qiri në çast trishtimi,
Kur errësira më pushton,
Dhe them "gjersa jeton Naimi
Këtu qiriri i tij mjafton"...

Dritëro Agolli [BN - 282]

Bir i madh i kombit që s'u shemb
Nga rrebesh' i egër shekullor,
Ti me zjarr të ligjëritit tënd
Ndez flakë shpirtin arbënor.

Jorgo Bllaci [BN - 283]

Kënga jote kujt s'i zgjon dëshirën
T'i flijohet Mëmës Shqipëri?
Shpirti i kombit, zgjohu, rrëmbe lirën,
Përvëlona gjokset përsëri!

Jorgo Bllaci [BN - 284]

Të të bënin ty, donin,
Shqipëri memece,
Por ja, erdhi Naimi,
Si yll mbi ty ecte.

Ismail Kadare [BN - 285]

Dorën e zbehtë
Mbi ballë ta vuri,
Të të hiqte zjarrllëkun
Prej të sëmuri.

Ismail Kadare [BN - 286]

Pastaj, kur zbardh dita, e shoh përsëri:
as në dritën e diellit nuk zbehet, flakë e tij,
që digjet në përjetësi.

Bilal Xhaferri [BN - 287]

Digjeshe ti flakë e bardhë
tek i bëje ze pranverës,
kur Atdheu s'kish behar,
Ti na dhe "Lulet e Verës".

Qazim Sheme [BN - 288]

Etje, Etje, Kam etje,
Po ku, ku është burimi?
Dal jashtë, verbtas, kërkoi
Takoje Naimin.

Xhevahir Spahiu [BN - 289]



I dëgjoji djaloshi këngët,
fjalët e dheut të ndritur,
tok me qumështin e nënës
gjuhën shqipe pati thithur.
Ato fjalë që t'i tha zemra,
o bilbil, kumbojnë mes nesh;
qysh fëmijë, "Mbaj vesh!, tha nëna,
dhe babai më tha: "Mbaj vesh!"
Futi brenda kraharorit
thuaj, siç themi ne ngaherë
që kur lindim, gjersa vdesim:
"Ti, Shqipëri, më jep nder!..."

Xhevahir Spahiu [BN - 290]

Gjuh' e zogjve nëpër djepe,
zgjove kombin, dritë derdhe,
bilbil i vendeve të mia, bilbil-o,
more Naim Shqipëria.

Vlorë [BN - 291]

Shqipëri, o shkëmb i sertë,
ti bilbila i bën djemtë,
shekujt vin e vitet shkojnë,
Naim, djemtë ligjërojnë.

Vlorë [BN - 292]

Vallë dergjja jote-e fellë pat pushim e lumtëri?
A t'j'u çduk dobare gjumit e përjetëshmeja zî?
N'atë varr ku për së fundi mort' i keq të zu në
rrasë,
Të çkëlqeu pakmos së largu fush'e ndriçim' e
Qerbelasë?
Të këndoje me këngë malli Drini plak e i kulluar?
Zot, o! Zot, të qofshim falë që Naimi pat
pushuar!

Lasgush Poradeci [BN - 293]

Vdiq Naimi, vdiq Naimi,
moj e mjera Shqipëri!
Mendje larti zemërtrimi
vjershëtori si ai!

Çajupi [BN - 294]

Vdiq Naimi, po vajtoni
Shqipëtarë, Shqipëtarë!
Naimnë kur ta kujtoni,
mos pushoni duke qarë!

Çajupi [BN - 295]

Vdiq Naimi, Naim Beu,
vate te zot i vërtetë!
Qysh u nda nga mëmëdheu
dhe iku e la për jetë?

Çajupi [BN - 296]

Vdiq Naimi, gjithë thonë,
qani turq, qani kaurë!
bilbil i gjuhës tonë
s' do të dëgjohej më kurrë!

Çajupi [BN - 297]

Vdiq Naimi, që këndoi
trimërinë, Skënderbenë;
vdiq Naimi, që lëndoi
dhe nderoi mëmëdhenë!

Çajupi [BN - 298]

Vdiq Naimi, po ç'të gjeti,
o moj Shqipëri e mjerë!
Vdiq Naimi, po kush mbeti?
Si Naimi s'ka të tjerë.

Çajupi [BN - 299]

Vdiq Naimi, vdekje e shkretë,
pse more të tillë burrë?
I ndritë shpirti për jetë
mos i vdektë nami kurrë!

Çajupi [BN - 300]

"Naimi preu shkurret, shkuli ferrat,
Pastaj qilizmë truallin punoi;
Fidanët mbollën me durim të tjerët
Dhe vreshti i bukur shpatin gjelbëroi.
Kur vajta unë atje, - ma tha Lasgushi,
Një mbrëmje buzë gjolit tek shëtisim, -

Hardhitë kishin lidhur vile rrushi,
 Por, kemi etje! dukej sikur flisnin.
 Ahere ç'bëra? Nëpër shkëmb të malit,
 Një brazdë hapa deri tek burimet
 Dhe më së fundi, ujrata si kristali
 U derdhën nëpër të me mërmërimë."
 Si tha këto, mbështeti të dy duart
 Përmbi bastun, dhe shtoi si nëpër lotë:
 "E keni radhën ju për ta punuar
 Këtë të bukur vresht, pa shok në botë,
 Ta rritni të shëndetshëm, ta selitni,
 Ta doni si thesarin më me vlerë;
 Dhe neve, që aty e lamë shpirtin,
 Na sillni nëpër mend ngandonjëherë! ..."

Jorgo Bllaci [BN - 301]

Hënë e diell edhe qiell
 Naim Frashërin a e njihni?
 Për liri ai përpiqesh,
 për lirin' e Shqipërisë.
 Të lutem, o baltë e varrit,
 mos iu rënd e lehtësoju,
 bëni nderin shqipëtarit,
 dimër, verë lulëzoju.
 Dhe ju shi, dëbor' e erë,
 kini mendjen kur zemrohi,
 varrin e atij të mjeri
 shqipëtarit, mos ngarkoni,
 Ju mbi të kurrë mos shkëlqeni,
 se keq i vjen njerëzisë,
 rreth e rrotull lule çeli,
 Ati i shenjt' i Shqipërisë.
 Dallëndyshet kudo shkojnë,
 prej qyteti ku kalojnë,
 vjershat shqipe që ka thënë,
 të dëgjojë dhe të zgjohet.
 Ditën e Shëngjergjit, më njëzet e tri,
 se ç'u doq dhe Frashëri,
 Digjeni të shkretin dhe e bëni hi;
 u doq, u shkretua për këtë Shqipri
 dhe foshnjat qajnë lajthi më lajthi.

Frashër, Përmet [BN - 302]

Unë e çmova si ju dhe pas gjurmëve ndoqa
 Naimin,
 Ai ma pushtoi dikur si shenjt'i shpirtin tim dhe
 mendimin.

Dritëro Agolli [BN - 303]

Shpirti i dliirë, tungjatjeta,
 Një stërnip të përshëndet
 Ti, o tempull me dy veta
 Një shenjt'or e një poet.

Pano Taçi [BN - 304]

Vështroj tej edhe përhumbe,
 Nëpër tis të poezisë.
 Ti më rri si një pëllumb
 Në altar të pavdekësisë.

Pano Taçi [BN - 305]

Marr lexoj ungjillin tënd,
 Thyej gjunjët mëkatarë,
 Edhe ndjej se përnjëmënd
 Vishem e pastrohem ar.

Pano Taçi [BN - 306]

Brenda vetes ndjej një himn,
 Te qiriri yt bëj rit
 Ç'tmerr që kam shenjt'i Naim,
 Fjala jote ma bën dritë.

Pano Taçi [BN - 307]

Si në ëndrra feks e ndizet,
 Toka amë siç qe një herë,
 Presim ne sërish të ngjizet,
 Katër copash ç'e kanë prerë.

Pano Taçi [BN - 308]

O Zot një me Perëndinë!
 N'ini të vërtetë si thonë,
 Kini kujdes Naimn
 Se punoi për kombin tonë.

Adham Shkaba [BN - 309]

Librat' e Zotëris' së tija
 Njeriut i apin shpresë,
 Rrëfejnë ç'është gjithësisja
 E bëjnë njeri me besë.

Adham Shkaba [BN - 310]



E mbushin dhe me dëshirë
E bëjnë të urt' e të qetë,
Rrëfejnë bukur e mirë
Zotn' e Math e të vërtetë!

Adham Shkaba [BN - 311]

Emri kurrë mos j'u harroftë
Vjershëtorit, Shqipërisë!
Shpirti i tij për herë qoftë,
Në dritë të Perëndisë!

Adham Shkaba [BN - 312]

Ej, ti që mban trishtim,
Jo, Jo, Jo, mos prit lufto!
Bëj dritë si një Naim.
Dhe jeto!

Alqi Boshnjaku [BN - 313]

O vjesht' e dytë, o mot i tretë,
Që na përmbyste një shpirt të bukur,
Ku vallë e shputë? Ku vallë e fshehtë?
në gji të Zotit! A ku është futur?

Jani Vruho [BN - 314]

Shokë e vëllezër, o Shqiptarë!
Ky shpirt i shenjtë s'duhet harruar,
Se na tregoi udhën e mbarë,
I ndritët balta, ku është mbuluar!

Jani Vruho [BN - 315]

Këto të këqia punë
që hoqa dhe po heq unë
s'i duron as det, as lumë.
dhe kush t'i shohë në gjumë,
do të tretet si qiri!
Po e kam zemrënë shkëmb
këto plagë i kam si gjëmb,
po të ishte tjetër komb,
do pëlcit të bënte bomb,
do shuhej dhe emëri.

Koto Hoxhi [BN - 316]

Kur isha i vogël,
Dy pëllëmbë e pak,
Im atë një gështenjë,
Preu me merak.

Nga gjithë trangu mori,
Ç'i duhej për vete,
Aq sa mund të bënte,
Për mua një djepe.

Kur e bëri gati,
Për të tundur djepin,
Te koka i gdhendi
Naimit portretin.

Arben Duka [BN - 317]

Nëna ime zogë
Kur më jipte gji,
ç'kishte bërë për mua
një ninull flori.

Eh, ç'qe ajo ninull,
që këndonte Zoga:
"M'u rriç biri i nënës,
Me flori tek koka!..."

Arben Duka [BN - 318]

Shpejt kaluan vitet,
Si një fllad i lehtë,
Pak nga pak fillova,
Të këndoja vetë.

Atë nina-nana,
Që ma thoshte nëna,
Desha ta kuptoja,
Si ma donte zemra.

Floriri i rrallë,
Te jastëku im,
S'mund të ishte veç,
I madhi Naim.

Arben Duka [BN - 319]

Prapë kaluan vitet,
Si një fllad i lehtë,
Nisa ndonjë këngë
Të thurja dhe vetë.

Naim zemërmadhi,
Thesarin ç'ma hapi,
M'i hodhi në dorë,
Gjithë florinj të që pati.

Arben Duka [BN - 320]

Eh, moj nënë shpirti
Naimi ç'më bëri,
Nga ai u veshja,
Me flori i tëri.

Arben Duka [BN - 321]

FRASHËRI

Sikur të shoh, i tmerrshëm Frashër,
Tek po mban zi përgjithmonë,
Ti: më besniku trashëgonjës
I dashuris' së vendit t'onë.

Lasgush Poradeci [BN - 322]

Këtu mbaj erë trëndafil,
dhe fjalët i kam këngë.
Më mbushet gjoksi me tërfil,
selvitë më bëhen këmbë.

Këtu kam qejf të kthehem tokë
me drurin, lumin, erën, bilbilin,
ta kem hollaken hënë mbi kokë –
qiriri i Naimit.

Kam qejf një plis të jem në Frashër,
një gur i fortë që mban qoshet.
Kur dielli të më ngrohë krahët
të ngrihem e të shkoj poet.

Teodor Keko [BN - 323]

Një e nga një i sollën fshatëret këta gurë të
çmuar
Për këtë shtëpi të rrallë,
Si foshnja të sapolindura i mbanin ndër duar
- Kujdes ustallarë!

Dhe, ja, tani ...

Dikush pluhurat fshin ngadalë,
Dikush me manushaqe odën e stolis,
E dikush tjetër reciton ngadalë:
“O malet e Shqipërisë!”

Tani është gati muzeu,
Le të vinë vëllezërit në shtëpinë e tyre
Dhe vetë dielli vizitor ja behu
Malet, gërxhet, fushat, pyjet ...
Oh, për këta vëllezër muzeu
Qenka i madh sa Atdheu ...

Zenel Anxhaku [BN - 324]

Si ty o Vidhehem, e Mek' e Arabisë
Që kini lerë Muhamet, e Krisht të krishterisë
Është për mua Frashëri, vent i Perëndisë
Atje ku lerë Naim beu, zembr' e Shqipërisë!

Mihal Grameno [BN - 325]



ADHURIMI I DITËLINDJES SË PROFETIT NAIM FRASHËRI 25 MAJ 1846

Fillon me lutjen e përbashkët të mëngjesit:

*Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qoff'i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Falna, Zot, i math ne njerëzinë,
Edhe të mirat' e dashurinë,
Vëllazërinë, zemrën' e qëruar,
Mëndjenë pa faj, shpirt të uruar,
Bëna të drejtë në këtë jetë,
T'urt'e të mirë dhe të vërtetë.*

(Naim Frashëri)

Vijon me leximin e ndonjë prej pjesëve të librit "BESA".

Në orën 11:00 ndizen tri qirinj: një për kujtimin e Naimit, një për mbarësinë apo kujtimin e prindërve dhe një për mbarësinë e fëmijëve. Qirinjtë mund të ndizen në cilindo mjedis të zgjedhur personalisht.

Lutja e drekës.

*Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qoff'i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithëmon'armiqtë e tij!
Gaz përjetë paçin zotërit e tij!*

(Naim Frashëri)

Dreka është festive dhe kalohet në bashkësi.

Pasditja është një kohë bujarie e trefishtë:

- njëra bujari duhet të jetë patjetër për fëmijë, (p.sh. dhuratë)
- bujaria e dytë duhet të jetë për institucion (p.sh. një libër për një bibliotekë)
- bujaria e tretë sipas zgjedhjes personale.

Lutja e fundit është për fëmijët:

*Zot'i math e i vërtetë!
N'atë sy kurrë mos shtjerë
Lotn' e hidhur e të shkretë,
Dhe mos e lërë të bjerë,
Po falu në buzët gazë,
Dhe në sythit bukurinë,
E rriti cazë-nga-cazë,
Duke dhënë urtësinë;
Epu jetëzën' e gjatë,
Edhe mos i lerë kurrë
Pa mëmëzë e pa atë,
Dhe në breng e të sëmurë,
S'munt t'i shoh të mallëngjyer,
A të varfër' e të mjerë!
Dhe të grisur' e të çqyer!
Kurrë, kurrë mos i lerë!
Falu gjithë mirësitë,
Të rrojnë me nder në jetë,
Të mësojnë dituritë,
Të bëhenë të vërtetë;
Të nderojnë mëmëdhenë,
Vjeftënë t'ia lartësojnë,
Mbi gjithë botët t'a ngrenë,
Si lule t'a zbukurojnë.*

(Naim Frashëri)

Në këtë ditë fëmijët organizojnë festat e tyre. Duke qenë se Naimi kishte një dashuri të veçantë për kafshët, ushqimi i kësaj dite është vegjetarian.

Kafshët edhe bagëtinë, që u ka kaqë nevojë,
Njëriu duhet t'i shohë, t'i ketë kujdes, t'i dojë.
Të mos t'i mudojë kurrë, po si fëmijë t'i kemi,
Është mëkat edhe fjalë të ligë për to të themi.

Naim Frashëri [BN -]



PARAJSA DHE SKËTERRA

Parajsa, kopsht' ndrejtuar
për të mirët është shtruar,
s'ta pret mendja, si të thuash
me nonj'emrë s'munt t'a quash
kur të shohç një vent të gjerë
një mirësi të paprerë,
një fatbardhësi për jetë,
atje dhe Zotth' i vërtetë,
edhe gjith'ata që vanë
të dashuritë, që na lanë,
dhe ata, që do të lemë
në mos qofshinë të rremë.

Naim Frashëri [BN - 327]

Lum të mirëtë ku venë!
sa çpërblim nga Zoti gjenë!

Naim Frashëri [BN - 328]

M'anët tjetërë skëtterra,
mbushurë gjëmba e ferra,
një rripë, një shkretëtirë,
një natë që s'ka të gdhirë!
mjerë të liqt' atë ditë!
djallë gjejn' e ligësitë,
një të madhe errësirë,
për ata po s'ka mëshirë,
mundonjësit i përpshijnë,
edhe në zjart' i vërvijnë!

Naim Frashëri [BN - 329]



Edhe vetëm filli të jesh, mos del udhës njerëzisë,
Je bashkë me shpirtin tënt, je përpara Perëndisë.

Naim Frashëri [BN -330]



FJALA E ZOTIT

Perëndija njerin' e parë e mori pej dore vetë,
E zbriti mbi faqet të dheut, q'ish me lulez'e me
fletë,
Më të drejtënë të themi, mbi faqet të dheut e
ngriti,
E bëri të zotthin'e dheut edhe kështu e porositi:

Nga kjo baltë të kam bërë, rri këtu, në paç
uratë,
Mos u lodh e mos psho kurrë, po përpiqu dit' e
natë,

Sheh si punon gjithësija, ashtu të punosh edhe ti,
Të mos rrish kurrë pa punë, e të vësh duartë në
gji.

Mos u bëj i lik e i keq, i paudh' e i pabesë,
I rrem, i ndyrë, i dëmshim, i rënduar e pa
shpresë,

Mërgohu nga të këqijat, pej çdo fare ligësije,
Pej nakari, pej lakmimi, pej vjedhje, pej
marrëzije,

Mos vra, mos merr tek s'ke vënë, edhe ki nom
dashurinë

Bes' e fe ki urtësinë, të drejtënë, mirësinë.

Në bëfsh mirë, liksht s'gjen kurrë, po në bëfsh
liksht, mos prit mirë,

Ki dëshirë për të mirë, dhe në zëmërë mëshirë,

Ji i but', i urt', i vjyer, e mos u bëj kurrë makut,
I egër' e i mërzitur dh'i mahnitur e ladut,

Mos ju afro dhëlpërisë, po së drejtësë ju nis pas;
Në dëgjofsh fjalët e mijsa, do të jesh gjithnjë në
gas.

Nga gjithë ç'pat gjithësija, të kam dhënë dhe ty
pjesë,
Në u bëfsh si them, i mirë, emr'i math do të të
mbesë.

Të kam dhënë mënt, të mësosh, të vërtetën me të
ta shohç,
Dhe zëmër' e vetëdijë, të mir', e të drejtë të
njohtë,

Do të të lë dhe nevojën, udhënë të të tregonjë,
Të të ndihnjë më çdo punë, të të psonj' e të të
zgjonjë.

Gjithë të mirat që janë, këtu në dhet i kam
mbluar,
Po gjësendi në shesh s'nxjerr dot pa dirsur e pa
munduar,
I gjen të gjitha me kohë, po rrëmo thellë e më
thellë,
Çdo gjë duhet kërkoje, barku i tij do ta pjellë.
Sa gjërërazë të vlera do të gjesh ti këtu brenda,
Edhe përsipërë soje, e sa do të t'i ket' ënda!

Me fuqit, që të kam dhënë, them që të vinjë një
ditë
Të marrç udhën e së mirës e të gjesh të madhe
dritë,
Të març vesh dalengadale sa punëra, që kam
bërë,
Diell, hënë, yj, dhe, qiej e gjithësinë të tërë!

Po që u bëre i urtë, mua më ke afër teje,
Ndryshe, - qofsh i mallëkuar, edhe mërguarë
meje!

Të parit tënë Perëndija këto fjalë vetëm i tha,
I fali gjithë të mirat, i dha uratën dhe e la.

Naim Frashëri [BN - 331]



Bes'është Perëndija
Për gjithë Shqipëtarët
Edhe vëllazërija,
Urtësia, të mbarët,
Fe është njerëzia.

Naim Frashëri [BN - 332]

Do udhën' e Perëndisë?
Mos ju mërgo njerëzisë,
S'ajj, që do Perëndinë,
Bën gjithnjë mirësinë.
Nga të ligat kush mërgohet,
Te Zot'i math afërohet.

Naim Frashëri [BN - 333]

Doni fjalën e vërtetë
njeriu është kuran vetë,
besa është në kraharuar
nuk është në kartë shkruar.

Naim Frashëri [BN - 334]

Me fjal' e me agjërime
Nuk' e gjen dot Perëndinë,
As me kreshm' e me kungime,
Si punojn' ata që s'dinë.

Naim Frashëri [BN - 335]

Është ndaj teje i gjallë,
Ti e kërkon nëpër gurë,
Në të rrem' e në përrallë,
Andaj nuk' e gjen dot kurrë.

Naim Frashëri [BN - 336]

Ne e dinim ndryshe, rrugn' e Perëndisë
Pa e lamë dashurin' ndaj njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 337]

Ai bir që do njerinë, - ai ka Zot.

Naim Frashëri [BN - 338]

Po të nderojë njeriu njerinë
E ka nderuar dhe Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 339]

Duaj atën' edhe mëmën,
Të jesh fatbardhë në jetë,
Se po të t'apinë nëmën,
Kurrë nukë bën përpjetë.
Duaj motërn' e vëllanë,
Bëje zakon dashurinë,
Duaj atë, që ke pranë,
Edhe gjithë njerëzinë.
Bëhu qënq i but' i leshtë,
E mos rro si egërsirë,
Që të bënesht njeri i fjeshtë,
I nderuar' e i mirë.

Naim Frashëri [BN - 340]

Fjalëve t'armiqve të egër kurrë mos u vini veshin,
Se ata duan gjithmonë, me intriga të urretshme,
Me çdo mjet ta bëjë fenë vegël të shkatërrimit
tonë.

Ata duan të na ndajnë për të tyret interesa.

Naim Frashëri [BN - 341]

Nga e drejta rrugë kurrë mos u ndaj,
Të mos thuash: Ç'bëra unë, ah, pastaj.

Naim Frashëri [BN - 342]

Bëhu shok e mik me gjithë njerëzinë!

Naim Frashëri [BN - 343]

Mërgo shtypjen, ligësinë dhe mërinë!

Naim Frashëri [BN - 344]

E si munden që të bëhen pluhur vallë
Vepra e mirë, shpirti i dëlirë, zemra e gjallë!

Naim Frashëri [BN - 345]



Po qe se nuk do njerinë, s'je njeri.
Shpirt e zemër s'janë gjë pa dëlirësi.
Ndaj nga zemra jote kthehu vështrimplot!

Naim Frashëri [BN - 346]

Dëlire shpirtin, o ti miku besëdëlirë,
Që kështu të gjesh pastaj të Zotit hirë!

Naim Frashëri [BN - 347]

Ndrite zemrën, mbaje larg nga ligësitë
Që të bjerë tek ajo e madhja dritë! ...

Naim Frashëri [BN - 348]

Te njeriu ke pasqyrn' e Perëndisë,
Ndaj hiq dorë, o njeri, prej ligësisë!

Naim Frashëri [BN - 349]

Ai që me brumn' e vuajtjes na gatoi,
Zemrën, shpresën dhe durimin e dhuroi.

Naim Frashëri [BN - 350]

Është i vetëm, i brengosur, i urishëm,
Si një gur në mes të lumit të furishëm.
Kush e bën atë të qesh i ngazëlluar,
Pa dyshim të vetën zemër ka gëzuar.

Naim Frashëri [BN - 351]

Thelbin tënd s'e di njeriu, moj natyrë,
Dhe pse thellë kësaj fushe i ka hyrë.

Naim Frashëri [BN - 352]

Kjo e gjera hapësirë pa kufi,
Kaqë drita dhe të fshehta mban në gji.

Naim Frashëri [BN - 353]

Veç një njeri shoh pa punë dhe të mjer' e të
brengosur,
Të këputur, të mejtuar, të grisur e të rreckosur;
Lipën i gjori pa shpresë, se atje e pru përtimi,
S'i ka mbetur gas në zemrë, se s'i la vend
idhërimi.

Është njeri, si dhe neve, po epini, o të pasur,
E mos e lini të urët dhe të mjer' e buzëplatur,
Se përtimn' e zi, që e pruri të gjorin më këtë
ditë,
Nuk e dimë vetë e zgjodhi, apo ja dhanë
perënditë;
Edhe për një mizë, kur heq, i vjen keq njeriut të
mirë,
Zëmëra s'thuhet zemrë me mos pasurë mëshirë.

Naim Frashëri [BN - 354]

Pa lodhur e pa këputur, pa djersë e pa mundime
Njeriu i gjorë në jetë nukë gjen dot as thërrime!
Si të punosh ditë e natë e të bësh ç'duhene
gjithë,
Aherë kërko nga Zoti të t'apë bukëz e drithë.
Njeri! puno, mos psho kurrë, dhe lark nga
makutërija,
Zemërenë kije të gjerë, mos ki keq, pa t'ep
Perndija.
Puna ka duk e uratë, Zot'i math e ka bekuar,
Njerinë mbi faqet të dheut e dërgoj për të
punuar.

Naim Frashëri [BN - 355]

Ju shokë, kur pini verën, mos dehi, mos zemërohi,
Mos u zihni, mos u shani, mos lëvdohi, mos
qërtohi,
Se përçmoni Perëndin, q'i ka falur hardhisë rrush,
Edhe kërkon dashurinë, e ndodhet pshehtazi ndaj
jush;
Po gëzohi, prehi, qeshni, duhi, xbaviti, dëfreni,
Flisni fjalë të pëlqyer, loni, këndonin, kërceni,
Bëjeni zemërn të gjerë edhe shtoni dashurinë,

Mirësinë, njerëzinë dhe besën e miqësinë;
Se në breng' e në të keqe, në punë e në të pirë,
Mirretë vesh njeriu i lik, njihetë njeriu i mirë.

Naim Frashëri [BN - 356]

Dhe zemra i gëzohet, pa i faletë Perëndisë
Q'ë çpërblen punën e djersën e mundimn' e
njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 357]

Është një'udhëtar i gjorë, që ka mbetur në
dëborë,
I kanë ngrirë të mjerit vesh'e goj, e këmb'e dorë;
Ngrihet i zoti i shtëpisë, edhe të huajthin e mer
E vë në krye të vatrës me njerëzi, me të math
nder,
Posa e shohënë që vjen, i ngrihen gjithë fëmija,
Se të huajnë më derë na e dërgon Perëndija;
Pa i bëjnë zjar e ngrohet, edh'e mbajnë me të
mirë,
I sjellin shtresë të flerë, edhe të ngrën' e të pirë.
Kështu të huajt' e miqtë njeriu q'është i uruar
I pret me krahëror hapur, e i përsjell të gëzuar.

Naim Frashëri [BN - 358]

A e doni miqësinë edhe dashurinë tonë?
Hiqni dorë nga sofizmat, nga gënjeshttrat, nga
mashtrimet.

Naim Frashëri [BN - 359]

Se ky shekull, o vëllezër, është shekulli i dritës,
Dhe pa gjuhën dhe pa shkencën, pa shkollën e
mbrothësinë,
Pa të mjafta dituri, sot asgjë nuk vlen në botë.

Naim Frashëri [BN - 360]

Lëfton gënjeshttra me të vërtetën
Dhe errësira dritën lëftonte
Që t'errësonte së gjithash jetën
Dhe djallëzija të mbretëronte.

Naim Frashëri [BN - 361]

Trajstën' e ke plot me bukë
Edhe hiqesh si i mjerë,
Dhe ke zën' e thua nukë
E lipën derë më derë.

Naim Frashëri [BN - 362]

Oh, epni ju që kini!
Kush i ndih varfërisë,
Ay q'ep, po e dini
Q'i huan Perëndisë.
T'apim, se vjen një ditë
Q'ë lemë këtë jetë
Dhe gjën' e bagëtitë,
Vemi në të vërtetë,
Përpara Perëndisë
Që do të na gjykonjë;
Urat' e varfërisë
Arrin të na shpëtonjë.

Naim Frashëri [BN - 363]

Epni t'u falnjë Zoti
Juve gjithë të mirat
E të mos muntnjë moti
T'u sjellë të pahirat.
Mba unazat në dorë
Pa një farë nevoje!
Zonjë! Shumë të gjorë
Vdesën për bukë ngoje!
Ep t'apë Perëndija
Të gjitha mirësitë,
Të të kenë fëmija
Shëndet e jet' e ditë.
Zot i math', i vërtetë
E gjithë ju të Mirët,
Mos e lini përjetë
Njerin n'errësirët!

Naim Frashëri [BN - 364]



Zemëra, q'është' e qëruar
Kurdoher' është' e gëzuar.

Naim Frashëri [BN - 365]

Mos ji me dy faqe kurrë,
Ji i drejt', i mir' e burrë.

Naim Frashëri [BN - 366]

Njerëzija anë mb'anë
Janë gjithë një fëmijë:
Një mëm' e një atë kanë,
Dhe një shpirt e një vetijë.

Naim Frashëri [BN - 367]

Shiko faqebardhë të rrosh,
E përpiku të bësh mirë.
Edhe me çdo njeri të shkosh
I pa dëm edhe i lirë.

Naim Frashëri [BN - 368]

Kusëria, ligësia,
Dhe sa të këqia janë,
Edhe gjithë marrëzia
Paditjenë mëmë kanë.

Naim Frashëri [BN - 369]

Mos mesavit e mos përqish,
Mos shaj, të rreme mos thuaj,
Qëro zëmrënë ligësish.
Nga të këqijat u ruaj.
Se dëmi me ligësinë
E përçmojnë fort njerinë.

Naim Frashëri [BN - 370]

I dëgjo fjalët e pleqet. Se ata janë të vuar,
Edhe punërat' e jetës një nga një i kanë msuar.

Naim Frashëri [BN - 371]

Me skamje shum' e me vjet
S'bënesh dot i math vërtet,
Po bënesh me urtësi,
Me ment e me njerëzi.

Naim Frashëri [BN - 372]

Mos e kthe fjalën kurrë,
Po qëndro më një si burrë.

Naim Frashëri [BN - 373]

Kohën e çdo pune e ndaj,
Çdo punë ka kohën' e saj.

Naim Frashëri [BN - 374]

Çdo gjë e verë në vënt të saj,
Të mos mundonesh ta gjesh pasdaj.

Naim Frashëri [BN - 375]

Për çdo gjë që ke dëshirë,
Mos pandeh se është' e mirë.

Naim Frashëri [BN - 376]

Lipset në këtë jetë
Të jemi të vërtetë:
Perëndinë ta besojmë
Njerinë ta nderojmë,
Të varfërin ta qasim,
Gjësendi të mos ngasim,
Si vëllazër të shkojmë,
Të ligat t'i harrojmë
Të drejtën ta gjejmë,
Të mirën ta shpërblejmë,
Fajet tona t'i ndreqim,
E njeri të mos heqim,
Gjithnjë të punojmë,
Kurrë të mos përtojmë,
Kurrë të mos gënjejmë,
Fajëtorë ta ndiejmë,
Të jemi të kënduar,
Të ditur' e të msuar,
Të rrim e të dëgjojmë,
Dhe fjalën ta peshojmë.

Naim Frashëri [BN - 377]

Sado i pasur të jesh,
Punënë të mos e lesh.

Naim Frashëri [BN - 378]

Ka uratë nga Perndija
Kush ha me djersët e tija.

Naim Frashëri [BN - 379]

Mos zërë punë që nuk e bën dot,
Se do mundohesh e të lodhesh kot.

Naim Frashëri [BN - 380]

Zoti vërtet njerinë
E bëri të shpenguar,
Po i dha urtësinë,
Dhe ment për të menduar.

Naim Frashëri [BN - 381]

Po s'pati njeriu zemrën të quar,
Shpirtin të mirë e të bekuar,
Vetijën e ti të lartësuar.
Dhe njerëzinë;

Po s'zuri udhën' e Perëndisë
Të marrë gjurmën' e mbarësisë,
Të mos bënë gjë, veç mirësisë,
S'ngjan më njerinë.

Naim Frashëri [BN - 382]

Po s'zuri të drejtën e të vërtetën,
E po s'mori vesh se ç'është jetën,
Po s'mbajti besën, po e ktheu fletën
Ka djallëzinë.

Naim Frashëri [BN - 383]

Ki në zemërë mëshirë,
Bëhu i urtë dhe me mënt,
E mos rro si egërsirë,
Po ruaje nderthinë tënt,
Të bëhesh njeri i mirë,
Dhe i lëvdur më ç'do vent.

Naim Frashëri [BN - 384]

Pa msuarë dituritë,
Nuk e gjen dot Perëndinë,
Lipset të kesh shumë dritë,
Pa ta shohç q'është tek tinë.

Naim Frashëri [BN - 385]

Kur të jesh i zëmëruar,
Mëndja është' e trumbulluar,
Bëj durim sa të kullohet,
Se njeriu pastaj pendohet.

Naim Frashëri [BN - 386]

Lum ay q'është i vërtetë,
Veç së mirës s'bën gjë tjetër,
Se lë emërin përjetë.
Dhe i vete Zotit afër.

Naim Frashëri [BN - 387]

Mos u mburr kurrë me mënt,
As me fis e me ergjënt.

Naim Frashëri [BN - 388]

Do të rrosh me nder mbi dhe?
Me të liq mos u përzje.

Naim Frashëri [BN - 389]

Mos u hiq nga njerëzija,
Dhe nga vetij' e pëlqyer,
Se mërgohe nga Perndija,
Pa pasdaj del i gënjyer.

Naim Frashëri [BN - 390]

Të varfërinë ta duash,
Sikur do djalënë tënt,
Dhe vëlla e bir ta quash,
Se Zoti andaj të dha mënt.

Naim Frashëri [BN - 391]



Ki njohënë të qëruar,
Dhe zëmërenë të larë,
Shpirtinë të lartësuar,
Edhe punënë të mbarë.

Naim Frashëri [BN - 392]

Përveçse një e vërtetë,
Gjësendi s'ka nder në jetë.

Naim Frashëri [BN - 393]

Njeriu që vetëm për vethe punon,
Është si një dru, që pemë s'lëshon.

Naim Frashëri [BN - 394]

Ki durimn' e trimërinë,
Se shum' e gjejnë njerinë.

Naim Frashëri [BN - 395]

Tjatrën mos e gënje,
Po të drejtën i rrëfe.

Naim Frashëri [BN - 396]

Ati puna s'i ka duk,
Që e bën për me u duk.

Naim Frashëri [BN - 397]

Mos u rrëmbe, mos u nxito,
S'dueht në çdo kohë çpejtim,
Me urtësi, dhe me mejtim,
Zërë ç'gjë munt, nuk ç'gjë do.

Naim Frashëri [BN - 398]

Gjuha është thik' e prehtë
Plag' e saj nuk është e lehtë.

Naim Frashëri [BN - 399]

Shumë njerës gjuha mundon
Ca të tjerë i turpëron.

Naim Frashëri [BN - 400]

Mos lerë punën për pasdaj,
Çdo kohë ka punën' e saj.

Naim Frashëri [BN - 401]

Miku njihet, q'është mik,
Në të keq e në rrezik.

Naim Frashëri [BN - 402]

Trupi shëndoshet me të punuar,
Mëndja ndritohet me të mësuar.

Naim Frashëri [BN - 403]

Folë kur është nevojë,
Pa nevoje mos hap gojë.

Naim Frashëri [BN - 404]

Po s'bëre një të mirë në botë,
Jetën' e bëre dëm, vate kotë.

Naim Frashëri [BN - 405]

Mos thuaj kurrë atë që s'ta pret,
Njeriu peshonet me fjalët që flet.

Naim Frashëri [BN - 406]

Ç'fjalë të thuash atëzë dëgjon,
Gjithnjë do gjesh atë që kërkon.

Naim Frashëri [BN - 407]

Atë gjë, që ti ndruhesh pej asaj,
Qysh kuxuake t'ia bësh tët vëllaj?

Naim Frashëri [BN - 408]

Atë që i bën t'yt eti,
Ta preç nga yt bir edhe ti.

Naim Frashëri [BN - 409]

E mir' e mëmës kurrë s'çpërblehet,
Si mjer' ajy q'e bën të pshonjë,
Mos e bëj kurr të mallëngjehet,
Dhe të të nëmnjë e të të mallkonjë.

Naim Frashëri [BN - 410]



Thuaj fjalën' e mirë,
E bëj punën e mbarë.
Gënjeshtër mos thuaj,
E gjë që s'ka të ngjarë.

Naim Frashëri [BN - 411]

Mos dëgjo t'atërin ç'thotë,
Po shiko se ç'bën në botë,
Mos e pyet se ç'gjë beson,
Po i shih punën që punon.

Naim Frashëri [BN - 420]

Kurrë mos qesh me shokë,
Munt që të vjen më kokë.

Naim Frashëri [BN - 412]

Njeriu nga shokët njihet,
Rrushi sheh rrushn' edhe nxihet,
Andaj të ligut, mos ju qas,
E së ligës mos i hiq pas.

Naim Frashëri [BN - 421]

Gjithë njerëzit, që janë,
Vëllezër janë të tërë,
Një mëm' e një atë kanë,
Nga një baltë janë bërë.

Naim Frashëri [BN - 413]

Ay që hiqet i math, edhe mbahet rëndë,
E ka mendjen të vogël, e të lehtë pëndë.

Naim Frashëri [BN - 422]

Një që bën liksht, mirë s'gjen,
Jeta njeriut ja çpërblen.

Naim Frashëri [BN - 414]

Mos vërë kurrë nakar,
Të djek zëmren, është zjarr.

Naim Frashëri [BN - 423]

Mos gënje, se të mësojnë,
Pa pastaj më s'të besojnë.

Naim Frashëri [BN - 415]

Punëtori s'varfërohet,
Përtesi s'bëhet i pasur,
I ligu kurrë s'nderohet,
I pabesi s'është i dashur.

Naim Frashëri [BN - 424]

Duhet të rronç i vërtetë,
Pa të lësh emër për jetë.

Naim Frashëri [BN - 416]

Mos i bëj njeriu në jetë
Gjë që s'do ta pësonç vetë.

Naim Frashëri [BN - 425]

E vërteta dhe e drejta kurdo njihen,
E shtrembëra dhe gënjeshtër nuk pshihen.

Naim Frashëri [BN - 417]

Më i mir' i njerëzisë,
Është i zot' i mirësisë.

Naim Frashëri [BN - 426]

A do të arrësesh djalën?
Mos thua vetëm fjalën,
Bej mirë të të shohë,
Që të mirën ta njohë.

Naim Frashëri [BN - 418]

Kohën e kurse,
Se vet' e më s'vjen,
Shkon e më s'e gjen,
Ikën e të le,
Me pun' e fiton,
Pa punë dëm shkon.

Naim Frashëri [BN - 427]

Duhet që nga vogëlija,
Bërë zakon mirësija.

Naim Frashëri [BN - 419]



Kalliu, që ka bukë nuk ngre lart kokë,
Ajy, që është fyl, del mi gjithë shokë.

Naim Frashëri [BN - 428]

Vetëm e mira njerinë,
E afron me Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 429]

Njeriu, që s'mba besën, dhe fjalënë që thotë,
Është shum'i panderçim dhe i frikshim në botë.

Naim Frashëri [BN - 430]

Njerëzit duke msuar,
Janë qytetëruar;
Ata që nuk msojnë,
Si kafsh' e egër rrojnë.

Naim Frashëri [BN - 431]

Ajy që s'bën mirë,
Është n'errësirë,
Është egërsirë,
S'thuhetë njeri;

Naim Frashëri [BN - 432]

Kush bën mirësinë,
E ka njerëzinë,
Shëmbëllen njerinë,
Ka dhe Perëndi.

Naim Frashëri [BN - 433]

Me udhë fito, me udhë kurse,
Dhe me udhë prish nga ato që ke.

Naim Frashëri [BN - 434]

Të varfërin mos e dëbo,
Që të vjen në der' e kërkon,
Duarthatë mos e dërgo,
Vetëdija ty s'të qërton?

Naim Frashëri [BN - 435]

Në mos ke e në mos ep dot,
Për të mjerën lësho një lot.

Naim Frashëri [BN - 436]

Ajy që ka dhe s'ep me nonj'anë,
Është m'i varfër nga gjithë ç'janë.

Naim Frashëri [BN - 437]

Njih vethenë se ç'gjë vëjen,
Se mëndjeja ty të gënjen.

Naim Frashëri [BN - 438]

Mendjeja pa dituri
Nuk ka fort bukuri.

Naim Frashëri [BN - 439]

Ndjenj' e lartë njerinë,
E pjek me Perëndinë,
E bën të shënjtëruar,
Mërgohet djallëzija,
Dhe buron mirësija
Brenda në kraharuar.

Naim Frashëri [BN - 440]

Duaj njerinë e urtësitë,
Dhe njerëzinë e dituritë.

Naim Frashëri [BN - 441]

Dhe të të falin kamjen e jetës,
Mos thua kurrë veç së vërtetës.

Naim Frashëri [BN - 442]

Mer vesh çë ke për të bërë,
Pastaj mejtohu dhe zërë.

Naim Frashëri [BN - 443]

Të këqijat mos i lëvdo,
Se duket që je mik me to.

Naim Frashëri [BN - 444]

Njeri kurrë mos hiq,
E mos i vër ofiq.

Naim Frashëri [BN - 445]

Kush përpiqet e punon,
Gjithë punët i mbaron.

Naim Frashëri [BN - 446]

Kurrë mos e dua
Gjënë e huaj.

Naim Frashëri [BN - 447]

Vetëm aq është i mjerë,
Që s'ka njerëzin' e nderë.

E mira të lartëson,
E liga të turpëron.

Naim Frashëri [BN - 456]

Mos e qesh fatzinë,
Se çnderon njerinë.

Naim Frashëri [BN - 448]

Njeriu as fare poshtë
Nuk duhet të bjerë,
As të mbahet i rëndë.

E kokënë ta ngrerë.

Naim Frashëri [BN - 457]

Mos zërë ngoje njeri,
përveçse me mirësi.

Naim Frashëri [BN - 449]

Fajet e tu po të mejtosh,
Njeri kurrë s'do të qërtosh.

Naim Frashëri [BN - 450]

Mos u qaj nga varfëria,
Po puno, se ka Perndija.

Naim Frashëri [BN - 458]

Gjithë botënë e dua,
Mos e pandeh për të huaj.

Naim Frashëri [BN - 451]

Madhërija është me mënt,
Nukë me vjet e me ergjënt.

Naim Frashëri [BN - 459]

Njeriu duke vuar,
Çdo gjë e ka mësuar.

Naim Frashëri [BN - 452]

Njeriu po pati dëshirë,
E gjen punëzën' e mirë.

Naim Frashëri [BN - 460]

Shpirtinë mos e fëlliqni,
Se Zoti do ta gjykonjë,
Nga e liga dorë hiqni,
Se do të u turpërojnë.

Naim Frashëri [BN - 453]

Dhëlpërit e djallëzia,
Ligësit' edhe padija,
S'kanë duk kurrë në jetë,
Pa njerin' e lënë të shkretë.
Njerëzinë ja rrëmbejnë,
M'egërsir' e shëmbëllejnë.

Naim Frashëri [BN - 461]

Mirësija, Dituritë,
Njerëzija, Urtësitë
Na nderojnë;
Ligësitë, E padija,
Djallëzitë, Babëzija
Na helmojnë.

Naim Frashëri [BN - 454]

Njeriu po s'deshi kombin' e tija
E mëmëdhenë,
Nuk ka pjesë nga njerëzija
S'do as vetëhenë.

Naim Frashëri [BN - 462]

Njeriu, q'është i lik,
I posht' i ndyrë,
I dëmçim, armik
Posi mynxyrë,
Nuk' është i mirë.

Naim Frashëri [BN - 455]

Kurr'armiqësi të mos kesh,
Gjithënjë njerëzit t'i ndjesh.

Naim Frashëri [BN - 463]



Njeriu, është vërtet,
Kur vdes e hyn në dhet,
Edhe në qoftë mbret,
Me vethe gjë s'mer.

Naim Frashëri [BN - 464]

Kombin tënt e mëmëdhenë
Lipsetë shumë t'i duash,
Më teprë se vetëhenë,
Nga shpirti mos i çquash.

Naim Frashëri [BN - 472]

Po puna, që punon
Dh'emri që fiton,
Mbi dhe përjetë rron
Gjithënjë i ep nder.

Naim Frashëri [BN - 465]

Për ta të vdeç, për ta të rroç,
Të përpiqesh nat' e ditë,
T'i zbukuroç, t'i lartësoç,
T'i nderoç e t'u apç dritë.

Naim Frashëri [BN - 473]

Në mënxyr' e në të keqe duhet durim e trimëri,
Dhe më çdo kohë' e më çdo vënt lipset të kemi
njerëzi.

Naim Frashëri [BN - 466]

Gjuhën e mëmëdheut mëso,
Ajo munt të të ndritonjë,
Edhe të tjerat' i këndo,
Po atë të kesh për zonjë.

Naim Frashëri [BN - 474]

Ki dëshirë për të mirë
E mos u bëj i pështirë.

Naim Frashëri [BN - 467]

Mos u lëvdo, të të lëvdojnë;
Mos qërto, se të qërtojnë.

Naim Frashëri [BN - 468]

Atë ta dha mëma jote
Bashkë me qumështit të saj,
Pa të tjeratë pej bote
I kë mësuar më pastaj.

Naim Frashëri [BN - 475]

Mos shaj, mos rrih, mos vith, mos rren,
Mos i bëj dëm njeriut kurrë,
Pa aherë munt të të them
Je i mir', i urt' e burrë.

Naim Frashëri [BN - 469]

Nga gjithë bota më parë
Të nderojmë Shqipërinë.
Të duamë shqipëtarë
Dhe shqipen si Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 476]

Gjithë ç'jemi shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Mëmë kemi Shqipërinë
Edhe besë Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 470]

Mësimi, vëllazëria,
Njerëzia, urtësië
Bijenë qytetërinë
E gjithë ç'janë të mirat,
Dhe njësin' e miqësinë,
Përhapinë errësirat.

Naim Frashëri [BN - 477]

Tek s'ke vënë, mos merr,
Se më s'të mbetetë nder.

Naim Frashëri [BN - 471]

Fort të larta kush kërkon,
Më së fundi e pëson.

Naim Frashëri [BN - 478]

Syr'i pangopur,
Lakmim i shkretë,
Na ka brengosur
Në këtë jetë.

Naim Frashëri [BN - 479]

Fjalët e zogut djali i dëgjoji,
Qau, edh'e puthi, pastaj e lëshoi.

Naim Frashëri [BN - 480]

O, lulez' e Perëndisë!
Që të mbolli vetë Zoti,
Xgjohu tani q'u ngroh moti,
Erdhi koha e gjallësisë.

Naim Frashëri [BN - 481]

Se dheu an'e mb'anë mberoi,
E të vdekuritë u ngrinë,
Gjithë ç'janë u përsërinë,
Zoti nga gjum'i rënd'i xgjoji.

Naim Frashëri [BN - 482]

Mos i hiq pas ligësisë,
Se të fut në errësirë,
Merr udhën' e Perëndisë,
Të bashkohesh me të mirët.

Naim Frashëri [BN - 483]

Mos vrisni kurr' e mos shani,
Nga e mira mos u ndani,
Është lark tej kurvërisë
Udh'e mbar' e Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 484]

Perversitetin e përhapin më me lehtësi ata që vetë janë prirur për të dhe e shijojnë atë. Është përgjegjësi e veçantë e atyre që ngrenë mjete të informimit publik masiv që të kujdesen që këto mjete të mos përdoren nga kushdo si kobure për mbrapshtira. Kufizimi i mundësisë për të përhapur të pamoralshmen, perversen, kriminalen nuk është censurë. Por dhe nëse krijohen rrethana, kur njëfarë censure bëhet e domosdoshme për të frenuar paturpësinë ose provokimin që vret moralin e procesit të edukimit kjo censurë duhet vendosur. Për këtë duhet të kujdesen në radhë të parë mekanizmat propagandistikë e shoqërorë, pa qenë nevoja që të kërkohej ndihma qeveritare. Unë mund të shkoj disi dhe më larg e të shpreh një dyshim se në minimin e moralit të përgjithshëm e të moralit shqiptar në Shqipëri nëpërmjet mjeteve të informimit kanë dorë dhe mekanizma antishqiptare të huaja që dinë të punojnë me shumë marifet.

Abdi Baleta [BN - 485]

Të këqijat mos i lëvdo,
Se duket që je mik me to.

Naim Frashëri [BN - 486]

Këjo jetë s'është' e gjatë,
Pse të futesh në mëkatë,
E të hysh në errësirë,
Se e liga po s'del mirë.

Naim Frashëri [BN - 487]

Do t'i falesh Perëndisë?
Bëji mirë njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 488]

Ajy, q'i sjell Zotit besë,
Kurrë nuk mund të vdesë,
urtësit' e mirësitë,
ato na nxjerrin në dritë,
se njerinë mirësija,
e shpije te Perëndija,
ajy, që nuk'është' i mirë,
futetë në errësirë.

Naim Frashëri [BN - 489]



Mërgohu nga ligësitë,
Mirësin' e mba si burrë;
Mirësia është dritë,
Që nuk shuhetë kurrë.

Naim Frashëri [BN - 490]

Mos pandeh, se Perëndija
s'e di ç'bëjnë njerëzija
mirësinë ka pëlqyer,
ç'do punë e ka ç'përblyer.

Naim Frashëri [BN - 499]

Lum kush është zemrë-qëruar,
posi lumi i kulluar,
mjerë kush vete i ngarkuar
si lumi i trubulluar.

Naim Frashëri [BN - 491]

Kushdo, q'u bë i pabesë
mallkimnë pastë pjesë.

Naim Frashëri [BN - 500]

Atë mos e bëj në jetë,
që s'do t'a pësonç ti vetë.

Naim Frashëri [BN - 492]

Ajy, që zë djallëzinë,
s'piqetë me Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 501]

Një e drejt'e një e vërtetë
na nderon në atë jetë.

Naim Frashëri [BN - 493]

Njeriu në këtë jetë
duhet të jet'i vërtetë
mirë duhet të punonjë,
sa të jet' e sa të rronjë,
atë, që bën, do të gjenjë,
se Zotnë s'munt t'a gënjenjë.

Naim Frashëri [BN - 502]

Për këto të paka ditë
pse të bëjmë ligësitë?

Naim Frashëri [BN - 494]

Do t'i falem Perëndisë,
T'i ap udhë njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 503]

Zotnë atje kur ta gjejmë,
nukë mundim ta gënjejmë;
njeriu kur të gjykohet,
atje shumë turpërohet

Naim Frashëri [BN - 495]

O njeri! mba Perëndinë!
hidhe poshtë djallëzinë!

Naim Frashëri [BN - 504]

Ne na gjykon vetëdija
më parë nga Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 496]

Zot' i math!
trim i mirë' e punë mbari,
të qofsha falë për jetë!
Ti je vërtet i vërtetë!

Në qiej fluturuan,
te Zot' i vërtetë shkuan.

Naim Frashëri [BN - 497]

nuk le gjë pa ç'përblyer,
edhe zëmërë të thyer!
të mirënë e nxjerr mirë,
mirësija 'sht' e pavidrë,
i ligu gjen ligësinë,
edhe vete në greminë!

Mjer'ajy q'është i pabesë!
e s'ka njerëzije pjesë.

Naim Frashëri [BN - 498]

Naim Frashëri [BN - 505]

Është e mirë urtësija,
mirësi e njerëzija,
është udh'e Perëndisë
mirësi e njerëzisë,
po kur shtohet ligësija,
sa s'e duron Perëndija,
bëhet jeta errësirë
dhe syri 's'të sheh të mirë,
e s'bën punë urtësija
është e mirë trimërija.

Naim Frashëri [BN - 506]

Ajy, që është egërsirë,
s'munt të gjenjë kurrë mirë,
kush ti ndihnjë njerëzisë,
miku është i Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 507]

Dua t'a di ç'gjë ka bërë
këjo njerëzi e tërë!
që heq kaqë të këqija!
po s'përgjigjet Perëndija!

Naim Frashëri [BN - 508]

S'i harronte Perëndija
aqë shumë të këqija,
pa kush e bën, do t'a gjenjë,
Zotn' e math s'munt t'a gënjenjë
s'gënjen dot dhe njerëzinë,
q'e njohënë ligësinë.

Naim Frashëri [BN - 509]

Gënjeshtër dhe ligësitë
s'dalënë kurrë në dritë,
pa të lënë n'errësirë
e vërteta'sht' e pavdirë.

Naim Frashëri [BN - 510]

Kurdoherë mirësitë
i mundinë djallëzitë.

Naim Frashëri [BN - 511]

E drejta edhe e vërteta
s'mbetenë kurrë të shkreta,
tek mbretëron urtësija,
atje është Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 512]

Ç'bën ata, ju mos e bëni,
njeriu, kur e ha qeni,
kur e ha qen' i tërbuar,
me dhëmbë duke kafshuar,
ajy po s'munt t'a kafshonjë
fajnë duhet t'j'a dhuronjë,
se e liga edhe e mira,
njeriu dhe egërsira
qysh mund të ndahet në jetë
ndaj njeriut të vërteta?

Naim Frashëri [BN - 513]

I pari ynë ka thënë:
njerëzija ç'do q'u bënë
Juve duhetë t'i ndjeni,
dhe mirësi të rrëfeni.

Naim Frashëri [BN - 514]

Besë kanë marrëzinë,
për gjë s'e zënë njerinë,
vunë lig' armiqësinë,
përmbysnë vëllazërinë,
për Zot të math zunë djallë,
edhe në mest tënë e kallë,
zunë djall' e djallëzinë,
s'e kujtuan Perëndinë,
kombinë në kurt e vunë,
e në hekura e shtunë,
marjen' e makutërinë,
prishjen' edhe babësinë,
të këqijat gjithë ç'janë,
e të ligat' an' e mb'anë,
në mest' t'ënë na i prunë,
me ato shikojnë punë,
e vunë kombin në xgjedhë
sa më s'munt mënttë t'i mbledhë!

Naim Frashëri [BN - 515]



Fajinë s'e ka njerëzija,
e ka vetëm ligësija,
andaj t'i rimë mërguar
se 'shtë shumë' e mallëkuar!

Naim Frashëri [BN - 516]

Bes' e udh' e Perëndisë
q'i duhetë njerëzisë,
është vetëm e vërteta,
me atë mbahetë jeta.

Naim Frashëri [BN - 517]

Bes' e mbar' e Perëndisë,
udh' e mir' e urtësisë
është vetëm mirësija,
e vërteta, njerëzija,
zëmr' e bardhë, shpirt'i mirë,
me mëshir' m'ëmbëlsirë,
e drejta, vëllazërija,
dashurija, miqësija.

Naim Frashëri [BN - 518]

Gjithë besëtë që janë,
vetëm këtë udhë kanë,
këtë thotë besa jonë,
dhe të tjerat këtë thonë,
se ndë jetë s'ka ky besë,
një është' e një do të mbesë,
besë është Perëndija
dhe udh' e saj njerëzija.

Naim Frashëri [BN - 519]

Ajy, që do njerëzinë,
ka besuar Perëndinë,
kush ka në zëmrë mëshirë.
thuhet njeri i mirë.

Naim Frashëri [BN - 520]

Çdo njeri vëllath e kemi,
gjithë nga një baltë jemi,
kemi një shpirt në vetijë,
jemi gjithë një fëmijë,

një mëm'e një atë kemi,
në një fytyrë po jemi.

Naim Frashëri [BN - 521]

Një zëmërë të qëruar
na kërkon Zot' i lëvduar,
edhe punëzën' e mirë,
dhe njerëzi e mëshirë,
dhe të madhit t'i bënç nderë,
dhe të vogëlit nga herë
na dha mëndjenë më kokë,
e na bëri miq' e shokë.

Naim Frashëri [BN - 522]

Atë që s'të vjen ty mirë,
po të duket' e fështirë,
mos e bëj dhe ti në jetë,
në je njeri i vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 523]

I ligu e gënjeshtari,
rrëmbenjësi e kusari
vrasësi, që vret njerinë,
i prish të vëllajt shtëpinë,
ata që shajn' e qërtojnë,
dhe heqin' e kallëzojnë,
edhe bëjnë të këqija
e rrojnë si bagëtiija,
i venë pas djallëzisë,
së rremës' e ligësisë,
s'kan as njerëzi as besë.

Naim Frashëri [BN - 524]

Besa edhe Perëndija
është vetëm mirësija,
dhe ajy Zot'i vërtetë,
edhe gjithë ç'ka në jetë,
te njeriu gjithë janë,
mos kërkko më tjetër'anë.

Naim Frashëri [BN - 525]



Po të bëjmë mirësinë
kemi ndër ne Perëndinë,
kur të bëjmë ligësitë,
kemi djall' e djallëzitë.

Naim Frashëri [BN - 526]

Kur të jemi të vërtetë,
është me ne Zoti vetë.

Naim Frashëri [BN - 527]

Besojmë se Perëndija
është vetë gjithësija
fletore kemi njerinë,
dhe mëndjen' e urtësinë
sepo udh'e Perëndisë
s'është jashtë urtësisë.

Naim Frashëri [BN - 528]

Falje kemi njerëzinë,
miqësin' e mirësinë,
se kur të duam njerinë,
kemi dashur Perëndinë,
s'është lark nga njerëzija
edhe vetë Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 529]

Falëtor' e diturisë
është shesh' i gjithësisë.

Naim Frashëri [BN - 530]

Udh'e mir'e bes' e mirë
është zëmra me mëshirë,
atje 'shtë dhe Perëndija
edh' e tërë gjithësija,
ëngjëlli dhe mirësitë,
djalli me gjithë të titë.
Më një vënt janë të tërë,
kë të duash atë zërë.

Naim Frashëri [BN - 531]

Urtësi e mirësija
na shpije te Perëndija
po të zëmë ligësinë,
do të vemi në greminë.

Naim Frashëri [BN - 532]

Kush njohu vehten' e tija.
e di ç'është Perëndija!

Naim Frashëri [BN - 533]

Te njeriu i mbaruar,
i mir' e i lartësuar
që ka gjithë mirësitë,
e të tëra dituritë,
atje e gjen Perëndinë,
atje tek gjen mirësinë,
sapo vetë Perëndija
mori fytyrën' e tija.

Naim Frashëri [BN - 534]

O njeri! të qofsha falë!
e kupëton këtë fjalë?

Naim Frashëri [BN - 535]

Pa mblith mëndjen' e mendohu,
dhe ngrehu e lartësohu
duke marë dituritë,
që t'a bësh natënë ditë,
sa të muntç ndritohu mirë
mos qëndro në errësi,
nga njeriu i vërtetë
s'ka më të lartë në jetë,
se mëndje e njerëzisë është pesh' e Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 536]

Po njeri themi njerinë
që ka gjithë urtësinë,
ka dritën' e diturisë,
dhe të tëra mirësitë,
ka me vehte Perëndinë,
duke pasur njerëzinë
edhe Perëndija vetë!
të njeriu 'sht e vërtetë!

Naim Frashëri [BN - 537]



Ndaj njeriut të uruar,
që nuk'është' i djallëzuar,
q'është pa faj e mirë
e ka në zëmrë mëshirë,
të këqija s'bën në jetë,
është'i drejt' e i vërtetë
pa ka të lartë vetijë
të bukurë vetëdijë
atje është vetë Zoti,
si kanë thënë qëmoti.

Naim Frashëri [BN - 538]

Edhe ëngjëlli dhe djalli,
gjithë janë tek i gjalli,
dhe parajsa dhe skëterra,
dhe gjithë ç'janë të tjera.

Naim Frashëri [BN - 539]

Pa njeriu s'vdes në jetë,
se s'mbetetë jeta shkretë,
gjithënjë vemi e vimë,
po të parëtë s'i dimë,
rron e ëma dhe i ati
tek i biri jetë gjati,
hëna hahet e venitet,
pa kthehet e përsëritet.

Naim Frashëri [BN - 540]

Po njerinë njerëzija
e shpije te Perëndija,
pa të s'vlen gjë në jetë
se nuk'është i vërttë.

Naim Frashëri [BN - 541]

E drejta edh' e vërteta,
ato janë pa të meta,
kur t'i bjerë njerëzija,
mbetetë si bagëtija,
posi trëndafil'i thatë,
q'i mbesin gjëmbat' e gjatë,
urtësit' e mirësitë,
ato na nxjerrin në dritë.

Naim Frashëri [BN - 542]

Pa lagësi e pështirë
na shpije në errësirë,
se na ndan nga Perëndija,
na shtije te djallëzija.

Naim Frashëri [BN - 543]

Mëntë na i dha në kokë
Zoti, që t'i kemi shokë,
neve kemi mënt të shohim,
të vërtetën t'a njohim,
pesh' e Zotit të vërtetë
mëndja 'shtë në këtë jetë.

Naim Frashëri [BN - 544]

Urtësit' e mirësitë,
drita edhe dituritë
janë udh'e Perëndisë,
q'i duhenë njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 545]

Nuk' e beson Perëndinë
ajy, që s'do njerëzinë.

Naim Frashëri [BN - 546]

Zoti në zëmrë të ndyrë
s'hyri dhe s'ka për të hyrë,
se atje rri djalli vetë,
s'qasetë Zot'i vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 547]

Në ke në shpirt mirësinë,
t'a dish, që ke Perëndinë.
jo, po në ke ligësitë,
ke djallë e djallëzitë.

Naim Frashëri [BN - 548]

Kush punon për njerëzinë,
ka me vehte Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 549]

Kur të bëjmë ç'na ka thënë,
e ç'mënyrë na ka lënë,
të bëhemi njerës fjeshtë,
t'urt' e të but' e të leshtë.

Naim Frashëri [BN - 550]

Të këqija të mos flasim,
njeri kurrë të mos ngasim.

Naim Frashëri [BN - 551]

Të mos vrasim, të mos presim,
në gënjeshtë të mos mbesim.

Naim Frashëri [BN - 552]

Të mos shajm' e të qërtojmë,
kurrë të mos kallëzojmë.

Naim Frashëri [BN - 553]

Të mos hamë gjën' e huaj,
të mos rrojmë posi buaj.

Naim Frashëri [BN - 554]

Të jemi të arësyer,
me zëmër të pa lyer.

Naim Frashëri [BN - 555]

Nakarë edhe zilinë,
vjedhjen edhe kusërinë,
dhe të tëra ligësitë,
ndyrësit' e djallëzitë,
të gjitha poshtë t'i hedhim,
si kafshëtë të mos bredhim

Naim Frashëri [BN - 556]

Të duamë njerëzinë,
Shqipëtarë' e Shqipërinë
gjuhënë e mëmëdhenë,
kombinë e vetëhenë
mirësit' e dituritë,
zotërin' e urtësitë.

Naim Frashëri [BN - 557]

Të kemi vëllazërinë,
dashurin' e miqësinë.

Naim Frashëri [BN - 558]

Të duamë shoku shoknë
të mos e përhapim tokën.

Naim Frashëri [BN - 559]

Qengji, që hiqet më një anë,
egërsiratë e hanë,
të mos kemi ne të ndarë,
gjithë ç'jemi Shqipëtarë,
po të jemi të bashkuar,
të afërt' e të pushuar.

Naim Frashëri [BN - 560]

T'i hedhimë marrëzitë,
babëzit' e laturitë,
ligësin' e djallëzinë
të tërë jezitërinë.

Naim Frashëri [BN - 561]

Të kemi nder' edhe besë,
dhe vëllazëri e ndjesë,
pa të punojmë të tërë
për ç'do punë, që do bërë
të ndritohet Shqipërija,
të na shohë Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 562]

O vëllezrë Shqipëtarë!
Shokë të mir' e të mbarë!
të përpiqemi me besë,
as një më pas të mos jeshë
të mësojmë gjuhën t'ënë
se Zoti na e ka dhënë,
ç'do kombi gjuhën' e tija
i ka dhënë Perëndija,
është lig' e Perëndisë,
gjuha q'i dha Shqipërisë,
gjithëkush ka mëmëdhenë,
edhe zogu ka folenë!
Ka edhe aji fëmijë,
gjë s'e ndan nga bir' e bijë.

Naim Frashëri [BN - 563]



Besa na thotë t'a duash
mëmëdhenë e t'a ruash,
gjuhën e dha Perëndija,
Zoti me të math të tija
j'a ka dhënë njerëzisë,
si mëma foshnjësë sisë,
s'munt të jenë të këqija
ato, që fal Perëndija,
nuk'i thotë këto fjalë
as i marri që mer malë!

Naim Frashëri [BN - 564]

Dhe ju! shpesh! me gjuhët tuaj
flisni, nuk më të huaj!
ti, qyqe më këndon ndryshe
ndryshe ti, o dallëndyshe!

Naim Frashëri [BN - 565]

Mua pse të më shtrëngojnë?
gjuhë t'jatrë të më msojnë?
të harronj gjuhën t'ime
paçin nëm' e mallëkime!

Naim Frashëri [BN - 566]

Do t'i lutem Perëndisë
t'u ap udhën e lirisë
e t'u heqë djallëzitë,
t'u sjellë mëndje dhe dritë
Zot i math e i vërtetë,
pa dashur njeriu vetë,
nukë ja ep djallëzitë,
sikundër dhe mirësitë.

Naim Frashëri [BN - 567]

Botës' i dhanë lirinë,
duke ngrehur parësinë,
të xgjedhënë një të parë,
dhe të urtë, jo të marrë,
lakëmime, madhëritë,
të ligatë, rëndësitë,
gjakëratë, marrëzinë,
mundimetë, robërinë,
të gjitha i kemi prerë

së drejtës i dhamë nderë,
të paudhatë i shtumë,
ligësitë i përzumë,
njerin' e lamë të lirë,
të bënë si është mirë
këto me shumë mundime
u bënë e me hidhërimë.

Naim Frashëri [BN - 568]

Të kini durime,
të jini si burra trime,
puna sido që të ngjanjë,
nonjë nga ju të mos qanjë,
neve na dha Perëndija
kaqë shumë të këqija
që të shohë sa durojmë,
e gjer më ç'vënt e besojmë;
na dha të këqija Zoti
si dhe të tjerët qëmoti
që paskëtaj njerëzija,
kur të heqin të këqija
të mos thonë që s'na deshi
Zoti, po na ther rrebeshi
për njerinë u përpoqmë,
edhe nga njeriu hoqmë
të këqijatë, që pamë,
njeriut mësim j'a lamë,
un' i falem Perëndisë,
që j'a bëri njerëzisë
mundimet t'ona pasqyrë
t'i ketë më çdo mënxyrë,
bregën t'ënë të rrëfejnë,
shpirtinë t'a përdëllejnë;
andaj dhe ju të duroni
si në mësim t'i tregoni;
se i duhet njerëzisë,
që i besoni Perëndisë,
zëmrënë mos e ngushtoni,
dhe Zotë mos e harroni,
sa do të rrojmë në jetë
s'shpëtojmë nga vdekj' e shkretë!

Naim Frashëri [BN - 569]

J'u fal Zotit të vërtetë
me zemërezë të qetë.
Pa pasdaj vate me natë,
dhe pa foshnjazët e gratë!
Do t'a lij këtë të shkretë,
e nisej për atë jetë,
do të ndahej nga fëmija,
e nga gjithë njerëzija!
gra e burra gjithë qanë,
një Zot' e di si u ndanë!
ndahet njeriu për jetë,
më të keqe s'munt të ketë.
Kaqë fuqi zëmrës s'ënë
Zot'i math nuk' i ka dhënë!
këtë s'e duron as guri,
as pem', as lisi, as druri
Duron njeriu i gjorë!
ç'të bënë, s'e ka në dorë,
po kjo është fjal' e vërtetë,
njeri s'ka hequr në jetë,
aqë, sa hoqn'e sa panë
Zotërinjt' e mirë t'anë
po hoqnë për njerëzinë,
për të nderuar njerinë.

Naim Frashëri [BN - 570]

Po ëngjëll i urtësisë
erdhi ng'an' e Perëndisë
i pru ndë zëmrë durime,
j'a bëri nga ç'ish më trime!

Naim Frashëri [BN - 571]

Pa jetëzën e vërtetë,
e rremja j'u duk'e shkretë,
dheu edhe punë e tija
edh' e tërë gjithësisja,
i erdhë fort të pështira,
se j'u çfaq ajo m'e mira,
se po rrojta gjumë quhet;
e vdekja xgjuarje thuhet.

Naim Frashëri [BN - 572]

Falm'edhe mua
lejë, se jetë më s'dua,
s'dua të mbes pas atyre,
të rronj pas kësaj myxyre,
do të vdes, s'rroj dot as pakë
se kam në zëmrë një flakë,
si t'ja bënë i mjeri unë
në jetë më s'më mbet punë
shokëtë gjithë u vranë,
e mua vetëm më lanë!

Naim Frashëri [BN - 573]

Dielli s'duket pa gdhirë,
natënë, në errësirë;
këjo jetë gjumë quhet,
shpirti pas vdekjesë xgjuhet;
njeriu, q'është'i vërtetë,
s'vdes kurrë në këtë jetë,
më sa humbet trëndafil,
er' e tij edhe bilbili,
aqë edhe njerëzija,
ashtu edhe gjithësisja.

Naim Frashëri [BN - 574]

Po sot vdekja s't'është thënë
për tjatrë koh'është lënë.

Naim Frashëri [BN - 575]

Nukë shuhet dera jonë,
kemi ndihmës vetë zonë.

Naim Frashëri [BN - 576]

Po për ty sot s'është shkruar
nga Zot' i math i lëvduar,
pas nesh vjen edhe ti vetë
dhe na gjen në atë jetë.

Naim Frashëri [BN - 577]

Tani të le urtësinë,
dhe durimn' e trimërinë,
udhëzën e Perëndisë
dhe shpëtimn' e njerëzisë,



pa të rrish në këmbët t'ime,
me zemërë plot durime
besënë dhe Perëndinë
e të tërë njerëzinë
mi qaftë tënde t'i lashë
që t'i shikosh si i pashë.

Naim Frashëri [BN - 578]

Kshu tha dhe i dha uratë
djalit t'urt' e jetë gjatë;
i tha ç'kishin thënë,
e i la ç'i patnë lënë;
e puthi me mallëngjime,
me zemërë plot hidhërime!

Naim Frashëri [BN - 579]

Djalënë kshu e mësojti,
edhe gratë i përqafojti
pa u tha: Të mos thërrisni
kuje kurrë të mos nisni,
se është e madhe mëkatë
edhe turp të qajnë gratë
është e mira të duroni,
kështu desh Zoti, të thoni,
po me lot pakëzë qani,
hidhërimnë mos e mbani,
ne Zot' i math i vërtetë
na fali lottë në jetë,
që të qajm' e të dëfnejmë,
zemërenë t'a gënjejmë
se nga gjithë ç'na ka dhënë,
asnjë pa ndihmë s'ka lënë.
Mos pandehni q'u le shkretë
se u le Zotn' e vërtetë,
u le vetë Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 580]

Nukë shuhet dera jonë,
që ka pushtuarë Zonë,
nga neve Zot'i vërtetë
s'e lë shkretë këtë jetë,
bres pas brezi do të vinë

të shpëtojmë njerëzinë!
dhe ju pas do të vini,
se për jetë këtu s'jini
po sa gjall me nder të rroni
udhënë mos e harroni,
me ne kushdo të luftonjë.
Zot'i math do ta mundonjë,
njeriu s'munt t'a gënjenjë,
gjithë sa bën do t'i gjenjë
po ju njerëzit t'i ndjeni,
dhe mirësi t'u rrëfeni
ç'do të hiqni, mos pshoni
zemërë ta xgjeroni
të parët kshu na thanë,
e këtë besë na lanë.

Naim Frashëri [BN - 581]

Kshu tha me zemërë të qetë
Zoti trim, burr' i vërtetë,
dhe u ngrit me vrap' e dolli
fëmija gjithë' e përsolli!
e përsolli duke qarë,
popo! për jetë të ndarë!

Naim Frashëri [BN - 582]

Qysh të ndahen më të gjallë
e si t'a mundinë mallë!
e popo! kulm' i shtëpisë!
mbret i gjithë njerëzisë!

Naim Frashëri [BN - 583]

Po ajoy Zot s'doj të dinte,
thoshnje se më dasmë vinte!

Naim Frashëri [BN - 584]

Kur i hipi kalit trimi,
grat'i mbyti mallëngjimi,
kal'i math posi hastriti,
këmbët e para i ngriti,
pa erdh' e u ashpërua,



posi dragoj u harbua,
nga goja flakë po nxirte,
frenë nër dhëmbë e mirte,
shkrefëtint' e hingëllintte,
dhen' e qiejt' i trëndintte!

Naim Frashëri [BN - 585]

S'më vjen keq për derët t'ënë
se nga Zoti kshu qe thënë,
po më vjen për Mëmëdhenë
dhe për besën' e për fenë,
më vjen keq për njerëzinë
që i dhatë arratinë.

Naim Frashëri [BN - 586]

Jetë; o e shkreta jetë,
je e rremë, s'j'e vërtetë!
gazi dhe helmi, që vinë,
shkojnë prapë, shumë s'rrinë;
Kthehen ndër na duke shkuar,
po t'i presim pa rënduar,
gjithë ç'pjell e shkreta jetë
i ha prapë ajo vetë.

Naim Frashëri [BN - 587]

Ju kuxuat' e na shatë
dhe na shuat' e na vratë,
po këtë të madhe plagë
Zoti nuk' e le pa shpagë!

Naim Frashëri [BN - 588]

Kshu tha dhe nga zëmr' e gjerë
psherëtiti fort një herë!
pa zu ngoje Perëndinë,
dhe mblodhi gjithë fuqinë,
unji kokën, j'u fal Zotit,
fuqimath mëshirëplotit!

Naim Frashëri [BN - 589]

Zot'i math! O Zot' i mirë!
falna durim e mëshirë!

Naim Frashëri [BN - 590]

Zoti është me të mirën
nuk është me egërsirën,
do të drejtën, të vërtetën,
se me ato e mban jetën
të ligënë kush t'a bënjë,
më së fundi do t'a gjenjë,
të drejtënë kush t'a lerë,
n'errësirë do ta bjerë!

Naim Frashëri [BN - 591]

Udhën e drejtë e patë,
pse s'e mbajtë, po e latë?

Naim Frashëri [BN - 592]

Ajy, që bën ligësitë,
bije në të madhe shkitë.

Naim Frashëri [BN - 593]

Djallëzi e ligësija
është lark nga Perëndija,
edhe gjithë djallëzitë,
s'dalënë kurrë në dritë.

Naim Frashëri [BN - 594]

Zoti u tha të gjykoni,
me të drejtë të punoni,
u tha të kini mëshirë,
të bëni nga herë mirë
të drejtënë mos e lini,
në arrati të mos bini,
të mos lini njerëzinë
të mos e ngisni njerëzinë,
mizën u tha të mos ngisni
e ju njerëzinë vrisni!

Naim Frashëri [BN - 595]

S'dëgjuatë Perëndinë!
po bëtë zot djallëzinë!
latë më nj'anë uratën,
muartë dëmn' e mëkatën!
lat'udhën e Perëndisë,
i ratë pas djallëzisë!

Naim Frashëri [BN - 596]



Njëri xgjodhi të vërtetën,
la gënjeshtrenë e të metën,
tjatëri mori të rremen,
vu përpara thash' e themen.
njëri i pat Zotit mallë,
e tjatëri zgjodhi djallë.

Naim Frashëri [BN - 597]

Pa qasuni, Shqipëtarë,
Zot'i math e sjelltë mbarë,
të zëmë vëllazërinë
mirësin' e miqësinë,
jemi të gjithë një farë,
e nukë jemi të ndarë,
vëllezrë të tërë jemi,
një shpirt e një zëmrë kemi
gjithë rrojmë me një shpresë,
dhe kemi gjithë një besë.

Naim Frashëri [BN - 598]

Lum të mirëtë ku venë!
sa çpërblim nga Zoti gjenë!

Naim Frashëri [BN - 599]

Ç'është' e mirë miqësija
në të tilla të këqija!

Naim Frashëri [BN - 600]

Njëriu ç'është' i gënjyer!
Zëmrënë e ka të thyer!
shumë herë le të mirën,
dhe xgjedh e mer errësinë!
le më një anë Perëndinë,
rrëmben djall' e djallëzinë,
heth dritën' e të vërtetën!
mer të rremenë të shkretën,
pa le edhe njerëzinë,
mirësin' e urtësinë,
i vete pas ligësinë,
le dritën e Perëndisë!

Naim Frashëri [BN - 601]

Se Zoti j'a la në dorë
gjithë njeriut të gjorë,
po i dha mënt që të njohë,
e të drejtënë ta shohë.

Naim Frashëri [BN - 602]

Mirësi e ligësija,
djalli edhe Perëndija,
dhe parajsa e skëtterra,
e gjithë ç'janë të tjera,
te njeriu gjithë janë,
ata që dinë kshu thanë,
i gjen ndaj teje të tërë
kë të duash atë zërë.

Naim Frashëri [BN - 603]

Është si foshnjë njeriu,
po t'i këllaç djallëzinë,
e mahnit fare njerinë,
bëhetë si egërsirë,
dhe soje s'vjen pun' e-mirë.

Naim Frashëri [BN - 604]

Kur t'i tregosh urtësinë,
e bën si ëngjëll njerinë.

Naim Frashëri [BN - 605]

Ligësi shumë' u rrëfye
andaj bota ngriti krye.

Naim Frashëri [BN - 606]

Një njeri që është' i parë,
është shumë nënë barrë
dhe ndaj zotit të vërtetë,
dhe ndaj njeriut në jetë,
bariu ka bagëtinë,
i madhi sheh njerëzinë,
s'i bëjnë dëm bagëtisë
qyesh t'i bëjmë njerëzisë!

Naim Frashëri [BN - 607]



Në t'errët po thua jemi!
s'dimë nga vim' e ku vemi!
gjithë shokëtë që shkuan,
një fjalëzë s'na dërguan!

Naim Frashëri [BN - 608]

Nga ajy Zot' i vërtetë
vemi e vimë në jetë!
nga'ajy vimë, atje vemi,
tjatër gjë s'mundim të themi.

Naim Frashëri [BN - 609]

Po, të themi, dhe kjo jetë
nuk mbetet kurrë shkretë,
pshihetë vetë i ati
tek i biri, jetë-gjati!

Naim Frashëri [BN - 610]

Mbas një lufte një lua
Po merr rrugën me shkue n'shpi,
Kur prej zjarrmit shef se shkri
Ishte shpia e s'kish mbet'gja:
Rrin e këqyr e nuk loton,
As ban dënesë, as ban ankim;
Veç këto fjalë' i tha si trim:
"Kam fuqin' kjo m'mjafton".

Ndre Mjeda [BN - 611]

At rrugë, ku mir'jeton,
N'e ndrrosh pa arsye, gabon.

Ndre Mjeda [BN - 612]

Egjra që rritej
Grunit përbri,
Nji dit' i foli
Si me kreni:
"Pa kurrfarë mundit,
Pa një kujdes,
Un'kallx e kokrra
Bri tejet qes.
Ty me djersë t'ballit

T'vin'rreth puntortë,
E me m'bërri mue
I ngjiat kaq t'ortë".
Ia priti gruni:
"Mos u kreno,
Se gjaja e keqe
Rritet sido."

Ndre Mjeda [BN - 613]

Po çfarë bëjnë ata t'mjerë në anije,
të munduar kaq fort prej stuhisë?
Një vullnet aty mes fatkeqësisë
shpërthen n'britmën: Pra, duhet luftuar!

Pashko Vasa [BN - 614]

Për të ngrën'e për të pirë
Nukë munt të shes lirinë.
I varfëri rron më mirë
S'ai që do madhërinë.

Çajupi [BN - 615]

S'më duet ergjëndi mua,
Dua lirinë dhe nderë,
Dua të bëj si të dua,
Jo si duan të tjerë.

Çajupi [BN - 616]

Kush munt e bën si do vetë,
Bën si thotë Perëndia;
Nukë ka në këtë jetë
Gjë m'e vyer se liria.

Çajupi [BN - 617]

Ndëgjoni, more të ri,
Ndëgjoni dhe ju të ra:
Duani atë që di,
Jo atë që ka para!

Çajupi [BN - 618]



Dil sa pa rënë nata e gjatë,
sa pa të marrë Harrimi osh.
Në këtë botë të pamatë
të rrosh, përkthehet: Të luftosh!

Xhevahir Spahiu [BN - 619]

Të zgjohësh vonë do të thotë
lulet t'i gjesh pa vesë, kokëvarur.
Të zgjohësh vonë do të thotë
dashuria të ketë lënë veç hijen.
Të zgjohësh vonë do të thotë
vdekja të ketë hedhur firmën.
Megjithatë, ti, zgjohu.

Xhevahir Spahiu [BN - 620]

Kërkove namin, e përbuzjen gjete;
thirre dashnin, e t'u përgjigj mëniya;
visaret e panjofne qi ndryn n'vete
more me i fal', por s'i pëlqei kurrkush:
me njëqind maska t'u ngërdhesh Shpotija.
E andrra diq, e shpirti n'helm u mbush.

Ernest Koliqi [BN - 621]

Vuej por mos hesht. E prap shikimet sielli
kah maja e malit ku do t'len agimi,
këndo n'errsi derisa t'dridhet qielli
e t'derdhet ari i rrezeve kah ti.
Vuej, por mos hesht. Këndo me shpres' ngadhnimi
tuej ec'kah kreshtat ku Lavdija rri.

Ernest Koliqi [BN - 622]

Syve qi kurr s'ia pan fytyrën Zanës
për çdo shokim të shtrembtë epu një rreze;
arbnorit qi përbuz' qumshtin e Nanës
kndoj fisnikin qi ai qumshtë ushqen në gjak;
paprash dëshirin nëpër zemra ndeze
m'e ndihmue t'drejtin pa u frigsue aspak.

Ernest Koliqi [BN - 623]

Me njëmij' gjuhna fishkulluese Smira
ka m'e përsjellun udhës kangën t'ande;
ti delu para agimeve ma t'lira
pa ia vu veshin turmës qi prozhmon:
mjaftoi vetvetes, gjej ma t'madhen ande
n'kangën kumbore qi mbi buz' t'lulzon.

Ernest Koliqi [BN - 624]

Mjer' ata që do gënjehen,
të besojnë si fëmi,
do vij' dita që të qajnë,
të gjakosur, n'agoni.

Polifonia labe [BN - 625]

Kur ta zgjedhësh vashërinë,
mos u vështro bukurinë.

Gjirokastër [BN - 626]

S'është çudi në këtë jetë,
Midis miqsh ka dhe "armiç",
Helm i egos i ngërthen ...
Dhe i bën vërtet të liq!

Timo Flloko [BN - 627]

Mos u lig, mos u mpak,
Thotë vetvetja, je një hiç,
I pavlerë në këtë botë,
Po nuk pate dhe "armiç"!

Timo Flloko [BN - 628]

Sa herë ndodh që një triumf,
T'i bën fir të paktët miq,
Hijen fshehin, maska venë,
Fundin lusin si "armiç" ...!

Timo Flloko [BN - 629]

I thotë vetvetes: “Ç’bëhesh makut?
Një ditë do vdesësh edhe ti.
Sa kohë që lodhesh me intriga,
puno të lësh një mirësi...”

Teodor Keko [BN - 630]

Perëndia, zotëri,
vetëm jep atë që ti
jo e do e dëshëron
po vepron, vepron, vepron.

Ali Asllani [BN - 631]

I ka hije detit vala, i ka hije kalit shala,
po më shumë nga të gjitha, i ka hije burrit fjala!

Ali Asllani [BN - 632]

Kjo është vetëm nisja juaj,
Por do të rritesh do të kuptosh
Se fatet s’janë njësoj.

Zhuliana Jorganxhi [BN - 633]

Bekimin merr nga mua
O shpirt i patrazuar
Një fjalë të thënë ma dëgjo
Zinxhirë të praruar
Ty kanë për të ofruar
Por prapë do të jetë skllavëri.

Zhuliana Jorganxhi [BN - 634]

O shpirti im,
mos bjer në dëshpërim.
S’u mbytën ëndrrat tona
në detin e trazuar,
në këtë mjerim pa fund.

Alqi Boshnjaku [BN - 635]

Mos më kërkoi.
Dhe le të ikim larg
të bëjmë pakëz dritë.
E sado pak,
në këtë errësi të gjatë.

Alqi Boshnjaku [BN - 636]

Ej, ti që mban trishtim,
Jo, Jo, Jo, mos prit lufto!
Bëj dritë si një Naim.
Dhe jeto!

Alqi Boshnjaku [BN - 637]

O ti zemër njerëzore,
pa dëgjoje zërin tim,
fal se jeta është e shkurtër,
se jeton dhe një pendim.

Alqi Boshnjaku [BN - 638]

Për Fe e Atme n’ball me i dal rrezikut:
Të ligështit doren me ia një të t’fortin
Mos me e gledhue kur t’jet me u thanë e drejta,
Mos me u shmangë syt prej cakut, n’cilin mendja
Dishron me u kapë, as kurr mos me u ligshue
Nder sa t’vishtira, qi t’na sjellin motet.

Gjergj Fishta [BN - 639]

Veç një qëllim i naltë t’ban me durue,
E zemrën ta forcon;
Ndër kundërshtime s’vjen kurrë me u ligshue
Mjerë ai qi nuk qindron!

Luigj Gurakuqi [BN - 640]

“Pikëllimi nuk njih kufij, por as dashuria”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 641]

“Jeta jote është të japësh, të duash dhe të jesh
dëshmitare e dashurisë së Zotit ndaj të tjerëve”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 642]

“Njerëzit janë të varfër, ngaqë janë të detyruar
të jenë të tillë. Ne jemi të varfër për dashurinë e
Zotit dhe të njeriut”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 643]



“Isha e sigurt se ky ishte zëri i Zotit. Isha e sigurt se ai më thërriste mua.

Mënyra se si më thirri nuk duhet të të preokupojë, se kjo është diçka midis Zotit dhe meje: ç’është me rëndësi, është se Zoti e thërret secilin në mënyrë të ndryshme. Ne nuk kemi ndonjë meritë. Ajo që është shumë me rëndësi është që t’i përgjigjemi me gëzim thirrjes së tij. Unë tani jam aq e sigurt sa ç’kam qenë në ato çaste të rënda dhe dramatike se kjo ishte punë e Zotit dhe jo e imja. Dhe, pasi që kjo ishte punë e Zotit, unë e dija se bota do të përfitonte, se ai do të përdorte varfërinë time, dobësinë time dhe jetën time për t’ua dhënë më të varfërve nga të varfërit dashurinë e Tij...”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 644]

“Misioni ynë është t’i sjellim dashuri secilit, do të thotë të sjellim Zotin”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 645]

Familja, që lutet së bashku, mbetet tok, fryt i lutjes është feja, fryt i besimit është dashuria, fryt i dashurisë është shërbimi i ndërsjelltë ...”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 646]

“Duajeni njëri – tjetrin siç ju do Zoti. Ne do të qëndrojmë të bashkuar nëse lutemi, ngaqë urata ushqen besimin dhe besimi ushqen dashurinë. Nëse ne besojmë dhe dashurojmë, atëherë do të mund të bëjmë diçka të bukur për Zotin dhe për të tjerët”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 647]

“Kudo ku jeta është në rrezik, aty duhet të jemi ne.”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 648]

“Dashuria jonë kurrë nuk duhet të ketë kufi, nëse është dashuri e vërtetë, ajo duhet t’i ngajë asaj të Zotit, që nuk përjashton askënd”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 649]

“Nuk mund të duash pa bërë diçka për të ndihmuar ata që kanë nevojë”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 650]

“Njeriu duhet të marrë atë që është e mirë nga secili, duke bërë çmos për të luftuar të keqen. Ka aq shumë vuajtje në botë, aq shumë të liga, por edhe aq shumë të mira”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 651]

“Njeriu duhet të ketë zemër të thjeshtë dhe të pastër, të pranojë vullnetin e Zotit dhe pastaj çdo gjë është e lehtë”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 652]

“Nëse dëshironi të jeni të lumtur, duhet të këni zemrën përplot dashuri dhe kjo dashuri bartet përmes punës suaj, shërbimit, me të cilin duhet ta takojmë secilin.

Sot njerëzit janë shumë të zënë me punët e veta, hallet, me rutinën e punës dhe të jetës së tyre, prandaj nuk kanë kohë për veten e tyre e lëre më për të tjerët.”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 653]

Zot'i math, q'ep idhërimnë,
e helmon njerin' e gjorë,
i fal edhe përdëllimnë,
se çdo gjë e ka në dorë;
më nj'an' i ep idhërimnë,
më nj'anë durim e shpresë,
m'anët t'jatrë mundimnë,
për çdo derë ka një lesë.

Naim Frashëri [BN - 654]

“Të muntjë e të fitonjë
njeriu’ shtë pun’ e mirë,
po më mirë të duronjë
është’ e të ketë mëshirë!”

Naim Frashëri [BN - 655]

Mbreti trim, me të dëgjuar
këtë fjalë, qeshi pakë,
dhe shokët duke vështuar
me atë vështrim si flakë,
u tha: “E shkreta nevojë
sa mir’ e mëson njerinë,
mjalt’i vë brënda në gojë
i bijë gjith’ urtësinë!”

Naim Frashëri [BN - 656]

Sidoqoftë, gjithsekush çdo besim ta repektojë.

Naim Frashëri [BN - 657]

Thotë e n’gaz vë buzën e tij:
“Shkojmë n’udhë të Zotit, bij!”

Zef Serembe [BN - 658]

“Do ta marr një gur, do ta vë në gji,
ta kem si kujtim, porsì top flori.
Oh, seç bëra unë, mos e bëni kurrë,
ikja nga vatani është’ e keqe punë!”

Delvinë [BN - 659]

Kam shitë mikun, kam la borxhet.

Shkodër [BN - 660]

Kafshët edhe bagëtinë, që u ka kaqë nevojë,
Njeriu duhet t’i shohë, t’i ketë kujdes, t’i dojë.
Të mos t’i mundojë kurrë, po si fëmijë t’i kemi,
Është mëkat edhe fjalë të ligë për to të themi.

Naim Frashëri [BN - 661]

Qyteti për banorët zë fill nga qendra
kurse për udhëtarin – nga periferitë.

Agron Tufa [BN - 662]

“Shpërblimi më i madh është ta duash Zotin.
Ai është çdo gjë për mua ... Gjëja më e bukur
për mua është të jesh në gjendje të vësh në jetë
dashurinë universale, sidomos ndaj atyre që
vuajnë”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 663]

“Nuk ka rëndësi se ku do të përfundojë trupi
im. Ajo që është me rëndësi është se unë e gjej
veten duke jetuar në amshim me Zotin”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 664]

“Gjëja më e madhe për mua do të ishte të
bëj që të mbretërojë dashuria universale të
mbretërojë, sidomos për ata që vuajnë”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 665]

“Unë dua të jem prania e dashurisë hyjnore në
mesin e njerëzve.”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 666]

“Bota e sotme është në kërkim për Zotin dhe ne
duhet ta ndihmojmë këtë, ne duhet të zbulojmë
dhe të jemi dëshmitarë të Zotit, sidomos përmes
dashurisë”.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 667]

“Nëse kam bërë diçka të keqe, faji është
imi, nëse kam bërë diçka të mirë, atëherë të
faleminderit, o Zot. Jeta jonë është të thuash
“faleminderit” dhe “më fal””.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 668]



Frikohemi prej vdekjes vetëm atëherë kur nuk e kemi ndërgjegjen e pastër,
kur frikësohemi të gjendemi para vetvetes,
mu për këtë shumë njerëz fikësohen prej vdekjes:
sepse frikohen të ballafaqohen me të vërtetën,
të ballafaqohen me vetveten
duke shikuar Zotin.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 669]

“Gjëja më e rëndësishme është ajo që ndodh në zemrat tona. Të jeni gjithmonë bartës të dashurisë dhe të paqes”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 670]

“Heshtja e varrit lypset përjetuar dhe interpretuar me çelësin e fesë, të dashurisë”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 671]

Kur dua të di ku i pushkatojnë ata të mirët që më s’do të jenë dal në dritare fill pas krismave e vështroj korbat ku do të venë.

Kujtim Murati [BN - 672]

Trëndafiletë q’u thanë,
thua se më nukë janë,
i sjell me lulet e tjera,
gjithnjë vin’ edhe venë,
janë prap’ ato që qenë.

Naim Frashëri [BN - 673]

Njeriu ka nevojë të këndojë për njeriun e lindur
Në kohën kur emrin ia ve për ta mbajtur në shekuj,
Njeriu ka nevojë të qajë hidhur
Për të dashurin, njeriun e vdekur.
Njeriu ka nevojë të fshijë frikën, skamjen, urinë
Njeriu ka nevojë të shohë lirinë.

Dritëro Agolli [BN - 674]

Gjuhë të ndryshme,
raca të ndryshme,
ëndërra e njëjtë-fytyrë njerëzore.

Bardhyl Londo [BN - 675]

Nëse do të dalë ndonjëri të pyesë:
I ç’race ish, çfarë ngjyre kish?
Ti me gjuhën që ligjëroi Naimi
“Njeri” – do të përgjigjesh sërish.

Bardhyl Londo [BN - 676]

Gjërat që kam bërë janë gjërat që kam përreth.
Brenda vetes i kam gjërat që prisha.

Parid Teferiçi [BN - 677]

Ka gjëra lakuriqe që s’janë të turpshme,
Siç ka dhe gjëra të çndershme të veshura mirë.

Dritëro Agolli [BN - 678]

Do të na duhet shumë kohë
sa të kuptojmë sa të ndryshëm jemi nga vetja
por vonë do të jetë.

Parid Teferiçi [BN - 679]





Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë.

Naim Frashëri [BN - 680]



Mëmëdhe qhet toka,
 Ku më ka rënurë koka,
 Ku kam dashur mëm' e atë,
 Ku më nje dhe gur' i thatë,
 Ku kam pasur shtëpinë,
 Ku kam njohur Perëndinë,
 Stërgjyshët ku kanë qënë,
 Dhe varret q'i kanë vënë,
 Ku jam rritur me thërrime,
 Ku kam folur gjunë time,
 Ku kam fis, e ku kam farë,
 Ku kam qeshur, ku kam qarë,
 Ku rronj me gaz e me shpresë,
 Ku kam dëshirë të vdesë.

Çajupi [BN - 681]

Qjell me shkaba shqipëtar!
 Male mbushur me dragona!
 Këto fusha derdhur n'ar,
 Deti plot margaritar-
 Këto janë viset t'ona!

Lasgush Poradeci [BN - 682]

Këtu leu që në fillim
 Trim'i dheut si zog i shkruar;
 Leu dh'u la për trashëgim
 - Me nderim e me qëndrim -
 Besa jon' e shentëruar.

Lasgush Poradeci [BN - 683]

Ha! dhe'e bukura liri
 Këtu mbretëroj përjetë:
 Mbretëroj: e plot mëri,
 Bëri në rezik të zi
 Prej kujtdo një trim me fletë.

Lasgush Poradeci [BN - 684]

Atje lejn, po, Toskë e Gegë,
 Si dy rreze n'flakë t'nji dielli:
 Si dy rrafe, qi shkojn te djegë,
 Kur shkrepë reja nalt prej qielli.

Gjergj Fishta [BN - 685]

Te ky vend ku jemi rritur
 Në një djep bërë me dru
 Kemi lindur, kemi vdekur
 Varret tona janë këtu!

Jorgo Papingji [BN - 686]

Ma kanose, syrgjynose
 Më dërgove s'di se ku
 Kemi ikur, kemi ardhur
 Trojet tona janë këtu.

Jorgo Papingji [BN - 687]

Ma tymose, ma nxirose
 Ma plagose qiellin blu
 Jemi gdhir'e jemi ngrysur
 Yjet tona janë këtu!

Jorgo Papingji [BN - 688]

S'jam tribu, s'jam tribu
 Ne k'to troje s'jam tribu
 Kam lindur në k'të tokë
 Dhe do vdes këtu!

Jorgo Papingji [BN - 689]

Brez pas brezi hapëm shkëmbin
 Me parmendën bërë me dru
 Kemi mbjellë e kemi korrur
 Rrënjët tona janë këtu!

Jorgo Papingji [BN - 690]

Morëm dritë nga faq'e diellit,
 Gjyhën tonë e bëmë me nur
 Shpendin e lirisë së qiellit
 Përmbi gjak e bëmë flamur.

Jorgo Papingji [BN - 691]

Sa bajlozë këtu dërgove,
 Mbret e krajla me ushtri
 Po shqiptar më mbeti emri
 Edhe vendit Shqipëri!

Jorgo Papingji [BN - 692]



Flamuri i ynë, që, u nis përpara:

Ndihmo, Zot, për Atme e Fe!

Gjergj Fishta [BN - 693]

Dua dhe Shqipërinë,
Se atje kam shtëpinë,
Ku rinja nëpër ferrat
Edhe losnja me shqerrat.
Për këto kam dëshirë
Edh'as dua më mirë,
Veç atje dua të shkonj,
Sa të jem e sa të ronj.

Asdreni [BN - 694]



Edhe atij i u thaftë, po, goja,
Qi e përbuzë kët gjuhë hyjnore;
Qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
Flet e t'veten len mbas dore.

Gjergj Fishta [BN - 695]



Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël! Sa e gjerë!
Sa e lehtë! Sa e lirë!
Sa e bukur! Sa e vlerë!

Naim Frashëri [BN - 696]

Geg' e Toskë, Malci jallia
Jan' një komb, m'u da s'duron:
Fund e majë një a Shqypnia,
E një gjuhë t'gjith' na bashkon.

Ndre Mjeda [BN - 703]

Pa shihni ç'gjuh' e mirë!
Sa shije ka e hije,
Ç'e bukur edh'e lirë,
Si gjuhë Perëndije!

Naim Frashëri [BN - 697]

Kjoft mallkue kush qet ngatrrime
Ndër kta vllazën shoq me shoq:
Kush e dan me fjal' e shkrime
Ça natyra vetë përpoq.

Ndre Mjeda [BN - 704]

Kjo 'shtë mëm' e mirësisë,
Që bie qytetërinë,
Gasthin' e vëllazërisë,
Njerëzin' e miqësinë.

Naim Frashëri [BN - 698]

Pra, mallkue njëi bir Shqyptari,
Qi ketë gjuhë të Perëndis,
Trashigim, qi na la i Pari,
Trashigim s'i a len ai fmis;

Gjergj Fishta [BN - 705]

Përmbi za që lëshon bylbyli
Gjuha shqype m'shungullon;
Përmbi erë që nep zymbyli
Pa da zemrën ma ngushllon.

Ndre Mjeda [BN - 699]

Edhe atij i u thaftë, po, goja,
Qi e përbuzë kët gjuhë hyjnore;
Qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
Flet e t'veten len mbas dore.

Gjergj Fishta [BN - 706]

Ndër komb tjerë, ndër dhena tjera
Ku e shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m'rreh zemra e mjera
E prej mallit derdhi lot.

Ndre Mjeda [BN - 700]

Në gjuhë shqype nanat t'ona
Shi prej djepit na kanë thanun,
Se asht një Zot, qi do t'a donna:
Njatë, qi jeten na ka dhanun;

Gjergj Fishta [BN - 707]

Njikto gjuhë që jam tuj ndie
Janë të bukra me themel;
Por prap kjo, si diell pa hije
Për me t'tanave ju del.

Ndre Mjeda [BN - 701]

Edhe shqyp na thanë se Zoti
Per Shqyptarë Shqypnin e fali,
Se sa t'enden stina e moti,
Do t'a gzojn kta djalë mbas djali.

Gjergj Fishta [BN - 708]

Por gazmo ndër gjith'kto t'vështira
Përse ende s'sharrove krejt;
Diçka t'mbet ndër ato t'mira
Mbas dy mij' e ma shum vjet.

Ndre Mjeda [BN - 702]

Pra, Shqyptarë, çdo fes qi t'jini,
Gegë e Toskë, malci e qyteta,
Gjuhen t'uej kurr mos t'a lini,
Mos t'a lini sa t'jetë jeta,

Gjergj Fishta [BN - 709]



Por per te gjithmonë punoni;
Pse, sa t'mbani gjuhen t'uej,
Fisi i juej, vendi e zakoni
Kanë me u mbajtë larg kambet s'huej.

Gjergj Fishta [BN - 710]

Nper gjuhë shqype bota mbarë
Ka me u njohtë se ç'fis ju kini,
Ka me u njohtë ju per Shqyptarë:
Trima n'za sikurse jini.

Gjergj Fishta [BN - 711]

Prandej, pra, n'e doni fisin,
Mali, bregu edhe Malcija
Prej njaj goje sod t'brohrisin:
Me gjuhë t'veten rrhoftë Shqypnija!

Gjergj Fishta [BN - 712]

Vjen një shqipe e bukur me krahë të pushton,
është vallë shqipe, apo zemra jonë?

Bardhyl Londo [BN - 713]

“Meqënëse asnjëri nga besimet nuk ishte në gjendje t'i bashkonte shqiptarët mbi një platformë fetare, gjuha u bë motori kryesor duke qenë krejt e dallueshme nga gjuhët sllave e greke [BN -] të fqinjëve të drejtpërdrejtë. Gjuha shqipe ishte i vetmi faktor që mund të bashkonte identitetet e ndryshme krahinore e fetare”

Ger Duijzinks [BN - 714]



Gjithë ç'jemi Shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Kemi të tërë një shpresë,
Një gjak, një gjuhë, një besë.

Naim Frashëri [BN - 715]

Shqiptarët mund të krenohen që trashëgojnë dhe ruajnë një sërë vlerash të mira tradicionale njerëzore, qytetare, familjare, një sërë rregullash të çmuara bashkëjetese demokratike dinjitoze në bashkësi, fqinjësi, një sërë normash solidariteti fisnor e krahinor. Por për shkaqe të ndryshme shqiptarët nuk kanë mundur ende që këto vlera t'i ngrenë në nivelin e duhur të organizimit të përsosur shtetëror të përbashkët e të pavarur për gjithë shqiptarët. Shoqëria shqiptare nuk ka arritur të sigurojë përputhjen e duhur të vlerave të mira të funksionimit të mekanizmave tradicionale të bashkëjetesës me mekanizma të mirëfilltë të organizimit të jetës moderne shtetërore. Përputhja e traditave të mira me nivelet e larta të zhvillimeve të shoqërisë moderne është bërë sot një proces i zhvillimeve të vrullshme tek shqiptarët, që shtron shpesh probleme, që kërkon vëmendje e përpjekje dhe që prodhon edhe vështirësi të caktuara me ndikime mbi karakterin individual e shoqëror të shqiptarëve. Shqiptarët shpesh kanë treguar se janë në gjendje të përballojnë mirë edhe problemet më të vështira në kushtet e mungesës së një jete shtetërore të përsosur. Por kanë shfaqur edhe dobësi kur është fjala për të kapërcyer shpejt e me lehtësi pengesat për të ndërtuar një jetë shtetërore të përsosur e të konsoliduar përfundimisht. Kjo ka lidhje edhe me disa aspekte të karakterit individual e shoqëror të shqiptarëve që duhen përpunuar. Shqiptarët në përgjithësi dallohen për një shkujdesje në fokusimin e aspiratave, interesave e përpjekjeve bashkësore. Tregojnë prirje të tepruara individualiste në perceptimin e realitetit

rrethues, në konceptimin e detyrave individuale e bashkësore. Shpesh u mungon edhe disiplina e duhur në përballimin e problemeve që mund të shtrohen e të zgjidhen vetëm bashkërisht. Nga kjo vjen dhe njëfarë moskokëçarje në ndërtimin e një modeli të ngurtësuar të veprimit shoqëror bashkësor. Kjo shpjegon edhe një rendje të tepruar pas huazimeve të modeleve të trajtimit të veprimtarive shoqërore, njëfarë skajshmërie në kërkimin e pranimin me lehtësi të modeleve të huaja, pra njëfarë pragmatizmi i tepruar në pranimin e modeleve të të tjerëve që shpesh nuk përputhen me natyrën e karakterin individual e shoqëror shqiptar. Shpesh është vënë re shfokusimi i mendësive dhe i mobilizimeve shqiptare, duke anuar nga zgjidhje të papërshtatshme me natyrën dhe jetën e shoqërisë shqiptare. Në dallim nga shumë popuj dhe kombe të tjerë tek shqiptarët fokusimi nacionalist në perceptimin e trajtimit e problemeve me të cilat atyre u është dashur të përballen ka qenë më i dobët. Kjo është shoqëruar dhe me një disiplinë të mangët individuale e shoqërore në përballimin e problemeve të mëdha që u kanë dalë shqiptarëve, me mungesën e këmbënguljes për t'iu përkushtuar për një kohë të gjatë zgjidhjes së problemeve të vështira. Kjo ka bërë, për mendimin tim, që shqiptarët të tregohen shpesh shumë refraktarë ndaj pranimin të disiplinës së rreptë të organizimit shtetëror të shoqërisë.

Natyra e karakteri i shqiptarëve janë të hapur, të ndikueshëm, por njëkohësisht shumë të qëndrueshëm, janë polivalentë, por edhe të patjetërsueshëm.

Abdi Baleta [BN - 716]

“Shumë popuj të Bizantit preferonin të ruajnë fenë e të humbasin lirinë ... shqiptarët gjithmonë kanë parapëlqyer lirinë e pasurinë, aq më tepër që dhe vetë tradita e lashtë si dhe karakteri i tyre nuk shkonte fare përshtat me fenë e krishterë ... Feja e krishterë mbështetet tek mëshira. Shqiptari nuk e do mëshirën, por admirimin”.

Aristidh Kola [BN - 717]



Gjithë ç'jemi Shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Kemi të tërë një shpresë,
Një gjak, një gjuhë, një besë.

Naim Frashëri [BN - 718]

Shqiptarë ne na thonë,
bëjmë si ç'kemi zakonë,
O shokë, ndë kemi besë,
kush ka lindur dhe do vdesë,
Ndë u vra nga trimëria,
Namin e merr Shqipëria.

popullore [BN - 719]

S'jemi grekër, as bullgarë
as gjë tjetër nuk jemi
jemi vetëm shqipëtarë
ne kët' emër nder e kemi.
Ky emër' është shumë i mirë
Se më s'jemi të gënjyer,
Nukë jemi n'errësirë,
E njohëmë gjën' e vyer.
Perëndija na e lëntë
Përjetë ta trashëgojmë
Edhe kurrë mos e dhëntë
T'a humbim a ta harrojmë!
Të lëmë mëmën tënë
E të marrim një shtrigë,
Zoti mos e pastë thënë!
Pun' e keq' e shumë e ligë.

Naim Frashëri [BN - 720]

Shqipëtarët janë trima.
na shpëtoftë Perëndija,
bijenë si vetëtima!
Janë burra kordhëtarë,
edhe trima të vërtetë,
luftëtarë e të parë,
janë trimërija vetë;
t'atillë trima s'ke parë,
janë gjithë të mësuar,

njeri s'e munt shqiptarë,
ta dish ne sa kemi vuar!
Pale aju mbreti vetë!

Naim Frashëri [BN - 721]

Të përkulur pas një parmende në muzg,
Të zinte gjumi.
Nën qiellin pus.
Dhe ëndërroje kaq pak lumturi,
Sa në botë s'ka ëndërruar njeri.

Ismail Kadare [BN - 722]

Plloça-plloça varg shtëpitë,
çdo shtëpi ka një copë mal.
Në kalldrëmet e rrëpirë
ati im u rrit shqiptar.

Teodor Keko [BN - 723]

Linde ti për të qenë i lir', shqiptar.

Lirim Deda [BN - 724]

Përmbi truallin tënd e pështete kokën,
Në çdo gëzim e shqotë, o shqiptar!

Lirim Deda [BN - 725]

Lumenjt' kurrë s'lodhen duke rendur në det.
As ti s'u ndale jo drejt lirisë.

Lirim Deda [BN - 726]

Nënë Shqipëri!

Mblidhen rreth teje burrat me thinjë të lashta,
Mblidhen rreth teje vajzat dhe djemtë si zogjtë,
Me tokën tënde në duart e ashpra,
Me hekurin tënd në supet e fortë.
Mblidhen rreth teje ata që të ngritën në qiej,
Ata që të dolën zot në furtunë,
Ata që të zbritën mbi male me mijëra diej,
Ata që të dhanë liri, paqe e punë.

Dritëro Agolli [BN - 727]

Po ndonëse dini vetëm fluturime
Dhe ngado shkoni, s'thurni as fole,
Ju s'vajtët kurrë larg në shtegëtime,
Ju s'e braktisët kurrë këtë dhe,
Por varfërisht u rritët, tok me mua,
Në këtë vis, ku shkabë e rreptë rron;
Dhe unë ndoshta për këtë ju dua, -
Një mall foshnjor me ju më vllazëron ...

Jorgo Bllaci [BN - 728]

Të gjithë një gjuhë kini
dhe një bes' e një mënyrë,
djemt' e mëmëdheut jini,
kini një gjak, një fytyrë;

Naim Frashëri [BN - 729]

Gegë, toskë vllazën jemi,
Të dy bashkë një emër kemi
Dhe një fat në këtë botë,
Shqyphtar'jemi fjala thotë.

Asdreni [BN - 730]

Prej një nane jemi lerë
Mysliman' e të krishterë;
Më një diell jemi ritur,
Si dy lisa pranë ngjitur.

Asdreni [BN - 731]

Të dy kemi një dëshirë,
Se një sisë kemi pirë;
Një të qeshur, një të qame
E një zemër të pandame.

Asdreni [BN - 732]



“Mbas 450 vjetësh u kremtua për s’parën herë n’Shqypni dita e dekës së Skanderbegut: kjo e kremte asht një shej i mirë; asht shej se shpirti ose ndiesitë e Skanderbegut kanë fillue me u ngjallë ndër zemrat t’Shqyphtarvet. Kangët e poetve e lgjendat e rapsoditë e popullit çfaqin Skanderbegun vetëm si një fatos fejet; por para synit t’historjakut e t’vrojtarit t’paanshëm, Skanderbegu asht fatos i liris e pavarësis s’komeve, tuj ken qj dishiri i liris kje, aj, qj ma s’parit e shtyni at burr me rrokë armet për Shqypni. Skanderbegu me at trimni e rrebtisi me t’cillel luftoj kundra Turqve qj ishin musliman, luftoj edhe kundra venedikasve qj ishin t’kshtenë. Prandaj t’gjithë shqyphtarët e vërtetë, pa ndërlikim partiet e besimit do ta nderojn Skanderbegun si një fatos t’komit e do t’u bahet nom me kremtue emnin e punët e tij. Skanderbegu asht ideali i liris e pavarësis s’Shqypnis”

Gjergj Fishta [BN - 733]



Pajtohemi me intelektualët që kanë shkruar thjesht e saktë se “Shqiptarët me Skënderbeun në krye luftuan kundër pushtuesve osmanë. Kjo luftë kishte karakter mbrojtës-çlirimtar dhe asnjëherë fetar, siç duan ta interpretojnë disa. Kjo luftë, pa dyshim, ka qenë dhe mbetet thelbi i nacionalizmit shqiptar. Ajo mbolli idenë e bashkimit kombëtar e të qënies popullore, ide që nuk u shuan kurrë, megjithëse pushtimi osman vazhdoi më se 500 vjet”

Abdi Baleta [BN - 734]



Punëtë që ka punuar
kordhëtari i vërtetë,
kombinë duke nderuar
dhe Shqipërinë për jetë,
nga gjiri i Perëndisë
pa m'i sill nër mënt e mija
t'i ap dritë Shqipërisë
nga shpirt'i ndritshim i tija.

Naim Frashëri [BN - 735]

Në ditët të ati mbreti
ishte qëndrë Shqipërija,
rreth soje gjithë rremeti
edh'e tërë njerëzija.

Naim Frashëri [BN - 736]

Shqipërija ishte mirë.
Mbretëronte shqipëtar
urdhëronte parësija,
punët' ishinë së mbari,
se gjykonte njerëzija;
mirësija ishte besë,
ligë ishte urtësija,
trimërija ishte shpresë,
dhe udhë vëllazërija.

Naim Frashëri [BN - 737]

Sa ishinë shqipëtarë,
ishin burra të vërtetë,
të bashkë e të pandarë,
të dashur' e miq për jetë;

Naim Frashëri [BN - 738]

Ajy më i vogël' i tyre,
që vij nga gjithë m'i çquar,
pej fytyr' e pej mënyre,
Zoti e kish lartësuar,
të mirat gjith' i kish dhënë,
të ligat ja kish mërguar,
gjë të metë s'i kish lënë,
së gjithash e kish mbaruar.
Kish shpirt e zëmër' e ndjenjë,

edhe mënt e njoh, e hije,
shtat edhe sjell' e rrëfenjë,
dhe fuqi pej Perëndije.

Naim Frashëri [BN - 739]

Mësoi gjithë dituritë,
u bë njeri i mësuar;
shpirtit i dha dhe më dritë,
ndritoj zëmrën' e qëruar;
kishte gjithë urtësitë,
ish mëndje me shumë dritë,
kish me vet'he Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 740]

“O vëllezrë ushtëtarë!
q'u nistë bashkë me mua,
unë punë të pambarë,
e të papëlqyer s'dua;
duhet të jini të mirë,
e të kini trimërinë,
të mos bëhi egërsirë,
po të mbani njerëzinë;
jo të merrni, të rrëmbeni,
të shani e të godini,
të rripni e të gënjeni,
po faqebardhë të jini;
gra' e foshnjat t'i mburroni,
dhe pleqet t'u bëni nderë,
të falurit t'i lëshoni,
mos i përdorni si berrë.
Trimi e çmon njerinë,
e sheh' si vet'hen' e tija,
s'do të likn' e ligësinë
Punënë mir' e mejtoni,
e ndonjë të mos gënjehet,
se pastaj më turpëroni,
po kush do që sot të kthehet;
njeri s'duhetë të qahet
nga shokët e mij ndë jetë,
dhe asnjë mënt të mos mbahet
për të keq e për të metë;
dua të drejt' e të vërtetë,

për të mbar' e për të mirë,
gjithnjë në këtë jetë;
luftëtarët t'i lëftoni,
në luftë do t'i godini,
po pastaj mirë vështroni,
njerës të urtë të jini;
unë dua trimërinë,
dhe i falem burrisë,
po dua dhe njerëzinë,
që është' udh'e Perëndisë;
u kam vëllezër' e shokë,
e miq me gjithë dëshirë,
edhe mbi sy e mbi kokë,
kur t'u shoh n'udhët të mirë;
n'u pafsha në prapësinë,
në dëm e në të këqija,
në të lig' e të pështirët,
s'shpëtoni duarvet t'mija".

Naim Frashëri [BN - 741]

Në zemrë kish mirësitë,
e ndër mendje diturinë,
në shpirt kish të madhe dritë,
kish të bën me Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 742]

Ty ta la radhënë moti.
që ta nderoç Shqipërinë,
fuqi më të dhëntë Zoti,
e bëfsh gjithë mbarësinë!

Naim Frashëri [BN - 743]

Do të lësh në këtë jetë
nj'emrë shumë të uruar,
e një dritë të vërtetë,
q'ajo kurrë s'ka të shuar.
Po një punë q'është' e thënë,
e vjen nga Zot'i vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 744]

Pa një ditë ndaj mëngjezi
dolli më një vënt të lartë,
Zoti zemërenë ja ndezi,
erth e ju bë fjesht' e zjartë!
Pa malet e Shqipërisë,
që ndo vogël' i kish parë,
në kohëzët të lirisë,
pa ndjeu në zëmret zjarrë,
një gas që nuk' e kish ndjerë,
që kur lindi, gjer ahë,
kurrë ndonjë tjtër herë,
i erdhi me shumë ndere,
ishte plot me ëmbëlsirë,
e kish një të naltë ndjenjë,
t'uruarë e të mirë,
të vjyer' e pa rrëfenjë.
Shtu syt' e pa mëmëdhenë,
lott'i vanë si burimi,
sa shqiptarë që qenë
qanë gjithë nga gëzimi.

Naim Frashëri [BN - 745]

Dëgjoj q'erdhi Skënderbeu,
rrodhi gjithë Shqipërija
ngriti krye mëmëdheu
pru lirinë Perëndija!

Naim Frashëri [BN - 746]

Pa këndo me ëmbëlsirë
o ëngjëll i ligjërisë,
atë burrë, trimn' e mirë,
q'i dh'aqë nder Shqipërisë,
që s'ka pasur shok në jetë,
që lartësoj mëmëdhenë,
kordhëtari trim me fletë!

Naim Frashëri [BN - 747]

Lum til! Shqipëri! o lule!
që pate trim të vërtetë,
kurrë në turp nuk' u ngule,
të la nder të math për jetë.
Mos ki keq se kurdoherë



do ta kesh ditën e mbarë
koha ty do të ta bjerë
si ta pat prurë më parë.

Naim Frashëri [BN - 748]

Qysh duken yjtë, kur erret,
që ndrijnë në hapësirë,
edhe në mest të të tjerët
Prëma ndrin shumë më mirë,
ashtu edhe ti më ndrinje,
mbret'i math i Shqipërisë,
në mes të shokëvet rrinje
posi drit' e Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 749]

Tha: "Mbretëri të dëgjuar!
pleq të urtë e të ndjerë!
dhe ju shokë të lëvduar!
djemt' e mëmëdheut të vlerë!
falem te Zot'i vërtetë,
që më pruri në mest tuaj,
s'më la në të errët për jetë
të përpiqem për të huaj.

Naim Frashëri [BN - 750]

e kam gas e për lëvdatë
të vritem për Shqipërinë
të përpiqem dit' e natë,
e t'i mërgonj ligësinë.

Naim Frashëri [BN - 751]

Në jan' ata shqipëtarë,
që i njoh e i di unë,
bota po ka për të parë
këtu një të madhe punë!

Naim Frashëri [BN - 752]

Shpreh m'atë Zotn' e vërtetë
sa të jem gjall' të përpiqem,
e sa shoh me sy në jetë
kurrë nga lufta po s'hiqem;
i huaj s'e shkel dot kurrë

dhe s'e merr dot Shqipërinë
se shqiptari' shtë burrë
e tërë bota e dinë.

Naim Frashëri [BN - 753]

Mbajeni mend këtë fjalë,
që u ap, e këtë besë,
mos harronj' as plak as djalë,
e për jetë le të mbesë:
Sa të jem unë në jetë
gjithnjë për Shqipërinë
do të lëftonj pa të metë,
edhe shpreh më Perëndinë,
më atë Zotn' e vërtetë,
që paskëtaj Shqipërija
posi lule do të jetë,
do ta shohë Perëndija".

Naim Frashëri [BN - 754]

Kështu the! mbret'i vërtetë
këjo fjalë të kish hije,
q'është e gjallë për jetë,
është fjalë Perëndije.

Naim Frashëri [BN - 755]

Mbreti burrë, trim' i mirë
u tha: "Burra të vërtetë!
pastë lavdi Perëndija,
me qënë ju gjall' në jetë
kurrë s'mundet Shqipërija;

Naim Frashëri [BN - 756]

Burr', o mbret i Shqipërisë!
armikëtë se ç'i korre,
ishte dor' e Perëndisë,
të keqen e asaj dore!

Naim Frashëri [BN - 757]

Mbreti u tha: "Mos i vrisni,
se shpërnderoni vet'henë,
lerini e mos i prisni,
lëshojini le të venë;

se ajy, që është burrë
s'e vret atë, që ka zënë,
as të falurinë kurrë,
s'u merr as shpirtin' as gjënë."

Naim Frashëri [BN - 758]

Skënderbeu kordhëlarë,
u tha: "Djemt' e Shqipërisë!
Mëmëdhenë e nderuat,
me ndihmët të Perëndisë
nga armikët' e shpëtuat.
Ajy q'është trim e burrë,
e lëfton për mëmëdhenë,
nukë vdes, nukë vdes kurrë,
për jet' e nderon vet'henë.

Naim Frashëri [BN - 759]

I jam falë trimërisë,
që më shpëtoj Shqipërinë,
i jam falë Perëndisë,
që ma dhe nder e fuqinë.

Naim Frashëri [BN - 760]

Me zëmrë shumë të qetë
lith duartë në kraharuar,
pa thotë: "Zot i vërtetë!
emri yt qoft' i lëvduar!"

Naim Frashëri [BN - 761]

Mbreti u tha: "Keq mos kini,
pa prap' e vëmë në dorë,
juve shëndoshë të jini,
pa Zoti s'na lë të gjorë.
Kijeni zemrën të gjerë,
kurrë mos u dobëtoni,
puna si do që të bjerë,
burra e trima qëndroni."

Naim Frashëri [BN - 762]

Nukë la njeri të qahej,
s'la punë të papëlqyer,
a mëri gjëkunt të mbahej,

a nonjë zëmrë të thyer.
Më të gjith' anët shënditi,
gjithë kombin e gëzojti,
jetën' ua përsëriti,
mëmëdhenë e ndritojti;
dha mësimë urtësisje
dhe, për gjithë mirësitë,
dashuri vëllazërije,
dhe për të mbar' e për dritë.

Naim Frashëri [BN - 763]

Nga Skëtterra duke dalë,
Ëngjëlli i urtësisë
mbreti i tha këtë fjalë
me zëthit të Perëndisë:
"Skënderbe! t'u ngjattë jeta!
Mbret'i mir'i Shqipërisë!
mos u ndaj nga e vërteta
dhe nga udh' e Perëndisë".

Naim Frashëri [BN - 764]

Po kur ngrihetë Nakari
me fytyrë të mërëzitur,
si i vdekuri nga varri,
i tretur e i venitur,
armiku i Perëndisë
ishte shumë' i zëmëruar,
vat' e ju lut Dashurisë,
fytyrën duke ndryshuar,
i tha: "Mbret'i Shqipërisë
më shpërnderoj këtë herë,
s'ju qas fare ligësisë,
ma hodhi në baltë nderë;
pa në zëmrë ndjen një plagë
e ti, ke fuqi shumë,
të më març sot soje shpagë,
ta hedhç në prëhij'e në gjumë".

Naim Frashëri [BN - 765]

Kështu tha i zëmëruar,
u lëshua Dashurija
nd'erë duke fluturuar



me shigjeta të këqija!
Ngadalez'i afërohet
dh'e përkëdhel mbretëreshën,
pa ajo shumë gëzohet,
se ja mer nga mëndja peshën!

Naim Frashëri [BN - 766]

Sa më shumë e përkëdhelte,
bukurija aq' i shtohet,
nga faqetë zjarr i delte
dhe sa vinte xbukurohej.
Ahere me një shigjetë
Dashurija e goditi
mbrenë ndë zëmërt të qetë,
me vërtik shumë e vërviti.
Në zëmërt i ndënj shigjeta
me të madhe ëmbëlsirë,
oh! sa është e ëmbël' e shkreta!
kur e mer zëmërt mirë.

Naim Frashëri [BN - 767]

Qysh vetëtin më fort moti
edhe shkrepëtin pa prerë,
kur na dërgon shinë Zoti,
e rrit luletë në verë?
Ashtu edhe Dashurija
shigjetatë këtë herë
të hollazë posi shtija
i heth fët-e-fët pa prerë!

Naim Frashëri [BN - 768]

Pa mbreti ishte goditur,
gas të math në zëmërt ndjente,
posi djalëth i nemitur,
Dashurija e gënjente!
Dashuri' e Bukurija
bashkë të dyja u bënë,
me shigjetat' e këqija
mbrenë posht' e kishin vënë!

Naim Frashëri [BN - 769]

Atë, q' ishte trim e burrë!

s'e zij as ushta as shpata
as shigjet' e luftës kurrë,
e shtu poshtë jetëgjata!

Naim Frashëri [BN - 770]

Kur e pa kshtu Urtësija,
zu për dore Trimërinë,
"Jak', i tha, se Dashurija
rreh të na mbyllnjë shtëpinë".

Naim Frashëri [BN - 771]

Kshu i tha dhe fluturuan
të dyja si dallëndyshe,
me vrrap të shumë nxituan,
s'ndënjn' e nukë bënë ndryshe,
po erdhë drejt e te mbreti,
të dyja në mest e vunë,
hu qasnë pranë së qeti,
dh'e muarr' e jasht' e shpunë.

Naim Frashëri [BN - 772]

Pale aju mbreti vetë!
Shqipërisë drit' i pruri.
Bashk' aju me Perëndinë
i pru dritën' e lirisë
dhe të tërë mirësinë
q' i duhetë njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 773]

Mbret! o hij' e Perëndisë!
drit' e Zotit! fill' i arit!
ti i dhe nder Shqipërisë,
edhe vjefhtë shqipëtarit.
lu bëfsha dorësë sate,
q' ishte dor' e Perëndisë,
i qofsha fal' asaj shpate,
q' i dha dritë trimërisë.

Naim Frashëri [BN - 774]

Qaje! moj Shqipëri! qaje
atë njerin' e vërtetë,
e zinë për jetë mbaje
se shok më s' i vjen në jetë.

Naim Frashëri [BN - 775]

A e shihni Skënderbenë?
mbren' e mirë, trim e burrë?
u përpoq për mëmëdhenë,
pa s'i vdes emëri kurrë.

Naim Frashëri [BN - 776]

Zoti me të math të vetë
është një dhe i vërtetë

Çajupi [BN - 783]

Skënderbeu sht'i gjallë,
rron e mbretëron për jetë,
kjo fjalë s'është përrallë
ndaj t'urtit është e vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 777]

Si këtu dhe n'atë jetë,
Si Ungjilli dhe Kurani;
Mos e ndajni Perëndinë
Shoku shoknë mos e hani,
Si punojnë ata që s'dinë.

Çajupi [BN - 784]

Po tani u afërua
Dit' e fundit dhe për mua,
Gjithë këtë ditë presëm,
Kemi ler' e do të vdesëm,

Çajupi [BN - 778]

Besa është e Gjithësisë;
Ne jemi të Shqipërisë,
Se kemi pirë një sisë.

Çajupi [BN - 785]

Njeri për jetë s'ka mbetur,
Dheu të gjith' i ka tretur;
Po lum kush është përpjekur
Dhe për Atdhenë ka vdekur.

Çajupi [BN - 779]

Për Perëndi që besoni,
Shqipërinë mos e harroni.
Pra, faluni si të doni ...

Çajupi [BN - 786]

Ndaj desha, sa jam i gjallë,
T'u mbledh, t'u them këto fjalë:
"O vëllezër Shqipëtarë,
U lutem të bëni mbarë,
Gjithë bashk' e të pandarë.

Çajupi [BN - 780]

Faluni te Perëndia,
Të shpëtojë Shqipëria.

Çajupi [BN - 787]

Mysliman' e të krishterë
Perëndia na ka bërë
Jemi vëllezër të tërë.

Çajupi [BN - 781]

Tani ta shpëtoni vetë,
Se unë nuk kam jetë,
Vete te Zot'i vërtetë.

Çajupi [BN - 788]

Zoti kur bëri insanë
Me një fytyrë të naltë,
Të krishter' e myslimanë
I gatoi nga një baltë.

Çajupi [BN - 782]

Do t'i lutem duke qarë
Të jetë me Shqipëtarë
Dhe t'u apë dashurinë,
Të nderojnë Shqipërinë.

Çajupi [BN - 789]



Zot'i math vëndinë tuaj
e bëri për ju të tërë,
për fqinjë e për të huaj
s'e ka bërë, s'e ka bërë.

Naim Frashëri [BN - 790]



Çoniu shqiptarë, prej gjumit çoniu,
të gjithë si vllazën, në një besë shtrëngoniu,
edhe mos shikoni kisha e xhamia,
fe e Shqyptarit asht Shqyptaria.

Pashko Vasa [BN - 791]

Flamuri kombtar nuk ka shka ban nder ne,
Po kje se dashtuni nuk kem p'r Atdhe!

Gjergj Fishta [BN - 792]

Kombit nuk i hyn aq shumë në punë kultura e
përbashkët nëse ai nuk dëshiron e nuk synon të
bashkohet edhe politikisht, të krijojë shtetin e
përbashkët si gjithë të tjerët.

Abdi Baleta [BN - 793]

Fet' e besëtë t'i kemi
Po të ndarë të mos jemi,
Hoxh' e xhami e dervishë,
Priftër' e klllogjër' e kishë
Nderë që kanë ta kenë,
Po të duan Mëmëdhenë,
Të duan njerëzinë,
Dhe të tërë Shqipërinë,
Mirësit' e urtësitë
T'i kenë përpara dritë,
Të ken' udhë njerëzinë,
dhe zot gjithë Perëndinë;
Me dritët të Perëndisë
T'i ndihinë Shqipërisë,
E të ngrënë Shqipëtarë
Të bëhet si ish më parë

Naim Frashëri [BN - 794]

Udh' e Zotit të vërtetë
Ësht' e vërteta në jetë.
Të besojmë Perëndinë,
Të duam dhe Shqipërinë,

Të duam dhe Shqipëtarë,
E të jemi të pandarë.

Naim Frashëri [BN - 795]

Vëllezër Shqipëtarë!
Të prekim urtësinë,
Të zëm'udhën e mbarë,
Të ngjallim Shqipërinë.

Naim Frashëri [BN - 796]

Ajo ish koh'e zjarrrë
Dhe kish mundime tepër,
Po sot pëndë dhe kartë
Na duhet, nukë tjetër.

Naim Frashëri [BN - 797]

O burra Shqipëtarë,
Të marrim dituritë,
Se s'është kohë e parë;
Tani lipsetë dritë.

Naim Frashëri [BN - 798]

Të shkruajm' gjuhën tënë,
Kombinë të ndrutojmë,
Gjithë ç'është e ç'ka qënë,
Ngadalëzë t'a mësojmë.

Naim Frashëri [BN - 799]

Shumë e bardhë kjo ditë
Për gjithë Shqipëtarët,
Do na sjellë një dritë
Që s'e kishin të parët.

Naim Frashëri [BN - 800]

Kjo dritë do na bjerë
Të gjitha mirësitë
Dhe gjithë do t'i ngrerë
Dëmet e marrëzitë.

Naim Frashëri [BN - 801]

Si lum kush zë të mbjellë,
Lum kush vë këtë pemë!
Se kjo ka për të pjellë
S'mbulohetë me rremë.

Naim Frashëri [BN - 802]

Sipas meje, në kushtet e sotme edukim kombëtar do të thotë të formosh personalitetin dhe identitetin e qytetarit shqiptar me dinjitet, me sedër, të aftë të respektojë vetëveten, që të dijë pastaj të respektojë edhe të tjerët e të respektohet nga të tjerët. Me edukim kombëtar unë kuptoj ngulitjen graduale në mendjen e vocrrakut, pastaj të fëmijës, të adoleshentit, të të riut e të të rriturit deri në vdekje se është bir i një populli dhe pjesëtar i një kombi të caktuar, se ka një atdhe fillestar të caktuar, edhe nëse më vonë do të birësohet nga ndonjë vend e shtet tjetër. Edukim kombëtar për mua do të thotë që çdo njeri të mësojë qysh në familje e pastaj në shkollë, në shoqëri se ai mund jetë një qenie shoqërore me aspirata të realizuara, të drejta të përfaqësuar, i mbrojtur dhe i sigurtë vetëm si pjesëtar i një bashkësie të caktuar dhe bashkësia themelore për lulëzimin e plotë të personalitetit të individit është ajo shoqëri që quhet komb. Është një përkatësi e caktuar kombëtare që i jep individit garancitë më të mira se do të respektohet dhe do të gëzojë të mirat e vlerave të shumta kudo që të shkojë vetëm pasi e ka të njohur një përkatësi kombëtare. Edukimi kombëtar kudo në botë nuk është trill, por nevojë. Edukimi kombëtar nuk është shpenzim i kotë kohe e energjisht, por investimi më i domosdoshëm dhe më i dobishëm për të përgatitur njerëzit për bashkëjetesë brenda një kombi, ose në gjirin e kombeve të tjerë. Në kushtet e sotme të shqiptarëve të Shqipërisë, edukimi kombëtar është armatosja më e mirë e individit për të përballuar gjithë problemet që do t'i dalin në jetë. Shqiptarët duhet të edukohen me nacionalizmin e vet të shëndetshëm, sepse kështu mund të hyjnë me dinjitet edhe në Europën e Bashkuar.

Abdi Baleta [BN - 803]

O vëllezër Shqipëtarë!
Gëzohi që erth kjo ditë
Kaq' e mir' e kaq' e mbarë,
Na sjell gjithë mirësitë.

Naim Frashëri [BN - 804]

Kjo është ditë e rezë,
Që bie vëllazërinë
E dëbon jetën e zezë
Dhe ndarjen e marrëzinë.

Naim Frashëri [BN - 805]

Ta lusim këtë ditë
Q'ë bekoj Zot' i vërtetë,
Dh'e dërgoj me shumë dritë,
T'i mbes' emëri për jetë.

Naim Frashëri [BN - 806]

Sot e vumë gurr' e parë;
Sa'sht' e bekuar kjo ditë!
Zot' i math e pruftë mbarë
E na dhëntë urtësitë!

Naim Frashëri [BN - 807]

Hapu, hapu, errësirë!
Pa jakë tëhu, o dritë!
Se arriti koh' e mirë,
U gdhi nata, u bë ditë.

Naim Frashëri [BN - 808]

Sot niset një tjetër jetë,
Të rremenë posht' e shtije,
Mbretëron fjal' e vërtetë
Dhe të mirat gjith' i bije.

Naim Frashëri [BN - 809]

Zot'i math qoft' i lëvduar!
Q'ë nxjerr në shesht të vërtetën,
Se ajo sij ka buruar,
Pa e ka ndrituar jetën.

Naim Frashëri [BN - 810]

Kushdo që është sot burrë
Dhe Shqipëtar i vërtetë,
Emëri s'i shuhet kurrë
Dhe nderi i rron përjetë.

Naim Frashëri [BN - 811]



S'jemi grekër a bullgarë,
as gjë tjetër nukë jemi,
Jemi vetëm shqipëtarë,
Nji kët' emër nder e kemi.

Naim Frashëri [BN - 812]

“Gjithkush, edhe pa dashjen e tij, në kundërshtim me idetë e tij e ka detyrimisht një përkatësi racore, etnike, kombëtare të përcaktuar jo prej atij vetë, ka të drejtën dhe detyrën të përcaktohet për këtë përkatësi. Por, askujt nuk mund t'i njihet e drejta për t'u hequr si nacionalist, ose të vihet para detyrimit për t'u ndërë nacionalist, vetëm për shkak të kësaj përkatësie. Pra, përkatësia në një komb është elementi objektiv i nacionalizmit, por jo element i mjaftueshëm. Duhet dhe qëndrimi subjektiv. Madje qëndrimi subjektiv merr më shumë rëndësi.”

Abdi Baleta [BN - 813]

Vëllazërija
Edhe bashkimi
E njerëzija
Është shpëtimi.

Naim Frashëri [BN - 814]

Tha: “Zotërinj! më dëgjoni?
t'u them dhe unë dy fjalë,
pastaj bëjmë si të doni,
po mos e merni me valë.
Shumë herë trimërija
sjell shpëtim, është e pëlqyer,
po herë dhe urtësija
është m'e mir' e m'e vjyer;

Naim Frashëri [BN - 815]

Gjon Kastrioti: “Ah! kam frikë prej mynxyre!
mos nuk' i shoh më në jetë,
e të vdes nga mall' i tyre,
ta lë dhe shtëpinë shkretë!”
pastaj djemtë pran' i mori,
i puthi e i qafojti,

psherëtiti fort i gjori,
lottë çurkë i lëshojti.
U thotë: “Të silli mirë,
të bëhi njerës në jetë,
të mos mbetni n'errësirë,
po të jini të vërtetë,
nat' e ditë të këndon
çdo q'u duhetë ta dini,
gjithë gjuhët t'i mësoni,
po shqipenë mos e lini;
mirësit' e Shqipërisë
i mbani, mos i harroni.
Mëmëdhen' e kombin tuaj,
shtëpinë e njerëzinë
dhe atje në vënt të huaj
t'i doni, dhe miqësinë;
shqipëtar' e Shqipërinë
kurrë të mos i harroni,
kini dritë urtësinë
çdo gjë me mënt ta gjykoni;
të bëhi trima të urtë,
të zottë të mbretëroni,
jo të marr' e mendjeshkurtë,
ndaj duhetë të mësoni,
të bëhi shumë të ditur,
fjalëbukur' e të çquar,
shpirtdashur' e mendjendritur,
të mir' e të kupëtuar.
Zoti e nderoj njerinë,
i dha mënt që të gjykonjë,
të punonjë mirësinë,
të ligatë t'i mërgonjë;
ruani nder' e shëndënë,
burrërin' e trimërinë,
kombin' edhe mëmëdhenë,
njerëzin' e mirësinë.
Shqipërija jush ka shpresë,
edhe pret shumë të mira,
po të mbani juve besë,
nuk' e ha dot egërsira.
Mësimet do t'u mësojnë
ato punëra, q'u duhen

atyre që mbretërojnë,
e mbretër të mirë quhen;
u duhetë njerëzija,
zotërija e të tjera,
mirësija, trimërija,
gjithë vetijat' e vlera;
kombinë shumë ta doni,
e si fëmijë ta kini,
me të drejtë të gjykoni,
e çdo punëzë ta dini;
dhe në brengë të mësohi,
dhe shpirtinë ta mundoni,
e kurrë të mos rëndohi
në doni të mbretëroni;
kini njohë të qëruar,
dhe ndjenja të larta shumë,
zëmër edhe shpirt të çquar,
mëndje pa lodhje e pa gjumë”.

Naim Frashëri [BN - 816]

Si të msojnë ligësitë,
e të mirat t'i harrojnë,
të çpikinë djallëzitë,
pastaj të na mbretërojnë?

Naim Frashëri [BN - 817]

Të gjitha humburë venë,
veç një munt emër të lerë,
që lëfton për mëmëdhenë,
s'mundohetë për të tjerë.

Naim Frashëri [BN - 818]

Mëmëdheu të ka shpresë,
që ta nxjerrç prej robërije,
nënë xgjedhë të mos mbesë,
t'i apç dritë si ka hije.

Naim Frashëri [BN - 819]

S'të vjen keq për shqipëtarët,
e për Shqipërin' e mjerë,
e s'të merr, biro, të qarët?
që humbi lirin' e nderë!

Naim Frashëri [BN - 820]

Gjithë njerëzit që janë,
mbi Shqipërit të lëshohen,
për të bërë gjë po s'kanë,
do të ikin, do tmerrohen,

Naim Frashëri [BN - 821]

Gjithnjë në jetë s'mbesim
dhe, sado që të mënojmë
më mirë me nder të vdesim,
se me turp të madh të rrojmë.

Naim Frashëri [BN - 822]

Se bashkimi dhe njësi
mban mëmëdhen e lirinë,
pej atyre vjen fuqija,
ndarja bije dobëtinë.

Naim Frashëri [BN - 823]

Gjithë kemi njerëzinë,
urtësin' e mirësitë,
dhe besë vëllazërinë,
e të vërtetëne dritë.

Naim Frashëri [BN - 824]

Po të jemi të bashkuar,
kurrë s'pëson Shqipërija,
faqebardh' e të gëzuar
do ta nxjerrë Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 825]

Me ato armëtë tuaj
mëmëdheu do të mbahet,
kurrë në dorë të huaj
nukë bij' e nukë ndahet.”

Naim Frashëri [BN - 826]

Burravet trima me besë
u tha fjalë e lëvdatë,
u dha trimëri e shpresë,
nder e dëshir' e uratë,
pastaj u tha: “Në mest tuaj
të kini vëllazërinë,



të mos hiqi si të huaj,
po ta mbani miqësinë,
Të gjithë vëllezrë jemi,
jemi gjithë shqipëtarë,
një gjak e një gjuhë kemi,
jemi një fis e një farë.
Të kemi vëllezërinë,
e gjithë ç'janë të mirat,
urtësin' e njerëzinë
dhe nd'udhë gjithë dëshirat.
E të mos kemi të ndarë,
djemt' e mëmëdheut jemi,
gjithë ç'jemi shqipëtarë
Shqipërinë mëmë kemi".

Naim Frashëri [BN - 827]

O vëllezrë shqipëtarë!
ju të jini të bashkuar,
sindëkur qetë më parë,
që të jini të nderuar;

Naim Frashëri [BN - 828]

Mos e lini trimërinë
dhe bashkimnë në mest tuaj,
po ta kini miqësinë,
se nuk jini të huaj,
jini gjithë shqipëtarë,
kini mëmë Shqipërinë,
jini një fis e një farë
e besoni Perëndinë;

Naim Frashëri [BN - 829]

Përpiqi dit edhe natë,
mëmëdhenë ta shpëtoni,
armikut hiqini shpatë,
kurrë mos u frikësoni;
sindëkur kini lëftuar,
ashtu prapë të lëftoni,
që të jini të shpëtuar
e të kini gjithë ç'doni;

Naim Frashëri [BN - 830]

Mos e humbisni lirinë
e mos bëhi rrop në jetë,
po të doni mirësinë,
ua ep Zotth'i vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 831]

Shpirt i Skënderbeut thotë:
"Djemt' mij trima, ku jini!
mos mundohi më për botë,
atë marrëzi e lini!
Bëhuni bashkë të tërë,
madhoheni miqësinë,
vëllezërë duke u bërë,
përpiqi për Shqipërinë;

Naim Frashëri [BN - 832]

Po të jini të bashkuar,
është' e bërë Shqipërija
dhe puna gjith' e mbaruar,
si do vetë Perëndija;

Naim Frashëri [BN - 833]

Fortësoni dashurinë
dhe bashkimnë, sa të muntni,
lini nakar' e zilinë,
nga e drejta mos u tuntu;

Naim Frashëri [BN - 834]

Bëhuni miq në mest tuaj,
si është' udh' e urtësisë,
mos përpiqi për të huaj,
t'i mërgohi marrëzisë;

Naim Frashëri [BN - 835]

Njëri tjetërinë doni,
se kini gjithë një shpresë,
të huajtë t'i mërgoni,
q'e kanë me të pabesë;

Naim Frashëri [BN - 836]

Kini besë Perëndinë
gjithë ç'jini shqipëtarë,
Edhe mëmë Shqipërinë,
si e pattë dhe më parë;

Naim Frashëri [BN - 837]

Hapni sytë dhe punoni
të gjithë për Shqipërinë,
tjatërë gjë mos kërkoni,
ajo e sjell mirësinë.

Naim Frashëri [BN - 844]

S'jini grekër' as bullgarë
as turq as tjatërë s'jini,
jini fjeshtë shqipëtarë,
pse gënjehi tek e dini?

Naim Frashëri [BN - 838]

Kombi nuk është koloni pinguinësh. Kombi dhe nacionalizmi nuk janë e njëjta gjë. Filozofia, doktrinën politike, tezat ideologjike nuk vlerësohen vetëm nga numri i njerëzve që i kuptojnë, i besojnë apo i ndjekin, sidomos në fillim. Partinë Komuniste të Kinës e themeluan vetëm 13 vetë. Po sot si është puna? Krishterizmi nisi si shoqëri sekrete dhe për dy shekuj mbijetoi vetëm në katakombe dhe armë më të përdorshme kishte martirizimin. Islami nisi nga një njeri. Shembuj të tillë mund të sjellim plot. Sa ide të mëdha fillimisht janë trajtuar si herezi, si blasfemi të një grupi njerëzish, të një njeriu të vetëm! Nacionalizmi nuk ka lindur asnjëherë për një ditë tek gjithë pjesëtarët e një kombi, as kurrë nuk ka pushtuar mendjet, ndjenjat e sidomos mendimin e veprimin e gjithë pjesëtarëve të një kombi. Të qenët nacionalist nuk vërtetohet e sigurohet me lëshimin e ndonjë dëshmie. Lëvizjet nacionaliste zakonisht janë lëvizje elitare, nuk janë gjithë kallaballëku në një vend... Nacionalizmit i përkasin ata shqiptarë që duan e dinë të jenë të tillë, jo të gjithë ata që thithin ajër në Shqipëri, apo që dhe veten e quajnë shqiptarë.

Perëndija Shqipërinë
e bëri për shqipëtarët,
s'e bëri për djallëzinë,
për të liqt' e për kusarët;

Naim Frashëri [BN - 839]

Zot'i math vëndinë tuaj
e bëri për ju të tërë,
për fqinjë e për të huaj
s'e ka bërë, s'e ka bërë.

Naim Frashëri [BN - 840]

Zoti kombet'i ka ndarë
edhe gjuhëtë me kohë,
pa u dha sy për të parë
dhe mëndjenë që të njohë;

Naim Frashëri [BN - 841]

Të lësh vëllanë s'ka thënë
e të bësh vëlla një tjetërë,
që s'ka as gjuhën' as zënë,
ta març e ta vësh në vatrë!

Naim Frashëri [BN - 842]

Abdi Baleta [BN - 845]

Po shtoni vëllazërinë,
ecëni pas urtësisë,
Madhoheni miqësinë,
q'është udh'e Perëndisë;

Naim Frashëri [BN - 843]

Dashurin' e mëmëdhethit
dhe zogu s'e harron kurrë,
që lëvrin në mest të gjethit
e s'e lë folen' e gurrë.

Naim Frashëri [BN - 846]

Për lirit të Shqipërisë,
për shpëtimit të shqipëtarit
po vjen ndihm' e Perëndisë.
q'i ep dritë punëmbarrit.

Naim Frashëri [BN - 847]



Po ju zini miqësinë,
bëhi të zottë të rroni,
të shpëtoni Shqipërinë
paskëtaj të mbretëroni.

Naim Frashëri [BN - 848]

Kini besë miqësinë
edhe ligë mirësitë,
udhëzë vëllazërinë,
urtësitë ndihm' e dritë,

Naim Frashëri [BN - 849]

Zot'i math e i vërtetë
do t'i apë Shqipërisë
shpëtimn' e lirinë vetë
dhe dritën' e njerëzisë".

Naim Frashëri [BN - 850]

Kshu thotë shpirt' i uruar,
nuk' e harron Shqipërinë,
se për atë ka lëftuar,
i la nder' e mirësinë.

Naim Frashëri [BN - 851]

Është turp për emrin tuaj,
Të mundohi për të huaj!

Asdreni [BN - 852]

Në duani Perëndinë,
Të duani Mëmëdhenë.

Çajupi [BN - 853]

Shkruani të vërteta pelini,
shqipeve u mësoni shqipen.

Xhevahir Spahiu [BN - 854]

Lini djallëzitë,
Lini prapësitë ...
Posi Perëndinë
Dojini Shqipërinë.

Çajupi [BN - 855]

Diçka do të përmbytim në emër të jetës së lirë,
Që jeta mos dergjet mes drotjeve strukur,
Që jeta t'i dalë përpara jetës së mirë,
Që brezat që vijnë të thonë plot gojën: bukur!

Dritëro Agolli [BN - 856]

Ta mbash të kulluar!
Kjo ishte dëshira dhe thirrja që delte nga çarjet
e tokës,
Që delte nga gjiri i ndërjegjes së njerëzve,
Që delte nga gjaku i tharë dhe hiri i kockës,
Që delte nga qielli i ëndrrës së brezave ...

Dritëro Agolli [BN - 857]

Po mos u trëmp, bëhu trime,
Edhe ki durim e shpresë,
E pa silli Zotit besë,
Dhe kësaj fjalësë sime.

Naim Frashëri [BN - 858]

E drejta vetë rrëfëhet,
e të miratë po njihen,
çdo gjë në jetë çpërblehet,
e gjësendi nukë lihet,

Naim Frashëri [BN - 859]

Në doni që të shpëtojmë,
çë të thot' aly të bëjmë,
fjalën' e tij ta dëgjojmë
dhe kurrë të mos bëzëjmë.

Naim Frashëri [BN - 860]

E i tha: "Edhe ti, o burrë!
Mos, mos e nga Bolkathanë,
se këto s'i bëmë kurrë;
ne s'i kemi vrar' barbarët,
q'i kemi vënë në dorë,
e të vrasëm shqipëtarët,
të prishimë dy të gjorë!

Naim Frashëri [BN - 861]

Kush punon për mëmëdhenë
atë Zoti e ka pranë,
më një vënt me Skënderbenë
s'e vë kurrë Ballabanë.

Naim Frashëri [BN - 862]

Kë të zësh ngoje më parë
ng'ata burrat' e vërtetë,
q'ishin vërtet shqipëtarë,
shokë s'kishinë ndë jetë!

Naim Frashëri [BN - 863]

I dhanë nder Shqipërisë,
Mbajtnë dhe Tyrqinë' e shkretë,
oh! i dhanë shpirt Tyrqisë!
ata trimat e vërtetë!

Naim Frashëri [BN - 864]

Trimërinë nuk e pshehnë,
andaj e mbajtnë Tyrqin!
dhe m'anët t'atërë ngrehnë
mynxyrënë! Grekërinë!

Naim Frashëri [BN - 865]

Mbajtnë plakën' e pabesë!
atë dhelprënë dinake!
e nuk e lanë të vdesë!
posi shtriga varfanjake.

Naim Frashëri [BN - 866]

Ngrehnë! popo! një myxyrë!
në kufit të Shqipërisë!
një dosë, kurvë të ndyrë!
burimnë e ligësisë!

Naim Frashëri [BN - 867]

Këto bëri trimërija!
se i ra pas marrëzisë,
nuk'ish bashkë urtësisë,
q'i ep dritë trimërisë.

Naim Frashëri [BN - 868]

Po edhe për Shqipërinë
shqipëtarët'u përpoqnë,
s'e harruan urtësinë,
soje kurrë dorë s'hoqnë;

Naim Frashëri [BN - 869]

Dhe për të huaj lëftuan
edhe për vet'he u vranë,
të t'jera punë mbaruan
dhe mëmëdhenë s'e lanë.

Naim Frashëri [BN - 870]

Po ka një kohë çdo punë,
pa thënë Zot'i vërtetë,
s'bëhete me të përdhunë,
pema s'lëshon lul' e fletë.

Naim Frashëri [BN - 871]

Prej Viose gjer te Drini
Mos na ndajë dot Shkumbini.
Porsi vllazën na të rrojmë
Dhe Shqypninë ta forcojmë.

Asdreni [BN - 872]

Se Shqypnia është besa,
Nderi ynë, jeta, shpresa,
Besën tonë pra ta mbajmë,
Kurrë armiqtë mos na çajnë.

Asdreni [BN - 873]

Të gjithëve sa gjaku u lëvrin
Edhe nxehtë ndë zemër i u valon,
Lini më nj'anë fetë dhe mërin'
E ngrihi, mblidhi, se koha kalon,
Ndënë flamurin e shenjtë me shpejtim,
për t'atdheut lirim!

Asdreni [BN - 874]

"Popull, ruani bashkimnë,
luftoni për Shqipërinë,
atdhetarë e gjysmëhopingë,
që ta fitojmë lirinë,
si për jugun dhe verinë,
Toskërinë e Gegërinë,
ndryshe bishat na përpinë."

Vlorë [BN - 875]



Jo me u shkelë zogu i shqiptarit
S'rrri nën kambë zogu i Shqipnis
Mbasi të lidhna të gjithë bashkë
At-herë njitna në shkallë të gjytetnis.

Shkodër [BN - 876]

Pra ça të jetë sot zog shqiptarit
Ndër dej gjaku do t'i vlojnë
Në duramë në lok e në maje të malit
Mos me lëshue shoqishojnë.
Të çohet gjumit mos të rrinë fjetë
Aj qi të donë i lirë me mbetë.

Shkodër [BN - 877]

Pat kenë koha e shqiptarit
Për tokë të veta me mendue
Mos me i dhanë liri tradhtarit
Se dote me na i zaptue.

Shkodër [BN - 878]

Na të ngratët jena shqiptarë
Për ket tokë jena mundue
Pushka e puna na shkoj mbarë
Kërkush s'mujt me na zaptue.

Shkodër [BN - 879]

O shqiptarë sot me veprue
S'ka mbet kohë ma me u hutue
Por të gjith zbashkut me punue
Shqiptarinë për m'e naltësue.

Shkodër [BN - 880]

E çdo anmik ka me u afrue
Pa gjak vend s'kemi me i lëshue
Rrënoftë pra kjo Shqiptari
Mund t'i rrisim me dije këto fëmij
Se na të njoftun jena n'histori
Qi të parët t'onë me botë janë gri
E njëkështu pra more shokë
Të sjellim syet kah këto kojshi
Të sjellim syet kah kjo Evropë.

Se edhe ata të gjith vllazën e shokë
Dorë për dorë na janë rrokë
Edhe na pra për ket tokë
Kushdo qi të na e përkasë
Në zjerm të Shqiptarëvet ke me hasë.

Shkodër [BN - 881]

Zoti n'qiellë e na mbi tokë:
Me gjithkënd vllazen e shokë,
Por se i cilli m'cak të vet.

Gjergj Fishta [BN - 882]

Por, po ndodhi se vjen dita,
Qi me faj Shqypnin e darni,
Qi e Liris u erret drita
Edhe m't' huejë Atdhen e mvarni
A per pare a marri tjera,
Si nder kohë, qi shkuen, atëhera,
U marroftë i Madhi Zot!

Gjergj Fishta [BN - 883]

Po, Juda janë, e gjinde jane trathtare,
Porsi njata, qi n'mend prej s'huejësh mahitun,
Varzat e djelmt, - e para uzdajë shqyptare –
Me ndiesi t'hueja n'shkollë i çojn me i rritun,
Tue lanë mbas doret t'amblen gjuhë amtare,
Pa t'cillen kombi s'mundet n'dritë me u qitun;

Gjergj Fishta [BN - 884]

Sot sheklli mbarë prir synin prej Shqyptarvet,
Me pa si perkujdesmi per Atdhe;
E si u dishmojm me punë na kundershtarvet
Se jemi t'zott me u lidhe me besë e fe
Edhe vetë me sundue vendin e t'Parvet

Gjergj Fishta [BN - 885]

Shqyptarë! Shqyptarë! Ndigjoni, pashi Zotin!
Pa ju kurr s'mundet n'dritë me dalë Shqypnija:
A thue, pra, n'terr po e lini m'e shkue motin,
Tash qi u dergoi t'bardhë fatin Perendija

Gjergj Fishta [BN - 886]



Ah! jo, Shqypnarë, jo; mos e lshoni doret
Shqypnin e mjerë, - ketë Atme t'uej t'bekueme
E cilla sod, pervujtë si vashë kunoret,
S'parit po hin nder fise t'qytetnueme.
A thue pse teper t'ngushta i ka terthoret
M'e lanë me dnesë prap nen kambë t'huej
t'poshtnueme?

Gjergj Fishta [BN - 887]

Profesori Shëflin ka theksuar se: “Atje ku shteti, shtetësia dhe etnizmi janë të gjithë të dobët, ekzistenca e jetës së pavarur kombëtare vihet shumë në dyshim nga banorët e vendit” Këto fjalë duhen marrë si një paralajmërim serioz edhe për ne shqiptarët, në rrethanat kërcënuese që po na krijojnë fqinjët dhe të huajt e tjerë që duan të na zhysin thellë e më thellë në një gjendje zhgënjimi, pezmatimi, të pashpresë; që të na bëjnë të mërzitemi deri nga qenia jonë kombëtare, të na rëndohet shpirti ynë shqiptar e të na neveritet lëkura jonë shqiptare, e cila, ç'është e vërteta, mban ende shtresa e aromë djersësh të vuajtjeve dhe dregëza të plagëve të tragjedive. Duan, pra, të na hedhin në një mjerim shpirtëror që të mos na bëjë më përshtypje se na ndërrojnë emrin, fenë, kombësinë, na hapin varret e të parëve, na grabisin eshtrat e të vdekurve vetëm që të na sigurohet një punë hyzmeqari në Greqi, Itali, në Kanada e firifistun, një copë bukë si lëmoshë, një vizë për të thyer qafën dikund larg.

Abdi Baleta [BN - 888]

Dhe fjalën turk e kaurë,
të mos e themi më kurrë,
po të themi shqipëtarë,
vëllezër e të pandarë.

Polifonike [BN - 889]

Lithni besën për Atdhe,
Ju me gjak të Kastriotit!
Lithni-e shpejt e bëni be:
Be që vret posi rrufe
Para Kombit – para Zotit!

Lasgush Poradeci [BN - 890]

Shqiptarë ne na thonë,
bëjmë si ç'kemi zakonë,
O shokë ndë kemi besë,
kush ka lindur dhe do vdesë,
Ndë u vra nga trimëria,
Namin e merr Shqipëria.

popullore [BN - 891]

Shembullin më të lartë të vetëflijimit për një qëllim të madh, jo duke bërë vetëvrasje, por duke u hedhur në luftë me bindje të plotë se do të gjesh vdekjen e sigurt e kemi në heroizmin shqiptar që treguan pjesëtarët e fisit Jasharaj në Drenicë të Kosovë në vitin 1998. T'i prish tërë fisit drejt vetëflijimit dhe të ndiqesh në këtë vetëflijim nga tërë njerëzit e fisit, të të gjitha moshave, për të vdekur në luftë me armikun e kombit, siç bënë Adem Jashari dhe njerëzit që vdiqën bashkë me të, është vendim shumë më i vështirë për t'u marrë se ai i kamikazeve të vetmuar. Sigurisht njerëzit që vetëflijohen në këtë mënyrë kanë nevojë për një “dehje shpirtërore” që mund të jetë ideologjike, fetare, nacionaliste. Por thelbi i veprimit mbetet ballafaqimi në luftën me një armik të fuqishëm.

Abdi Baleta [BN - 892]

Po dhe Krishti ndë na thëntë
Se – “jam grek, jakni pas meje”,
Do t'i themi: - Pa mblidh mentë
Se shqiptari s'vjen pas teje.

Petro Nini Luarasi [BN - 893]

Nga gjithë ç'kemi kënduar,
Për të njohur vetëhenë,
Kaqë gjë kemi mësuar,
Të nderojmë mëmëdhenë.

Naim Frashëri [BN - 894]



Se njerëzit gjithë vdesin,
Por jeta s'mbetet e shkretë,
Gjuha, Mëmëdheu mbesin
Të patundurë përjetë.

Naim Frashëri [BN - 895]

Parajs' e vërtetë vetë
Është Mëmëdheu në jetë.

Naim Frashëri [BN - 896]

Kur n'kët shekull n'dritë e qite,
Kur e rrite

Me njat mund që nep hitia,
"Nji nanë tjetër, thoshe, ke,
Bir, n'ket' dhe,
Nana jote a Shqyptaria,
Mend e zemër për të shkrij,
E përtëriji
"Nam e lavd kur t'i vijë dita"
Mbas fjalësh t'tua përherë shkova,
E t'ndigjova:
Shqyptarinë nuk e korita.

Ndre Mjeda [BN - 897]

E më thotë: o vlla, nji teje
Këto zemra për gjithëherë,
T'forcueme prej një feje
Rrahne n'këtë jetë të mjerë;
Një caku kje, nji shkëndija
E zemrës: Shqyptaria.

Ndre Mjeda [BN - 898]

Po 'j dit' do t'vite e ma i lum do t'ishe
Ndër gjith' qytete me t'thirrun t'parin,
Kur n'nji kish' tande me mbajtun kishe
Ma t'madh Shqyptarin.

Ndre Mjeda [BN - 899]

Se birin tënd s'e thau civilizimi,
S'e thau shekulli i atomit
Dhe i zbritjes në Hënë;
Në buzët e plasura s'iu vyshk belbëzimi,
Belbëzimi i foshnjës që përgjërohet për nënë.

Dritëro Agolli [BN - 900]

Ejani mblidhuni shqiptarë,
kudo jeni nëpër botë,
ta dijë njerëzimi mbarë
sa miliona kemi sot!

Alqi Boshnjaku [BN - 901]

Hija ime nuk di dhunë,
Di veç frymëzim liriye,
Dhe di punë, punë, punë,
Mund pa fund për art magjije.

Lasgush Poradeci [BN - 902]

Dhe t'a shoh të pasqyruar
Vetëveten fije-fije,
Fije-fije poezije,
Që mban erë Shqipërije.

Lasgush Poradec [BN - 903]

Se njerëzit gjithë vdesin,
Por jeta s'mbetet e shkretë,
Gjuha, Mëmëdheu mbesin
Të patundurë përjetë.

Naim Frashëri [BN - 904]

Pa njeriu si të mësonet,
më s'i ndahet djallëzisë.

Naim Frashëri [BN - 905]

Si të msojnë ligësitë,
e të mirat t'i harrojnë,
të çpikinë djallëzitë,
pastaj të na mbretërojnë?

Naim Frashëri [BN - 906]

Si të rriten nënë xgjedhë,
nukë bënenë të lirë,
pastaj s'e hedhëm dot ledhë,
po mejtohi që sot mirë.

Naim Frashëri [BN - 907]

Ata duhet të mësojnë,
të bëhenë të vërtetë,
të lëftojn' e të gjykojnë
pas nevojës që të jetë.

Naim Frashëri [BN - 908]

Fjala liri nëpër natë ndez një vetëtimë,
Buzët e saj janë përherë etje për njerinë,

Xhevahir Spahiu [BN - 913]

Pash Zotin, lshoni hutat!
Pse teper gjak asht derdhun,
Pse teper bajtë kem'futat:
Prej vajt' na asht marrun zani...

Gjergj Fishta [BN - 909]

Fjala liri lind një botë, botën e ndriçon
Dhe në çdo komb mbijeton.

Xhevahir Spahiu [BN - 914]

Medet, o qiell, medet!
A thue nuk jemi vllazen
T'njaj atmje t'tanë rritë n'prehen,
T'tanë t'quejtun me nj emen?

Gjergj Fishta [BN - 910]

O toka ime, m'i jep pranverat,
Mbah në shpirt zjarrin tënd – çudinë e tetë të
botës.

Xhevahir Spahiu [BN - 915]

A thue, kështu do t'xehen
Ata, qi 'i gjuhë e 'i doke
E 'i gjak kanë bashkë e 'i mbret?

Gjergj Fishta [BN - 911]

O këngë diellore shpalosi velat,
Si Kolomb nëpër botë udhëto,
Udhëto si Kolomb
Drejt së ardhmes, udhëto!

Xhevahir Spahiu [BN - 916]

Buzë kaltërsisë, ja një shteg, thonë se loton,
Pranë bukurisë, ja një yll, thonë se ëndërron,
Ne çdo ujëvarë, ja një diell lind dhe perëndon,
Ne çdo pulëbardhë krahëllirë, kush jeton?
Tek çdo njeri, ja një shpresë, niset si Kolomb
Në horizont, ja një velë, det kërkon,
Pranë dashurisë një re bëhet pemë e gjelbëron,
Në çdo shqiponjë të lirë kush jeton?

Xhevahir Spahiu [BN - 912]

Buzë kaltërsisë, ja një shteg, thonë se loton,
Pranë bukurisë, ja një yll, thonë se ëndërron,
Në çdo burim si lëndinë era vjen e shkon,
Në çdo legjendë krahëshpend, kush jeton?

Xhevahir Spahiu [BN - 917]



E pyesin udhëve: “nga mban
Ruga e kaltër për vatan?...”
- Ikni më larg, më larg; diku
Atje ku qielli është’ më blu,
Ku era fryn më me hare
Andej çon udha për Atdhe.

Imail Kadare [BN - 918]



Jam lark jush i dëshëruar, edhe s'e duronj dot
mallë,
Po s'e di si dua unë do t'u shoh një herë vallë?

Naim Frashëri [BN - 919]

Të munjam të fluturonja e të kishnjam krahë si ti!
Me gas të math do t'i vinjam Shqipërisë brenda
në gji.

Naim Frashëri [BN - 920]

Kam fort mall për Shqipërinë,
për miq edhe për të njohur,
e për gjithë njerëzinë,
i kam lottë të pashtrohur;
shumë kohë këtë herë
shkoj pa marrë ndonjë kartë,
zëmërn' e ndjen fort të mjerë,
edhe nga malli të zjarrtë;
zëmrënë dhëmbja ma mbushi
me helm e me hidhërime,
pa më digjetë si prushi,
e kam plot me mallëngjime,
për motërat' e për farët,
për vëllezër' e të tjerë,
dhe për gjithë shqipëtarët,
e për mëmëdhen' e mjerë,
aqë kam një mall të shumë
për Shqipërit nat' e ditë,
sa s'kam as prehje as gjumë,
më gjeti si çilimitë!

Naim Frashëri [BN - 921]

Sa të dua, o Shqipëri,
Sa mall ndiej e sa dëshirë,
Për ty gaz e dashuri
Mu në zemër më ka mbirë.

Asdreni [BN - 922]

Dua dhe Shqipërinë,
Se atje kam shtëpinë,
Ku rinja nëpër ferrat
Edhe losnja me shqerrat.
Për këto kam dëshirë
Edh'as dua më mirë,
Veç atje dua të shkonj,
Sa të jem e sa të ronj.

Asdreni [BN - 923]

Gjithë më thonin se kjo dit' do vinte,
por unë s'pata besë që të arrinte.
Tani po ikën me kalin flutur n'erë,
Si ëndërr t'ëmbël, ti merrmë përherë.
Në vend të huaj, arbrishten s'do ta ndjesh,
Shtëpinë e kopshtin tënd nesër s'do gjesh.
Nderime si këtu, s'do kesh atje ti,
O zemërgur, përse me ne nuk rri.

De Rada [BN - 924]

E pyesin udhëve: "nga mban
Rruga e kaltër për vatan?..."
- Ikni më larg, më larg; diku
Atje ku qielli është' më blu,
Ku era fryn më me hare
Andej çon udha për Atdhe.

Ismail Kadare [BN - 925]

Larg ne jemi si zogj pa fole
Zogjt kemi zili
Retë kemi zili
Që shtegtojnë drejt teje Atdhe.

Ismail Kadare [BN - 926]

Përmbi fusha dhe male
Fluturo,
Përsëndetje të zjarrta
Vendit tim i dërgo.

Ismail Kadare [BN - 927]

Duke njohur shqipëtarë,
gjithë të mirat' e tija,
e di punën q'është' e mbarë,

Naim Frashëri [BN - 928]

Mjaft,
Se pash me pash
I rashë botes
Qark.
Unë
Vetëm me veten
Shtegëtar i ngratë.
Bota më josh si magji
Por dua të kthej nga vij.

Rovena Dilo [BN - 929]

Për Shqipërinë
Ditët e mira
Paskëtaj vinë,
Shkoj errësira;

Naim Frashëri [BN - 935]

Se Shqipëtar
E gjuh' e tija
Venë së mbari

Naim Frashëri [BN - 936]

Se,
Shpesh e me shpesh,
Ndiej që malli me mbyt
Se,
Dua pak ajër
Të ngopem me frymë.

Rovena Dilo [BN - 930]

Pa dituritë
Dhe mbrothësija
E mirësitë
Dhe njerëzija,
Do të burojnë,
Nukë mënojnë.

Naim Frashëri [BN - 937]

Çdo natë në gjumë
Shoh shtëpinë
Në pragun e saj
Të shplohë trupin tim.

Rovena Dilo [BN - 931]

Por nuk u shuejt edhe jo, Shqyptaria:
lodhun prej hekrash që mizori i njeti,
Lodhun prej terri ku robnimi e qiti,
Shpreson me e zgjue fluturim mënia.

Ante i tokës sime
Atdhe të prek dhe jam Perëndi.

Rovena Dilo [BN - 932]

Ndre Mjeda [BN - 938]

Po, kam veç një zemër
Po deshe ti
Do rilind për ty, Ante.

Rovena Dilo [BN - 933]

Ka zogj fatlumë që shkojnë e vijnë,
ka zogj që nisen, por kurrë s'mbërrijnë,
nga udhë e gjatë, padurimi,
në fluturim ngrijnë.

Timo Flloko [BN - 939]

Ante i tokës sime
Atdhe të prek dhe jam Perëndi
Po, tek ti kam zemrën
Rrënjët tek ti
Kur të shoh, rilind, Ante!

Rovena Dilo [BN - 934]

Dhe tek i sheh atje lart,
në kthimin prej së largu,
s'di janë të gjallë, a malli i ka ngrirë,
në vdekje krahëhapur!

Timo Flloko [BN - 940]



Komb'i kombeve do ngjallet!
Sado që është sot i vdekur,
Drit' e Zotit do të çpallet!
Se e vërteta dermon hekur!

Dushi Jorgobaba [BN - 941]

Po zgjati pak shkëlqimi
i Flamurit n'ditët tona përtëritur
krahu s'ish, as gjenia
e Princit Gjergj nga qielli i zbritur

Zef Serembe [BN - 947]

Dhe Muza ime seç u drodh ndër këngë
me lutje të thella, e me psherëtima.
Atdheut i urova ditë të kthjellta, pa brengë
mua në të ardhmen të qeta dafina.

Zef Serembe [BN - 942]

Dhe Muza ime qau e qan përherë
dhimbjen shqiptare që rilind përsëri
dhe me kujtimin e lavdisë së hershme
në çdo zemër do të zgjojë dhembshuri
se për një epokë fisnik s'është i denjë
ai që harron të mirat që pat dikur
se gjaku i Shqipërisë Evropën të tërë shpëtoi ...

Zef Serembe [BN - 948]

Dhe m'ikte mua me të shpejtë rinia
tok me dëshira dhe me dashuri
dhe loti i nxehtë në qepallat e mia
para se të më dilte seç u ngri

Zef Serembe [BN - 943]

Sa pisk e kam, sa dhembje ndjej, sa dua
Të më përpijë brenda dheu i zi!
Oh, zgjate dorën sonte edhe mbi mua,
Të ngrohtë dorë, o mëma Shqipëri!

Mandej pashë Flamurin dhe ish Ai
që u bë leckë, u ndot dhe u pat varrosur
me qivurin në Lezhë. E ashtu u shkri
në botë kujtimi i truallit shqiptar.

Zef Serembe [BN - 944]

Një çast më merr në gjirin tënd të shenjtë
Të mbështes kryet e të qaj, të qaj,
Ashtu siç mund të qajnë, o mëmë e shtrenjtë,
Veç foshnjat dhe fajtorët e pafaj!

Jorgo Bllaci [BN - 949]

U duk në Prizren, i bukur dhe krenar,
ende i çjerrë dhe i pluhurosur
Dhe ngjan atëherë se brofi nga varri i thellë
Heroi ynë, shkëlqimtar si diell.

Zef Serembe [BN - 945]

Se pas dimrit vjen një verë,
Që do t'kthehemi një herë,
Pranë vatrës, pranë punës,
Anës Vjosës, anës Bunës.

Jorgo Bllaci [BN - 950]

Seç histori, zie e shkatërrimi
lavdie; qëndrese dhe trimërie
e ç'madhështi te ai varr gjejnë pasqyrimin
çfarë force të madhe atdhedashurie!

Zef Serembe [BN - 946]

Fan Noli [BN - 951]





O flamur-gjak, o flamur-shkab,
o vlla e motër, o nën' e bab,
lagur me lot, djegur me flag,
flamur i kuq, flamur i zi.

Fan Noli [BN - 952]



Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin Shqipëtar,
Zemërnë ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.

Naim Frashëri [BN - 953]



Xbrit, pa xbrit, o e vërtetë!
xbrit nga gjur' i Perëndisë,
jakë pakë tatëpjetë,
t'u apç dritë njerëzisë.
Ta mësojnë shqipëtarët
ç'ish Shqipërija njëherë,
ç'burra qen' ata të parët,
të dëgjuar' e të ndjerë.

Naim Frashëri [BN - 954]

E dashura Mëmëdhe,
Të dua dhe kshu si je!
Po kur të të sho të lirë,
Do të të dua më mirë!

Çajupi [BN - 962]

Balt' e Shqipërisë,
Djep' i Trimërisë,
E ëmbël si mjaltë ...
Zoti na e faltë!

Çajupi [BN - 963]

Në ç'vend kemi lerë?
Ku na bëjnë nderë?
Në Shqipëri.

Çajupi [BN - 955]

.. Pse t'ka rrejton fati
t'njomë edhe virgjin? Egërsija e jote
mos mban n'at gji, q'i hueji nuk peçati,
stinën e fundme t'poezis s'ksaj bote?

Po njeriu vetë
Cilinë do në jetë?
Do vend' e ti.

Çajupi [BN - 956]

Ernest Koliqi [BN - 964]

Ku i duket balta
M'e ëmbël se mjalta?
Në Shqipëri.

Çajupi [BN - 957]

Jo, jo ky dhe asht nana që na ka rritun
Me tamel të gjive të vet na ka ushqye,
Asht vasha qi dashtnin e ka njëton
Në zemra t'ona e të butit e kemi ylnjye.
Kush kish me mujtë, qi ka dashtnin e dlirë
Si bir e dhandër, me gjak të vet me e pshtirë.

Ku rron me një shpresë?
Ku kërkon të vdesë?
Në vend të ti.

Çajupi [BN - 958]

Shkodër [BN - 965]

Ku munt të gëzojë
Dhe me nder të rrojë?
Në Shqipëri.

Çajupi [BN - 959]

Eni e gazmonju, o Shqiptarët e mi,
Zoti me ne asht kenë, qi na ka pri.

Përse të punojë
Dhe të lakëmojë?
Për vënd' e ti.

Çajupi [BN - 960]

Shkodër [BN - 966]

Eni, djelmt e mi, dhandrrit e dashunis,
Eni të ju shtrëngoju me mall, në krahnuer,
Se pa ju kishim mbetë, mbetë të gjith t'robnis,
Kishim bjerrë erz e kishim mbetë shtuer,
Eni e pushoni në krahnuer t'em e mësoni,
Fmive t'uej se sa jeni trima e si luftoni.

Kjo tokë e ruajtë ëndrrën në malet si foshnjën në
djepet,
Kjo tokë përzuri nga ëndrra e saj merimangat,
Kjo tokë i shtypi nga ëndrra akrepët ...

Dritëro Agolli [BN - 961]

Shkodër [BN - 967]

Sielli syet e rrotulloj
Shife diellin kah shëndritë
Hylli i Paqit pra agoj
Për Shqypni qi t'dalin në dritë.

Shkodër [BN - 968]

Ikne retë qi na panë mblue
Me mjerim e me ligшти
Shkuen gjakpizat aq të tërbue
Tash sa mot pane në Shqypni.

Shkodër [BN - 969]

Mbërrini koha e dishrueme
Tash sa mot qi e patme pritë
Doli hylli i Paqës së gëzueme
Dashtuninë zbashkut me na rritë.

Shkodër [BN - 970]

Orrla e bisha, peshqit në detë
Si të tërbuem tuj ba rrenim
Tash të gjith bota paq do të ketë
E të fillojnë një jetë me gëzim.

Shkodër [BN - 971]

Reja u zhduk qi na pat mbëlue
Hylli duket se agon
Me flamurin tuj flakrue
Porsi dielli rreze lëshon.
Tuj prue kohën e liris,
Rrënoftë flamuri i Shqipnis.

Shkodër [BN - 972]

And e kand gjithkah Shqipnija
Për atdhe zemra më ngufon
Tuj u mbledhë bashkë të gjithë komsija
Nën flamurë tuj britë s'pushojnë.
Rrënoftë flamuri kuq e Zi
Porsi dielli shëndritë në Shqipni.
Të lutem shoq qi je tuj këndue
Nji, ket vjerrshë qi e rrethojnë
Njato germa q'i kam vu
Më difto çka shenjojnë?

Shkodër [BN - 973]

Gëzohu Shqipni se tuj luftue
Je e përmendun për gjithmonë
Emni i yt s'ka me u harrue
Sikuer herët njashtu vonë.
Në gëzim të nanës gëzou, o bir,
Se komi i yt thirret i lirë.

Shkodër [BN - 974]

Rrezja e diellit mbi ne ka dalë.
Edhe Zotit i qofshim falë
Se nji kështu dalë ka-dalë
Shqipnija do të venë mbarë.
Rreze dielli mbi ne ka lshue.

Shkodër [BN - 975]

Po, edhe hana do t'a dije,
Edhe dielli do t'ket pa,
Se për qark ksaj rrokullije,
Si Shqipnija 'i vend nuk ka!

Gjergj Fishta [BN - 976]

N'ty mendoj kur agon drita,
Kur bylbyli mallshem kndon,
N'ty mendoj kur soset dita,
Terri boten kur e mblon.

Gjergj Fishta [BN - 977]

Porsi fleta e Ejllit t'Zotit
Po rreh Flamuri i Shqypnis,

Gjergj Fishta [BN - 978]

Mbi njatë Flamur Perendija,
Me dorë t'vet Ai e ka shkruë:
"Për Shqyptarë do t'jet Shqypnija:
Kush u a prekë, ai kjoftë mallkue!"

Gjergj Fishta [BN - 979]

Permi flatra
të bardha t'Fes kjo lutë u çue kah qiella
E i shkoi n'vesh Perendis e e preku n'zemer.
I Amshuemi, atëhera, prej visarit t'qiellvet
Xjerrë nji pelhurë të njyme "kuq e zi",



Qi Engjujt vetë n'Parriz endun e kishin:
E mbasi e puthë i Lumi e ven në ball,
Nji Kerubini t'lehtë i urdhnon tu' i thanun,
"Na, e ketë Flamur Skanderbegut çoja
Atje poshtë n'Krue, e thuej prej ane s'ëme,
Se dërsa t'rrije tok fisi i Shqyptarit
Nen hije t'ktij emblemi t'em t'bekuem,
Zot m'vedi e i lirë gjithmonë ai ka me kenun".

Gjergj Fishta [BN - 980]

Si Lajmi i qiellvet n'dorë i a dha Flamurin
E i tha se per nen hije t'tij Shqypnija
E lirë e zojë m'vetvedi p'rherë do t'jite.

Gjergj Fishta [BN - 981]

Nji fllad i lehtë, i ambël –
Flladi i Dashtnis – po e zhdrivillon Flamurin.
- Flamurin e Atdheut t'em – qi tue gufue
Madhnueshëm neper ajr të lirë t'Shqypnis,
Nisë me u valvitë si fleta e Kerubinit,
Si njai skundilli i petkut t'Perendis,
Qi, mirë qendisë me hana, hyj e diella,
Prej krahvet t'amëshuem e t'gjithpushtetshëm
I mvalet poshtë neper hapsi t'Empirit,
Kah, pshtetë m'stuhë e m'flatra t'rribës s'Murranit
Sheston boshtin e moknes s'rrokullis.

Gjergj Fishta [BN - 982]

Fizjonomi nuk ndrroi as s'u pilue
Njaj ideali i ynë kombtar e shpresa
E gjallë, se zojë m'vedvedi 'i herë Shqypnija,
Stolisë me rreze t'lumënis s'perparshme,
Madhnueshem shtegut t'qytetnis do t'bite.

Gjergj Fishta [BN - 983]

E me atë fuqi, qi shejtet t'drejtat t'ona
Na epshin ne, i thyem, edhe prej Zotit
E jona duel; pse sod po ka Shqypni.

Gjergj Fishta [BN - 984]

Nuk e di se qysh e si,
nuk e di se qysh nga se,
po nashti një shpres' e re,
shtin e shkrep në sy të mi.

Ali Asllani [BN - 985]

Do na zhduket errësira,
do të zhduket ajo dorë,
nesër vjen me shum' të mira
shkaba jonë dykrenorë.

Ali Asllani [BN - 986]

Dora juaj, ajo dorë
kordh' e shkabës dykrenorë,
diti shkrep shkrepëtit,
diti bukur e goditi
pra, nga lind e perëndon
nami juaj po gjëmon!

Ali Asllani [BN - 987]

Kjo tokë-me lirinë dashuruar,
Një grusht dheu dhemb si zemra

Xhevair Spahiu [BN - 988]

Valët rrahin tokën.
Toka me njerëzit gëzon.

Xhevair Spahiu [BN - 989]

E dua qiellin e Shqipërisë
me diell, hënë e yje,
edhe me re e dua
nëse derdhin lotë lumturie.

Alqi Boshnjaku [BN - 990]

E dua lumin e Shqipërisë sime
me ujën e maleve,
dua të rrojë gjuha shqipe
sa jetëgjatësia e oqeanëve.

Alqi Boshnjaku [BN - 991]



Urdhëroj i Madhi Zot:
Zu ndrin yll' i Shqipërisë;
Ndrin e më s'përmbahet dot,
Se që sot e jetë-plot
Po rreh zemr' e Djalërisë.

Lasgush Poradeci [BN - 992]

Bjenë telat venë-e vinë,
Po na tundin Shqipërinë,
Toskërinë, Gegërinë,
Më çdo vënd, më çdo krahinë:
Që në Shkodër në Janinë,
Që në Vlorë-e në Prishtinë:
Opopo! ç'fitoj lirinë!

Lasgush Poradeci [BN - 993]

Se që sot e paskëtaj
Më s'ke breng e më s'ke vaj!

Lasgush Poradeci [BN - 994]

Se që sot e që tashi
Po të ndrin një yll i ri
Mun në zemr'e mun në gjil!
Pa ke nder e madhëri!
Ke gëzim e lumtëri!
Ke flamur të-kuq-të-zi!
Ke liri! liri! liri!
Rrofsh! e lira Shqipëri!

Lasgush Poradeci [BN - 995]

E sakaq një vall'e madhe
U përhap n'ato luadhe:
Ishte vall' e dashurisë,
Në luadhet e lirisë,
Mun në thelb të Shqipërisë!

Lasgush Poradeci [BN - 996]

Dh'atëhere... nënë mal...
Nisi kënga me-nga-dal...;
Nisi këng'e shentëruar,
E j-a mori më të shtruar...;
E j-a drodhi më të qarë...
E j-a zjeu... j-a hoqi zvarrë...;-

E pastaj si më s'u ndje,
Zu të ngrihet që përdhe
Gjith më nge ... e gjith më nge...;
E pastaj filloj të ritet ...
E të ngjitet ... e të ngjitet ...
Më me sulm... e më me jetë...
Më përpjetë ... e më përpjetë ...

Lasgush Poradeci [BN - 997]

Qjelli! qjelli! ç'ushëtoj!
Bot' e tërë ç'e dëgjoj!
Zot'i math seç kuvëndo!
Q'atje lart ku ndizen retë
Kuvëndo me zë të vetë
Zot' i math e i vërtetë:
"Rrofsh! moj Shqipëri përjetë!"

Lasgush Poradeci [BN - 998]

Shqipëri! moj nëna ime,
Më ke rritur me thërrime!
Shqipëri! të qofsha falë,
Të kam nënë-e më ke djalë!

Naim Frashëri [BN - 999]

Janë Toskë-e Malësorë-
Janë Toskë-e Malësorë
Me flamur të kuq në dorë
Si dhëndurë me kurorë.

Lasgush Poradeci [BN - 1000]

Do t'i falem pa pushuar
Ditës së njëzetetëtës,
Kësaj ditës së shënuar.

Lasgush Poradeci [BN - 1001]

Se kështu pat urdhëruar
Goj' e artë-e Zotit-vetës:
Do t'i falem pa pushuar.

Lasgush Poradeci [BN - 1002]



Po me gas në kraharuar
Të jam falë-o Zot i jetës!
Ti na dhe për të krentuar
Ditën e njëzetetetës.

Lasgush Poradeci [BN - 1003]

Ç'është' ajo shënjë Perëndije,
Që skuq si yll vetëtimtar:
Flamur'i shenjtë po mban hije,
Po fryn me frymë Shqipërije
Mi qjell të kombit Shqiptar!

Lasgush Poradeci [BN - 1004]

Flamur, o! shënj'e Perëndisë,
Me shkabën trime drejt në gji:
Valo mi qjell të Shqipërisë,
Mburroje çerdhen e lirisë
Me bes'e nder e burrëri!

Lasgush Poradeci [BN - 1005]

Ç'është ajo shënjë therrorije,
Që djeg me afsh si yll me zjarr:
Flamur i shentë po mban hije,
Po fryn me frymë Shqipërije
Mbi fat të kombit Shqipëtar!

Lasgush Poradeci [BN - 1006]

Flamur, o! shënj' e therrorisë,
Me shkabën trime drejt në gji:
Valo mi Fat të Shqipërisë,
Mburroje shpirtin e lirisë
Me bes' e nder e burrëri!

Lasgush Poradeci [BN - 1007]

Shqipëri! të qofsha falë!
Të kam mëm' e më ke djalë.

Naim Frashëri [BN - 1008]

Mirësetëgjëjmë, atdhe bujar!
Kosovë e lavdëruar!
Pranon ti, oh! Pak gjak shqiptar,
Që vjen për t'u dëshmuar?

Lasgush Poradeci [BN - 1009]

Po kërkoj një Tokë të Re
Që duhet të jetë
Atdheu im.
Kjo Tokë e Re
Ekziston diku
O dheu im, por nuk është prej dheu.

Lindita Arapi [BN - 1010]

Me zemërë të gëzuar
Dhe me gjithë shpirt uroni
Zotërinjt' e Zotëruar,
Gjithë përnjëherë thoni:
Rroft' e qoftë Shqipërija!
Dhe kombi e gjuha jonë!
Lulëzofte diturija!
Edhe ndihmës paçim Zonë!

Naim Frashëri [BN - 1011]

Se për mua ti, o atdhe,
Je një lule aq e vyer,
Sa nuk gjendet përmbi dhe,
Shpirtin tim për ta ushqyer.

Asdreni [BN - 1012]

Qindra vjete gjith në zi
Qindra vjetësh i helmuar,
Po një vlerë pate ti,
Që s'ka shembull, s'është dëgjuar.

Asdreni [BN - 1013]

Valët shkuan përmbi ty,
Kombe shkelën pa mëshirë,
Po një s'pati faq' e sy,
Të të shoh' prej dheut fshirë.

Asdreni [BN - 1014]

Se ke trima si më s'ka
Se ke burra të pavdirë,
Droja syrin s'ua ha,
Sisën tënde kanë pirë.

Asdreni [BN - 1015]



Mos ki frikë, mos vajto,
Mos me kryet, trupin zgjatur,
Tunde krahun, u forco,
Dëfto namin që ke patur.

Asdreni [BN - 1016]

Lermë të bie në prehrin tënd të ngrohtë,
O hallemadhja ime shekullore!
Të puth duart e tua, më të mirat në botë,
I ngazëllyer të hesht me heshtje foshnjore.

Dritëro Agolli [BN - 1017]

Lermë të bie në prehrin tënd plot ledhatime,
O hallemadhja ime shekullore!

Dritëro Agolli [BN - 1018]

Më ke parë ti, atdhe, se cili kam qenë,
Edhe nëse jam lodhur për një çast,
Kokën në prehrin tënd kam vënë!

Dritëro Agolli [BN - 1019]

O vendi im, më gozhdo, mbamë.
Më buzëqesh paksa si foshnjës në duar.

Pano Taçi [BN - 1020]

O malet' e Shqipërisë, që mbani kryet përpjetë,
Tëmerr e frikë përhapni! përpini qiejt e retë!

Naim Frashëri [BN - 1021]

Mbretëronte urtësia,
paqa, kamja, nderi, shpresa,
drejtësi e dashurija,
miqësija besa-besa.

Naim Frashëri [BN - 1022]

Mëmëdhe, o jetëgjatë!
për shpëtimthit tënd njëherë
lëftoninë edhe gratë,
e s'të lininë të mjerë.

Naim Frashëri [BN - 1023]

Në kurt kurrë Shqipërija
nukë hyri, e në xgjedhë
s'e ka shtënë Perëndija
edhe nukë do ta hedhë,
po kërkon emrin e vjetrë,
dhe nderë që pat njëherë,
e s'e kish nonjë vënt tjetrë,
Zoti sërish do ta bjerë.

Naim Frashëri [BN - 1024]

Hape krahët, fluturove
thellë nëpër kaltërsi.

Udhëtove, udhëtove,
çerdhen ku do ta bësh ti?
Ty asgjë s'ta mbushka syrin?
As kjo pemë? As ky gur?
Më në fund, moj trimëreshë,
bëre çerdhe në flamur.

Xhevahir Spahiu [BN - 1025]

Rend kudo duke bërëtitur,
Nëpër shekuj faqendritur,
Se i vogli shtrin viganin,
dhe i shtypuri tiranin.
Veç e tok

Tok, or Maratonomak!

Fan Noli [BN - 1026]



Përse mendohen këta male të lartë
Ndërsa dielli perëndon tutje në xhade?

Imail Kadare [BN - 1027]

Male, o ju male,
keni shumë halle.

Popullore [BN - 1028]

Përditë shoh qartë e ma qartë
dhe vuej thellë e ma thellë.

Migjeni [BN - 1029]



Shpëndëra, hithëra, ferra
Përsipër të kanë rënë,
Dritënë ta kanë zënë,
Me fletë shumë të gjera.

Naim Frashëri [BN - 1030]

Sot një heshtje, një përtesë
Me një rojtje në shërbesë.
Ësht i ftohur, është' i ngrirë,
Pa një ndjenjë, porsi i mpirë.

Asdreni [BN - 1031]



Përse mendohen këta male të lartë
Ndërsa dielli perëndon tutje në xhade?

Imail Kadare [BN - 1032]

Shpëndëra, hithëra, ferra
Përsipër të kanë rënë,
Dritënë ta kanë zënë,
Me fletë shumë të gjera.

Naim Frashëri [BN - 1033]

Të kanë kallurë gjemba,
Që të çpojn' e të lëndojnë,
Edhe gjaknë ta helmojnë,
Që të lëvrin nëpër rrëmba.

Naim Frashëri [BN - 1034]

Dimër i math e me dëborë,
Me të ftoht' e me të ngritë,
E me gjithë ligësitë,
Të la të mjer' e të gjorë.

Naim Frashëri [BN - 1035]

Ah! Ta xbriti bukurinë,
Dhe gjëllimn' e gjithë ç'kishte,
Vdiqe, u trete, u prishe,
Të thatë të shoh taninë!

Naim Frashëri [BN - 1036]

Ish në t'errët nat' e ditë,
gjë s'shihte e gjë s'dëgjonte,
nukë shihte kurrë dritë,
jetën të zez' e shkonte!
Ishin ca të mallëkuar,
vinin rrotull n'errësirë,
t'egër' e të tmerruar,
mundonjës e të pështirë!
Këmbëxbathur, kërshinjtatë,
e shumë të shëmëtuat,
lakuriq e mjekrëgjatë,
pa zëmërë në krahëruar;
gjithë gërxe kok' e tyre

nga rrekat e nga lëvaret,
me fytyrë prej mynxyre,
u vininë rreth të mjerët!
Kishin nëpër breza thika,
dhe ndër supa kordha vartur,
t'i shihnje të merrte frika,
ndjenje në zëmërë të mardhur!
N'emërit të Perëndisë
na' të vënt të mallëkuar
i faleshin djallëzisë
duke larë këmb' e duar!

Naim Frashëri [BN - 1037]

Ish një komp i mallëkuar
në gjuhët kish dhelperinë,
syn' e kish të egërsuar,
në zëmërt kish djallëzinë;
ngado vij e kudo shkonte
zin e gjëmën po shpinte,
vrste, priste varfëronte,
atje tek shkelte, bar s'mbinte;
më një anë kishte fuqinë,
gënjeshtrenë m'anët tjetrë,
për të mbytur njerëzinë,
bënej her' ujk, herë dhelprë.

Naim Frashëri [BN - 1038]

Ç'u bë emr' i Shqipërisë,
dhe liri e saj e ndjerë?
Ajo drit' e Perëndisë
vallë më s'vjen tjetrë herë?

Naim Frashëri [BN - 1039]

Ndale, ndale Drin vrapimin,
Qëndro pak e hidh vështrimin!
Rrotull teje duke i parë,
Se sa janë për t'u qarë,
Viset tona që rënkojë,
Kur të parat i kujtojnë!

Asdreni [BN - 1040]

Lulëkuqja e mjera
Asgjëkundi s'ka shtëpi,
E shkon jetën nd'arrati,
Ajo s'është si të tjera,
S'ka stoli!

Fushës, kodrës del vetiu,
Verës ngrohet, dimrit ngrin,
Vetë shkundet, vetë mbin
Dhe skuqet, vjen veriu
dh'e përfshin.
Nëpër këmbë të gjithë e shkelin
Vend në kopshtet ajo s'ka,
Dorë ndihme kurrë s'pa;
As e mbjellin, as e vjelin,
shkoj u-tha ...

Po veç ngjyra e saj si zjarri,
Si një hyll që xixëllon,
Tërë bota e imiton;
Është shenjë për së mbari,
nga shëkon.
Ajo ngjyrë kur zë e çfaqet,
Mbreti fronë shkon e le,
Njerës robër fare s'sheh,
Vjen e drejta del në faqe:
si zot je.

Ajo ngjyrë nd'ato fletë
Është shpresë që tregon
Një të ardhme që ëndërron...
Është flamuri ynë vetë,
që valon!

Asdreni [BN - 1041]

Mes kënaqësive dehet
mendja, e humb fuqinë,
molisen fare shpirtrat,
njeriu t'zezën s'e ndien,
dhe meqë i do gëzimet,
i kënaqur dhe i përtuar,
harron se është robëruar
se atdhe ai më nuk ka;
e n'kaq duron te qafa

një zgjedhë që s'meriton,
edhe pa ditur asfare
despotin e ndihmon.

Pashko Vasa [BN - 1042]

Të tillë bisedë u mban:
"Gëzo, o ti i zdërhallur,
ti popull skllëvëri, dehu,
zhytu me trup e shpirt,
ligshto ato kocka e deje,
ndër qejfe, me gjithë zemër
për t'mirën tuaj veprojmë,
në gjumë ne mirë t'ju vëmë
helm t'ëmbël ne ju shtrojmë.

Pashko Vasa [BN - 1043]

Gëzoni, pra, dhe shporruni
nga ajo mendjemadhësi
e atdheut edhe e lirisë ...
Lindët për skllavëri!
E n'qe se ju kënaqeni
që ju trajtojmë kaq mirë,
ç'kërkoni më? Të shtrirë
shërbeni n'altar tonë!"

Pashko Vasa [BN - 1044]

Të ka bërë Perëndia
luftëtar,
Si s'të lodhi robëria,
shqipëtar!

Çajupi [BN - 1045]

Djalërin' e Trimërinë
S'i humbe për Shqipërinë,
Vajte lëftove për botë,
U mundove dëm e kotë!
Bir, o djal' i vetëmë,
Se ç'më nzive jetënë! ...

Çajupi [BN - 1046]



Pse rrini lidhur me lak?
Pse s'shpëtoni vëndë tuaj?
Apo s'u mbeti më gjak
Se e derdhtë për të huaj.

Çajupi [BN - 1047]

Oborrin m'a muarr
gjer në shtëpi
dhe ngrehnë për vete shtëpi
në syt e mi!

Mitrush Kuteli [BN - 1053]

Flamuri

S'i shihet n'horizont i dliirë shkëlqimi
Dhe as nuk i fal ngjyrat për fitore
më nuk shartohet mbi lavdinë njerëzore
porsi një shenjë drite apo mjerimi.

Zef Serembe [BN - 1048]

I grisur ra dhe s'e përfill njeri,
dhe gjindja e Arbrit, e ndershme e krenare
mori mërgimin dhe as ndalet fare
në një breg mikëpritës n'siguri.

Zef Serembe [BN - 1049]

N'mëshirë të fatit përherë duke ndeshur
intriga diplomatësh, n'hidhërim
çdo shpresë e çdo premtim ngadalë i tretet
Dhe koha kalon, rend fluturim.

Zef Serembe [BN - 1050]

Nga gjithçka na premtuan asgjë s'mbetet.
Më keq na shkelin se sa truall'n e zhveshur.

Zef Serembe [BN - 1051]

Duhet t'ikin q'andej ku mezi mbërritën.
Të vijnë atje ku ikja ëndërr ish.
Mëdyshjet shpirtrat kështu ua sflitin,
Tek rendin midis shtetesh e kufijsh.
Shkabën sovrane e kërkojnë ndër qiej
Të vijë të mbledhë shtetasit e vet ...
Por qielli s'jep asgjë, e aq më pak
Shqipen dykrerëshe veç në ethe e jep.

Imail Kadare [BN - 1052]

Dhe unë
ja, unë!
që isha zot
që qëmot:
mbeta pa dhe,
-bujk pa dhe,
bari pa kope –
këtu,
në dherin t'im
Dhe plori m'u ndryshk,
Po shpresa s'm'u vyshk!

Mitrush Kuteli [BN - 1054]

Durova
durova, -
Sa nuk duroi njeri!
as Perëndi!

Mitrush Kuteli [BN - 1055]

Më thanë të shkruhem vojnuk
mynafik
i Kombit t'im.

Mitrush Kuteli [BN - 1056]

Më dhanë armë të vras
vëllanë
sipas kanunit
të gjakut ...

Mitrush Kuteli [BN - 1057]

Po s'desha
Dhe në e bëra,
m'a falni:
Se jam gjak-nxehtë.

Mitrush Kuteli [BN - 1058]

Po malli i Tokës s'më la
po malli i Fushës s'më la
as gjaku i Babës s'më la.

Mitrush Kuteli [BN - 1059]

Po dot nga toka s'u ndava
dhe mbeta të jem
ku jam
e ku do jem!

Mitrush Kuteli [BN - 1060]

Po malli i Vendit s'më la,
ah, malli i Gjakut s'më la
e mbeta këtu,
raja!
ndënë raja
të ha
një bukë-zehër
lagur me lot
njomur me vrer
dhe të pres
po, të pres!
një tjtër mëngjes,
e dit për dit,
e net pas net
e vjet pas vjet
rrojta
e vojta
kaba
ndënë shkjah:
raja
ndënë raja
si në hata
si tjtër s'ka!
Po prita
dhe prita
të vijë dhe për mua
dita!
Tani
tani,
Liri!

Mitrush Kuteli [BN - 1061]

Lëvon topi, kërcet pushka,
gjak po derdhet si rrëke,
burrat bien si lëpushka
për tyj i dashur Atdhe.
Pse, vallë kjo gjëmë e madhe,
pse, vallë, kjo ulërimë?
i bë kjo fqinjia zuzare
për të humbur Shqipërinë.
Fëmijët i djegin në zjarr,
grave nderin ua humbasin,
të gjalla i fusin në varr,
vetëm shqip të mos flasin.
Cila perëndi duron,
këto që po bën Greqia,
cila histori nuk shkruan,
seç po vuan Shqipëria?
Nënë fshat që quhet Lekël,
që është thjesht shqipëtar,
ndë kishë të vrarë gjetën
mbi treqind e ca të vrarë.
Therur me thika si berra,
i kishin lënë kapicë,
ulërijnë mëmat e mjera
për të shkretët hormovitë.
Ishnë gjithë nga Hormova,
mu ndë kishë i kishnë shtënë,
atje ku kishte ikona ...
krishti grek kështu ka thënë?

Vlorë [BN - 1062]

E na do rrimë ndër fjalë e tue kujtue?
Se çka me ba, se çka me gjykue?

Shkodër [BN - 1063]

Ndera mbi shekull dhunë gjithmonë asht kthye,
E t'mirën nieri kurr s't'a ka permendun,
Sa t'keqen punë me t'cillen t'a keshë fye;
Si edhe ma t'shumen, miq s'gjen nieri i shkretë,
Kur skami e kobi t'a ket mblue n'ketë jetë.

Gjergj Fishta [BN - 1064]



Na e tregojnë drejtimin plumbat që fishkëllejnë
në errësirë.

Na e ndriçojnë rrugën flakë, që gjithë tokën
kanë përpirë.

Bilal Xhaferri [BN - 1065]

Dhe rrugët zgjaten e zgjaten në veri
Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi.

Bilal Xhaferri [BN - 1066]

Lirin' e keni ju! Na hekra kemi,
Na terr e niegull deri n'ditt ma t'vona;
Na pa emën kurrkund, pa atdhe; na jemi
Shërbtorët e t'huejve nëpër vende tona.

Ndre Mjeda [BN - 1067]

Porsi berre që bleu mishtari vemi
Mbas shkopit, t'kalamenduna ku s'dona,
Ahte t'ankueshme nëpër buzë polemi
Vaj e mjerime qet kjo tokë e jona.

Ndre Mjeda [BN - 1068]

Vinin vargmalet e tmershme vërdallë
Nëpër natë e mjegull,
Të verbër,
Të frikshëm.
Si të trembur me klithma të lashta, tragjike,
Hingëllinin nëpër ëndërr malet kreshnike.

Imail Kadare [BN - 1069]

Sërishmi të rënë nga varret kokën përgjakur
çonin
Nën qiellin me tym, mbi tokën breshër
Dhe grykat e lashta me plagë rënkonin:
A erdhi ëndrra e madhe që pritëm, vëllezër?
Nuk erdhi, vëllezër, nuk erdhi, vëllezër,
Në rrugë ka gjemba dhe ndofta vjen nesër!

Dritëro Agolli [BN - 1070]

E njoma pendënë në vrer –
të nis t'ju shkruaj kart,
ah, këtë kartë!

Mitrush Kuteli [BN - 1071]

Sa tmerr, o zot, sa tmerr,
ta njomësh pendënë në vrer!
Kaq tmerr të zi e lemeri
që panë sytë e mi –
s'ka parë asnjeri.

Mitrush Kuteli [BN - 1072]

...Shtëpinë e pashë kur m'u doq,
e pashë foshnjën kur m'u poq –
edhe tim shoq,
po, dhe tim shoq!

Mitrush Kuteli [BN - 1073]

Dhe jam q'ahere siç më sheh,
ah, siç më sheh e nuk më njeh:
një fletë e thatë nëpër erë,
kur në parajs, kur në skëterrë.
Edhe mendimi im ...
Çmendim!

Mitrush Kuteli [BN - 1074]

Un' natë për natë bredh ndër qiej,
po, bredh ndër qiej –
e kur më shkrep shkoj tej përtej,
mbi male shkumb, mbi kulme hej,
po, tej përtej.

Mitrush Kuteli [BN - 1075]

....

Shtëpinë e pashë kur m'u doq,
e pashë foshnjën kur m'u poq –
edhe tim shoq,
po, dhe tim shoq!

Mitrush Kuteli [BN - 1076]

Sa tmerr i madh, sa tmerr
ta njomëshë pendënë në vrer!
Kaq tmerr të zi e lemeri,

sa panë sytë e mi –
s'ka parë asnjeri.

Mitrush Kuteli [BN - 1077]

Për drekë shkoj ne Zoti vet,
ne Zoti i madh e i vërtet',
që rri në ret'
me këmbë varurë në det.

Mitrush Kuteli [BN - 1078]

Më thotë shenjti: "Ulu, ha."
dhe unë qesh: "Hahaha!"
dhe unë qaj: "Hahaha!"

- Jo, mish prej foshnje nuk do ha ...

Dhe ik pastaj e fluturoj,
në qiej të verdhë si limoj,
e shkoj e shkoj.

Mitrush Kuteli [BN - 1079]

....

Tak-tak troket tak – tak:

- As hape derën pak,
as hape shpirtin pak."

- "Kush është në çardhak?"

S'përgjigjet asnjeri
nga terri i zi.

I them: - "Hej, folë! Kush je ti
në terr të Zi?"

"Jam zonja Shërmëri."

Mitrush Kuteli [BN - 1080]

... I bje më gju, bëj metani,
një herë, dy, dyzet e tri
edhe lotoj si foshnjëri:
"Ergjëndë je, moj Shërmëri,
e vojtur je, moj perëndi,
se ti ke qarë, se ti di,
sa është e dhembshur një fëmi,
sa është e ëmbël një fëmi,
Ah, kisha zonjë, një fëmi,
dhe desha fort ta mbaj në gji,

ta mbaj, ta rrit për Shqipëri,
për Shqipëri!"

Mitrush Kuteli [BN - 1081]

... Shtëpinë e pashë kur m'u doq,
e pashë foshnjën kur m'u poq –
edhe tim shoq,
po, dhe tim shoq!

Sa tmerr i madh sa tmerr,
që panë sytë e mi,
s'ka parë asnjeri.

Pa nis qan zonja Shërmëri,
aty në sytë e mi:
i rrjedhin lotët në shami.

Mitrush Kuteli [BN - 1082]

Dhe nis e unë edhe qaj,
vajtoj, vajtoj me vaj.

O sa çudi,

o sa çudi,

Të qajë zonja Shërmëri,
si qan një çilimi!

Mitrush Kuteli [BN - 1083]

Më erren sytë kur zë qaj,
më mbytet shpirti kur zë qaj,
nga kaqë vaj:

nga vaji im, nga vaji i saj.
Pa muret nis që t'i zgërmas,
ah, thonj-përgjakurë i zgërmas,
edhe bërtas,

porsi e çmendurë bërtas,
ah, leshëshuara bërtas:

Mitrush Kuteli [BN - 1084]

"Gënjeshtër je, moj perëndi,
gënjeshtër, zonjë Shërmëri,
se po të ishit, s'ka se si
të derdhej gjak në njerëzi,
të vishej jeta në të zi:
Jo, ju nuk jeni asgjëkund
në botën që s'ka fund."

Mitrush Kuteli [BN - 1085]



... Tak – tak troket, tak – tak:

- “As hape derën pak,
dhe zemrën hape pak.”

Dhe përsëri

hyn brenda zonjë Shërmëri.

Mitrush Kuteli [BN - 1086]

Kjo zonjë e rëndë Shërmëri,
kjo nënë e vuar Shërmëri,
veshur me ‘rgjënd e me flori,
në dorë një qiri.

Mitrush Kuteli [BN - 1087]

Dhe mbushet oda dritëplot,
pa mbushet shpirti këngëplot,
dhe syri im s’ka pikë lot,
o zot i madh, o zot!

Mitrush Kuteli [BN - 1088]

E më ka zonja rrotull saj
një tufë engjëjsh të pafaj,
dhe s’ndjej më vaj ...

Pa midis engjëjve e shoh

ah, foshnjën time dhe e njoh!

Mitrush Kuteli [BN - 1089]

I bje më gju, bëj metani,
një herë, dy, dyzet e tri:
“E madhe je, moj Shërmëri,

ti dorëlarë me flori,

ti më ke engjëj mizëri,

ah, falmë ti një mituri,

ta marr ta mbaj në gj,

ta mbaj, ta rrit për Shqipëri.”

Mitrush Kuteli [BN - 1090]

Dhe duart zgjata që ta marr ...

Këndon këndesi një, dy, tri

e tretet zonja Shërmëri,

si engjervi.

Qiriri shuhet pas qiri

e mbetem rishtaz në të zi,

në terr të zi,
në lemeri.

O sa çudi,

o sa çudi!

Jam unë vetë Shërmëri –

e s’di njeri,

nuk di njeri!

Mitrush Kuteli [BN - 1091]

Po mos i thoni asnjëri,

se del ariu

nga kora e zotit Shëndaum:

troket në shkallë bum-bum-bum,

buçet në derë dum-dum-dum,

e s’ka askush që më shpëton,

kur bubullon e vrungullon

e topi i shkretë kur gjëmon,

kur mitralozi të gozhdon,

kur qen milici të gërmon

e yt vëlla të tradhëton –

Paterimon ... Peterimon ...

Mitrush Kuteli [BN - 1092]

Më thirri i shenjtë e më tha –

i rrepti Shërmëhill:

“Pse s’vjen, moj bijë, atje la,

ku brenga s’ka, ku dhembje s’ka?” –

me gojë vetë seç më tha.

Mitrush Kuteli [BN - 1093]

S’i thashë: po,

s’i thashë: jo,

se un’ pres foshnjën që ta shoh

e ndër një mijë do ta njoh,

Po, do ta shoh!

E mitur është e sisë do,

e vogël është e këngë do –

“Më lërë e shko!”

Dhe iku zoti Shërmëhill,

e fut në kora, në kandil.

Mitrush Kuteli [BN - 1094]

Pa ngrihem natën e këndoj,
 ah, foshnjës sime i këndoj;
 “Tumna, tumna, tumnana!
 Këtë foshnjë kush e ka?
 Kush e ka e kush e do?
 Kush s’e ka e kush s’e do?
 Obobo, obobo!”

Ah, foshnja ime u bë hi,
 e unë klith nëpër çmendri.
 Mitrush Kuteli [BN - 1095]

...
 Po sonte prapë do fluturoj
 në qiej të verdhë si limoj,
 në qiej të athët si limoj
 dhe foshnjën time do kërktoj,
 do fluturoj!
 Mitrush Kuteli [BN - 1096]

Mos qeshni, zonja e zotëri,
 se flas kështu si çilimi,
 se qaj kështu si mituri,
 e veshur tërë në zi,
 në një qelizë në çmendri,
 këtu brenda në çmendri.
 Mitrush Kuteli [BN - 1097]

... Shtëpinë e pashë kur m’u doq,
 e pashë foshnjën kur m’u poq.
 Sa u përpoq!
 Sa u përpoq!
 Edhe tim shoq ...
 Dhe qindra njerëz si tim shoq
 e djem të varur në litar,
 kufoma hedhur në pazar,
 e gjak të kuq në gur të zi,
 fashistë qena mizëri.
 Mitrush Kuteli [BN - 1098]

Më vjen nga thellë të bërtas,
 në mes të natës të këlthas

e majë botës të buças,
 që të dëgjojë fund e krej,
 kush gjak njeriu ka në dej:
 Perandori!
 Perandori!

Perandori, xhehnem i zi,
 ti, nëmëmadhe Itali,
 ti që më solle robëri,
 ti që më veshe në të zi,
 ti që më mbylle në çmendri,
 u bëfsh hi!
 E mos të mbettë gur mbi gur,
 po vetëm pluhur,
 ah, vetëm pluhur!

Tak – tak trokas, tak-tak:
 as hapni derën pak,
 dhe shpirtin hape pak ...
 Mitrush Kuteli [BN - 1099]

Ma kanose, syrgjynose
 Më dërgove s’di se ku
 Jorgo Papingji [BN - 1100]

Ma tymose, ma nxirose
 Ma plagose qiellin blu
 Jorgo Papingji [BN - 1101]

Kur erdhën ishin lakuriq si zoti i vet
 Se posa kishin zbritur nga dega
 Nisën zënkën me zhurmë e poterë
 Se janë më të moçëm se rrënja.
 Sabri Hamiti [BN - 1102]

Kur erdhën rrënuan fshatra e qytete
 Urrenin çdo gjë për ta ish e huaj
 Ngritën tempujt e fesë së tyre të re
 Sabri Hamiti [BN - 1103]

A do mbetet Shqipëri,
 a do bënet tym e hi!
 Ali Asllani [BN - 1104]



Ideal' i tyre paqe,
punë e paqe dhe prandaj
ku dhe trepet bëhen parqe,
ku qesh gropëza në faqe,
ujku bombën që ta haj!

Ali Asllani [BN - 1105]

Ujku bombat nëm e gjëmë!
këto pote kapitalli
rrymë e frymë farmak çakalli,
fund e krye duhen çdukur,
ndryshe bëhet byk në lëmë
tejpërtej kjo botë e bukur!

Ali Asllani [BN - 1106]

Pika dorës që s'i ra
që kurdís pusi në qiej,
ndjek fakirë e fukara
dhe përdheset me një tra,
sharton vdekje nëpër deje!

Ali Asllani [BN - 1107]

Edhe un' kam një përdhese
dy të tretat e një pjese,
që e quaj prokopi,
lem, pra, lem të puth të pi,
të shijoj me stil të ri,
në shqiponjën Shqipëri!

Ali Asllani [BN - 1108]

Lem, pra lem se, deomos,
sot a nesër un' do sos,
dhe do bëhem fije bari,
ose plis i një ugari,
ose fletë e një hardhie
do më ndukë një dhëmb dhie!

Ali Asllani [BN - 1109]

Shum' i hidhur, shum' e shumë,
mirpo imi më për lumë.
Kam një dert që s'thuhet sheshit,
un' kam dertin e arbreshit!

Ali Asllani [BN - 1110]

Un' kam dertin, atë dert
për një fjal' të lir të shkretë,
për një fjal', një fjal' të lirë
digjem plumb në zjarr i shkrirë!

Ali Asllani [BN - 1111]

Gati thika të më grisë,
robërin se kam për fisë!
Gati thika të më therë,
vënd'i mjer' e komb' i mjerë!
Nga të vemi, ku të vemi,
një kafshit' e vogël jemi!

Ali Asllani [BN - 1112]

Sytë i kish aty gjithë Shqipëria
Po i shkuleshin filizat
Deti iu bë mal me njerëz
Dhe toka det me lot.

Zhuliana Jorganxhi [BN - 1113]

... Na mbajtje rop gjith nënë thumb,
Na prure vdekjen gjith me plumb,
E kur nuk ra- yn' at u mvarr;
Dh'i hape truallin për varr,
E varrit-vet i vure zjarr,
Dh'e bëre shkumb.

Lasgush Poradeci [BN - 1114]

Por kjo gjamë që ban natyra,
Kjo duhi që s'ka pushim,
E kësaj zemre a pasqyra,
A pasqyra e vajit tim.

Ndre Mjeda [BN - 1115]

Është keq njerith' i mjerë
kur ka qënë si desh vetë,
pastaj bije menjëherë
e s'i mbetet gjë në jetë!

Naim Frashëri [BN - 1116]

Ah! o jet', e shkreta jetë!
që s'qëndron më një, po ndrohesh,

je e rreme, s'j'e vërtetë,
vet'e vete, pa ndryshohesh!
e mëson njerin' e mjerë
të heqnjë e të duronjë,
të ngrihetë e të bjerë,
dhe të parat t'i harronjë.

Naim Frashëri [BN - 1117]

Mos më zezo,
mos u kthe në shushamë.
Të kam mbajtur,
mbamë!

Xhevahir Spahiu [BN - 1118]

Ju priftërë mjekrë-gjatë!
Q'u quan kombi uratë,
Uratë e Perëndisë,
Q'është drit' e gjithësisë,
Mund të bëhi të pa-besë
Për të mirët të Moresë?
Mund të lini Perëndinë?
Dhe Krishtin' e Shqipërinë?
Edhe i fali Moresë?
Q'është pa-fe e pa besë.

Naim Frashëri [BN - 1119]

Dhe ju hoxh' e ju dervishë,
Mos shihni Xhami e Kishë,
Si Kisha është dhe Xhamija
Tekdo është Perëndia.

Naim Frashëri [BN - 1120]

“Në mos ndihetë Perëndija,
këtu janë dhelprëtë,
rroft' e qoftë pabesija,
dhe djalli e djallëzitet!”

Naim Frashëri [BN - 1121]

Po sot vallë, sot si janë?
Kryeunjur an'e mb'anë.
Sot më s'është ay zjarri,
Që e kishte shqipëtarin.

Ay gjaku që valonte,
Kur detyra ia kërkonte,
Me një fjal'e një besë,
Për atdheun'ay të vdesë;
Pasjen, gjënë mos kursejë,
Trimërinë të rrëfejë.
Sot një heshtje, një përtesë
Me një rojtje në shërbesë.
Ësht i ftohur, është i ngrirë,
Pa një ndjenjë, pors i mpirë.

Asdreni [BN - 1122]

E kish mbuluar fe-zija,
njeriu s'e doj njerinë,
mbretëronte e padija,
nukë ishte si taninë.

Naim Frashëri [BN - 1123]

Shqipëtarëtë punojnë,
gjith'ata kombet' e shuar
përpiqenë që t'i xgjojnë
ng'ajy gjum' i mallëkuar.

Naim Frashëri [BN - 1124]

Flutro, shqype, flutro kah çilet lama,
Siell'ju malevet përreth që ka Shqypnia,
E vështroje ku i del lirimt ama.

Ndre Mjeda [BN - 1125]

Në vendin tonë
kudo valojnë
flamujt e një melankolie
të trishtueshme ...
... dhe askush s'mund të thotë
se këtu rron
një popull që ndërton
diçka të re.
Aty këtu në hijet
e flamujve
mund të shifet
një mund, një përpiqje
e madhe përmbi vdekje



për të pjellë diçka të madhe,
 për të qitë në dritë një xhind!
 Por, (o ironi)
 nga ajo përpjekje lind
 vetëm një mi.
 Dhe kështu kjo komedi
 na plas dellin e gazit,
 nsa prej marazit
 pëlcasim.
 Në pragun e çdo banese
 ku ka ndoj shenj jetese
 valon një flamur
 melankolie të trishtueshme.

Migjeni [BN - 1126]

Luftova për atdhe
 Lëftova për liri,
 Por veshin, një s'ma vë,
 As dorë s'm'ep njeri.
 Pa kurrnjë ndihmë jam,
 Me plagë plot në trup,
 Fuqi më t'ecij s'kam,
 As rrobë s'kam mi sup.
 Armikut s'i jam tutë,
 Në ballët i kam dalë,
 Shpesh dërmën ia kam futë
 Dhe hovin ia kam ndalë.
 Nër nete, qiell pa hyj,
 Shtërngata vij me shi,
 Vend s'keshe ku të hyj,
 S'di vetë qysh jam gdhi.
 U-treta për disa,
 Q'as njihjin komb, atdhe;
 Mbi frone sot ata
 Që shgryhen pa një fre.
 Me mburrje posht'e lart
 Bërtasin me një zë,
 Se hyjtin mu në zjarrr,
 Kur zjarri s'ishte më.
 Kur isha në kushtrim
 Me shokët për atdhe,
 Ata gjithmon' pengim:

Çdo çap na venin re.
 Kur qe ndonjë rrezik,
 Disa që rrinin lark,
 Sot rendin vrik e vrik:
 S'mendohen veç për bark.
 Të tjerë më shpirtliq,
 Që prapë na kanë vra,
 Sot bëhen miq për fiq,
 Sikur më s'jan ata.
 Mundimet kush s'i njuh,
 Rrezikun kush s'e pa,
 Tekdo të ngopur sheh,
 Q'as vunë kurrnjë krah.
 S'pyesin sot kush je,
 S'kujdesen se si rron,
 Kur shkon, kurrkush s'të njuh:
 Syshtrembër të qëllon.
 Fëmijët mos më keq,
 Të çveshur un' i kam,
 Të zit' t'ullirit heq,
 Ndër mënd e mija s'jam.
 Përjashta, pa shtëpi
 Po breth andej këtej,
 Të lyp si faqezi
 Fëmijët që t'ushqej.
 Një send veç më ngushëllon,
 Detyrën se kam la.
 Kjo helmet mi shëron,
 Pa, fati-i em-m'u-pa.

Asdreni [BN - 1127]

S'kish dëshmitarë, TV nuk pati
 Zinxhiri i tankut kur ju griu,
 Por retë e globit veç ju panë,
 Ndërgjegje e botës te ju mbërriu.

Ismail Kadare [BN - 1128]

Por tuj kenë të gjithë një kom
 Katërqind vjet bark e shpind
 Me u vra me shoqishojnë
 Dihet që anmiqt na shtinë.

Shkodër [BN - 1129]

Anës lumit, i palarë,
Pranë dritës, i paparë,
Pranë sofrës, i pangrënë,
Pranë dijes, i panxënë,
Lakuriq dhe i dregosur,
trup e shpirt i sakatosur.

Fan Noli [BN - 1130]

Fat i ynë mizor – shpatë e Damokleut.
Si vall! Të gjitha përpjekjet na dështuen në terr?
E jeta na bahet ma zi se skëterrë.
Të vërtetat, as rrenat, s'i ndihmuen Dheut.

Migjeni [BN - 1131]

Të vërtetat dhe rrenat? – Xhevahirët e çmuem.
Me ta kur të dësh e shet dhe e blen botën.
Por mos mendo se me ta do t'ia ndreqish rrotën
...
Jo se i pëlqen jetëçalë me shkuem.

Migjeni [BN - 1132]

Me çalue n'anë të djathtë, me çalue n'anë të
majtë ...
Si paljaço i gjorë që kah t'ia mbajë s'di,
mbasi kambën e theu n'akrobaci –
jet' e tij asht helm pa asnjë pikë mjalhtë.

Migjeni [BN - 1133]

Dhe kemi qenë tmerrësisht të persekutuar.
Dhe jemi biblikë me biografi të mirë.

Frederik Rreshpja [BN - 1134]

Plehrat e qytetit mund të hiqen,
Për një javë, e shumta për një muaj
Po plehun në shpirtin e njerëzve,
Kush mund ta pastrojë?! Më thuaj.

Arben Duka [BN - 1135]

O, kur do të kthehesh ti, vjeshtë e njeriut,
vjeshtë e dasmave me flamur?
Të pres me një lule bozhuri në dorë
në dyert e dimrit, qyshkur.

Xhevahir Spahiu [BN - 1136]

Të vije veç një ditë e s'desha tjetër,
Të vije veç një ditë e le të plasja,
Të vije veç një ditë, o mik i vjetër,
Të më thuash se si është parajsa.

Arben Duka [BN - 1137]

Të vije veç një ditë, të kuvendojmë
Për jetën dhe për vdekjen fjalë të tjerrim,
S'e njoh parajsën, po këtu ku rrojme
Më mirë se veten e njoh Ferrin.

Arben Duka [BN - 1138]

Egërsir', o egërsirë
pse s'të lë lakmim' i shkretë?
Sa gjakëra ti ke pirë!
do të rronjç vallë për jetë?

Naim Frashëri [BN - 1139]

Ish thënë vallë nga Zoti
këjo punë e mallëkuar?

Naim Frashëri [BN - 1140]



Ne jemi për Shqipëri,
ti për jetë faqezi!

Vlorë [BN - 1141]



Hiqni dorë, hiqni dorë!
Mblithi mënt' e turpërohi,
Mos u bëj trathëtorë,
Se pastaj do të pendohi!

Naim Frashëri [BN - 1142]



Shokë! kemi në mest tënë
Shum'armik' e trathëtorë!
Popo! mos u qoftë thënë!
Veç që s'kanë gjë në dorë!

Naim Frashëri [BN - 1143]

Fajn' e math kur do ta njohin
Njerëzit' e mallëkuar?
Dritënë pse nuk' e shohin,
Apo janë të verbuar?

Naim Frashëri [BN - 1150]

Harruanë Mëmëdhenë!
Dh'e lanë kombinë tënë
E një tjatërë na gjenë!
Popo! mos u qoftë thënë!

Naim Frashëri [BN - 1144]

Janë së gjithash të marrë!
Dhe të liq me të vërtetë,
Mëmëdheut bëjnë varrë,
Po do të bienë vetë.

Naim Frashëri [BN - 1151]

Lanë Zonjën' e lëvduar
E zunë një kurvë shtrigë,
Të ndyr' e të mallëkuar,
Të fëlliqur' e të ligë!

Naim Frashëri [BN - 1145]

Se mbretëron e vërteta,
S'del kurrë gënjeshtër'e shkretë,
T'ish ashtu, qe prishur jeta,
S'kish mbetur gjë e vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 1152]

Lanë mëmëdhenë të çveshur
Dhe mundohenë për botë,
Pa dhe bota, duke qeshur,
U thotë: mundohi kotë!

Naim Frashëri [BN - 1146]

Ata turpinë fitojnë,
Nder' e tyre posht' e hedhin,
Dhe armikëtë gëzojnë
E në errësirët bredhin.

Naim Frashëri [BN - 1153]

Qysh u bënë Efialtë
E nuk e njohin të mirën?
Uthullën pandehin mjaltë
Edhe dritë errësirën!

Naim Frashëri [BN - 1147]

Nuk' është kurrë harruar
Dh'e mira dh'e lig' e shkretë
Të gjitha janë paguar
S'ka mbetur gjë në jetë.

Naim Frashëri [BN - 1154]

Buk' e Mëmëdheut i zëntë!
Trathëtorët' e pabesë!
Dhe Zoti dërmën' u dhëntë!
Kurrë mos paçinë pjesë!

Naim Frashëri [BN - 1148]

Lerini, pa do ta gjejnë,
Të vërtetën do ta njohin,
Se tani s'e dinë ç'bëjnë,
Janë të verbër' e s'shohin.

Naim Frashëri [BN - 1155]

Miq' armiq i kanë bërë,
Armikëtë miq i zunë,
Qysh janë fyell të tërë!
Ç'është kjo e madhe punë!

Naim Frashëri [BN - 1149]

Opopo! ç'turp kanë marrë!
Janë bërë trathëtorë!
Dhe s'janë më shqipëtarë,
Se nga kombi hoqnë dorë!

Naim Frashëri [BN - 1156]

Me të huajnë u bënë!
Me armikn' e Shqipërisë!
S'duanë gjuhënë tënë
Armikëtë e Perëndisë!

Naim Frashëri [BN - 1157]

Si ferrat jini, jetën q'e ndalojnë.
Çdo bim'e lule e mbytni ndënë gjembat,
Se as dritë, as diellë më s'shëkojnë,
As gjaku s'u lëvrin në dejt'e rrembat!

Asdreni [BN - 1164]

Ndiej', o Zot, se nuk dinë
Se ç'bëjnë, janë mahnitur,
Rrahin të prishin shtëpinë;
Pun' e lig'edh' e mërzitur!

Naim Frashëri [BN - 1158]

Si bisha e malit, gjahu kur i derdhi,
As gjurmë më s'i mbetet në ka rrojtur;
Mëshirë s'kini, drojës ju nuk mverdhni
Për shpirtet, jetën që ua kini shojtur.

Asdreni [BN - 1165]

Të gjorët janë në gjumë,
Të vërtetënë s'e dinë,
Do të mundohenë shumë,
Pastaj mentë do t'u vinë.

Naim Frashëri [BN - 1159]

Si mjerë ata që presin dorë ndihme
Prej njerës pa mëshirë Perëndije,
Si mjer ata me djersa dhe mundime,
Kështu që shohin çase lumërije!

Asdreni [BN - 1166]

Vëllazërin' e harrojnë
Dhe kombin' e Mëmëdhenë
Dhe armikëtë dëgjojnë
Edhe s'dinë se ku venë!

Naim Frashëri [BN - 1160]

Ju s'kini as shpirt as zemër dhembje s'ndjeni,
Përpara jush kur krah'e duar ndehen,
Fytyrën, sytë më nj'anë i u a ktheni
Atyre shpresës suaj që ushqehen.

Asdreni [BN - 1167]

Hiqni dorë, hiqni dorë!
Mblithi mënt' e turpërohi,
Mos u bëni trathëtorë,
Se pastaj do të pendohi!

Naim Frashëri [BN - 1161]

Sa lot janë derdhur pa shterruar,
Shtëpi, sa s'kanë mbetur sot të shkreta,
Sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar,
Therror q'u ranë krejt nën'thonjtë e mprehta!

Asdreni [BN - 1168]

Ju njohim cilët jini, s'është nevojë
T'u hapet Libri i veprave të bëra,
Se populli i përment papra me gojë;
Me kut i mat, me syt' i sheh të tëra.

Asdreni [BN - 1162]

Mëkatet shpinës, shpirtit që i përmbani,
As posht në ferr pak vent s'ka që t'u nxerë,
Me ujtë e detit dot nuk i çpërlani
Mallkimi do t'ju ndjekë gjat' e gjerë!

Asdreni [BN - 1169]

Se çfarë shëmbëlltyrë t'ju përqasim
Me ç'emër botës mundim t'u tregojmë,
Ne, kot, si trut'e mendjen do t'i vrasim,
Me juve, e dimë, kombin turpërojmë!

Asdreni [BN - 1163]

Prej gurit zemrën ju sikur e keni,
Që as pak s'e ndjeni qarjen e rënkimin;
Ju ligësitë e fajet s'munt t'i mfshehni,
Çdo e keqe këtu posht e ka çpërblimin.

Asdreni [BN - 1170]



Mjaft, mjaft! Se u mbush kupa e hidhërimit!
Gjarpërinj pushoni! Helmin tej e çporrni,
Mos dalim tej kufirit të durimit:
Që më në fund se ç'mbuallt ju të korrni!

Asdreni [BN - 1171]

Hani, pini e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni
xepe,
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!

Ali Asllani [BN - 1172]

Hani, pini dhe rrëmbeni, është koha e çakenjvet;
hani, pini e rrëmbeni, është bot e maskarenjvet;

Ali Asllani [BN - 1173]

dhe kolltuku ku ke hipur, duke hequr nderin
zvarrë',
është trikëmbëshi që përdita varet kombi në litar!

Ali Asllani [BN - 1174]

E na tunde, na lëkunde, nëpër salla shkon e
shkundet,
mbasi dora e armikut ty me shok' të heq për
hunde.

Ali Asllani [BN - 1175]

Rroftë miku yt i huaj, që për dita los e qesh,
të gradoi katër shkallë, pse i the dy fjal' në vesh!

Ali Asllani [BN - 1176]

Koha dridhet e përdridhet, do vij' dita që do
zgjidhet
dhe nga trasta pem' e kalbur deomos jasht' do
hidhet!

Ali Asllani [BN - 1177]

Koha dridhet e përdridhet, prej gradimit katër
shkallë
nuk do mbetet gjë në dorë veçse vul' e zez' në
ballë!

Ali Asllani [BN - 1178]

Mirpo ju që s'keni patur as nevojt' as gjë të keqe,
më përpara nga të gjithë, ju i that' armikut:
"Peqe!"

Ali Asllani [BN - 1179]

Që të zinit një kolltuk, aq u ulët u përkulët,
sa në pragun e armikut vajtët si kopil u ngulët!

Ali Asllani [BN - 1180]

Dallavera nëpër zyra, dallavera në pazar,
dallavera me të huaj, dallavera me shqiptar'

Ali Asllani [BN - 1181]

Vetëm, vetëm dallavera, dhe në dëm të këtij
vëndi
që ju rriti, që ju ngriti, që ju ngopi, që ju dëndi!

Ali Asllani [BN - 1182]

Nëse kombi vete mbarë, nesër ju veproni
ndryshe,
dylli bënet si të duash, kukukavajk' dhe
dallandyshe...

Ali Asllani [BN - 1183]

kukuvajka gjith' me lajka, nesër silleni bujar,
nënë dorë e nënë maska, shkoni jepni një kapar!

Ali Asllani [BN - 1184]

Dhe kujtoni tash e tutje me të tilla dallavera
kukuvajka do përtypi zog e zoga si përhera....

Ali Asllani [BN - 1185]

Ja, ja, grushti do të bjeri përmbi krye të zuzarve,
koha është e maskarenjve, po Atdheu i
shqiptarëve!

Ali Asllani [BN - 1186]

Edhe ju të robëruar, rob në dor' të metelikut,
fshini sofrat e kujtdoj', puthni këmbën e armikut!

Ali Asllani [BN - 1187]

Që ta kesh armikun mik e pandehni mënçuri,
mjafton bërja pasanik, pasanik dhe bej i ri,

Ali Asllani [BN - 1188]

dhe u bëtë pasanikë, me pallate, me vetura,
kurse burrat më fisnikë japin shpirtin në tortura!

Ali Asllani [BN - 1189]

Vëndi qënka sofr' e qorrit, vlen për goj' e për
lëfytë,
bëni sikur veni vetull', shoku shokut kreni sytë...

Ali Asllani [BN - 1190]

Dhe për një kërkoni pesë, po më mir' njëzet e
pesë.

Le të rrojë bataçiu dhe i miri le të vdesë!

Ali Asllani [BN - 1191]

A e dini që fitimi brënda katër vjet mizor'
nuk është' yti, nuk është' imi, është' i kombit arbëror,
është' i syrit në lot mekur, është' i vendit djegur,
pjekur,

Ju do thoni si të doni... po e drejta dërmon hekur!

Ali Asllani [BN - 1192]

Shka bajn Shqyptarët? ... Han fiq e kastraveca:
E pijn mastikë, e qesin petlla n'uej;
E ngrehen rrugës e fryhen si gjeldeca;
E rrijn tue kqyrun udhës ushtarët e huej.

Gjergj Fishta [BN - 1193]

Jo, po; Shqyptarët kanë sot të madh kujdes ...
Njata, po thom, qi ndo'i miras e presin,
E druen se emta a gjyshi vrik s'u des:
Pse per Shqypni, qi krajlrat po ua shesin,
S'çajin kryet aspak, me sa çaj kryet un sot
Per shkarpa t'vjetra, qi kam shkye kahmot.

Gjergj Fishta [BN - 1194]

Vendet ma t'mirat ne na i mori shkja, u,
E, shk'asht ma zi, ne vlla me vlla na dau!

Gjergj Fishta [BN - 1195]

E n'kjoftë se lypet prej s'hyjnueshmes Mni,
Qi flije t'bahet ndo'i Shqyptar m'therore,
Qe, mue tek m'kini, merrni e m'bani fli
Per Shqyptari, me shue çdo mni mizore.

Gjergj Fishta [BN - 1196]

Oh! edhe pa mue Shqypnija kjoftë e rroftë,
E nami i sajë per jetë u trashigoftë!

Gjergj Fishta [BN - 1197]

Dhe ca nga fletët e tua
Me të huaja përzjerë,
Sicila do të të bjerë,
Dëmn'e vdekjenë pothu!

Naim Frashëri [BN - 1198]

Oh! Fletëtë që i rrite,
Duke nxjerrë nga gjiri yt,
T'u bënë si halë në sy!
Pa m'u fishk' e m'u drobite.

Naim Frashëri [BN - 1199]



O! sa qenë të gënjyer
Ata që vuan për botë!
Turp të math kanë rrëfyer,
Punuanë fare kotë.

Naim Frashëri [BN - 1200]

Hiquni, o të pabesë!
Se e zeza do t'u presë!

Naim Frashëri [BN - 1201]

“Perëndije s’pattë frikë?
Është i lik e i pabesë
kush tradhëton mëmëdhenë
e kombinë, pa s’ka shpresë,
se atë gjall’ nuk’ e lenë.
Qysh u ndodhtë ju të marrë,
ju bët’ armik kombin tuaj,
tek ishitë shqipëtarë,
përse u bëtë të huajt?”

Naim Frashëri [BN - 1202]

Mbreti u tha dhe ca fjalë,
ata shum’ u mallëngjyen,
pasdaj fajne ua falë,
se të gjorët’ u gënjyen,
pa të vërtetën’ e njohne,
ng’ajo që bënë më parë,
me gjithë zëmr’ u pendohne
dhe u bënë shqipëtarë.

Naim Frashëri [BN - 1203]

U lëshua përmbi mbrenë!
se dojt të bëhej mbret vetë!
të përmbyste mëmëdhenë!
mëndj’ e zez’, o mëndj’e shkretë!

Naim Frashëri [BN - 1204]

Lëfton vëllaj të vëllanë!
godit t’ëmënë i biri!
djali mund të vrasë t’anë!
punë që s’e bën i miri.

Naim Frashëri [BN - 1205]

Po e kishinë gënjyer,
të shkretënë errësirë
dritë ja kishin rrëfyer
dhe ligësinë të mirë!

Naim Frashëri [BN - 1206]

Vinte të goditte mbrenë!
e të prishte Shqipërinë!
të shkretonte mëmëdhenë!
e gjettë më Perëndinë!

Naim Frashëri [BN - 1207]

Shqyptari kistë shkruë:
N’kët vërr po kalben eshtnat t’një qyqari,
Qi turpnisht jetën e vet e ká shkue;
Shqyptar, për fat t’zij edhe bír Shqyptari,
Punoi për Grekët, Shqyptinë me tradhtue:
TRADHTUER emnohej, sa ish gjallë ky i shkretë,
E tradhtuer emnin ká m’e pasë për jetë.

Filip Shiroka [BN - 1208]

Mjerë ai që i jep puthjen e tradhtis’ kombit të
vet,
Mëmëdheut dhe të birit të të lartit zot në qiell!
Deri kur, o miq të dashur, do mundin këta të huajt
Të na kthejnë ne në kafshë me atë shkopin e
Çirçës?
Deri kur për interesat e të tjerëve do të
punojmë?
Pse të tjerëve t’u shërbejë gjith’ kjo mendje e
trimëri?
Mjerë ne! Pse për të huajt kaq flijime e
vetëmohim?

Naim Frashëri [BN - 1209]

Ne jemi për Shqipëri,
ti për jetë faqezil!

Vlorë [BN - 1210]

“Mos dëgjojmë çka thot’ tradhtia, -
Gegë e Toskë një asht’ Shqipnia”

Kukës [BN - 1211]

O mini-ministrat tanë,
harram e paçi paranë,
ju që na shitët vatanë!

Përmet [BN - 1212]





O sikur të mundja gjithçka të tregoja,
Si do të ngrinit para meje si gur,
Por unë jam i dënuar mes rropamës tuaj
moskokëçarëse, monologun të thur.

Imail Kadare [BN - 1213]



Ti s'u trembe nga e liga,
trimërinë ç'e tregove,
vehten, djal', s'e turpërove;
deshhtë e cjeptë brikurorë
ta lëpijn' gjakun me gojë.

Përmet [BN - 1214]



Ndaj meje është i gjallë
gjithënjë ajy në jetë,
që lëfton si trim me pallë,
shpëton nder' e bije vetë.

Naim Frashëri [BN - 1215]

Me flamurin kombëtar
të stolisëm për në varr.

Përmet [BN - 1216]

Nga kjo balt' e kësaj toke,
merr një grusht e shtrydhe fortë,
pika gjaku do kullojnë
luftën e madhe tregojnë.

Polifonia labe [BN - 1217]

Ngrimun si 'j gur, mbi krye
Kqyrshë ato vol trishtimi;
Kur ai, si t'ish tuj kthye
Shpirti prej ndo'j udhtimi,
tuj çilun syt'përsri
Tha t'mbramen fjalë: Shqypni.

Ndre Mjeda [BN - 1218]

Shumë e deshën Shqipërinë,
Prandaj vdekja nuk i trëmbi,
me gjak e prunë lirinë,
luanët e këtij vendi.

Polifonia labe [BN - 1219]

O ju nëna e baballarë,
rrofshi e qofshi të nderuar,
djemt' e vajzat nuk i qatë,
po vat' dhe vetë e luftuat.
Maja, gërxe dhe lugina,
mbushur plot me lapidarë,
atje prehen djemt' e bijat,
që jetojnë' e jan' të gjallë.

Polifonia labe [BN - 1220]

E po n'vorre t'fatosavet t'nderueshem,
Qi m'kto t'egera male e bjeshkë t'thepisne,
Si ulaj t'pergjakun me trimni spartane
Rrebtë tue luftue per Atme e per Liri
Shqypnis i u bane fli, a thue m'kto vorre
Sod ndo 'i kunorë Atdheu ka per t'u a çuem
Si peng çmimit e bindijet e nderjet
Per shka ata psuene per Liri t'bekueme?

Gjergj Fishta [BN - 1221]

Heu po! burrat e dheut, qi m'armë mizore
Rrokullin dynden per Liri t'Shqyptarvet
E flakë ndezen Europen, e qi e shuma
As vorr nuk paten me u kondisë per s'deknit

Gjergj Fishta [BN - 1222]

Heu! ju burra të dheut, m't' dy gjijt, po, un ulun
Perpara vorrit t'uej, po puthi bucen
Ende me gjak t'uej t'rime e qi mbi krye
Ju pret furin e motit, urë – përvujtun

Gjergj Fishta [BN - 1223]

Un ktu po u falem, edhe juve u bindem,
Porsi martyrvet t'atmes s'onë t'derptueme,
S'cilles me gjak Lirin perligjë i a kini.

Gjergj Fishta [BN - 1224]

Oh po! mos t'vlote ai gjaku i juej p'r Atdhe
E gjyq mos t'lypte ai para fronit t'qiellvet,
Po, se kto bjeshkë e njikto male t'ona
Shqypni ma s'ishin quejtë; as shqyp s'isht lutun
Ma i Madhi i jetës, qi n'dorë ka fise e popuj.

Gjergj Fishta [BN - 1225]

Për Atdheun e paprekur,
Thurr-e këngën e pavdekur!

Lasgush Poradeci [BN - 1226]

Kështu në vorbull të epokës
U ngritët ju si monument,
Ju që e prekët historinë,
Dhe n'histori u kthyet vetë.

Ismail Kadare [BN - 1227]

Ç'u bënë e ku vanë
Ata njerëz të ashpër e të mirë?!
Grykave të tua ndofta janë,
Përkëdhelin barin, që ka mbirë.

Dritëro Agolli [BN - 1228]

Në male,
Kur nata zë bije;
Zën' mblidhen herojt dy a tre
Rreth zjarresh të vegjël
Nën re, nënë yje ...
Nuk vdes kush lufton për atdhe

Ismail Kadare [BN - 1229]

Veç retë që vinin që larg nga vatani
E panë dhe e njohën e zunë të qanin.

Ismail Kadare [BN - 1230]

Po kur u vra nën shkëmbin ndezur zjarr,
U ndodh në çetë një këngëtar
E këndoi tok me ne mbrëmave:
"Lule djemtë e nënave"

Dritëro Agolli [BN - 1231]

Shumë vjet shkuan e vanë,
trimat flenë nëpër lëndina.

Polifonia labe [BN - 1232]

Mujua në Durrës,
Mitrua në Sarandë.
Mitrua në Sarandë,
Hamiti në Vlorë.
Pas, juve, u trima,
vijm' mijra dëshmorë!

Sarandë [BN - 1233]

Në çdo lëndinë-e një theror,
E një'shtër në çdo vënd botor;
Dhe çdo kujtim e vjershëri
Qan e thërret prej dheut të zi
Një trim që ra për nder të ti
Drejt mun n'obor.

Lasgush Poradeci [BN - 1234]

Unë jam nga Shqipëria,
Avdul Frashëri,
rritur në male të larta
me libra në gji,
ju lutem, shëkoni mirë
ju për Shqipëri,
mos e bëni copa-copa,
sikur s'ka njeri;
s'jemi grekër, as bullgarë,
as na Mal i Zi,
jemi vetëm shqipëtarë,
kërkojmë liri!

Përmet [BN - 1235]

Ata burra, që u vranë
për nderthit të Shqipërisë,
për ndert të lirisë ranë
njerëzit' e Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 1236]

Ata vëllezërit tanë,
q'u vranë për Shqipërinë,
emrë të pavdekur lanë,
gjithë bota do t'i dinë.

Naim Frashëri [BN - 1237]

Qaj, Shqipëri, ata trima,
që lan' emërë për jetë,
vanë posi vetëtima,
U vranë për mëmëdhenë,
për shpëtimt të Shqipërisë,
për kombinë e për mbrenë,
ndë udhët të Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 1238]



Atje brenda është trazuar,
Në çdo kohë të tmerruar,
Gjaku e djers' e ushtëtarit
Dhe të fundit dhe të parit,
Që për emër të lirisë
I dha shpirtin Perëndisë;
Me mjaftim q'ë dhuroi jetën
Për të drejtën, të vërtetën
Për valdimin e kombësisë
Dhe për nder të Shqipërisë.

Asdreni [BN - 1239]

Ti s'u trembe nga e liga,
trimërinë ç'e tregove,
vehten, djal', s'e turpërove;
deshtë e cjeptë brikurorë
ta lëpijn' gjakun me gojë.

Përmet [BN - 1240]

Në botë m'i madh nder as mund të ketë
Për burrat lart q'ë mbajnë fjalën, benë,
Se ata statuj' e tempull ngrehin vetë,
Me gjak kur skuqin flamurin e dhenë.

Asdreni [BN - 1241]

Ai diq, o Zot, për mbas detyrës, por t'shkretën
Atme ti rueja, që dikur përtrini,
Ti n'qiell ndër mprojsa t'Shqyptarisë rreshtojë."

Ndre Mjeda [BN - 1242]

S'kje toka, jo, per ty kje qiella!

Gjergj Fishta [BN - 1243]

Nuk dekka i miri,
Jo kurr; e sidomos nj', i cilli'i zemer
E len mbrapa m'e ankue. Prej vorrit t'errshem,
Gjumin e dekës ku ai ban, na i flet mendimit,
Ambel edhe na nzitë kah punët e mbara,
E n'mende t'onë gjallon.

Gjergj Fishta [BN - 1244]

Mua edhe, qi sheklli e një dishir Lirijet
T'thepise raven m'i a kanë shtrve gjallimit,
Mue, po, edhe zemra mbi vorr t'and t'pervujtun
M'ndezet kah punët e mbara e kah burrnija.

Gjergj Fishta [BN - 1245]

Permbi vorr t'and, po, xa të fortë me e mbajtun
Besen e dhanme – e miqasin e zanme;

Gjergj Fishta [BN - 1246]

Për Fe e per Atme n'ball me i dalë rrezikut:

Gjergj Fishta [BN - 1247]

Të ligshittit doren me i a njitë e t'fortin
Mos me e gledhue; kur t'jet me u thanë e drejta,

Gjergj Fishta [BN - 1248]

Mos me i shmangë syt prej cakut, n't'cillin mendja
Dishron me u kapë, as kurr mos me u ligshue
Nder sa t'vishtira, qi t'na sjellin motet.

Gjergj Fishta [BN - 1249]

Po, po! se pre' atij vorri kam me shkepun
Hovin kah punët e mdhana.

Gjergj Fishta [BN - 1250]

Der qi të shkimen n'qiellë e hana e dielli
E t'ngele moti e sheklli mbarë t'rroposet
E t'vije dita e gjyqit t'rruzullimit,
ai ka per t'm'kenun Zana. E atëherë pa u tutun
Zgjetat e prehta e t'zjarrta kam me i prehun,
Qi kundra vesit do t'i a lshoj njerzimit:
Atë herë un kangët kam me i ndërtue kreshnike,
Me t'cilat botës un do t'ia la të shkrueme.

Gjergj Fishta [BN - 1251]



M'vorr t'and kam per t'ndertue, të cillin moti
Me fletë të ngrita kot ka per t'a rrahun;
Pse, si curr, qi n'mjes t'detit rreh tallazi,
Edh' ai njashtu do t'jesë nder gjire t'motit
Qi bumbullojn mbi faqe t'rruzullimit.

Gjergj Fishta [BN - 1252]

E atë herë prej bjeshkvet kanë me u djergun
Zanat
E me të njoma vjollca e drandofille
Vorrin kanë me t'vallue, e kanë me rritun
Me shum kujdes per qark selviija t'blerata;

Gjergj Fishta [BN - 1253]

E shtektarit mundqar, qi n'ato hije
Ka me zanë vend, me ndalë pak gja t'dihamet.
Kanë me i kallzue se sa pjesë qiellat vrani
Deka n'atë vorr.

Gjergj Fishta [BN - 1254]

E atë botë i largë shtektari
Të lehtë dhen ka me t'urue, e t'paqta e t'buta
Shinat e boren: e, kur m'male t'veta
T'dredhojë ke stani, fms ka me i kallzue
Shka ndjeu per ty.

Gjergj Fishta [BN - 1255]

E fmija e atij aso bote
Emnin t'and kanë per t'kndue, e vrrini e bjeshka
Gjithmonë i ri, tue njuhë furti e mnershme,
Ambel prej emnit t'and kanë me jehue.

Gjergj Fishta [BN - 1256]

Me maje t'briskut kanë me shkruie mbi lisa
Me shkrola t'njohtne veç e prej barivet:
Kanë me u rritë lisat, perse spata as reja
S'e prekin landen, ku asht ravisë aj emen:

Gjergj Fishta [BN - 1257]

E t'u u rritë lisat kanë me u rritun shkrolat;
E kshtu ma t'kjarta mbas disa qindvjetve
Nipat ma t'vonët kanë me i këndue, e emni
Sa t'bjere dielli tokës ka me t'u kndue.

Gjergj Fishta [BN - 1258]

Ujë kërkua, ujë s'u dhanë.
Ju tha buza, more djalë.

popullore [BN - 1259]

Jemi trima shqipëtarë,
plumbin e presim në ballë.

popullore [BN - 1260]

O trima, flini të qetë
Se hakun e marrim vetë.

popullore [BN - 1261]

Se të deshte dhe s'të deshnin,
Se të qante, kur të qeshnin,
Se të veshte, kur të zhveshnin,
Nëno moj, të ra dëshmor.

Fan Noli [BN - 1262]

Nëpër kodrat lule kemi dashur
Aq sa lule trimave u dhamë,
Dhe kur shokët ndër beteja ranë
U qëndisëm trëndelinë dhe këngë.

Hysni Milloshi [BN - 1263]

Prej qelave ndër pranga
ku presim pushkatimin,
o bij t'atdheut ku t'jeni
ju lamë na trashigimin.
Prej nesh ju merrni zemër:
s'na trembet syni ne,
s'na dhimben t'rit as jeta
kur vdesim për atdhe.
Luftuem për idealet
e thjeshta kombëtare.
Na ramë, por mbasi mbollëm
virtytin e një fare
që jep ndër ju filiza.

Arshi Pipa [BN - 1264]



Asht për rrugë në armë shtrëngue
bomba dore me gjerdanë:
“Loke, s’mundem me mungue
Lamtumirë kam ardh me t’thanë”.

Arshi Pipa [BN - 1265]

Durimi nuk është vetëm gjenui
që përpunon madhështinë
Ai shpreh në një masë tjetër
edhe të ultën skllavërinë.

Kujtim Murati [BN - 1266]

Pra, durimi është edhe pika
ku token gjenui me hiçin
Ndaj koha do të thotë për ne
Sa të dobët ata ishin.

Kujtim Murati [BN - 1267]

Pa ejani të vdesim me nder
në grykë t’i hidhemi fatit
Mjaft u rropatëm zvarrë
nën goditjet e xhelatit.

Kujtim Murati [BN - 1268]

Tek më vini rrotull, unë them me vete
Kaq të verbër të jeni, sa mos ndieni këtë,
Që ky ngërç e ky ankth në gjithë qënien time
S’është nga gjarpërinjtë, por nga tjetër gjë.

Imail Kadare [BN - 1269]

O sikur të mundja gjithçka të tregoja,
Si do të ngrinit para meje si gur,
Por unë jam i dënuar mes rropamës tuaj
moskokëçarëse, monologun të thur.

Imail Kadare [BN - 1270]

Pajtim me armikun, ulërinin tradhëtarët,
Mjaft më me luftë, zjarre dhe helm.
Erdh’koha që shpatat t’i kthejmë në parmenda,
Armiajtë në miq erdh’ koha t’i kthejmë.

Imail Kadare [BN - 1271]

Në mbledhje të gjatë “pro” dhe “kundra” kalit,
Unë “kundra” kryesova me tërbim.
Dhe juve ju kanë thënë se aherë hyjnitë
Gjarpërinjtë më dërguan si ndëshkim.

Imail Kadare [BN - 1272]

Atë kalë unë i pari e kisha goditur,
Ndaj, e dija, këtë s’do ma falnin përjetë.
Më në fund “vijë e butë” fitoi mbi “të ashprën”
Dhe ne, “kokëfortët”, na vunë në arrest.

Imail Kadare [BN - 1273]

Në burg, me gotën e ujit, në mesnatë
Helmin më dhanë ata të pi,
Ata që ulërinin kundër dhunës dhe shpatës,
Që dinin të kafshonin tamam si gjarpërinj.

Imail Kadare [BN - 1274]

Në mëngjes që pa gdhirë në breg të detit
Ma hodhën kufomën drejt mbi zhavorr.
Rapsodët aherë anembanë përhapën
Versionin fals të gjarpërinjve hyjnorë.

Imail Kadare [BN - 1275]

Ky ishte mbarimi i polemikës për kalin,
Ju e dini me Trojën ç’ ndodhi pastaj,
Tre mijë vjet rresht,
nga muzeu në muzera
Unë hamalli i mermertë gënjeshtërën mbaj.

Imail Kadare [BN - 1276]

Më kanë lodhur më shumë, besomëni ca fjalë,
Se kjo peshë e neveritshme gjarpërinjsh.
Ju, që gjer në hënë keni shkuar, si vallë
S’depërtoni dot gjer në gjoksin tim?

Imail Kadare [BN - 1277]

Dëgjoj emra shtetesh të reja që kanë dalë,
Emra kombesh e popujsh të rinj dëgjoj,
Veç ai, i vjetri, i tmerrshmi kalë,
Ashtu si aherë ka mbetur njëlloj.

Imail Kadare [BN - 1278]





... dhe pranvera erdhi ...
Nëpër fytyrat tona rrëshqiti një gëzim
dhe ndër zemra tona ngrehi një fole
e një jetë e bukur, e një jetë e re
me dëshira të shumta po buzqesh në lulzim.

Migjeni [BN - 1279]

Zoti dha një vetëtimë,
i tërë qielli ndriti,
një gjënim, një kërcëllimë,
malet' e lart' i tronditi,
Oshëtimë dha Tomori,
edhe zjar e flakë qiti,
flaka qiellën mori,
gjithësija vetëtiti.

Këjo shenjë s'ish e pakë
që dha Zoti mbi Tomorë,
nxori zjar dhe zë e flakë
nga majatë me dëborë.

Naim Frashëri [BN - 1280]

O Shqipërië! gëzohu,
se të erdhi prapë dita,
lulëzohu, sbukurohu.
të xbriti nga Zoti drita.
Edhe juve, o të vdekur!
merri ngaha ky gas pjesë,
që shkuatë buzëpjekur,
nd'atë jetë, paçi ndjesë.

Naim Frashëri [BN - 1281]

Erdhi si vera liri
edh' e nderoj Shqipërinë,
dha urdhërë Perëndija,
pa e shpëtoj njerëzinë.

Naim Frashëri [BN - 1282]

Zokn' e mjerë kur e vënë
në kuvli, qysh varfërohet
as ha as pi as nxjerr zënë,
po unj kokën' e mejtohet,
si ajy, q'e kanë vënë
në burk e në të këqija,
ndë hekura duke shtënë,
pa i digjet mushkërija,
e kur shpëton nga kuvlija,

qysh fluturon me gas shumë,
i bëhetë zëmër' e ti ja,
q'e ka të butë si brumë,
ashtu edhe Shqipërija
anëmbanë u gëzua,
dhe djalli e djallëzia
u përmbys e u mërgua.

Naim Frashëri [BN - 1283]

Si shqerratë kur kërkojnë
mëmatë me blegërimë,
rreth e rrotullë vështrojnë,
me një sy si vetëtimë,
ashtu edhe Shqipërija
po e kërkonte lirinë,
pa ja fali Perëndija,
i dha gjithë mirësinë.

Naim Frashëri [BN - 1284]

U hoq nata, erdhi dita,
gazi, kamja, dashurija,
e vërteta miqësija.

Naim Frashëri [BN - 1285]

O liri e shenjtëruar!
ëngjëlli i Perëndisë,
erdhe me gëzim ndër duar,
i dhe dritë Shqipërisë.

Naim Frashëri [BN - 1286]

Ardhi dita e liritimit,
Dita e bukur e bashkimit!

Asdreni [BN - 1287]



Simboli për bashkimin kombëtar është “Lidhja e Prizrenit”. Skënderbeu jetoi në epokën parakombëtare të shqiptarëve. Lidhja e Lezhës ishte aleancë e disa princërve dhe jo ndonjë formacion unitar shtetëror. Kombi shqiptar u formua dhe mori fizionominë që ka sot si komb modern pas Skënderbeut, gjatë periudhës kur trojet e tij ishin përfshirë në Perandorinë Osmane dhe gjatë procesit kulturor që u karakterizua nga myslimanizmi.



Në këtë kohë u mbrujt edhe nacionalizmi shqiptar, i cili shprehjen e tij të përqendruar politike dhe organizative, si dhe fizionominë shtetërore e mori në Lidhjen e Prizrenit. Ja ku është baza dhe simboli i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, që u sendërtua me shpalljen e pavarësisë në vitin 1912. Skënderbeu është simbol i bashkimit kombëtar të shqiptarëve në kushtet e epokës kur jetoi e veproi, si bashkim princash shqiptarë, por jo në kushtet e zgjidhjes së detyrave kombëtare moderne. Skënderbeun ende kërkojnë të na e përvetësojnë serbët, grekët, sllavomaqedonasit. ... Kurse Lidhjen e Prizrenit asnjë nga fqinjët nuk do të na e marrë, përkundrazi duan që ta harrojmë edhe ne shqiptarët.

Abdi Baleta [BN - 1288]



Na të birtë e shekullit të ri,
që plakun e lamë në “shejtnin” e tij
e çuem grushtin për me luftue
ndër lufta të reja
dhe me fitue ...

Migjeni [BN - 1289]

Na të birtë e shekullit të ri,
filizat e një toke së rimun me lot,
ku djersë e ballit u dikonte kot –
se dheu ynë qe kafshatë e huej
dhe në marrzi duhej shumë shtrejtë t’u paguhej ...

Migjeni [BN - 1290]

Na të birtë e shekullit të ri,
vllazën të lindun e të rritun në zi,
kur tinglloi çast’i ynë i mbramë
edhe fatlumë
ditëm me thanë:
S’duem me humbë në lojë të përgjaktë të historis
njerëzore,
jo! jo! s’i duem humbjet prore –

Migjeni [BN - 1291]

duem ngadhnim!
ngadhnim ndërgjegje dhe mendimi të lirë!

Migjeni [BN - 1292]

S’duem për hir
të kalbsinave të vjetra që kërkojnë “shejtnim”,
të zhytemi prap në pellgun e mjerimit
që të vajtojmë prap këngën e trishtimit,
kangën monotone, pa shpirt, të skllavnis –
të jem’ një thumb i ngulun ndër trutë e njerëzis.

Migjeni [BN - 1293]

Na të birtë e shekullit të ri,
Me hovin tonë e të ndezun peshë,
ndër lufta të reja kemi m’u ndeshë
dhe për fitore kem’ me ra fli.

Migjeni [BN - 1294]

Dhe t’imtë, të pastër si n’ag vere vesojnë
Të valët lot rrjedhin qetë, me mall,
Që betimin për Ty prore e madhërojnë
Për të madhin blatim që tani u shpall.

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1295]

Zjarrin, pra, dhe le të digjet gjithë bota,
anembanë!
Po të jetë se humbasim ne atdhen’ e dashur tonin,
Qielli le të përmbysset, me të edhe perënditë!

Naim Frashëri [BN - 1296]

Do të shkoj, nëno, tha, do shkoj:
kaqë varre,
kaqë zjarre,
kaqë shokë në litare ...
Jo, nuk duroj!

Mitrush Kuteli [BN - 1297]

Rri të ha e nuk ha dot,
bje të fle e nuk fle dot,
se vendi gjithë u mbyt me lot,
në zjarr e lot,
në gjak e lot.
Nëno!

Mitrush Kuteli [BN - 1298]

Më ndizet zemra kur dëgjoj,
më erren sytë kur shikoj
kaq lule zie nëpër mure
dhe varret që përpijn’ qivure.

Papritmas një,
Papritmas dy,

papritmas ran’ njëqind e dy –
kush ra në mal dëshmor,
kush ra në burg theror ...

Nëno!

Mitrush Kuteli [BN - 1299]

Mbas tejet, Shqype, burrat flutruene
Ndër male t'reja, n'nji lugje t're;
Ngadhjim o deken tuj lypë u lëshuene
T'gjith për atdhe.

Ndre Mjeda [BN - 1300]

E prej gjith'fushash bajnë valle t'mnershme
Arët e livadhet që 'j ditë grabite;
Sot, vonë, ma t'rrebshëm për faje t'hershme
Gjikimin prite.

Ndre Mjeda [BN - 1301]

Ti je tash nga dor' e tyre, më i madhi amanet:
Amanetin – thot' arbreshi – edhe toka nuk e tret;

Ali Asllani [BN - 1302]

Sa të rroj e sa të jetë,
Gjiri i qiellit plot me yje,
Ty shqiptari do të ketë,
Si ka diellin përmbi krye;
Si ka diellin si ka hënën,
Mu si nëna që ka djalën,
Mu si burri që ka fjalën.

Ali Asllani [BN - 1303]

Un', im at' e gjysh stërgjysh
e di bota si dhe qysh,
cilin kemi më të shenjtë,
shum të dashur e të shtrenjtë,
dhe për cilin bëjmë be,
be për qiell e be për dhe,
be për tokën kombëtare,
dhe për ty, moj tok' bujare.

Ali Asllani [BN - 1304]

A me hir' a me pahirë
deomos do rroj i lirë!

Ali Asllani [BN - 1305]

Djalëri, lart për liri!
Lart për Zonjën Shqipëtare!
Yll në ballë-e zjarr në gji,
Zjarr në gji për Shqipëri,
Digj-u! zemra djaloshare!

Lasgush Poradeci [BN - 1306]

Armik! po shpejt u përgatit
Të shkosh ngaj ardhe më me nxit;
Se n'u vonofsh gjer më në fund:
Kushtrimi-u dha! Shqiptari-u tund!
Flamuri-u ngrit mi çdo katund!
Atdheu u ndrit!

Lasgush Poradeci [BN - 1307]

Pa vjen sulmon dragoj shqiptar
Si lajm i Zotit çpërblimtar
E bën urgji për Shqipëri
E dridhet tok' e det-dhe ti:
Ti qen i botës kobë-zi,
Ti gjakatar:

Lasgush Poradeci [BN - 1308]

Hy! qen e gjak që shëmbëllen,
Ti lyp mëshirën që s'të vlen:
Po nuk t'a fal dragoj ty sot:
Tmerrisht godet me shpirtin plot!
Të shtyp si djall plot helm e ndot!
Të flak si qen!

Lasgush Poradeci [BN - 1309]

... Ku bes' e rënd' urdhron për-čas,
Ku burr'i dheut sulmon me gas,
Ku Zot' i Math dërmon me shkak-
Jo! s'rron Shqiptari varfanjak-
Liri-a përgjithmonë gjak
Do rrjedhi pas!

Lasgush Poradeci [BN - 1310]



Unë gjall' e më të gjallë
s'munt të bënem aq i gjorë,
a e shihni këtë pallë?
do të vdes me të në dorë!
Se turpin e Shqipërisë
s'e shoh dot me sy në jetë.

Naim Frashëri [BN - 1311]

“Qe dishmuesin, o Zot”, këndoshin, “që jetën
Për shejten Fe, për Shqyptarinë e shkrini
E patundshme përherë shtyllë e mburoje.

Ndre Mjeda [BN - 1317]

A gjall' e me nder të rrojmë,
apo në luftë të vdesim,
a mëmëdhenë shpëtojmë,
a mbi të më të mos mbesim!
Kështu the, o trim i vërtetë!
q'ë donje fort Shqipërinë,
të ndritte shpirti për jetë,
qofsh bashkjë me Perëndinë!

Naim Frashëri [BN - 1312]

Dritëro Agolli [BN - 1318]

E thosha me vete:
“Kërkon nga unë aq shumë, o tokë e dashur!”
Dhe ti i kuptoje mendimet e mia,
Përndryshe s'kishte përse të më nisje aq larg;
Dhe ti e kuptoje se unë isha një grusht me
shkëndija

Një grusht me shkëndija i zjarrit tënd të madh ...

Për shpëtimt të Shqipërisë
e kam gas e nder në jetë,
ap fjalën ndaj Perëndisë
s'pendohem dhe të mbes shkretë”.

Naim Frashëri [BN - 1313]

Dritëro Agolli [BN - 1319]

Tokë e dashur,
Ti diçka ke kërkuar nga unë:
“Ndryshomë, o biri im!”, - më ke thirrur nga
grykat e maleve.

Dritëro Agolli [BN - 1320]

Faqebardhë që të dy
Do të jemi për çdo sy
Kur të shohim më çdo mur
Një shqiponjë, një flamur.

Asdreni [BN - 1314]

Dhe kam uri
-Si s'ka njeri -
për Drejtësi
e për Liri!

Mitrush Kuteli [BN - 1321]

Me sa mall e sa dëshirë
Atë ditë po e pres,
Që edhe unë atje i lirë
Pranë prindërve të vdes!

Asdreni [BN - 1315]

Lidhni, bijtë e mi, një besë, një fjalë,
Se bota po shkon me dallg'-ankth-e-valë!

Hekuran Zhiti [BN - 1322]

E kur fatosi n'patërshmanë tuj prekë,
“Ç'detyrë” tha “kemi për atdhen', o burra?”
Nji t'ilirve kje t'gjegjunit: “Me dekë”.

Ndre Mjeda [BN - 1316]

Do t'humbim shqim ata qi sot na shtypen!
Kulshedra e re me lakminat e vjetra
atëherë do t'shembet kur ta shofim shqypen
prej majesh tu' e sulmue me sqep e kthetra.

Arshi Pipa [BN - 1323]

Gjall Shqypnin na mos t'a lshojmë:
N'mend t'a kem' per jetë e mot.

Gjergj Fishta [BN - 1324]

“Un ktu sundoj! M'ketë shkamb mue m'vuni Zoti
E kndej nuk luej, pa u shuemun stina e moti”

Gjergj Fishta [BN - 1325]

Ah! ktu, Shqypnarë, po, ktu; e m'vorr t'Kastriotit
Per rreth Flamurit t'onë t'gjith t'bahmi 'i vlla
Edhe t'apim shoshajt besen e Zotit
Se per Atdhe na kem m'u orvatë pa da,
Tue shkri per te te gjitha ditt e motit:
Se para t'gjith në vorr na kem' me u kja,
Se e lamë Shqypnin me e shkelë prap themra e
huej.
Posë Zotit n'qiellë, s'do t'i sherbejm ma kuej.

Gjergj Fishta [BN - 1326]

Po prapë tek unë do vinë,
krielartë dhe të lirë;
të më ndreqën dhe më mirë.

Sarandë [BN - 1327]

“Që kur ndritën diell e hënë,
neve jemi në vënd tënë.
Askujt të keqe s'i bëjmë.”

Vlorë [BN - 1328]

Moj Vlorë, po të lirojmë
nga kthetrat e Italisë,
se pa tyj ne s'mund të rrojmë,
që je djepi i lirisë.
Në këtë luftë të shenjtë,
s'lufton vetëm Labëria,
po i gjithë Atdheu i shtrenjtë,
lufton gjithë Shqipëria.

Vlorë [BN - 1329]

Mos të na shtyhet tepër vonë
Se na mbrapa kem me ngelë
Mbassi të lirë kem kenë gjithmonë
Kend mos të lamë për me na shkelë.

Shkodër [BN - 1330]

Do të luftojmë si kemë zakonë
Mos të harrohet emni jonë.

Shkodër [BN - 1331]

Në kambë, o burra, i madh e i vogël
Mos të pritojmë pra për Shqipni.

Shkodër [BN - 1332]

Të thona të gjith një za shqiptarë
Rrnoftë flamuri i jonë kombtarë.
Rrnoftë pra shqypja e të birt e sajë
Me flamurë tuj ngulun rrajë.

Shkodër [BN - 1333]

Çonu o burra pa pritesë
E le të bahet një bashkni
Këtij flamurit tuj i ndejë në besë
Të mdhaj e të vogjël në brohori.
Të thona rrënoftë flamuri i jonë
Me njatë shqype për gjithmonë.

Shkodër [BN - 1334]

I vlon gjaku ndër dej Shqiptarit
Sikuer landës në prendverë
Sikuer në fushë si në majë të malit
Tuj pa vedin të lirë gjithë herë.
I Shqipnis flamuri qoftë
Me shqiptarë të vlerë rrënoftë.

Shkodër [BN - 1335]

Ty o shqype çfarëdo eret
Hovin t'and s'mujt me t'a ndalë
Të birt e tu, po , vonë o herët
Në mprojtje t'ande në luftë kanë dalë.
Me luftue si e pat zakonë
Skënderbeu baba i jonë.

Shkodër [BN - 1336]



Deh moj shqype në fushë e male
Tash sa mot qi të patme lypë
Në çerdhe t'ande hovin ndale
Nbi zogjt e tuj të ftojnë me zhdrypë.
Me krahë t'ue qindro mbi ne
Në mprojtje t'ande, në shejten atdhe.

Shkodër [BN - 1337]

Dua të sjell për ty fjalët e gjuhës së mirë,
Që tok me qumshtin tënd i kam pirë;

Dritëro Agolli [BN - 1338]

S'e kursenj për mëmëdhenë
shpirtn' e jetënë time,
as vet'henë as shëndenë

Naim Frashëri [BN - 1339]

Shqipërin' e njoh për trime.
S'e kurseva për të tjerë
gjaknë tim edhe fuqinë,
qysh ta kursenj këtë herë
për ju e për Shqipërinë!

Naim Frashëri [BN - 1340]

Të bëhemi gjithë ç'jemi
shqipëtarë, një fëmijë,
ndarje në mest të mos kemi,
si mëm', at' e bir e bijë.

Naim Frashëri [BN - 1341]

Shqipëri, o jetëgjatë!
Ty të kemi mëm'e atë,
Dhe për ty do të luftojmë,
Gjersa të të trashëgojmë.
Për ty gjithë dit' e natë
Mejtohemi gjër' e gjatë.

Naim Frashëri [BN - 1342]

Ne e mbollëm këtë farë,
po të tjerë shqipëtarë
do ta korrin më të mbarë!

Përmet [BN - 1343]

O vullnete të ndrydhuna ndër grushta të çelikta
të shekujve të kaluem!

O vullnete të shtypuna me thembra të ngurta
të titajve të tërbuem!
Të cilët n'udhë për në theqafje këtej pari i ranë
dhe vatrat tona në mjerim i përulanë ...

O vullnete të ndrydhuna!
O vullnete të shtypuna!

Shkundni prangat e mbrapshta! E me brimë
ngadhnjese,
me hove viganash, dëshirash flatruese,
turniu në të gjitha anët dhe poshtë në dhe zbritni
- ndosht'aty keni për të gjetë fillin e një hymni,
që Illyri e vjetër ndër kremtime këndonte,
ndërsa zemra e kombit në liri kumbonte.

O vullnete të ndrydhuna!
O vullnete të shtypuna!

Tash shigjetat e flakta të shprehjes suaj zharitse
drejtoni kah qiella në ball të hyut a të dreqit,
i cili fatin tonë mbytte në mnijë të vet përpise –
ta dije se të Birt' e Shqipës folen ia ngrehën
vetvetit.

Migjeni [BN - 1344]

Këngët e atdheut tim
janë ilaç, janë, more, shërim.

Polifonike [BN - 1345]





Mbarë bota flet për besën dhe për nderin e shqiptarëve,
Për vetijat, vllazërimin, harmoninë, miqësinë,
Dashurin' afetarizmin, kombësinë, urtësinë,
Trimërinë dhe kujdesin për të mirën e atdheut.
Bota mbarë u njëh prirjen për liri, dituri, dritë.

Naim Frashëri [BN - 1346]



Kështu duke thënë mbreti
dritësë ju afërua,
si lumi kur del te deti,
ra në të e u bashkua.

Naim Frashëri [BN - 1347]

Në dritët të Perëndisë
ishte më një'an' e Vërteta,
q'është shij' e gjithësisë
e me të mbahetë jeta,

Naim Frashëri [BN - 1348]

m'anët tjetër Mirësija,
bukurosheja bardhushe,
pas asaj ishte e bija,
Dashurija sylarushe,

Naim Frashëri [BN - 1349]

Pas asaj ish Urtësija
në një front shumë të lartë,
posi vetë Perëndija
ndrinte posi top' i artë;

Naim Frashëri [BN - 1350]

më tej ishte Miqësija,
dhe bir' i saj, Shpëtimi,
dh'e motra Vëllazërija,
pas atyre vij Gëzimi.

Naim Frashëri [BN - 1351]

Në mest ishte Diturija,
që rrëfente Perëndinë,
rreth e rrotull Gjithësija
pshtetur' ish mbi Diturinë.

Naim Frashëri [BN - 1352]

Mëndja, mëm' e Diturisë,
q'ish më shumë e afëruar
në dritët të Perëndisë,
mbante peshënë në duar;
gjithë punët' i peshonte,
pa vajisur më nonj'anë,

një dritë soje buronte
e tregonte gjithë ç'janë..

Naim Frashëri [BN - 1353]

E drejta dhe Bjerëzija,
të dyja pas soje rrinin,
vashatë, që i ka bija,
posi drita vetëtinin.

Naim Frashëri [BN - 1354]

Më pas ishte Trimërija,
Sedra, Nderi, Turpi, Fati,
Gazi, Prëhja, Mbarësija
dhe Durimi jetëgjati.

Naim Frashëri [BN - 1355]

Pa në mes të një rrëmeti,
q'ishte mbyturë në dritë,
ndrinte më shumë Shëndeti
dhe pas soje kish të titë.

Naim Frashëri [BN - 1356]

Më tej shumë Bukuroshe
ishinë ndarë më shkallë,
po Paqa, muntje të thoshe,
mi të gjitha është ballë.

Naim Frashëri [BN - 1357]

Më vënt të lart'ish Lirija,
e bijëz' e Trimërisë,
pas soje Fatbardhësija
dhe Urat' e Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 1358]

Pas asaj ish Vetëdija,
ajo Frym' e Shenjtëruar,
q'e ka motërë Lirija
e për çdo gjë' shtë zotuar;
mbante një masë të artë
në dorëtë si dëborë,
vështronte me sy të zjartë
dhe kish hapurë krahorë.

Naim Frashëri [BN - 1359]

Në kraht i rrinte Mëshira,
Dhëmbja, Dhënja, Ndjesa, Besa,
me shumë shoqe të mira,
edhe Dëshira e Shpresa.

Naim Frashëri [BN - 1360]

Pa ishte Shpirtmadhësija,
Njoha, Hiri, Kupëtimi
dhe Butësija, e bija,
Qetësija e Dëgjimi.

Naim Frashëri [BN - 1361]

Në një shesh të lulëzuar
ishin Vetijat' e mira,
me lulezë nëpër duar,
bukurosh' e të pavdira.

Naim Frashëri [BN - 1362]

Mbreti trim i urtësisë
vu re mir' e po vështronte
dritëzën' e Perëndisë,
dhe zën' e Zotit dëgjonte.
Ajo ish Parajsa vetë,
ishite drit' e Perëndisë,
drit' e Zotit të vërtetë,
e shpirtit të gjithësisë.

Naim Frashëri [BN - 1363]

Duartë në krahëruar
i kishte lidhurë mbreti,
në çudi e i gëzuar
dhe më vënt si shtyllë mbeti.
Kur hyn bilbili ndë verë
nër trëndafil' e gëzohet,
hump në bukuri e n'erë,
qysh digjet' e përvëlohet!
N'atë shtatë ish dhe mbreti,
kur ëngjëll' i Urtësisë
erdhi me vrrap edh' e gjeti
në dritët të Perëndisë,
dhe i ra përpara mbretit,
nëpër dritët duke shkuar

e nëpër mest të rrëmetit
me zëmërë të gëzuar;
panë të gjithë të Mirët
të urtët' e të pavdirët
në dritët të Perëndisë
nga rrëmet' i njerëzisë.

Naim Frashëri [BN - 1364]

E pyet ëngjëllin mbreti,
i thot' ëngjëll' i uruar,
me zë t'ëmbëlë së qeti
e përquark duke vështuar:
"Ç'janë gjithë këta vallë,
që kanë dalë në dritë,
e kanë rënë në ballë
duke bërë mirësitë?"

Naim Frashëri [BN - 1365]

Tha: "Këta janë përpjekur
për shpëtimit të njerëzisë,
e të tëra kanë vdekur
në udhët të Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 1366]

Pa më tej sheh ca të tjerë?
Kanë qenë të vërtetë,
shpirtmbëdhenj, zëmërgjërë,
pa të keq' e pa të metë.

Naim Frashëri [BN - 1367]

Këta gjithë janë vrarë
dhe kanë hequr në jetë,
e ranë dëshmimëtarë
për një fjalë të vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 1368]

Të tjerët kanë vuar
për të dhënë mënjës dritë
edhe për të lartësuar
diturit' e mirësitë.

Naim Frashëri [BN - 1369]



E sheh atë varkn' e gjatë?
Janë njerës të uruar,
që s'kanë fare mëkatë,
posi ergjënd' i kulluar.

Naim Frashëri [BN - 1370]

Pa ata përtej, që ndrijnë
e janë gjithë në dritë,
posi ylli vetëtijnë,
janë përpjekur një ditë
për shpëtimthit të lirisë,
për shpëtimt të mëmëdheut,
për nderthit të njerëzisë”.

Naim Frashëri [BN - 1371]

Kështu i tha Skënderbeut.
“Lan”, i tha, “emrë për jetë,
i dhanë nder njerëzisë,
qenë trima të vërtetë,
janë të bijt' e Lirisë”.

Naim Frashëri [BN - 1372]

Kshtu i tha, pa më tej vanë,
nëpër mest të Bukurisë,
një rremet të shumë panë
në dritët të Perëndisë.

Naim Frashëri [BN - 1373]

“Ishin pleq, të rinj, gra, burra
edhe gjithë foshnjërija,
q'i kish shkuarë nga ura
zëmr' e bardh' e mirësija.

Naim Frashëri [BN - 1374]

Qen' ata që kishin vuar,
po kishin pasur durime,
kurrë nuk kishin mpshuar,
s'kishin thënë mallkime.

Naim Frashëri [BN - 1375]

Kishin hequr të këqija,
po i kishinë duruar,

s'u qanë nga Perëndija,
nuk ishinë zëmëruar;

Naim Frashëri [BN - 1376]

erdhë me zëmrë të qetë
dhe të bardh' e të qëruar,
te Zot' i math i vërtetë,
gjë të keqe pa punuar.

Naim Frashëri [BN - 1377]

Pa i ndihne varfërisë
me gjithë fuqinë që patnë,
s'i bënë dëm njerëzisë,
ndaj e gjetnë këtu fatnë;

Naim Frashëri [BN - 1378]

nderë kurrë nuk' e lye,
as udhën e perëndisë,
gjën' e botës s'e rrëmbyen,
i qenë miq njerëzisë;

Naim Frashëri [BN - 1379]

Fjalënë kurrë s'e kthyen,
s'e lanë vëllazërinë,
s'shanë, s'vodhë e s'gënjyen,
s'e harruan Perëndinë;

Naim Frashëri [BN - 1380]

s'rrahnë, s'vran', s'kallëzuan
e s'ju qasnë dhelpërisë,
nga e drejta s'u mërguan,
bes'i prunë Perëndisë;

Naim Frashëri [BN - 1381]

nuk' u ndanë mirësije
dhe në hoqnë keq në jetë,
s'u larguan Perëndije,
qenë gjithë të vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 1382]

Zëmrë kurrë s'kanë thyer,
besë kishin njerëzinë,

ligësi s'kanë rrëfyer,
po gjithënjë mirësinë;

Naim Frashëri [BN - 1383]

miqësin' e dashurinë
lig' i kishinë në jetë,
u bënë me Perëndinë,
pandaj nukë mbenë shkretë.

Naim Frashëri [BN - 1384]

Se besë e Perëndisë
është vetëm Mirësija,
q'i duhet njerëzisë,
pa e do dhe Perëndija".

Naim Frashëri [BN - 1385]

Engjëlli i Urtësisë
këto fjalë duke thënë
bashkë me mbretthinë tënë.
Pasdaj për dore e more
mbrenë ëngjëlli me besë,
jashtë rremetit e nxorri
dhe hapi me vrrap një lesë.

Naim Frashëri [BN - 1386]

Ca më tej ishte një lumë
i thell' e i trumbulluar
dhe zëmth e valëshumë,
i gjer' e i tëmerruar!

Naim Frashëri [BN - 1387]

Veç ëngjëllit t'Urtësisë,
tjatërë s'e heth atë lumë,
është lum' i marëzisë,
papo rrëmben njerës shumë!

Naim Frashëri [BN - 1388]

Përtej lumit ish një tërë,
s'ish as e lig' as e mirë,
as Parrajsë, as Skëtërrë,
as me gas, as e pështirë;

Naim Frashëri [BN - 1389]

dhe rrëmet'i njerëzisë,
q'ish i shum' e i përzjerë,
posi tuf' e bagëtisë
as fatmir' ish as i mjerë.

Naim Frashëri [BN - 1390]

Më tej ish një tjetërë lumë,
ishte lum' i ligësisë!
trumbull e i ndyrë shumë!
ishte faj' i njerëzisë!

Naim Frashëri [BN - 1391]

Oh! sa ish i zi i shkreti!
popo! ç'punon njerëzija!
ishte bërë posi deti!
na shpëtoftë Perëndija

Naim Frashëri [BN - 1392]

Të dy tatëpjetë rrodhë,
Engjëlli me Skënderbenë,
e përtej lumit u hodhë
dhe ati vahnë ja gjenë.

Naim Frashëri [BN - 1393]

Atje tej ishte Skëtërra!
një shkëmp e një shkretëtirë!
njerëzitë bërë derra!
faturë në errësirë!

Naim Frashëri [BN - 1394]

I kishte shpënë Vetija
n'atë vënt të mallëkuar!
se i gjykoj Vetëdija,
pa i prua për të munduar,

Naim Frashëri [BN - 1395]

Foshnja kur i qaset lumit,
gjëmimnë duke dëgjuar,
dhe dritën' i sheh Zëshumit,
qysh mbetet'i tëmerruar?
Ashtu n'atë vënt dhe mbreti,
kur pa gjith' atë mynxyrë,



si i mahniturë mbeti,
s'i mbet gjyrë mbi fytyrë!

Naim Frashëri [BN - 1396]

N'errësirëtë ndë ballë
ishte vetë Ligësija!
kish zënë pej dorë Djallë!
dhe pas syresh Djallëzija!

Naim Frashëri [BN - 1397]

Djalli vet'i mallëkuar
nd'errësirët mbretëronte!
ishte shum' i mallëkuar
ta shihnje të tëmerronte!

Naim Frashëri [BN - 1398]

Më nj'an' ish Makutërija,
m'anët t'jatrë Lakëmimi,
në mest ishte Babëzija,
Dëmi, Viedhja, Kallëzimi!
Zihja, Sharja, Vrasja, Presja,
Ngrënjë, Rrahja, Zëmërimi,
Gënjeshtëra, Prishja, Ndesja,
Bregna, Nëma, Mallëkimi.

Naim Frashëri [BN - 1399]

Vrasj' e shkret' e tëmerruar!
mbytyrë në gjak e tërë!
kërcuren e mallëkuar
Djalli vet' e kishte bërë!

Naim Frashëri [BN - 1400]

Më tej ishte mizërija,
që rroitte posi mbleta
ish në ballë e Padija,
e zezë si sterr' e shkreta!
Atë gjithë kishin mëmël!
përpara e kishin vënë,
ish mynxyr' e madh' e gjëmël!
një rremet pas i kish rënë.

Naim Frashëri [BN - 1401]

Çquante në mest e Rremja,
E fëlliqura dh'e Ndyra,
pasdaj vinte Thash'e themja,
pas atyre ish Myxyra!

Naim Frashëri [BN - 1402]

Më pas ishin Shtrigëritë,
dhe të gjitha të Këqijat,
Mëritë e Pabesitë,
I Paudhi me të Bijat!

Naim Frashëri [BN - 1403]

Pas atyre ish Nakari,
i mërzitur' e i qarë,
i ligu e i çpërlari
me një fytyrë të vrarë;
rrinte si i turpëruar,
ishte nxir' e ishte tharë,
syn' e kish të sgurdulluar,
në mundim të math kish rarë.

Naim Frashëri [BN - 1404]

Pas tufës së ligësisë,
q'ishte posi mizërija,
ish rremet' i njerëzisë,
që kish bërë të këqija.

Naim Frashëri [BN - 1405]

Popo! ç'hiqninë të mjerët
n'atë vent të mallëkuar!
në Skëterrëtë, në t'errët!
nga drita shumë mërguar!

Naim Frashëri [BN - 1406]

Ligësisë pas i ranë,
pa i shpu ndë errësirë,
se të liqtë shpëtim s'kanë,
kurrë s'shohënë të mirë!

Naim Frashëri [BN - 1407]

Shpirt' i ndyrë' e zëmr' e lyer
i kishin shëmëtuar.
fytyra u ishte kthyer,
njerëzija u kish shkuar!

Naim Frashëri [BN - 1408]

Nuk' i ndihne varfërisë,
ndonëse patnë fuqinë,
i qen' armik njerëzisë,
kanë bërë ligësinë.

Naim Frashëri [BN - 1414]

Pa ishinë bërë derra!
ujqër' e arrinj e dosa!
gjëmba, hithra, shkarpa, ferra!
breshka, grera, bretëkosa!

Naim Frashëri [BN - 1409]

s'kanë pasur mëshirë,
kafshët' i kanë munduar,
nukë bënë gjë të mirë,
s'patnë zëmrë të qëruar;

Naim Frashëri [BN - 1415]

Njeriu kur humbet nderë,
le mënjane njerëzinë,
shëmbëllen vërtet me derrë
dhe m'ujkun e më arinë.

Naim Frashëri [BN - 1410]

fjalënë e kanë thyer
e s'kanë mbajturë besë,
kanë rrejtur' e gënjyer,
andaj Zoti s'u dha pjesë.

Naim Frashëri [BN - 1416]

Duke parë këta mbreti
në aqë shumë mundime,
durim në zëmrë s'i mbeti,
ndonëse e kishte trime.

Naim Frashëri [BN - 1411]

Ca i pru makutërija
e të tjerëtë kurcimi,
ca nakari e zilija
dhe ca dëmi e mundimi.

Naim Frashëri [BN - 1417]

Oh! moj e shkreta mëkatë!
të gjorëtë ç'i mundonje,
n'idhërime dit' e natë
i mbanj' e nuk' i lëshonje!

Naim Frashëri [BN - 1412]

I sheh ata që mundohen?
S'rrëfeketë ç'kanë bërë!
dit' e natë përvëlohen!
se qenë të liq të tërë!

Naim Frashëri [BN - 1418]

Në mest të gjithë rremetit,
q'ishte brenda në Skëterrët,
Ëngjëlli i thotë mbretit:
"A i sheh këta të mjerët?
Jan' ata, që kanë vrarë!
e kanë mbyllurë derë!
dhe kanë rrahur' e sharë!
andaj erdhë në Skëterrë!
Perëndi s'kanë kujtuar!
pa kanë prishurë punë,
njerëzin' e kanë shuar,
kanë qënë të përdhunë!

Naim Frashëri [BN - 1413]

Pa shih atë plakën shtrigë!
si heq brengë dhe mundime!
se ka qënë shumë' e ligë,
andaj ra ndë idhërime.

Naim Frashëri [BN - 1419]

U bënë shokë me djallë!
s'patnë turp, të turpërohen,
pa hoqnë dhe më të gjallë,
edhe tani po mundohen!

Naim Frashëri [BN - 1420]



Harruanë Perëndinë,
zunë djall' e djallëzitë,
punuanë ligësinë,
pa kurrë s'shohënë dritë!"

Naim Frashëri [BN - 1421]

Kështu tha Ëngjëlli vetë,
pa duallë duke shkuar
të dy me mbren e vërtetë
ng'ajy vent i mallëkuar.

Naim Frashëri [BN - 1422]

Oh! moj marrëzi e shkretë!
ç'je e lig e shum'e ndyrë:
të shoftë Zotth'i vërtetë!
s'e ç'bije dëm e myxyrë!

Naim Frashëri [BN - 1423]

Lakënim! o nëmëshumë!
se ç'e bën ari njerinë!
edhe ti nakar! o lumë!
e gjeçi më Perëndinë!

Naim Frashëri [BN - 1424]

Eja, kënga ime, s'kemi ç'rrimë
Mes kësaj rrëmuje pa kuptim,
Vrasësi ku hiqet për viktimë
dhe viktimës i kërkon shpagim,
Ku të përdhunuarat gjykohen,
Me të rrugës ligj, nga prostitutat,
Ku të marrë e t'urtë përgojohen
Dhe servilët, porsi minj nga skutat,
Dalin rrahin gjokset edhe mburren
Se luftuan vrimash, si heronjtë,
Kua jve të ngordhur tek u sulen
Për t'u hequr me tërbim patkonjtë ...
Ku gjithkushi klith e shfryn pa prerë,
Me një duf që, mëshirona o zot!
Eja, këngë e dashur, kaq poterë
Unë e ti nuk e durojmë dot,
Se jo pakëz jeta na ka vrarë ...
Ndaj le t'ikim, ku s'na sheh njeri!
Mbase larg në pyjet magjistare
Do të gjejmë prehje dhe qetsi.

Jorgo Bllaci [BN - 1425]

Mashtrimi po na mbyt,
asgjë e shenjtë në botë s'mbeti,
s'ka më virtyt!

Timo Flloko [BN - 1426]

Prej thellësisë,
dëgjoj zërin e tij:
"Më dhimbset bota juaj, o njeri,
medet, për virtytin ...!"

Timo Flloko [BN - 1427]

Mes rrebeshit të shiut,
një fantomë njeriu,
u faneps përtej,
e kish mpirë pendesa ...

Timo Flloko [BN - 1428]

Tepër vonë për ndjesë!
Të padenjit,
iu dhimbs vetja,
kurse dashurisë as jeta ...

Timo Flloko [BN - 1429]

Do të vuash një ditë,
do të t'brejë pendesa,
të fala gjithë dashuritë
ti, kufoma shpresash.

Timo Flloko [BN - 1430]

Hije e fajit e ndoqi pareshtur,
S'mundi më, ra poshtë, përdhe,
Më të tmershme rënie s'ka në jetë,
Se në hon të vetes po re ...

Timo Flloko [BN - 1431]

Njeriu le njerëzinë,
edhe xgjedh makutërinë
mer të ligën, le të mirën
le dritën, merr errësirën.

Naim Frashëri [BN - 1432]

po fuqi e gjë e shkretë
çdo punë e muntkan në jetë
dh'e drejta edh'e vërteta
mbetkanë fare të shkreta,
paska fuqi djallëzia,
sa s'e muntka urtësija,
të gjithë nuk e durojmë

Naim Frashëri [BN - 1433]

.... Mbreti u tha: “Le të shkojnë,
janë mjaft këta që mbenë,
gjëkund mos i ndalojnë,
lëshojini, le të venë.”

Këta shumë u gëzuan
e mbretit burrë ju falë,
të gJORËTË me gas shkuan,
duke thënë këto fjalë:

“Vallë ëngjëllë të jetë
me këtë zemrë të mirë,
apo Zoti i vërtetë
i fali kaqë mëshirë?”

Naim Frashëri [BN - 1434]

Mbreti u tha: “S’është mbarë
që ta marrim e të shkojmë,
se ka brenda shqipëtarë,
s’më ka ënda t’i lëftojmë;
ata do t’i marr’ urija
edhe do t’epenë vetë,
pse të vritet njerëzija
pa nevojë të vërtetë?”

Naim Frashëri [BN - 1435]

Pasdaj më gjuhët të trashë
i tha: “Rri, prëhu, qetohu,
e mos ki keq, Asim pashë,
po mer shënden’ e shërohu:
mos u trëmp e mos ki frikë,
se të falurit s’i vrasim
kurr’ e s’i kemi armikë,
si miqthitë tan’ i qasim;
ne shqiptarëtë themi:
“Kryet e falurë s’pritet’,
dhe më këtë fjalë jemi,
njeriu i zënë s’vritet;
rri i lir’ e i çpënguar,
sikur je në shtëpit tënde,
se gjë s’ke për të pësuar
se të jesh në këto vënde.”

Naim Frashëri [BN - 1436]

Ty, o lakëimim i shkretë,
Të shoftë Zotth’i vërtetë!

Naim Frashëri [BN - 1437]

O njerëzit’ e vërtetë:
u qofsha falë për jetë!

Naim Frashëri [BN - 1438]

në prehje, tek Perëndija
do të vejë mirësia
ligësija në skëterrë
do të vejë e do të bjerë.

Naim Frashëri [BN - 1439]

Do t’i lutem Perëndisë
t’u ap udhën e lirisë
e t’u heqë djallëzitë,
t’u sjellë mëndje dhe dritë.

Naim Frashëri [BN - 1440]

Ase s’është aspak harbut
Dhe se hiqet “Derë e Madhe”,
Kurse natën del hajdut,
Ç’vesh sa shkojnë rrugës madhe?

Asdreni [BN - 1441]

... “Ja ta ula hundën,
Ja në hell të shkova porsi dash!”
“Shkomë, - i thotë trimi, - dhe po munde,
Zemrën time për meze ta ndash!”
Siç u tha, u bë ... Më pas u ndalën
T’i kërkonin zemrën, po më kot;
Zemra zog qe bërë e nëpër male
Fluturonte e fluturon dhe sot.

Jorgo Bllaci [BN - 1442]

A më jepni pak dorinë,
tri dit’ ta bëj Shqipërinë?
- Çfarë’ na jep të të lëshojmë?
- U jap fjalën edhe besën.

Përmet [BN - 1443]

Tuj trathtue vlla e motër;
Masi vllanë m’e vra ke shkue,
Ti gja s’leke pa punue.
Vjerrni, qenin, qen t’tërbue
Qi Shqipnin na ka shnjëzue.

Shkodër [BN - 1444]



Ditën e pashkës së madhe,
seç u ther një ka në fshat!

Vajta e mora një ok' mish
dhe e hodha në kusi.

Po në qepra, mi shtëpi,
na del një gjarpër i zi,
u fut brenda në kusi
dhe helmoi djemt e mi.

Nëntë djem e nëntë nuse,
të nënta me djem në duar,
nëntë djepe i përmbisi,
nëntë pajë i zhuriti,
nëntë kapaklli m'i shiti,
nëntë varre m'i bitisi,
mbeta unë kallogrinjë,
për të nxirosur shtëpinë,

Lanet paç, o Kostandin,
lanet paç, o biri im,
ma dhe Dhoqinën në fqinj,
më le vetëm për vajtim.

Konstandin, ç'të të thotë nëna,
po tani që m'u bë gjëma,
ku është besa që më dhe,
Dhoqinën ti ku ma ke?

E martove aqë lark,
lark, e lark mërguar,
tre male kaptuar! ...

Ç'e vajton nëna mbi varr
dhe u kthie duke qarë.

U ngris dita erth akshami,
Kostandini u ngrit nga varri,
gur'i varrit ju bë kalë,
dheu i varrit ju bë shalë.

Mirë kalin e shaloi,
mori udhën edhe shkoi
tre malet i kapëtoi,
Dhoqinën vate kërkoi.

Na ish ditë e pashkës së madhe,
Dhoqina luante valle,
rrobat qëndisur me ar,
njihej që ish derë e parë,

Preu vallen nuseria
Dhoqina njohu vëllanë,
e njohu, dolli mënjanë.
Edhe Kosta ju afrua:

- Mirëdita, motra Dhoqinë!
- Mirë se erdhe, Kostë vëllai,
për të keq a për të mirë?
Në më erdhe për të mirë,
do vete të bëj stolinë,
të vesh kostumin e mirë,
të var gushës xhevahirë,
në më erdhe për të keq,
të vishem si kallogre.

- Unë të erdha për të mirë,
o moj ti, motra Dhoqinë,
po ç'i do rrobat e tjera?
Ashtu si të zuri hera!

- Merrëm, o vëllai i xhanit
hipëm në vithje të kalit.

U nis kali e po shkonte,
kalin Kosta e nxitonte,
si në erë fluturonte,
kali udhës turfullonte.

- Ç'ka kali që turfullon,
mor Kostë vallai?
- Nga gëzimi që gëzon,
moj Dhoqinë motra.

Udhësë tek shkonin,
te pemët dëgjonin,
zogjt që cicironin:
"Ciliviu, ciliviu,
kini parë a s'kini parë,
di veta hipur mi kalë,
shkon i vdekuri me të gjallë."

- Ç'kanë zogjtë që këndojnë,
ç'janë ato fjalë që thonë,
o Kostë vëllai?
- Zogj janë, le të këndojnë,
si të duan le të thonë,
moj Dhoqinë motra.

- Supet e tua të lartë,
pse më bien era baltë,
o Kostë vëllai?
- Janë llohët e beharit
moj Dhoqinë motra ...

Në varr te qisha errinë:
- Ik në shtëpi, moj Dhoqinë,
se un' do ngjatoj dorinë
atje sipër në lëndinë.

Dhoqina u sos në portë,
Kostandini u fut në gropë.

- Hap, moj nënë, derën,
jam Dhoqina vetëm!
- Lipsu, moj murtajë e shkretë,
vjen këtu të më gënjesh,
ti më hëngre nëntë djemtë,
nëntë djem e nëntë nuse,
nëntë nuse e nëntë djepe,
kërkon dhe mua me vete,
do që të më març dhe mua?!

- Hape nënë, çfarë thua,
hape nënë derën,
Jam Dhoqina vetëm!

- Me kë erdhe, moj Dhoqinë?
- Kam ardhë me Kostandinë!
- Ç'Konstandin, të ardhhtë gjëmë!
Kostandini ka vdekur,
ç'bën tre vjet pa tretur?

- Kosta, Kostë vëllai më pruri!

- E ku e ke Kostandinë?

- U ngjit lart në një lëndinë,
shkoi të ngjatojë dorinë ...

Nëna hapi derën,
sheh Dhoqinën vetëm.
Tek u puthën e u ngalasnë,
që të dia në vënt plasnë.

Popullore [BN - 1445]



Veç kshtu mundin ktij popull
ti mundesh m'i a shpërblye:
përndryshej tash t'vret djersa
qi qe dikue për tye.

Ernest Koliqi [BN - 1446]



Ti qi na e ndien vetveten
 n'vënd t'yt-et i mërguem
 tue shetitë udhash lodhshëm
 si t'ishesh i randuem
 mbi sup nga pesha e 'i bote
 mendimesh s'reja e t'nalta
 qi s'mund kuptoj' Shqiptare,
 le me gjallnue ndër balta;
 Ernest Koliqi [BN - 1447]

ti qi nga tryeza e kafes
 rrethue me miq qi t'gjasin
 shan zakonet arbnore
 dhe vrret: - S'do lejshem çasin
 me ik' po t'kisha mjetin
 t'largohem për gjithmonë;
 Ernest Koliqi [BN - 1448]

ti q'ushqen aq dëshirë
 t'mdhaja sa toka e jonë
 t'gitet e ngushtë, e vogël
 dhe' e errt' si burg mizuer
 ku t'thahen trut qi t'thithen
 një qutetnim epruer;
 Ernest Koliqi [BN - 1449]

ti qi dridhesh n'lakmime
 udhtimi n'çdo ndrrim stine
 edhe fshan: - Ah kish t'mujshem
 m'e lan'kët vis qelbsine,
 me kthye n'qytete t'verit
 ku rrëshqet n'lëvizje jeta
 dhe dita asht e qindisun
 me mirakande t'leta,
 me bisedime t'holla,
 me valle e me muzikë,
 me sendet ma të bukra
 qi mendja e njerit çpikë,
 kish t'mujshem m'u larguemun
 nga amtija e ksaj Shqipnije,
 nga kjo moçale e turbullt
 ku njerzt s'jan' njerz por hije,
 ku s'njifet dija as harti,
 ku s'lejn' përftime t'gjana,

ku jam i dnuem me ndejun
 përzie me trasha mana,
 tue lshue fuqit mendore
 m'u ndryshkun pse veprimi
 n'kto dhena t'verbta e tvobta
 për mue s'ka far'kuptimi -;
 Ernest Koliqi [BN - 1450]

ti, qi ndër shprehje t'tilla
 mërzin vjen tue përmbledhun,
 mendo kush n'tru t'pajisi
 me arsim të rrallë e t'zgjedhun,
 mendo se s'je djal'lordi
 shkollue me pare t'tueja,
 por fryti i djersës s'popullit
 t'dërgoi ndër shkolla t'hueja.
 Ernest Koliqi [BN - 1451]

Për ty dhetar't dhetuene
 drithin, si mirë e maten,
 e bulku për mësim t'andin
 rralloi n'shtëpi kafshatën,
 malsorit i u muer dhija,
 taksën pagoi puntori,
 tregtari dhe, gjithkushi
 pjesën e vet e nxori;
 Ernest Koliqi [BN - 1452]

e t'gjith pa ankim me andje
 kët randim e kan'bartë
 me t'ndifun qi të marrish
 n'dhe t'huej dije të lartë,
 Ernest Koliqi [BN - 1453]

pse ushqejshin n'shpirt uzdajen
 se ti n'vënd t'parve kthye
 do t'bahshesh dit ma t'mira
 n'qiell't t'ona me shkëlqye.
 Ah, nuk menduene t'shkretit
 me t'pa kshtu tu' u tërhuzë,
 se at vis qi derdhi djersën
 me t'mbajt' ke me përbuzë,
 se n'vënd t'a dikoish dijen
 për m'i a lecue mjerimin,
 do t'turfullojsh mërzitshëm
 tue deshirue largimin!

N'mos e merrsh ti n'kët popull
 kush do t'a marri at barrë,
 me ia ndritue padijen,
 me shndoshun smundje e varrë
 qi n'shpirit i lane shekujt
 e territ e t'robnis,
 ndër ta me ngjallun shpresën
 n'agime t'ardhmenis,
 me i nxjerrun sharte tjera
 ma t'gjana e t'drejta jete,
 mbi male e vrrije e fshatra
 sikur edhe n'qytete?

Ernest Koliqi [BN - 1454]

Mos humb n'ankime t'kota,
 por ço synin me kqyrë,
 mbi mjegull t'egoizmit
 qi t'kapërthei, ç'detyrë
 ka djelmënija arbnore
 ndaj kët popull fatmjerë
 qi dha, flijoi e priti,
 por fryt s'pau kurrnjihërë.

Ernest Koliqi [BN - 1455]

Eja t'i thejm' djerrinat
 edhe t'a zgjojm' prendverën
 n'kto vise kaq t'shkretnueme;
 eja t'a mbushim erën
 me ethet e veprimt
 qi sjell shndet e lumni
 e lavd e dritë e frymën
 e t'bardhes qytetni;
 eja t'a ndrojmë ankimin
 n'nji hymn uzdaje, eja
 t'ndërtojm' permbi gërmadha
 faletoret e reja,
 ku me vallet e moçme
 t'a qarkojm' çdo therore,
 me vllaznit ma t'përvujtun
 t'kapun lirisht për dore;
 eja t'i falim lule
 edhe jetës shqiptare,
 t'zgjojm' n'te qeifet e lehta,
 mirakandet bujare,

ngjyret e gjalla, jonet
 e bukra, drandofillet
 e gzimit ndër të cilat
 jeta e përjashtme shtiellet,
 e atbot' dhe toka e t'parve
 shpirtin ka me na knaqë:
 na t'rijt atbot'ndërgjegjen
 duhet t'a kemi n'paqë.
 Veç kshtu mundin ktij popull
 ti mundesh m'i a shpërblye:
 përndryshej tash t'vret djersa
 qi qe dikue për tye.

Ernest Koliqi [BN - 1456]

Ju falem,
 o bajama t'lulzuem t'kolegjës s'eme,
 pse ju kët flad prej s'largu po m'a çoni.
 Kur ju çilshi në prill bashk' me qershija,
 kumbulla e pjeshka atbot' kolegja dukej
 si djep lulesh. Edh'ishte! Sa e sa mija
 shpresash krenare ka përkundë e andrra
 t'bukura, kur jashta shekullit jetojshim
 si n'nji ishull magjik ... Nxanës i hovshëm,
 synin nga librat plot dëshir e lshojsha
 përtej atyne ledheve, - mbi jetën ...
 Shpesh-hera mallëngjyeshëm zani msuesit
 na thonte, po, se jeta a plot mashtrime
 e se të shumtën ndodh' qi n'udha t'saja
 i drejti vuen edhe ngadhnen bakeqi.
 Kush e ndëgjonte? Me një hark si ylberi
 premtimesh i rrethuem, na çfaqej para
 vegimi i jetës. Kur dhe librat thojshin
 se bahen t'mdhaja paudhësi, na n'parzem
 ndiejshim një shpirt e një guxim pushtuesash
 qi zbresin me i vu ligjën dheut t'fituemun
 me shpatë. O botë e njerzve, n'vete ushqejshim
 shpresën hyjnore, shpresën guximtare
 qi vepra e jon' ty shqim do t'kish përtrimun
 tu' e kthye prap jetën n'bukurin e prallave ...
 Ku asht ai shpirt? Pse s'jam prap ai?

Ernest Koliqi [BN - 1457]



Tet'heresh
 ende s'ia a siellun bota rrolles s'diellit, -
 e kam ndrrue krejt ... un qi desha t'ndrojt botën!
 Kush m'qiti kaq me shpejt nga praku i
 heshtëshëm
 i shkollës s'eme? E ku jam sot?
 Sakt, n'andërr.

Ernest Koliqi [BN - 1458]

Ndoshta m'ka marrun gjumi tue lexuemun,
 o Dant, poemën t'and me durr ndër tamtha,
 pse nesër n'klasën t'ime më vjen rendi
 t'zhilloj at vargun plot me lot, at vargun
 e mërgimit: "Sa fort i ndiehet krypa
 bukës së huej edhe sa shteg i ngurtun
 asht zbritja e ngjitja nëpër shkalla t'hueja ..."
 Un sakt jam n'andërr e mërgimi i Dantit
 m'ban t'a shof veten n'nji dhe t'hueja ..."
 Un sakt jam n'andërr e mërgimi i Dantit
 m'ban t'a shof veten n'nji dhe t'huej mërgue ...
 por tekembramja mue kumbonza e shkollës,
 qi vje n'çdo orë e na kallzon detyrën,
 ka me m'a hjek'kët angth kur do t'më zgjoje
 n'mes shokve t'dashun të kolegjes s'eme ...
 Ah jo, or mik, vërte jan'kumbon' t'hueja
 qi qajn' tue tingullue n'nji qiell mërgimi ...

Ernest Koliqi [BN - 1459]

Lam tumir! Kaloj prendvera,
 muer me vete kangë e fletë;
 u tha kopshti e gjethlat era
 përtej prrojeve i ka tretë.
 M'kan' mbulue kujdese tjera
 qyshse nisa t'njof, o Jetë;
 s'm'joshin ma agime e ylbera:
 tash Mysterin due me pyetë.
 Due m'i a terun lott t'mjeruemit,
 n'shgjeta due me i gjuajt' t'praksuemit
 n'shkam të Febos tue zan'pritën.
 T'rrzuemin due t'a çoj nga balta;
 due m'u ngjit' mbi maje t'nalta
 me shtegtar' qi kerkojn' Dritën ...

Ernest Koliqi [BN - 1460]

E kur nata vjen dhe xhixhillojnë hyjt
 gzohe fort, se hekrat nuk m'i kryqzojnë syt',
 por t'u sjellmun mbrapa shof dritën e smutë
 dhe hijën teme tu'u zgjatë në murt

Migjeni [BN - 1461]

si një kërcnim ligji, posi një dajak.
 Dhe atëher tërbohëm dhe urrej pa masë
 dritën, hijën, veten, muret edhe hekrat
 edhe e ndiej veten lua të ndryem në kafas.

Migjeni [BN - 1462]

A çilë kafazi,
 bylbyl flutro;
 Ndër pyje e ograia,
 Bylbyl, shpejto.

Ndre Mjeda [BN - 1463]

Kafaz ke qiellin,
 Epshin pengim;
 E gjithë ku t'rreshket
 Shkon fluturim.

Ndre Mjeda [BN - 1464]

Por vaj! Se 'i dimën tjetrë
 Paske, o bylbyl i shkreti;
 Pa da ty zemra t'treti
 Mbas vajit që t'rrethon.

Ndre Mjeda [BN - 1465]

Ndërrojnë' edhe stinët e motit,
 E për çdo herë ndrron era.
 Mbas dimrit vjen prendvera,
 Mbas borës blerimi del.

Ndre Mjeda [BN - 1466]

Por ty, n'kafaz t'shtërngueshëm,
 Ty t'paska ndry mizori,
 E kurnjijherë nuk t'nxori
 Me t'lëshue ku zemra t'thretet.

Ndre Mjeda [BN - 1467]

Ti kurr, një kangë s'ia këndove
Diellit kur nadje çohet;
Zemra me vaj t'coptohet
E me pajtue nuk don.

Ndre Mjeda [BN - 1468]

Por ça ka toka, bylbyl, ndrron moti;
Ankimi e vaji nuk asht i zoti
Përgjithmonë zemrën me na coptue;
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1475]

Çdo krajl i madh ndër shpija
Ty t'mba m'u thanë i veti;
Vetë bukuria, o i shkreti,
Kenka për ju një kob.

Ndre Mjeda [BN - 1469]

Mbas boret t'dimnit çilet prendvera;
Një ditë nuk gjindet që s'po ndrron era;
Sendet që patmë janë tuj mbarue;
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1476]

Por njaj vaj që je tuj lëshue
Bylbyl, zemrën ma copton;
Ditë e natë rri tuj prigjue,
Vaj për mue! Kush mund t'ngushëllon?

Ndre Mjeda [BN - 1470]

Tuj dnes' i vorfni se e mbluene t'kqijjat,
Me ankime t'veta mbush rrugët e shpijat;
Lehtësim por s'mbramit gjen tuj punue;
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1477]

Gjama jote a porsi ankimi
I një fëmijës që vetun mbet;
Gjama jote a si shungllimi
I një t'zezës që gja s'e pre.

Ndre Mjeda [BN - 1471]

Kjajnë fëmijn e dekun printd e shkretnuem
Me 'j vaj që duket se s'ka t'pajtuem!
Por zemrën moti jua ndrron tuj shkue:
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1478]

Por aj kob që hana e diti
E njaj vaj që ylli pau,
T'shkretve n'vesh kurr nuk iu mbririti,
E kurr zemra nuk ju ndau.

Ndre Mjeda [BN - 1472]

Ndër ishuj t'detit kjan i burguemi
Për fmij, për grue që s'shef i shuemi,
Por prap durimi ka me ja prue,
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1479]

Me ditë hyjt me bisedue,
Me pasë sy që me derdhë lot,
Vajin tand ju kishin prue
T'kishin kja për jet' e mot.

Ndre Mjeda [BN - 1473]

Shpend tjerë burgosi sa herë mizori,
E rishtas jashta dikur i nxori;
Ndër fushë e male janë tuj fluturue;
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1480]

Nëpër fush'e nëpër shpija,
Me kujdes që s'nep afat,
Rreth e rreth t'kish ardhun fëmija,
Kjamun t'kishte i ngriti fat ...

Ndre Mjeda [BN - 1474]

Flutrojnë ndër male, flutrojnë ndër lule,
Flutrojnë ku çerdhen motit e ngule,
E kangët e parshme nisin me këndue:
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1481]



Ndër zogj që kishe ndonjëherë do t'hasin,
Ndër pemë, ndër lule bashkë me ta ngasin;
Për ty t'vorfnuemit rrijnë tuj shpnesue;
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1482]

Bylbyl, ky shekull or e ças ndrrohet:
Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;
Edhe natyra po don m'u ndrrue:
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1483]

Krajlnit' ma t'moçmet ndrrohen me t'reja
E një mij' popuj ranë porsì rrefta;
Po kthen motmoti që pat mbarue:
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1484]

Porsì motmoti ndrrojme dhe na vetë,
Herë – herë gazmohna, herë rrijmë të shkretë,
Por vaji e ankimi kanë për t'u shue;
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1485]

Mbas vajit t'tashëm ka me t'ardhë shendi,
Ka me ta shëndoshun zemrën gazmendi,
Për mall, si motit, zanë ke me e lëshue:
Fillo me gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1486]

Kur t'shkojsh në fusha, kur t'shkojsh ndër male,
Afër shpisë seme hovin tand ndale;
Mahnit' at zanin tand tuj prigjue
Kam për t'u gëzue.

Ndre Mjeda [BN - 1487]

Ah, edhe unë ndofta më shumë, më shumë,
Më shumë se ju shqetësohem e vuaj,
Vuaj për botën e madhe me zhurmë,
Vuaj për vendet dhe shokët tuaj ...
Kjo torbë që zien, kjo torbë që kam përmbi
shpinë,

Më vë në mendime dhe mendjen ma prish,
Më thotë ta dua, ta dua njerinë,
Njeriut t'i jap nga shpirti im shpirt.

Dritëro Agolli [BN - 1488]

(babait) Një ditë i lodhur, i menduar,
I thashë mengadalë:

“Përse kaq shpejt m'i ke mësuar
Kaq punë e brengë e halle?”

Dritëro Agolli [BN - 1489]

Gjithandej ndjehet një fshehtësirë: pika e gjakut
dhe e limfës zbret tinëz në brendësi, ku së thelli,
ka mijëra vjet që përsoset Fryma e Madhe e një
thelbi të Ri.

Agron Tufa [BN - 1490]

Nxito, kapedan, për të mbjellë popullin tim të ri.

Arian Leka [BN - 1491]

Sa krupë, sa ndyrësi jashta shtëpisë! –
Dhe jo për ndyrësinë e rrugëve, shesheve,
as për marrëzira, thashetheme, grindje –
me to jemi plot, gjer në vrimat e veshëve –
por Fryma e kësaj bote, si vrug i paskaj
ndot Thelbin dhe Thelbin s'ka det që ta lajë!”

Agron Tufa [BN - 1492]

Dhe si pushtova duke fluturuar,
Me krahët gjak, të thellat kaltërsi,
E prita vdekjen pa u dëshpëruar,
Sepse e ngopa shpirtin me liri!

Jorgo Bllaci [BN - 1493]

Kambët më mbetën në borë e gishtat më ranë
tue lypë nëpër akull
zemra që i ruhen frymës së diellit.
Kryet ia fala vendit e zanin propagandës
për një alibi të qëlluem e të përsosun.

Martin Camaj [BN - 1494]

Seç këndon një zok
poshtë nga bostanet,
një merak që kam
nga zemra s'më ndanet.

Seç këndon një zok
përtej nga kori jet,
një merak që kam
nga zemra s'më hiqet.

Seç shtrova trapezën,
rakia s'më pihet,
një merak që kam
nga zemra s'më hiqet.

Seç më shtruan bukën,
dhe buka s'më haet,
një merak që kam
nga zemra s'më ndahet.

Përmet [BN - 1495]

Në një ketë hall i ka çue goja
Tuj shkruet, tuj rrejtë pa t'drejtë
Për gjithë anësh ju ka dalë boja
Hiqe ragbetit s'ju ka mbetë.
Sado që një Fe nuk jena
Prej nesh ndonjë të keq s'kanë pa.

Shkodër [BN - 1496]

Po, po; Ti sod, o gurra e dashtnis shejte,
Lshoj fashë zemrat e njerzvet,
Vllaznoj popuj e mbreten,
E ban qi paqa vrik t'na ngushllojë jeten;
Pse bota mbarë, atëherë, kah len e kah merr
dielli
ka me t'lavdue me t'ambla jone t'reja,
E ma e kerthnesët ka me lulzue prap Feja.

Gjergj Fishta [BN - 1497]

Për mua sheklli kufij s'ka
Synin kam ma t'kthiellët se dielli;
Perendis 'dhe i kam pergja,
Hiqe t'reja n'jetë kah shtielli.

Mbas Tenzot un jam fuqija
S'cillës perkulet rrokullija:
Hovin pezull gja s'm'a mban.

Gjergj Fishta [BN - 1498]

"Sëmundja më e madhe sot nuk është kanceri
apo lebroza, por indiferenca dhe mungesa e
interesimit"

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1499]

"Thirrja ime dhe thirrja jote janë të njëjta:
shenjtëria"

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1500]

"Thirrja jonë është shenjtëria, do të thotë të jemi
tërësisht dëshmitarë të Zotit për njeriun, për
çdokënd".

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1501]

Ti je Kau - ...

Njeriu me ty punon tokën, pastaj të ther e të ha

Ervin Hatibi [BN - 1502]

Sa milje duhet të ecë njeriu
për të takuar njeriun?

Parid Teferiçi [BN - 1503]

Çdo njeri e ka një fjalë ku vë kryet.

Frederik Rreshpja [BN - 1504]

Këto janë fjalë që thuhet me besë e nuk
harrohen

që i thonë fëmijët kur flasin për herë të parë.
që hyjnë në urtinë e popullit në vargje dashurie
Fjalë që i lidhen tokës rreth brezit si vargoj lirie.

Qerim Ujkani [BN - 1505]

Pastaj u shpjegoj zogjve

Që edhe unë jam në këtë botë pa fole.

Frederik Rreshpja [BN - 1506]



Më thotë zani me i kundue jetës,
Më thotë zani me i kundue kohës,
Më thotë zani: “Kndoi s’vërtetës!”

Gaspër Pali [BN - 1507]

Pse toka e qiella kan’ heshtë para fjal’s s’tij,
Buzët i dridhen gjith’ herë me hov t’ri,
Pse kangtari n’zemër ndryen
Gëzimet e bot’s mbarë
E dhimbat e bot’s mbarë.

Gaspër Pali [BN - 1508]

Ardhtë një vjeshtë pa shtegëtim zogjsh!

Frederik Rreshpja [BN - 1509]

Ardhtë vëllazërimi
I qiejve dhe kontinenteve.

Imail Kadare [BN - 1510]

E dashur,
Në zemër mund të rrish dhe një çikë,
Se zemra më e butë është se kënga zakonisht,
Por në këngën që e braktise në çastin heroik,
Sido që të bësh,
Më kurrë s’mund të hysh,
Se dhe n’u pendofsh,
Dhe në u kthefsh,
Tek porta në shi dhe në trokitsh,
Portën s’ta hap,
Rri në rrebesh,
Tek porta në shi për jetë të rrish.

Imail Kadare [BN - 1511]

Përpara
nuk e dishe, o jetë,
se kaq i tmerrtë
asht grushti i yt
që mbyt
pa mëshirë.

Migjeni [BN - 1512]

E vjetër është bota,
E parruar,
Kaq shumë akoma duhet bërë.

Nga pislleku i vjetër për ta pastruar,
Për ta rilindur të pastër të tërë.

Imail Kadare [BN - 1513]

Si varfanjak sa herë e pata lutur
Të vinte tok me mua nëpër male,
Por thoshte: “Unë s’ngutem, ti je ngutur
Dhe s’kam lajthitur t’i besoj një përralle”!
Po, po, ti nuk lajthite asnjëherë,
E llogarite jetën mjeshtërisht,
Fytyrën s’ta përzhiti asnjë erë,
Punove dhe jetove ngrohtësisht ...

Dritëro Agolli [BN - 1514]

.... qeshën hidhur: “Është i marrë!
I marri mburr pa turp veten e tijal!”
Kush ish i marrë e zgjidhi historia.

Dritëro Agolli [BN - 1515]

Bij çobanësh kemi qënë
kemi fjetur nënë tënë,
shiu e bora na kan’ zënë,
herë ngrën’ e her’ pa ngrënë.

Polifonia labe [BN - 1516]

Dhe kështu në rrugë të madhe e shitme zemrën
tonë
njerzve që vetëm një të përqeshun dhanë për të
e shkuen të kënaqun e tu’ u gëzue – pse
panë mfshehsinat intime të kësaj jetesës sonë.

Migjeni [BN - 1517]

Në mjedis shndriste tempulli
i librit n’pergamenë – biblioteka –
me fexe idesh madhështore
në ballin e gjanë të shekullit.

Martin Camaj [BN - 1518]

Me bukën e fushës
Me erën e malit
Me këngë trimërie.

Zhuliana Jorganxhi [BN - 1519]





Mjerimi asht një njollë e pashlyeshme
në ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj.

Migjeni [BN - 1520]



Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta
që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin
të tanë jetën e vet derisa të vdesin.
E mbi ta n'ajri, si në qesëndi,
therin qiellën kryqet dhe minaret e ngurta,
profentënt dhe shejtënt në fushqeta të
shumngjyrta
shkëlqejnë. E mjerimi mirëfilli ndien tradhti.

Migjeni [BN - 1521]

Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme;
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme;
balli që e ka, syt që e shprehin,
buzët që më kot mundohen ta mshefin –
janë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes,
të mbetunat e filiqta rreth e përçark tryezës
mbi të cilën hangri darkën një qen i pamshirshëm
me bark shekulluer, gjithmon i pangishëm.

Migjeni [BN - 1522]

Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,
zhele fund e maje, flamujt e një shprese
të shkymë dhe të coptuem me të dalun bese.

Migjeni [BN - 1523]

Mjerimi tërbohët në dashuni epshore.
Nëpër skaje t'errta, bashkë me qej, mij, mica,
mbi pecat e mykta, të qelbta, të ndyta, të lagta
lakuriqen mishnat, si zhangë; të verdhë e pisa;
kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore,
kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e
ndragta
edhe shuhet uja, dhe fashitet etja
n'epshin kapërthyesh, kur mbytet vetvetja.
Dhe aty zanë fillin të marrët, shërbtorët dhe
lypsat
që nesër do linden me na i mbushë rrugat.

Migjeni [BN - 1524]

Mjerimi në dritzën e synit te kërthini
dridhet posi flaka e mekun qirini
nën tavan të tymuem dhe plot merimanga,
ku hije njerzish dridhen ndër mure plot danga,
ku foshnja e smueme qan si shpirt' i keq
tu' ndukë gjithë e shterruna të së zezës amë,
e kjo prapë shtatzanë, mallkon zot e dreq,
mallkon frytn e vet, mallkon barrn e randë.
Foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lëngon,
e ama s'e don, por vetëm mallkon.

Migjeni [BN - 1525]

Vall sa i trishtueshëm asht djepi i skamit
ku foshnjë përkundin lott edhe të fshamit!

Migjeni [BN - 1526]

Mjerimi rrit fëmin në hijen e shtëpive
të nalta, ku nuk mrrin zani i lypsis,
ku nuk mund t'u prishet qetsia zotnive
kur bashkë me zoja flejnë në shtretënt e lumnis.

Migjeni [BN - 1527]

Mjerimi pjek fëmin para se të burrhohet;
don ta msojë t'i iki grushtit q'i kërcënohet,
atij grusht që në gjumë e shtrëngon për fytit
kur fillojnë kllapitë e etheve prej unit
dhe fëtyrën e fëmis e mblon hij' e vdekjes,
një stoli e kobshme në vend të buzëqeshjes.
Një fryt kurse piqet dihet se ku shkon
q'ashtu edhe fëmia në bark të dheut mbaron.

Migjeni [BN - 1528]

Mjerimi punon, punon ditë e natë
tu'i vlue djersa në gjoks edhe në ballë,
tue u zhigatun deri në gjuhë në baltë
e prap zorrët nga uja i bahen palë – palë.
Shpërblim qesharak! Për qindenjë afsh
në ditë – vetëm: lekë tre – katër dhe “marsh!”.

Migjeni [BN - 1529]

Mjerimi kaiher' i ka faqet e lustrueme,
buzët e pezmatueme, mollzat e ngjyrueme,

trupin përmendore të një tregtis së ndytë,
që asht i gjikuem të bijë në shtrat vet i dytë;
dhe për atë shërbim ka për të marrë do franga
ndër çarçafë, ndër fëtura dhe në ndërgjegje
danga.

Migjeni [BN - 1530]

Mjerimi gjithashtu len dhe në trashëgim
- jo veç nëpër banka dhe në gja të patundshme,
por eshtnat e shtrembta dhe në gjoks ndoj
dhimbë,
mund të që të len kujtim ditën e dikurshme
kur pullaz' i shtëpisë u shemb edhe ra
nga pesha e kohës, nga pesha e qiellit,
kur mbi gjithçka u ndi një i tmerrshëm za
plot mallkim dhe lutje si nga fund i ferrit,
ish zani i njeriut që vdiste nën tra.

Migjeni [BN - 1531]

Kështu nën kambë të randë të zotit t'egërsuem –
thotë prifti – vdes ai që çon jetë të dhunuem.
Dhe me këto kujtime, ksi lloj fatkeqsinash
mbushet gotë e helmit në trashgim brezninash.

Migjeni [BN - 1532]

Mjerimi ka motër ngushlluese gotën.
Në pijetore të qelbta, pranë tryezës plot zdrale
të neveritshme, shpirti, me etje derdh gotën
në fyt për me harrue nanthetenand' halle.
E gota e turbullt, gota satanike
tu'e ledhatue e pickon si gjarpni –
dhe kur bie njeriu, si gruni nga drapni,
nën tryezë qan – qeshet në formë tragjikomike.
Të gjitha hallet skami në gotë i mbyt
kur njëqind i derdh një nga një në fyt.

Migjeni [BN - 1533]

Mjerimi ndez dëshirat si hyjet errsina
dhe bajnë tym si hejt q'i ban shkrum shkrepitima.

Migjeni [BN - 1534]

Mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba,
dhimba paduruese që të bajnë të çmendesh,
që t'apin litarin të shkojsh fill' e të varesh
ose bahe fli e mjerë paragrafesh.

Migjeni [BN - 1535]

Mjerimi s'don mshirë. Por don vetëm të drejt!
Mshirë? Bijë bastarde e etënve dinakë,
të cilt në mnyrë pompoze posi farisejt
i bijnë lodërtinës me ndjejt dhelparak
tu' ia lëshue lypsit një grosh të holl' në shplakë.

Migjeni [BN - 1536]

Mjerimi asht një njollë e pashlyeshme
në ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj.
Dhe këtë njollë kurr nuk asht e mundshme
ta shlyejnë paçavrat që zënë myk ndër tempuj.

Migjeni [BN - 1537]

O shpirt! Pëllumb i gjorë! Lajm i idealit të ri ...
Zhgule shëgjetën nga vetja, e rishtas, me
dhimbsuni
flutro mbi valët e jetës e fjalë ngushllimi pëshprit,
shëro plagat e skamnoreve e shpresën në jetë ua
rrit.

Migjeni [BN - 1538]

Por hesht, shpirt'i goditun, felltë hesht në pikllim,
i dhimbset vetja shpirtit ... o vall, se ç'idhnim!
Shikon botën skamnore, plagën shikon me sy
e lotë xhevahiri derdh ... o vall, u fik një hy!

Migjeni [BN - 1539]

U vodh kanga nga zemra e kombit,
shpërtheu në vaj të dikuem mjerimit,
këndoi ujen e së bijës, këndoi ujen e të birit,
qau jetën e thyeme nga rrufe e fatit,
i mbyti në lotë shpirtënt që ndjejnë dhimbë për
të ngratit.

Migjeni [BN - 1540]



Kangë a vaj? Çë je? Thuejma, zemër kombi!
Zemër që ke vuejtun, që ende po vuen ...
Këngë a vaj? Çë je? Çë në ty po vluen?
Mallkimi ndaj fatit që ditët t'i helmuen,
që dëshirat e jetës të gjitha t'i gozhduen?
Migjeni [BN - 1541]

Oh – jo! Kanga jote asht shprehje e dhimbsun
e një jetese që dergjet e dergjet
dhe tu'u dergjë ndoshta do hesht e molisun ...
Migjeni [BN - 1542]

Ndrit shkëndi e gjallë në qiell plot me hyje,
ndrit shpirti i ri, lidhë me t'arta nyje,
nyjet e dashnis,
dashni e fëminis
për të mjeruemët në botë
që vuejnë, derdhin lotë.
Migjeni [BN - 1543]

Të keshë ftohtë
Do të thotë
se s'di gjë për ty njeri
Gjallë në botë
Qeveria dhe media të fsheh
Si monedha në kek
Në darkën e bamirësisë së fundvitit. Të fshehin
Pas të vërtetës së hidhur të drurëve të shtetit.
Ervin Hatibi [BN - 1544]

Ata
Që na vënë revolucionin si alternativë
Për të na qeverisur me frikën nga ai
Ata që na trembin me anarkinë
Ata që deformojnë fenë dhe fjalinë
Për të mos prishur rehatinë
Për mos të të ngrohur
Mbrohen pas faktit se nuk të kanë njohur
Personalisht
Ervin Hatibi [BN - 1545]

Të kesh ftohtë
Frigohem se mos mendosh
Se të ftohtin s'ta ka kush borxh

Se mos të duket vetja tepër
Se mos bëhesh i egër
Se mos bëhesh vrasës serial, ku i dihet
Dhe na fut në shënjestër
Si në një varr të përbashkët
Të gjithëve që djegim drutë e Zotit
Popullin Kain të të ngrohtit.
Ervin Hatibi [BN - 1546]

Bir, të ka ndodhur të nisësh pa bukë në rrugë?
Të ka ndodhur ta ndiesh në çdo pore të lëkurës
urinë?

Dritëro Agolli [BN - 1547]

E nuk lind gaz në votra pa zjarrm mbetë.
Gaspër Pali [BN - 1548]

“O Zot, ti je çdo gjë për mua.
Më shfrytëzo kur të duash ... Nëse nuk mund
t'u ndihmoj këtyre njerëzve në fatkeqësinë dhe
vobektësinë e tyre, më lejo të paktën, të vdes
me ta dhe pranë tyre, që të mundem në këtë
mënyrë të jap dëshmi për dashurinë tënde!...”
Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1549]

“Për të gjetur një vend, kërkova dhe eca shumë,
aq shumë derisa më la fare forca. Tani, këmbët
dhe duart po më dridhen. Tani mund të kuptoja
më mirë vuajtjen e trupit dhe të shpirtit të më të
varfërve ndër të varfrit, pa shtëpi, pa ngrënë,
dhe pa kë të gjallë që do të përkujdesej për ta
... Prandaj, u luta:

Më lë të ngushëlloj, në vend se të jem e
ngushëlluar,
Më lër të kuptoj, në vend se të më kuptojnë,
Më bëj të dua, në vend se të më duan,
Sepse:
Vetëm duke dhënë njeriu merr,
Vetëm duke harruar vetveten, njeriu e gjen
veten;
Vetëm duke falur njeriu është i falur.”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1550]

O, si nuk kam një grusht të fortë
t'i bij mu në zemër malit që s'bëzanë,
ta dij edhe ai se ç'do me thanë i dobët –
n'agoni të përdihet si vigan i vramë.

Migjeni [BN - 1551]

Unë – lugat si hij' e trazueme,
trashigimtar i vëjtjes dhe i durimit,
endem mbi bark të malit me ujën e zgjueme
dhe me klithma të pakënaquna t'instiktit.

Migjeni [BN - 1552]

Mali hesht. Edhe pse përditë
mbi lëkurë të tij, në lojë varrimtare,
kërkoj me gjetë një kafshatë më të mirë ...
por më rren shaka shpresa gënjeshtare.

Migjeni [BN - 1553]

Mali hesht – dhe në heshtje qesh.
E unë vëj – dhe në vëjtje vdes.
Po unë, kur? heu! kur kam për t'u qesh?
Apo ndoshta duhet ma parë të vdes?!

Migjeni [BN - 1554]

O, si nuk kam një grusht të fuqishëm!
Malit, që hesht, mu në zemër me ia njesh!
Ta shof si dridhet nga grusht' i paligjshëm ...
E unë të kënaqem, të kënaqem tu'u qesh.

Migjeni [BN - 1555]



S'kje toka, jo, per ty kje qiella!

Gjergj Fishta [BN - 1556]



Mbahu ti, o zëmra ime,
që shkel tek do e je trime,
thuaj si thoshin qëmoti,
nga Zoti prapë tek Zoti,

Naim Frashëri [BN - 1557]



Një shkollë e lartë, e frytshme
t'vërtetash plot çudi
shëtitja n'këtë mënyrë
bëhet për njerëzi;
kështu mes varresh, kockash,
udhëzohen të menduar,
n'heshtje duke qëndruar
njerëzit për në vërtyt;
t'i bluajnë mirë të mortjes
të shquarat mendime,
t'mendojmë se fati i sotëm
me t'nesrit sjell ndryshime,
se sot ata gëzojnë,
por nesër vjen mbarimi,
kështu e ka njerëzimi,
kur jermi s'ka kufi.
Popujt e perëndimit
të mburren që ua kalojnë
për qytetërim gjithë tjerëve,
por sytë këtej t'i drejtojnë:
do të mësojnë prej teje
atë shprehi bujare,
si dritë t'panjohur fare:
varrezash për t'shëtitë.

Pashko Vasa [BN - 1558]

Krahë shpirti ... i lyp vdekjes pa pushim.
Që të vij te ti, moj motër, fluturim,
Që të t'gjej në qiell të lumtur e të qetë
Në mes dritës, pranë Zotit të vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 1559]

Të vdekurit t'i qajmë,
Nga shpirti të mos i ndajmë,
Po mos me zë e me kujë,
Me kësish farë rrëmuje,
Me vaj e me ulërimë,
E me shumë kërcëllimë;
Po me lot vetëm të qajmë,
Dhe me zemërë zi të mbajmë;

Naim Frashëri [BN - 1560]

Vashën vërtet e mbuluan, po shpirt' i saj në qiej
shkoj,
Hapi krahëthit e lehtë, në hapësirët fluturoj,
Bukuri e saj u përzje me bukurizët të prillit,
Me fjalëzët të bilbilit, me erët të trëndafilit;
Gjësendi s'humbetë kurrë, e gjë s'vdes me të
vërtetë,
Mase ndryshohenë pak, pa janë në këtë jetë,
As shtohet, as pakësohet, as prisetë gjithësija,
Vdesën e ngjallenë prapë si gjith' edhe njerëzija.
Këtu janë gjithë ç'janë, e gjithë ç'gjë mund të
jetë,
Ëngjëllitë, perënditë dhe aly Zot i vërtetë!
Se një trup e një shpirt është gjithësija, që s'ka
anë,
Të gjallë edhe të vdekur, gjithë brenda në të
janë.

Naim Frashëri [BN - 1561]

Se Zoti i math i vërtetë
Na fali lottë në jetë,
Që ta nxjerrim hidhërimnë,
Edhe zjarr e mallingjimmë.

Naim Frashëri [BN - 1562]

Po sa keq që në mes urë s'mund të hidhet
Që i gjalli me të vdekurin të lidhet.

Naim Frashëri [BN - 1563]

Pikërisht si ai pëllumbi
që dikur nga arka u shqit,
mbi këtë varr këmbën e vuri
pastaj n'prehër t'Hyut u ngrit.

Pashko Vasa [BN - 1564]

Trimi
nukë mundet nga mundimi
ata vanë n'atë jetë,
te Zot'i math i vërtetë,
u poqnë me Perëndinë,

Naim Frashëri [BN - 1565]

Në qiej fluturuan,
te Zot' i vërtetë shkuan.

Naim Frashëri [BN - 1566]

Po t'ju pyesin se ku mbeti,
Thoni: shkoi në kaltërsi.

Dritëro Agolli [BN - 1567]

Ngushëllim ishe për mua,
ishe kënaqësia ime
dhe asaj buzëqeshje engjëjsh
borxh i kam sa gëzime.

Pashko Vasa [BN - 1568]

Ti u zhduke! Ngjyrë e bardhë
fytyrën tënde e veshi
dhe mbi atë buzë të zbehtë
krejt qeshja e qiellit qeshi,
dhe qe një brengë zharitëse
për shpirtin tim të gjorë.

Pashko Vasa [BN - 1569]

Vetë qielli ty të la
vetëm gjashtë muaj, t'jetoje,
pastaj, si u ktheve n'shpirt,
cipën njerëzore e lëshove
dhe tash, bijë, mes engjëjsh
ti prindit i buzëqesh.

Pashko Vasa [BN - 1570]

Porsa me ato flatra rrëshqit dheut i shkoi,
kuptoi se çfarë ishte dhe n'qiell fluturoi.

Pashko Vasa [BN - 1571]

Me flamurin kombëtar
të stolisëm për në varr.

Përmet [BN - 1572]

Barbarët... e mbyten! E pra
Ky 'i dhunë kurrkuj s'i a bani;
Nuk bani kand me kja:
Per t'keq s'i duel kurr zani;

Gjergj Fishta [BN - 1573]

Per Atme e shejten Fe
Punoi me t'drejtë m'ketë dhe.

I vorfni, pa prind mbetun,
Qi kjan per bukë i mjeri,

Gjergj Fishta [BN - 1574]

Te ky shujten pat gjetun:
Ky lott prej sysh i a teri,
S'e la nen dhunë me fsha
E at e mamë i u ba.

Gjergj Fishta [BN - 1575]

Shkoj. Dhe zgjoj ditë të bukura,
diellin foshnjë mbaj në gji.
Kur mos jem, do jem i tëri
tek e bukura Shqipëri.

Teodor Keko [BN - 1576]

Më mirë ta dish se do të vdesësh!
Lulet lule do të jenë dhe nuk do të kundërmojnë
me trishtim
dhe njerëzit do kthehen më shpesh te distributori
i harruar
të furnizohen falas me besim ...

Teodor Keko [BN - 1577]

Po, a thue, krejt deka n'asgjasesend t'përpini
E, posë se do kocijsh edhe 'i grusht pluhën,
Nuk t'la tjetër? Jo! N'prehën t'Amëshuemit,
Pjesa ma e mirë e jotja ka flutruë
Me gzue n'dritë t'qiellvet, ku pushon dishiri
I nierit t'drejtë, si drita m'sy të kthiellun.

Gjergj Fishta [BN - 1578]

Po, po, se pertej vorrin shpirti i nierit
Gjallon për jetën! Njeki mendim i ambël
Deken e zbutë e vorrin e ban të pëlqyeshëm,

Gjergj Fishta [BN - 1579]



Kur zemrën fa'i s'e grisë. Prej ktij mendimi
As vetë për ty s'lotova shumë, kur ndjeva
Se diqe: se n'ma t'mirën lule t'motit
E lae ti këtë shkretë, ku shuen e Drejta
E Paudhnia, ku sundon mizore;
Ku i zhyemi m'vese sod me dorë dhunuese
Vesin shinon Theta t'zi, e selia
M'rrashta t'përgjakshme t'njerzvet m'kambë, ku
mbahet.

Gjergj Fishta [BN - 1580]

Ehu! Po, se shpirti yt kulluet si rrezja
E diellit, qi përfton lulen e erandshme,
Kur bora dehet, s'mujt me e bajtë qelbsinen
E randë t'ktij sheklli t'zi; por fletët i rrahi
Kah jeta e dytë, ku Njai qi rruzullimin
N'themel e dridhë veç me 'i vetimë t'qerpikut:
Amshon n'lumni shka Atij t'i ket përgja
S'kje toka, jo, per ty kje qiella!

Gjergj Fishta [BN - 1581]

Ti, miku im, u bëre shpirt
S'ke frikë nga bora, as nga vapa
Atje mbi re mos u mërzit
Se botë e tërë të vjen nga mbrapa.

Arben Duka [BN - 1582]

Nuk vij të qaj tek varri yt,
la kursej vetes ato hapa,
Se trupi rri aty i shtrirë,
Po shpirti yt më ndjek nga prapa.

Arben Duka [BN - 1583]

Jepi dorën, jepi dorën
kësaj nëne që i biri
iu këput si yll nga gjiri,
qyqe, korb' e la të gjorën!
Ësht' mëkat, për perëndi,
në mos tjetër, sot për sot,
eja derdhi dy tre lot,
eja bjeri dy tre gur,
sa t'iu bënet një qivur!

Ali Asllani [BN - 1584]

U ndie'j frymë përbrenda shpijet
Porsi erë që vjen pa shkas;
E, n'at muzg, një vegim hijet
Lokes n'votër let'iu qas;
Përmbi plakën krahët i uli
E n'gryk t'shuemen e shtrëngoji;
Buzët t'shpuplueme n'ball' ia nguli;
U ndal drita e ajo mbaroi.

Ndre Mjeda [BN - 1585]

Kish kënduar gjel'i parë,
po këndonte gjel' i dytë,
buz' e shkretë i ish tharë,
po kur hapi të dy sytë!
"Djemtë!" tha dhe psherëtit,
dhe rreth e rrotull shikojti,
sytë përpjetë i ngriti,
pa e la jetën' e shojt!
E! po përse Perëndija
mbretëreshës' i dha vallë
kaqë shumë të këqija?
I pati shkruar në ballë?
Mëngjezi e gjeti të vdekur,
posi një thëngjill të shuar,
ftohur' e bërë si hekur,
edhe tretur' e kulluar;
dukej brenga, që kish hequr,
në buzët të përzhëlitor,
dhëmbj'e zemrës'i kish mbetur
mbi syt, q'i ishte venitur!
Jeta kërkon ta mundonjë,
po vdekja s'e lë njerinë,
papo i vjen ta shpëtonjë,
dhe s'ja dinë mirësinë!
Më nestrët hapnë dëborën,
edhe mihnë dhen' e shkretë,
e vunë në varrt të gjorën,
e mbaroj të zezën jetë!
Vashatë mbenë pa mëmë,
dhe pa vëlla e pa atë,
u erth gjëmë përmi gjëmë,
dit' e tyre u bë natë!

Naim Frashëri [BN - 1586]



CEREMONIA MORTORE

Faltorja Shqiptare me kërkesën e familjarëve, ndihmon në organizimin e ceremonisë mortore të një bujari shqiptar. Synimi është që njerëzit të ndihen sa më afër Zotit në këtë ditë të dhimbjes.

I vdekuri mbulohet me Flamurin e Faltores, i cili para mbylljes së arkivolit hiqet, paloset dhe i dorëzohet familjes.

Këtë flamur familja e vendos para hyrjes së shtëpisë (apartamentit) për 25 ditë.

Para se të mbyllet arkivoli dhe para se të varrosset thuhet kjo lutje e Profetit Naim Frashëri.

*Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qof' i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Mbahu ti, o zëmra ime,
që shkel tek do e je trime,
thuaj si thoshin qëmoti,
nga Zoti prapë tek Zoti.*

Për 25 ditë rresht dikush nga familja ndez nga një qiri për çdo ditë, mbi varr ose në shtëpi.

Ditët e rikujtimit të vdekurit do të jenë dita e dhjetë, e shtatëmbëdhjetë, dhe e njezetë e pestë pas varrimit. Gjatë dhjetë ditëve të para pas vdekjes secili shkon për vizitën e tij përkujtimore dhe i paorganizuar.

Pas këtyre ditëve, përkujtimi varet nga dëshira dhe mundësitë të afërmëve apo shoqërisë së të vdekurit.

Sugjerime për ndërtimin e varrit.

Varri është vetëm një pllakë guri dhe pjesa mbi varr është e mbjellë me bar, lule ose bimë, sipas dëshirës së familjarëve apo amaneteve e kujtimeve të të vdekurit.

Në varr nuk vendoset fotografia.



Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vlla.
Të lutem, pak dritë në këtë natë kur shpirti vuen,
kur të dhemb e s'di ç'të dhemb, e syni gjum nuk ka,
urren nuk din ç'urren, don e s'din se ç'don.

Migjeni [BN - 1587]



Thellë në veten teme flejnë kangët e
pakëndueme
të cilat ende vëjtja dhe gëzimi s'i nxori,
të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme
me shpërthye, m'u këndue pa frigë e pa zori.

Migjeni [BN - 1588]

Thellë në veten teme kangët e mia jesin ...
e unë jam vullkani që fle i fashitun,
por kur t'i vijë dita të gjitha kam me i qitun
në një mijë ngjyra të bukra që nuk vdesin.

Migjeni [BN - 1589]

Por a do të vijë dita kangët me u zgjue?
Apo ndoshta shekujt me ne prap po tallen?
Jo! Jo! Se liria filloi me lulzue
dhe e ndjej nga Dielli (alegorik) valën.

Migjeni [BN - 1590]

O kangët që fleni reliket e mia
q'ende s'keni prekun as një zemër të huej,
vetëm unë me ju po kënaqem si fëmia
unë – djepi juej; ndoshta vorri juej.

Migjeni [BN - 1591]

O dhimbë krenare e shpirtit që vuen
dhe shpërthen ndër vargjet e lira ...
A deshte, vall, për t'u ngushlluem
tu'e stolisë botën me xhevahira?

Migjeni [BN - 1592]

O dhimbë krenare ndër vargjet e lira,
që kumbojnë me tinguj të sinqertë ...
Vall, a do të prekish kënd ndër ndijesina?
Apo do vdesish si vdes gjethi në vjeshtë?

Migjeni [BN - 1593]

O kanga e dejë e dhimbës krenare ...
Mos pusho kurr! Por bashkë me vaje,
si dy binjakë këndonin mjerimin –
se koha do t'ju bijë ngushëllimin.

Migjeni [BN - 1594]

Një lis pasqyrohet në lotin e qiellit,
tundet dhe përgjaket në pasion të viganit:
“Jetë! Jetë unë due!” – e frymë merr prej fellit,
si stuhi shkyn ajrin ... por në fund ia nis vajit.

Migjeni [BN - 1595]

Frymëzim' i em i pafat,
që vjen e më djeg mu në gji,
për kë po më flet? për kë të shkruet?
përse po më ban që kaq të vuet?
pse vjen e më djeg mu në gji,
frymëzim' i em i pafat?

Migjeni [BN - 1596]

Për të gjorët? për ata që nuk kanë dritë?
O frymëzim' i em i ngratë,
mjaft me plagë që s'kan shërim,
leni të dergjen në mjerim,
Njerzit s'duen ma trishtim,
botës s'ia kande atë kangë të thatë,
thot se mjell një farë të idhtë.

Migjeni [BN - 1597]

Far e idhtë ... far' e idhtë ...
- O njerz të bimë nga far'e ambël!
Frigë të mos keni, pse një kangë
mund t'ju theri në ndjesi,
t'ju kujtojnë zemrën në gji
në ndërgjegje dhe një dangë ...
por ju t'ju bajë edhe ma zi.

Migjeni [BN - 1598]

Frymëzim'i em i pafat!
Shporru ktej! Nuk të due!
S'i due hovet tueja të nalta,
as fluturimet ... Njëpër balta ...
të ditve tona të shklas un due
rrokë me njerzit që rrok nata.

Migjeni [BN - 1599]

Kronikat historike s'janë të mjafta
për potretin e gjakderdhjeve, mizorive:
numrit të viktimave të luftërave duhet t'u shtohen
të vdekurit larg dashurive.

Dhe nga shekujt që ikën mësim i pashlyer
mbeti një aksiomë e përgjakur, e rëndë:
kasaphanat e përbotshme nisin marshimin
kur ëndërrat njerëzore shkelen me këmbë.

Bardhyl Londo [BN - 1600]

Prap ju kujtova, vjetesh krejt harruar,
Si gjë të vjetur rrall e tek q'e gjen.
Ju shkunda, letra, dorës sime shkruar,
Njëj gjumit, mund q'as juve s'ju pëlqen.

Asdreni [BN - 1601]

Ju mblodha, vjersha, nga ju kisha lënë
E një nga një ju pashë prap me mall.
Më dridhet dora si njëj të pangrënë,
Që dridhet pas ca buke q'e sheh rrall.

Asdreni [BN - 1602]

Ca jush prej kohësh gjith me skajet brejtur,
Qysh brehet zemra keq kur send e pik,
Disa me faqet shuar, sërët mvrejtur,
Si shenjtër kishe, moti q'i ka fik.

Asdreni [BN - 1603]

Me ju përmenda jetën e kaluar,
Në radhët shkruar pashë shpirtin tim,
Me disa pika lotesh zemre së lënduar
Mi ju të thara, mbetur si kujtim.

Asdreni [BN - 1604]

Ndër ju ca çaste gazi dhe pikëllimi,
Sa drithma trupi s'pata mdjehur plot,
Kur shihnja në çdo radhë dorëshkrimi
Hir dashamiri, hir që s'e gjej dot.

Asdreni [BN - 1605]

Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vlla.
Të lutem, pak dritë në kët natë kur shpirti vuen,
kur të dhemb e s'di ç'të dhemb, e syni gjum nuk
ka,
urren nuk din ç'urren, don e s'din se ç'don.

Migjeni [BN - 1606]

Pak dritë! O burrë! O hero! ngado që të jesh! ...
Burrë që shkatrron edhe që ndërton sërish!
Pak dritë vetë, të lutem, mshirë të kesh,
se do çmendem në kët natë pa gjumë dhe pa
pishë.

Migjeni [BN - 1607]

Oh! ta kisha pishën të madhe edhe të ndezun!
Me flakën e pishës në qiellin e kësaj nate
ta shkruajshe kushtrimin ... Ehu Burrë i tretun!
Do ta shifsha vallen tande në majë të një shpate.

Migjeni [BN - 1608]

Por pishë nuk kam e vetëm janë burrat, shokët ...
Dergjem n'errësinë pa gjumë dhe pa dritë ...
Askush s'më ndigjon, çirren kot më kot ...
Hesht more, hesht! por qindro, o shpirt.

Migjeni [BN - 1609]



Të duket gjë e zakonshme: jap pare, marr bukë!
Po ne e pritëm kaq shumë!
E mbollëm, e korrëm e djersët na vanë çurkë,
Pastaj e shimë në lëmë e mbetëm pa gjumë;
I mbushëm thasët dhe ecëm në pluhur e në gurë,
Mullirit e bluam dhe e vumë në magje,
Në krahë e morëm dhe e shpumë në furrë,
Pastaj rrodhi në sofër nga korja e ngrohtë një
paqe ...
Të duket një gjë e zakonshme?

Dritëro Agolli [BN - 1610]

Hapni udhën të kalojë buka!

Dritëro Agolli [BN - 1611]

Kur sytë po mbyllte, lëvizi ngadalë buzët
E në agoninë e mëngjesit tha:
“Ne jemi bujq e si bujk dëgjo veç një muzë,
Dëgjo muzën e tokës së njomë, vëlla!”
Me dorën tënde, o tokë, pishat ule mbi trupin e
tij

Dhe gjirin e hape e nxore një luleshqerrë
Pranë fytyrës së zbehtë të djalit të ri,
Pranë syve të mbyllur e ballit të çjerrë.

Dritëro Agolli [BN - 1612]

E pashë atin tim mbi plisa
Përkulur sikur falej:
“O tokë e mbushur me filiza,
O tokë e mbushur vaje,
Gjer kur do shitesh si një lopë
Me plisat e ugarit,
Pse tallet kaq kjo shtrigë botë
Dhe pse të nxjerr pazarit?”

Dritëro Agolli [BN - 1613]

Im atë tokën shumë e donte,
Siç donte nënë e grua,
Për tokën lodhej dhe rënkonte
Dhe djersën derdhte krua.

Dritëro Agolli [BN - 1614]

Tatimi më rëndon mbi trup e gojë,
Mbi truallin amtar që s’di të lulëzojë,
Dhe mbi ajrin q’ë thith or’ e çast.

Zef Serembe [BN - 1615]

Gjersa s’mundem të paguaj në çdo rast
Sillen me mua si një bataqçi,
Më mbytin gjobot e jam aq fatzi.

Zef Serembe [BN - 1616]

Zotëri, dëgjoni, ju fal të voglën arë
Ku im atë rrojti plot gaz e shpresë
Edhe shtëpinë po deshët ju kam falë
T’jetoj i qetë, qoftë dhe pa banesë.
Po rebel mos më quani Zotëria juaj
Duke më çuar shkresa pa pushim
Që veç me çirren “Paguaj! Paguaj!”
Sa m’shuhet gazi e bie në dëshpërim.

Zef Serembe [BN - 1617]

Po ju jap dhe këpucët, në ju pëlqen,
Kapelen, setrën si edhe pantallonat,
Po kini pak mëshirë për bijtë e mi.

Zef Serembe [BN - 1618]

Me kthetra vdekja gati po i mbërthen,
Të zhveshur, t’zbathur, t’uritur gjithmonë
Qajnë pa shpresë për fatin tim të zi.

Zef Serembe [BN - 1619]

Po taksidari është shumë “trim”,
I dëgjon këto ankime e as që pyet,
S’përfill fare çka, s’prek atë vetë
E në krye t’ngulur ka veç një mendim.

Zef Serembe [BN - 1620]

I zhvesh borxhlinjtë me aq trimëri
Thesare fjalësh harxhon në çdo shkrim
Që dërgon me të madhe shpejtësi
Me një varg rojesh në çdo rregjistrim.

Zef Serembe [BN - 1621]

Dhe ara, stola, madje edhe shtëpi
Për pak lira fajdexhiu i ulët zhvat
Dhe borxhi as paguhet ndonjëherë.

Zef Serembe [BN - 1622]

Godasin veten borxhlinjtë përherë.
Po ... ky vend do të bëhet shtet i madh.
Ç’ë ha meraku atë se kush ka uri?

Zef Serembe [BN - 1623]



Hoxha e prifti, murgu e murgesha apo dervishi,
pavarësisht nga punët e lëvduara në shërbim
hyjnor që kryejnë nuk mund të zëvendësojnë për
njeriun shenjtërinë e Nënës dhe Babait që i ka
lindur.

Abdi Baleta [BN - 1624]



Na dha ne t'shkretve vetë perëndija
Mallin m'u pamun, me ndejë n'nji votër
Grueja me t'shoqin, prindën fëmija
E vllau me motër.

Ndre Mjeda [BN - 1625]



Qan me lot vasha jetime,
qan me lot
qan me lot krua më krua,
thotë – kush më marton mua,
se pa nënë e baba jam,
dhe pajë e shkreta s'kam?!
- Hesht, moj bijë, se ke xhaxhanë,
një vëllezëri të tërë,
që pa martuar s'të lënë,
dhe pajën ta kanë blerë,
dhe do veç në proto derë
me këto rroba që ndrijnë,
prerë e qepur në Janinë!

Gjirokastër [BN - 1626]

Rrotulloje sirin moj,
sirini dhe një herë,
të shikoç babain, moj,
për të fundit herë.
Babai për tija, moj,
shumë e ka qederë,
nuk i hahet buka, moj,
nuk i pihet verë!
Mbi kurorën tënde, moj,
ngre fole birbili,
të rriti mamaja, moj,
të mori bandilli!

Polifonike [BN - 1627]

Krushqit tanë me lezet,
na pritën me muhabet,
me llokume, me sherbet,
Krushqia na qoftë e mbarë,
si për djalë edhe për vajzë!

Sarandë [BN - 1628]

A m'u trashëgofsh, o djalë,
gëzofsh nënën e babanë!

Gjirokastër [BN - 1629]

O ju, o krushqit tanë,
krushqia na qoftë e mbarë,
bukë e ëmbël e pandarë,
dalçi me faqe të bardhë!

Sarandë [BN - 1630]

Filloi babai dasmën
o për të t'martuar,
djal' i vogël i babait,
o pëllumb i shkruar.

Përmet [BN - 1631]

- Erdhi dita të të marr,
o flori, margaritar!
- Ti pa valle s'më merr dot,
trëndafil e borzilok.

Përmet [BN - 1632]

- Moj faqja protokalle,
pse m'i mban sytë përdhe,
frikë ke a turp më ke?!
S'është më ty vetëm,
por është për gjithë ne.
- As frikë, as turp nuk kam,
po dua të dal me nam,
të nderoj nënën, babanë.

Përmet [BN - 1633]

Ike, ike more dhenë,
kush i bën nënës kafënë?
- Le t'ia bëjë kush të dojë,
kush i tha të më martonjë?!
- Kush ia bën, s'ia bën si ti,
moj thëllëza në kuvli.

Përmet [BN - 1634]

- Më rrite, baba, më rrite,
më rrite me tul simite,
kur erdhi vafiti më shite.
Ti baba, më rrite mua,
paç kësmet nuset e tua.
- Udh' e mbar', o bijë,
të bëneç e mirë,
mos bënesh si bota,
se s'të qas te porta.

Përmet [BN - 1635]

- A s'm'i thoni kësaj nuse,
pse s'këndon, po qan me lot?
- A s'm'i thoni babait tim,
të më lerë dhe një mot.
Babai dolli te dera,
i mbushi sytë me lot,

dhe çupës ç'na i thotë:

- Ç'bëri sot e ç'bëri mot.

- A s'm'i thoni kësaj çupe,

pse s'këndon, po qan me lot?

- A s'm'i thoni nënës sime,

të më lerë dhe një mot.

Nëneja dolli te dera,

i mbushi sytë me lot,

dhe çupës seç na i thotë:

- Ç'bëri sot e ç'bëri mot.

Përmet [BN - 1636]

- Ku je dirë sonte,

manushaqja e sojme?

- Në shtëpi të huaj,

m'u duk nata muaj!

Sa të vete në shtëpi,

të shoh babanë me sy.

Vlorë [BN - 1637]

Djali me këmbë të mbarë,

u bëft' si gjyshrit e parë,

na u bëftë një mëhallë.

Përmet [BN - 1638]

Djalinë e mori gjumi,

të ligat ia martë lumi.

Përmet [BN - 1639]

Çunat lozin, vashat qepin,

Plakat e urta tjerrin lesh,

Nuset shkundin, tundin djepin,

Burrat shatë, pleqtë grepin,

Një mban fjalë, tjetri qesh.

Asdreni [BN - 1640]

Fushës zbresin tatëpjetë

Punëtorët në mëngjes,

Nëpër arat porsi mbletë,

Kush me vegël, kush me qetë

Me pëqinjtë përmbi brez.

Asdreni [BN - 1641]

Ky hyn baba, qeshet zhaba,

Ku hyn vllau, qeshet trau,

Ku hyn motra, qeshet votra,

Ku hyn nana, qeshen t'tana.

Shkodër [BN - 1642]

Vjen mesdita, gratë u shpien

Buk' e gjellë me ç'u ndodh,

Ndënë hije redhe shtrihen,

Hanë drekë, çlodhen, bien,

Pastaj nisin punën mbrodh.

Asdreni [BN - 1643]

Të bëhesh gjysh e të rritësh nipër e mbesa,

Pastaj t'i shpërndash si një grusht me shkëndijë

Plot ëndrra dhe shpresa!

Dritëro Agolli [BN - 1644]

Ngaherë nisesh larg në udhëtim,

Po si s'të lodhi udha, more djalë?

Po si s'të lodhi udha, biri im?

Dritëro Agolli [BN - 1645]

Rritu ti, moj gjeraqinë,

u bëfsh drit' për njerëzinë!

Përmet [BN - 1646]

Milosau: - Qetmu, vash, edhe mejtohu:

me ditët shkon helmi, e koha

do të vijë që edhe anije

prej këndeje do të na çojnë

të mërguar në vend t'huaj,

ku dhe ne shtëpi do ngremë.

Edhe atyre që do lindnin

prej nesh atje, do t'u thonë:

"Vllezër, hypni prapë anijet

prap' të gzojmë n'atdhe prindësh!"

De Rada [BN - 1647]

Rina: - Në më do,

më mbaj ku linda,

larg prej vendesh ku të shumtë

t'huajt krenarisht harbojnë.

De Rada [BN - 1648]

"Djep lirie për krejt vendin

ish shtëpia e gjyshit tim,

tash ndaj t'huajsh e përlur,

ndaj s'besoj se do të gjejë

vasha dishka që të mburret."

De Rada [BN - 1649]



Milosau: - Ç'deshëm gjer tashti, e patëm
andaj m'u qeto, moj grua.
Zoti s'na u bë i huaj,
që më besë mos t'i zem.

De Rada [BN - 1650]

Milosau: - Si një re, në dukje e bardhë,
mbi qytet shiun e fsheh,
se s'di ende ku ta zbrazë,
ti më rri kur më ke pranë,
dhe kur vij, të gjej tek qan.

De Rada [BN - 1651]

Rina: - Birit tim asnjë njeri
nuk ia mbrojti foshnjërinë,
as m'i dha ndihmë kur vdekja
ma mbërtheu e i piu gjakun.

De Rada [BN - 1652]

Milosau: - Grua, s'është urrejtja e Zotit
që shpejt birin na rrëmbeu:
çdo njeri mbaron nën baltë.
Si në djep natën më ndjente
tinguj këngësh e s'dij ç'ishin,
si nuk di q'yjet lëvizin,
që qyteti po merr frymë,
ashtu dhe si mbylli sytë
ai më sheh anije detit,
lumenj të mëdhenj, e bregut
ai më sheh trima dhe kuaj;
po për ne ai s'është më.

De Rada [BN - 1653]

Rina: - Porse t'ëmën që ma mbante,
atje biri im s'e sheh.
Ai qëndroi ndër sytë e mi
i përvjerrë si lëvere.
Fill pas tij, do vdes edhe unë!
Këtë sytë e tij ma thanë.
Por nuk di se çfarë varri
jetën time do përpijë?

De Rada [BN - 1654]

Oh, sa t'i ngryset këto ditë,
dhe të vij atje mes yjesh,
të të shquaj në mes shoqesh,
të ta rrok prapë atë dorë,
kurrë më mos ndahemi!

De Rada [BN - 1655]

Ime-zonjë, shoqja ime.
ti nuk je këtu me mua,
tok më kurrë s'do të rrimë!
Vjeshtën që shkoj, kur u ngryset
shpejt një e diel, ti më thoshje:
"Dita sa vete shkurohet.

Po më e shkurtër se çdo stinë
po na bëhet jeta jonë.
Prap' që pas qelqesh dritsoresh
borën që na plak do shohim."

Unë qeshja dhe s'besoja.
"Bora, the, do të më marrë,
se nuk di: më la një breshër
kurmit, sa më pat goditur
në vreshtë, kur isha e vogël."
Dhe më hodhe llërën qafës
sikur të doje mbështetje.

De Rada [BN - 1656]

"Kështu ndodh, o moj Harezë:
vajzës që mëngon dhe dielli
i qesh më tepër se dheut.
Vajza që është e papërtuar
rritet në hije të mëmës
e pafjalë e zemërdhembshur,
e pajisur plot me hire.
M'ecën posi një'yll shtëpive,
edhe vashëzat gjithë
e shikojnë, e dëshirojnë
ajo vajzë t'i drejtojnë.
Edhe nuset gjin plot qumësht
atje bashkëshortët duan
barinj t'i kenë a pendarë.
Kur ajo lë derëbabën
gjithë gjithë ngryset
dhe zilepset rreth i dhëndërit
për fatbardhësin që pati." De Rada [BN-1657]

Mbesa jetime, e meruar,
hyn tek e ëmta edhe i thotë:

Mbesa: - Ulu pak, më bëj gërshetën.

Dhe mbesë e ëmtë na ulen
kundrejt shtëpis' së zotrisë.

mbesa sheh kundrejt: prej derës

hynte dielli pranë djepit;

ajo vren pesë thëllëza

që ndën fronet u përpushnin,

edhe më ti bijen lotët

drejt në duart t'ëmtës saj:

Emta: - Ç'pikëllim është ky moj bijë?

Mbesa: - Pikëllim, dhe shumë i madh:

Më fatbardha ato thëllëza,

Që nuk kanë njerjë shtrigë.

Emta: - Vajzë e bij e s'ime motre,

ti kur bën buzën në gaz,

dhe kur flet, dhe kur shtije sytë,

zemër s'ka që s'bën për vete.

Mbesa: - Që të gjitha nuk më vlejnë,

kur s'kam mëmën të më shoh;

dhe njerka shtrigë që kam

natë e ditë më qorton.

Emta: - Mos qaj, ti bija ime,

shpejt vjen koha e më shkon nus,

atje me t'ët shoq fatbardhë

i harron të gjitha helmet.

vajza me një psherëtimë,

t'artën gërshetë e tërhoqi

dhe lotët e saj më fshihu,

pa m'iu llambaritën sytë:

Mbesa: - Po edhe sa do të rroj kështu?

De Rada [BN - 1658]

Çfarë bukurie që kishte!

Ç'hir në sjellje e në zakone!

De Rada [BN - 1659]

"Atje më s'do zgjohem unë

luleve që i përkund era

si suvalë të pasosje.

Do të mblidhen shokët mbrëmjes

në qytet, në vatrë tona.

Unë si njëndërrzë i lë!

Të Milosaut s'ka më." De Rada [BN - 1660]

I hidhur ky zhgënjim.

Si kërkon ta mbys fëminë,

nuk ka parë ajo, jo ende dritë.

E ndjej si më lëviz jo vetëm këtu në trup.

E ndjej të më lëviz edhe në shpirt.

Alqi Boshnjaku [BN - 1661]

Ti po shkon ...

kur ajo vjen ...

Do të ndjekin pas dy sytë e saj.

Sonte nuk qesh dot, nuk mundet dot të qaj,

por ndjej se diçka ta thotë.

Alqi Boshnjaku [BN - 1662]

Sa të besoja

por s'di se si

më dukesh tani...

Më i frikshëm se vdekja.

Se ajo vjen dhe jetën ta rrëmben

e ti e mohon.

Alqi Boshnjaku [BN - 1663]

Besoja se më doje,

a e dëgjon ...

Tani trokiti urrejtja.

Ti s'e meriton këngën e jetës

të foshnjes kur të qajë,

O turp i mohimit të saj!

Alqi Boshnjaku [BN - 1664]

Se me sy do ta shiqoj,

E me gji do t'a pajtoj,

E me dorë do t'a lëmoj.

Shkodër [BN - 1665]

Ike, djal', o bir i nënës,

u nise në drit' të hënës,

more urinë me vete,

kalove male dhe dete,

O nëno, sytë ç'më panë,

vall' a do ta shoh vatanë?

Këtu po shoh lemerinë,

po ha njeriu njerinë.

Përmet [BN - 1666]



Lamtumirë, o ti nanëshkreta,
Që me t'vështira m'rrite kaq,
N'kohë ma t'mirë për ty unë treta,
Kur pleqnia kërkon paq.

Ndre Mjeda [BN - 1667]

O mëma jon' e vërtetë!
të qofshim falë për jetë!
ç'zemërë të bardhë patel!
Të keqen e baltës s'ate!

Naim Frashëri [BN - 1668]

Është gruaja ime e rraskapitur,
në fytyrë po hap pak krem.
Ajo, e bukura e botës,
s'ka forcë të qeshë. Dhe buzëqesh!
Ka mbajtur djalin, ka bërë gjellën,
shkruar ditarin, larë shtëpinë,
ka pritur miqtë, ka larë enët,
ka ndezur zjarrin dhe dashurinë.

Teodor Keko [BN - 1669]

Kur m'i drejton ato bebëza të ndritshme
Ku dashuria shkëlqen e kulluar
Dhe ku burojnë të gjalla e të fuqishme
Gëzimet e kësaj jete të pushuar.

Zef Serembe [BN - 1670]

Në mendjen time i ndiej kupat qiellore
Të ndritura nga shkëlqimi i pavdekshëm
Dhe i harroj krejt dridhjet njerëzore
Në dritën tënde amtare zhytyr etshëm.

Zef Serembe [BN - 1671]

Në zemër rroftë gjithnjë pamja e buzëqeshur
Të asaj fytyrë tërë dashuri
Dhe u shkrofsha ndër bijtë e tu të zgjedhur.

Zef Serembe [BN - 1672]

O nënë, ndjenjat bëmi ti pjellore
Mendje e zemër në dorë m'i merr ti,
Të kam ndjenja plot gaz e thellësi.

Zef Serembe [BN - 1673]

O nënë jam larg,
për ty më djeg një mall.
I varfër jam, ndonëse para unë kam.
Porse s'jam pranë teje.

Alqi Boshnjaku [BN - 1674]

E ndiej, se gjumi më është vrarë.
Në ëndrra shoh unë sytë e tu
dhe klith porsi i marrë.

Alqi Boshnjaku [BN - 1675]

Për herë të parë
panë dritë sytë tanë,
ku çdo gur i rrugicës sime
dhimbje mban.

Alqi Boshnjaku [BN - 1676]

Për herë të parë
panë dritë sytë tanë,
ku dashuria,
ka të bukurat fjalë ...

Alqi Boshnjaku [BN - 1677]

Nesër do shkoj,
Do të dal unë nga kjo portë
Me yllin e bardhë,
Me përcill ti nëna ime
Dhe ma fal,
Lotin e artë,
Të ëmbëlat fjalë...

Pandi Laço [BN - 1678]

Fjala nënë kudo në botë,
Zgjon në zemra dashurinë
Mirmëngjes!- jetës i thonë
Se nëna lind njerinë.
Kjo dorë që tundi djepin,
Gjithë botën lumturon.

Agim Doci [BN - 1679]

Me se rrojnë foshnjat? Ç'i rrit çilimitë?
Dashuri e mëmës dhe përkëdhelitë.

Çajupi [BN - 1680]

“Perëndi, lemë të gjallë,-
Po lutetë mëm’ e mjerë,-
Të mund të rrit këtë djalë,
S’ka një javë që ka lerë.
Kush do ta marrë ta rrijë?
Jetimi që do të rrojë?
Kush do t’i apë të pijë?
Si unë kush do ta dojë?

Çajupi [BN - 1681]

Engjëlli me këto fjalë,
Nga jet’ e rrëme shpëtoi,
La baban’ e zi me djalë
Dhe ndë Qiell fluturoi.

Çajupi [BN - 1682]

Na dha ne t’shkretve vetë perëndija
Mallin m’u pamun, me ndejë n’nji votër
Grueja me t’shoqin, prindën fëmija
E vllau me motër.

Ndre Mjeda [BN - 1683]

O prind, o vllazën! Te’j vorr me jue
E gjall’ e i dekun unë do t’rri;
Sado n’gjuhë teme kan’me m’urue:
“Dritë pastë n’lumni”..

Ndre Mjeda [BN - 1684]

Do të më qash, moj e mjerë,
Se s’piqemi tjetër herë!
Do t’më qajnë dhe të tjerë,
Se këndova dashurinë,
Këndova dhe Trimërinë,
Mëmëdhen’ e Perëndinë.

Çajupi [BN - 1685]

Megjithëse keq të vjen kur ndahesh,
Në rrugë ndjen prap një gëzim:
Kudo të shkosh, kudo të ndalesh

Të presin njerëz në takim ...
Dhe vjen një çast kur kthehesh prapë
Dhe ulesh plot me mall në vatër,
Shtëpia krahët do t’i hapë,
Që ti të rrisi si zog i kaltër.

Dritëro Agolli [BN - 1686]

Nësa ishte e re e me burrë
fëmija i thithën palcën e eshtnave:
tash i bien dhambët një nga një prej goje.
Pavëmendshëm në kalim
ia shtrydhin gjurmën e teshtijnë
të bijtë
për të mos i ndigjojnë vajin.

Martin Camaj [BN - 1687]

Grueja s’e përdori mëngjinë
me ngrehë një kështjellë në det me hala peshku
dhe alga
e me ndejë e ndritun në shkamb ari,
pa të bijtë.

Martin Camaj [BN - 1688]

- Vri tim zot e merëm mua,
o djalë more.
- Nuse me bela nuk dua,
vajzë, moj lule.

Përmet [BN - 1689]

Familja, që lutet së bashku, mbetet tok, fryt i
lutjes është feja, fryt i besimit është dashuria,
fryt i dashurisë është shërbimi i ndërsjelltë ...”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1690]

“Para së gjithash, ne duhet t’i kthehemi të luturit
në familje, sepse pa lutje besimi ynë është i
dobët. Nëse me të vërtetë besojmë dhe lutemi,
ne do të bëjmë jetën tonë të përkushtimshme, do
të japim ndihmesën tonë për paqe. Pa dashuri
nuk do të ketë kurrë paqe.”

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1691]



Ç'ke që vuan, o njeri?
Ç'ke që bret me dhembshuri?
Ç'ke që djek posi qiri?-

Lasgush Poradeci [BN - 1692]

**NDJENJA DHE NJERIU**

Pa e pyet dhe vet' e ti
 Të mosbindurin njeri,
 Dhe për zemrën që j-u thye
 I kërkoj një arësye:
 Ç'ke që vuan, o njeri?
 Ç'ke që bret me dhembshuri?
 Ç'ke që djek posi qiri?-
 ... Veç në djellë- e veç në shi!
 Veç në det me llaftari!
 Gjith të ndjell një mall i ri!
 Mall i ri, - haj! mall i zil...
 Po njeriu ndaj e dëgjonte,
 Hapte gojë-e kuvëndonte-
 Kuvëndonte më të qarë,
 Me zembrim, me shpirt të vrarë:
 Mall'i em, qëllim'i em
 Që qëkur m'u bë ujëm...
 M'u bë fije prej qëmoti,
 Sapo shpirt më fali Zoti,
 Me të parën pikë loti...
 Lot' i parë- ah! lot'i shkretë
 Zu më shket për tatëpjetë
 Sapo Zoti më dha jetë:
 Më dha jetë-e më la vetë...
 Dhe q'ahere vete-e vi,
 Nxihem keq, a shkrepëti,
 Rrah të bje në gji të Ti:
 Po si turrem me vërtik,
 Si rrah Zotin të m'a çik...
 Zot'i em që m'është' armik
 Gjith më çduket... gjith më ik...

Lasgush Poradeci [BN - 1693]

NJERIU DHE ZOTI

Në ty qëndron, po, Zoti – tha zemra shpesh vetiu,
 Më tha me zë të fellë, dhe prapë-u qetësua;
 Dhe prapë që nga gjiri q'u tund e psherëtiu
 Me fshehtësi më foli: Ay qëndron në mua...

Lasgush Poradeci [BN - 1694]

Ahere pata heshtur, e s'kuvendova dot,
 Ahere thelb' i zemrës m'u drodh posi thërrime:
 Sepse në vetëveten të pata ndjerë, o Zot!
 Mjerush të pata ndjerë në vetëveten t'ime!

Lasgush Poradeci [BN - 1695]

A! dyke neveritur gëzim e dhembje pas,
 Me sy të vetëtimshëm e dyshimtar e tinës,
 Kur që nga shkëmb'i vetes qëndrova të sodas
 Sa keq m'j-u patnë hapur të fellat e greminës

Lasgush Poradeci [BN - 1696]

Ndaj fundesh llaftarije ku syr'i em u mvrejt,
 E mënt' e turbulluar askur s'u mund t'i matin:
 T'a pata matur shtatin! T'a pata matur krejt!
 Ndaj fundesh llaftarije! T'a pata matur shtatin!

Lasgush Poradeci [BN - 1697]

O Zot! Po rroj pëndesën e jetës me së nxire:
 Shtërmath në vete t'ënde-më dhe kaq vogëlsi...
 E si m'a ngrite shpirtin nër kulme lartësire –
 Sesa në fund ke zbritur! sesa në fund të ti!...

Lasgush Poradeci [BN - 1698]

Të lus, o Lajmës qielluar!
 O Frym' e Zotit, Vetë Zot!
 Me hirin t'ënd të pashteruar
 Që ka mburim përjetësije,
 Hirplot, o Shpirt, nër gaze Ti-je.
 Dhe nër mjerime je hirplot!

Lasgush Poradeci [BN - 1699]

Ti botës s'onë-i prure lajmin
 E njëndërimi të pafaj:
 Për mallin t'ënd me të pastajmin
 Ti kuvendon që përmi botë,
 Dhe në gëzim i bije lotë,
 I bije gas në zi të saj.

Lasgush Poradeci [BN - 1700]

Kur del mi male yll' i ditës
E shuhet nata prapa ti,
Ti me vështrimin vetëtitës
Çkëlqen në fund të zemrës s'ime
Dh'i bën prej këngës së një grime
Një të përjetshme-harmoni.

Lasgush Poradeci [BN - 1701]

E kur pat humbur jet' e dherit,
Kur syr'i lodhur m'u përgjum,
Në shkëndijim të kandilerit
M'i çfaq ylberin e një rruaze....

Lasgush Poradeci [BN - 1702]

Fatlum, o Shpirt, ti je nër gaze,
Dhe nër mjerime je fatlum!

Lasgush Poradeci [BN - 1703]

Sot hapa sytë që-me-natë
E po këndoje si kurrëkush:
Drejt lartësirës së pamatë
Ah, mëshiro të ngjitë-i-çmuar
Prej gjinit t'im të përvëluar
Fjalim' i mallit t'im mjerush.

Lasgush Poradeci [BN - 1704]

Sbret një yll prej lartësije,
Një të ndritur shkrepëtime-
Posi flakë e posi hije
Ajo ryn në zemër t'ime.

Lasgush Poradeci [BN - 1705]

E kuptoj me shpirt të sosur
Si kullon dale-nga-dale,
Dhe si fjalës së palosur
M'i hap kindën e një pale....

Lasgush Poradeci [BN - 1706]

Kjo ditë lumtërije që nuku ka të ngjarë,
Si hir i perëndishmë në shpirt më pati rarë,
M'u çduknë pikëllimet e vanë sërë-sërë...
Lëkundet nër të fella e dridhet bot' e tërë:
Një yll përjetësie u ndes në shpirtin t'im!...

Lasgush Poradeci [BN - 1707]

- Ju botë! që lëvrijni nër qiej pa pushim!
Përse nuk shuhi fare! po diqni aqe pak!
Përse nuku ndaloni haj! rrutullimin t'uaj!
Të shihnit prej së lartrash, me syrin zemërak,
Në ç'dritë lumtërije çkëlqeu ky dhe i huaj!...

Lasgush Poradeci [BN - 1708]

M'i nxehtë sesa zemra, që djek si flak' e qetë,
M'i ndritur se mendimi që shkrep si vetëtim,
E sesa çdo dëshirë m'i ndritur e m'i nxehtë
Është'yll'i dashurisë që u ndes në shpirtin t'im.

Lasgush Poradeci [BN - 1709]

Marr të rëndët që përdhe.
Marr të fellët nënë dhe.
Po që Lart prej Qënies vetë
Marr e jap përjetësi.

Lasgush Poradeci [BN - 1710]

Flamuri i pastër që m'u nxi
Në sulm të lumtur për liri,
Qëndron gazmor në lartësi!...

Lasgush Poradeci [BN - 1711]

E shpirtin dyke m'a përcjellë,
Më thotë-ah! shih sesa'sht'i fellë
Ky gjir'i em që të pat pjellë...
... Me zjarr ju flas, me zjarr.

Lasgush Poradeci [BN - 1712]



Zot!
... Në botë kaq mjerime,
Kaq një mall i nxirë
Pati mbushur jetën t'ime
Plot me shkretëtirë.

Lasgush Poradeci [BN - 1713]

Ti ndrin në thelb të jetës si dritë-e përvëluar,
O gjuhë-e zemrës s'ime, o mos-e-kuvenduar.

Lasgush Poradeci [BN - 1714]

Kështu rrjeth dyke kënduar
Ëndr'e zemërës së shkrete.
Rrjeth si varg i pambaruar,
Varg i thurrur vdekje-e-jetë,
Jetë-e-vdekje-përqaftuar.

Lasgush Poradeci [BN - 1715]

-Ç'punë bëj e ku kam lerë,
Në kam nënë-e në kam at-
Me kuvëndin e përzjerë
Pate pyetur, shok i ngrat!

Lasgush Poradeci [BN - 1716]

Un' i ziu që s'kisha fatin
Të përgjigjem më një ças,
Pasi von t'a mata shtatin
Kam vendosur të të flas:

Lasgush Poradeci [BN - 1717]

Më pat lindur vend'i Zotit,
E bëj punën e njeriut,
E për prind... – o! pik' e lotit,
Pse më re prej vetvetiut?

Lasgush Poradeci [BN - 1718]

Me kuptim të përvëluar
U pat mbushur shpirti im
Shpirti im q'u pat zembruar,
Shkëndijon si vetëtim.

Lasgush Poradeci [BN - 1719]

Po në qaj e ziej me-vete,
S'dëshpërohem kursesi
Ndaj i ndiej së mjerës jete
Vetëm mall e dashuri.

Lasgush Poradeci [BN - 1720]

Dhe loti tha: Vërteta! më lindi dhëmbj'e zezë,
Dhe dal nga syr'i vuar i zemërës njerzore:
Po kur se ti prej qjellit pikon vetëm përdhezë,
Un'ik nga balt' e rëndë drejt kaltërsish qjellore.

Lasgush Poradeci [BN - 1721]

Edhe duroj durim me lot
Tashi dhe nj'herë,
Mendoj mendim të shentë, o Zot!
Si përgjith-herë.

Lasgush Poradeci [BN - 1722]

Vjen si klithmë zemre
"Mos urre në jetë,
Larg nga ne urrejtje,
të urrej"

Alqi Boshnjaku [BN - 1723]

Çdo ditë që zbardh
unë penën marr,
shkruaj dashuro në shpirt,
se nga dashuria erdhëm në këtë botë dhe ne,
sot e shoh në mjegull, në re.

Alqi Boshnjaku [BN - 1724]

Sot e ndiej të strukur larg
dua t'i bëj strehë.

Alqi Boshnjaku [BN - 1725]

Në sytë e ëndrrës,
ylber i shpresës,
vjen e më zbulon kaltërsinë.

Alqi Boshnjaku [BN - 1726]

Si vjen rrotull Toka
përreth diellit rrezear,
edhe ne rreth mirësisë
të marrim dritë prej saj.

Alqi Boshnjaku [BN - 1727]

Vjen si klithmë zemre,
mos urre në jetë,
larg nga ne urrejtje,
të urrej ...

Alqi Boshnjaku [BN - 1728]

Vjen dëshirë zemre,
dashuro në jetë.

Sa m'u lodh kjo fjalë

ky shpirt ...

Alqi Boshnjaku [BN - 1729]

Nëse një çast
troket nga larg,
një kujtim që thotë:

Urre!

Varkën e harresës
merre ti dhe larg lundro
vala ia nis këngës
harro.

Alqi Boshnjaku [BN - 1730]

Në fund të detit,
gremis urrejtjen,
që as varr mos të ketë
në këtë jetë

Alqi Boshnjaku [BN - 1731]

Në fjalor të zemrës
të mos jetë urrejtja fjalë.

Dua gdhendur të lexoj

Dashuro dhe fal.

Alqi Boshnjaku [BN - 1732]

Dua të më duash
Dua të mos vuash
Një refren i humbur
Që mes njerëzve e kërkoj.
Beso e mos beso
Me gjurmët e vetvetes
na shkoi jeta

Jorgo Papingji [BN - 1733]

Dhe thërras e heshtur
Mbah një frymë të mekur
S'kam një flok të prekur
S'kam një dorë
Që ta shtrëngo
Të rrosh a të mos rrosh
Të kjo dilemë e vjeter
Nisi jeta.

Jorgo Papingji [BN - 1734]

Sa kam dëshirë të pres
Kur ke se kë të presësh
Ke një ëndërr, ke një shpresë.

Jorgo Papingji [BN - 1735]

E dua-
Dhe pres dikë të vij...
Me derën pa trokitur
Të mos mbetet asnjëri.

Jorgo Papingji [BN - 1736]

Ti eja-
Një mik të të trokasë
Të trembi heshtjen time
Veten s'dua ta humbas.

Jorgo Papingji [BN - 1737]

E dua-
Një dorë që ta shtrëngo
Ta mbaj në dorën time
Dhe të them se po jetoj.

Jorgo Papingji [BN - 1738]



Jam nuk jam
Më vetja ime.
Kam nuk kam
Më frymën time.
Ma piu lotin dita
E më bren dhe nata
Ëndërroj botën pa mure
Rikrijoj zërat e tyre.

Pandi Laço [BN - 1739]

Besoj një Zot të vetëm, t'mirë, t'amshuar
Që në çdo shpirt shndrrit pa i ndryshuar
Të përjetshmet ligje të natyrës.

Zef Serembe [BN - 1745]

Imagjinoj çfarë humba dje
E pres pa fund, eja me merr!
Qaj e qesh, këndoj vallëzoj
E gënjehem dhe marrosem.
Të vërtetat s'i ndryshoj
Pa dua të jetoj.

Pandi Laço [BN - 1740]

Kur të lidh grumbull bar e trëndafila,
Të shmang dëshirat e padenja e t'kota,
Nga shpresa e gjallë rrëmbyer, nga mëshira
Do t'i besohem fatit që ka bota.

Zef Serembe [BN - 1747]

Qaj e qesh, këndoj, vallëzoj
E trishtohem e brengosem
Të vërtetat s'i besoj
E prapë jetoj.

Pandi Laço [BN - 1741]

E në krahët e Perëndisë, plot dashuri,
I lirë nga çdo lak e çdo litar,
Do të ringjall gëzimet përsëri
Që ndër duna të errta kam shpërndarë.

Zef Serembe [BN - 1748]

Jam unë erë e lirë
E t'i marr botës
Pakëz qiell
Jam një pemë e çmendur
Dhe në dimër do të çel.

Pandi Laço [BN - 1742]

Kujtimi im në dhe ardhhtë plot mall
Atyre që i desha si aromë
Pranvere gasplote në një serë
Ose prej melodiye të jetë jehonë
Që ndihet tok me puhinë e një mbrëmje
Dhe dashuri e lutje të ringjallë.

Zef Serembe [BN - 1749]

Ti më merr
Ti nga këto mure eja më merr
Në veten time mos më ler.

Pandi Laço [BN - 1743]

As madhështia, as zilia shpirtin tim
S'arritën që ta bëjnë fajtor në jetë,
Po gjithnjë pa djallëzi e plot besim
Në vepra t'shenjta ai rronte i qetë.

Zef Serembe [BN - 1750]

Jam era e lirë.
Jam
Mos më ler
Ti në këto mure mos më ler
Brenda vehtes ti më merr.
Eja më merr, mos më ler....

Pandi Laço [BN - 1744]

Dhe nëse tash unë s'kam më asnjë gëzim
Dhe, i brengosur, shpreh dhimbjen nga jeta,
Kurr's'do të ankohem prej Atdheut tim.

Zef Serembe [BN - 1751]

Lëviz, o Zot, kah unë ktheji sytë,
se mirë e njoh un' zemrën tënde t'butë;
pa mjete jam, jetoj i rrezikuar,
e ti ma jep një ndihmë n'kët' trishtim.

Zef Serembe [BN - 1752]

Kur do ta kesh kaluar ti mërgimin
në kët' luginë plot shpirtligësi,
dhe Zoti do t'pranojë pors i bir
n'fronin e gazit e të dashurisë.

Zef Serembe [BN - 1753]

Mëshira është ajo që bën pjellor
të shenjtat dashuri, e çdokujt rrugën
ia sqaron si shtegtarit rrezja e Diellit.
Ajo ia çel madje rrugën qiellore
dhe kujt jetoj n'fatkeq' si i zhytur,
se është bijë e Qiellit që i shenjtëron t'gjithë.

Zef Serembe [BN - 1754]

Mandej me fjalën që e dallon të urtin
jepi trajtë të artë, përbuz trupin
që pa pranga të çelë e Mira prore.

Zef Serembe [BN - 1755]

... dhe ndiej se jetë e re
po lind këtu pranë meje.

Pashko Vasa [BN - 1756]

Në zemrën time gaze e helme rrinë.
Inati m'zë, po shpejt e kapërcej,
Pak rri me shokë, dua qetësinë
Dhe me shumë ëndrra kohën e gënjej.

Zef Serembe [BN - 1757]

Mllef i më ndez e dua në vend të vë
Të vërtetën që e flakën mu në baltë

Zef Serembe [BN - 1758]

Do t'ndreqja botën ... Po s'kam shpresë për këtë
Dhe lotët lumë më rrjedhin nëpër faqe.

Zef Serembe [BN - 1759]

Gjuhën me miqtë e kam si kumborë
Rrallë jam idhnak, më shumë kam butësi
Megjithëse dëshëroj beteja shumë.

Zef Serembe [BN - 1760]

Të gjithë i fal. Të lëshuar kam dorë
Sidoqë s'kam e s'jam në varfëri.
Më njomet thellë zemra pors i brumë.

Zef Serembe [BN - 1761]

Helmi më lodh. Shkon mendja fluturim
Sipër yjeve të qiellit dhe shikon
Atë shenjë paqeje që të jep shërim.

Zef Serembe [BN - 1762]

Që të ngrihesh aq lart ç'bregë e ç'mund
E m'afrohet një dritë që më gëzon
Dhe e kuptoj se fati ynë s'ka fund.

Zef Serembe [BN - 1763]

qyqja ti, zemra ime, korba,
dil e prit krushq të zinj, dil e prit te porta,
prit korbat shaluar mbi dhoga,
po vij në, mishi im, të t'i hanë sytë e zinj,
sytë e zinj, zemra ime, sytë e zinj
e ti të mos e shohësh atë nënë që qan në lëmë,
jeta ime,
e ti të mos e shohësh atë motër që qan në kodër,
jeta ime,
e ti të mos e shohësh atë grua që qan në krua,
jeta ime,
Kaloje atë urë,
kaloje atë urë të mallkuar, shpresa ime

Xhevahir Spahiu [BN - 1764]



Që ditën kur kurmin ma veshi
si rrobë dhe m'u ngul në ashtnor,
ky shpirt m'i kalli gjithë pengjet
e fatit të lashtë njerëzor.

Agron Tufa [BN - 1765]

Nga pasione të bukura, njerëzore
lindin dhe rilindin miliona dashuri.

Bardhyl Londo [BN - 1766]

Kur tue iu ngjitur malit t'jetës njeri
siellet mbrapa për t'parën her't'a shofi
udhën e bame, a shenj se nis m'u plakun.
Un, or mik, qi te kripi i zi një fije
të bardh' s'e gjej, qysh tash kam zanë e siellem...
Edhe n't'siellun fytyrën m'a fladisin
puhi t'ambila qi m'bijn' një am'prendverash
t'afërme n'mot, por t'largta ndër kujtime
mbassi qi 'i det kraijatash m'dau prej tyne.
Ky flad prendvere prej kah m'vjen? ...

Ernest Koliqi [BN - 1767]

Këngë, jetë, dritë, hapësirë,
Brohori jehonash plot kumbim!
Ëndërrat e shpirtrave të dliurë
Kaltërojnë qiellin pa mbarim!

Jorgo Bllaci [BN - 1768]

Po je ti Shpirt i këngës, që vjen fluturim
Nga hapsirat pa anë e mbarim
Edhe shkrihesh me tingujt, me rrezet e ngjyrat,
Me çdo bukuri që u shfaq syve tanë natyra,
Je ti që na sjell ëmbëlsi, dashuri
Dhe dëshira dhe vrulle të reja, pas vverit,
Që mendjen dhe shpirtin s'i lë të fundosen
në det të misterit,
Po flatra të forta, që s'thyhen nga vrull' i stuhisë,
Fshehtas u sjell,
Dhe i ngjit nëpër qiejt pa fund të gjenisë!

Jorgo Bllaci [BN - 1769]

Shpirt, a demon i përbindshëm, s'po pyes kush je,
Po rrëmbemë këndeje nga të errëtat shpella
Dhe ngjitmë me gaz e hare
Kaltërsive të thella,
Ku ti,

Përmbi valët e kohrave endesh në pafundësi!
Ah, s'di ku zvarritem kështu kuturu ...

Jorgo Bllaci [BN - 1770]

Mistere të panumërta në kokë
M'u mblodhën e s'po di se nga t'ia mbaj;
S'më mbetet veçse me të ftohtën tokë
Morinë e të fshehtave ta ndaj.

Jorgo Bllaci [BN - 1771]

Nis e kujtoj e të hidhurit lot,
Nuk gjej forca në shpirt t'i përmbaj ...
Si s'e kam një të afërm në botë,
Që me të gjithë dertet t'i ndaj!

Jorgo Bllaci [BN - 1772]

Oh, sa dridhem, pa dashur gjith' jeta
Më fanitet plot dallgë e stuhi! ...
Dhe çuditëm me veten, si mbeta
Kaq i brishtë në shpirt, kaq fëmi!

Jorgo Bllaci [BN - 1773]

Unë ngjaj me bredhat, por, në dimër,
Tek mbi supe borën pres i heshtur,
Mendja më rri larg te një qershezë,
Që acar' i ngrirë e gjen të zhveshur ...

Jorgo Bllaci [BN - 1774]

Askënd nuk e kujtoj për keq në botë, -
Në zemrën time shteg të mbyllur s'ka;
Mjafton një fjalë e çiltër, fjalë e ngrohtë,
Që të më bësh prap mik e prap vëlla.

Jorgo Bllaci [BN - 1775]

Ato çka shkrova,
s'i fshi më dot.
Atje ku eca,
gjurmë lashë.
Ato që në jetë s'i bëra dot,
ëndrrave i pashë.

Dritan Zaimi [BN - 1776]

Shumë gjëra mbetën pa u thënë,
shumë gjëra mbetën pa u bërë,
shumë ëndrra mbetën në shtegëtim,
shumë dëshira s'njohën kurrë plotësim.

Dritan Zaimi [BN - 1778]

Dhe aspak nuk ndjej në jetoj,
kam dalë jashtë vetes, jashtë trupit tim.
Shpirtlakuriq, unë bredh nëpër botë
i pastrehë, i zhveshur, në trup veç kërcëllim.

Dritan Zaimi [BN - 1779]

I thashë lamtumirën fëmijërisë
dhe symbylltazi duart ia zgjata
rinisë.

Një dorë e zezë duart më shtrëngoi
dhe një buzëqeshje e moçme sytë
m'i verboi.

Pleqëria qëndronte në krahët e mi.
Ç'ishte vallë kjo anomali?!

Dritan Zaimi [BN - 1780]

Kështu shpresa u venit,
tashti unë eci i hutuar në të,
sepse duhet të eci.

Dritan Zaimi [BN - 1781]

Në vend ne dot s'qëndrojmë,
ditët tek njëra-tjetra na çojnë.
Ne duhet të ecim,
kjo është detyra jonë.

Dritan Zaimi [BN - 1782]

Në shpella gjoksesh njerëzorë
strukur rri ëndërrimi.
Nga jashtë mbuluar
me petkun e së përditshmes,
ndërsa në gji zien qëllimi.

Dritan Zaimi [BN - 1783]

Rebele e moskokëçarëse
ajo s'njeh kufi.
Ecën në absurde kohësh,
mushkëritë mbushur me liri.

Dritan Zaimi [BN - 1784]

Por, kur i mjerë e i hidhur, e i velë
ndërsa është me këtë jetë,
veç ëndrra e tij i vjen pranë, i zgjon etje,
ia njohmë buzët me shërbet.

Dritan Zaimi [BN - 1785]

Te portat e parajsës ka mbërrirë,
Mbase troket atje dhe pret,
Premtimin e ëndrrave të hershme,
Të rinisë së vet!

Timo Flloko [BN - 1786]

Zemra jote, det i dashurisë,
Jeta jote falur për të pashpresë.
Hyj i vetëmohimit, muzë e mirësisë,
Madhështi e thjeshtë ...

Timo Flloko [BN - 1787]

Të shoh atje, me sytë e besimit,
Si vjen këtë natë mes rrezesh,
Shpirtrat tanë t'i paqtosh,
Shpresë t'u sjellësh njerëzve.

Timo Flloko [BN - 1788]

Çdokush vjen fillikat në jetë,
Jeton një herë, pastaj vjen prehja ...
Më tremb më shumë se gjithçka në botë
Humbja e vetë shpresës, jo vdekja!

Timo Flloko [BN - 1789]



Fjala jote më shpuri, Zot, atje,
Në limane paqeje ku urrejtje s'ka,
Në oaze hyjnore, ku mëshira,
Më kuptim në botë ka se gjithçka!

Timo Flloko [BN - 1790]

Unë do të mbjell jo pemë, po parqe,
paçka se gjoksin kam plot trishtim.
Edhe në qaj,
me lot pemët që mbolla
do t'i vadis!

Teodor Keko [BN - 1797]

Nga rëniet dhe pësimet në jetë,
Më të çmuarin kuptim ma dhe Ti,
Shpresën mos ta humb në durim,
"Fuqinë të përsos në dobësi ...!"

Timo Flloko [BN - 1791]

E i mekur pyeta lotin,
rash' në gjunj' e pyeta Zotin

Ali Asllani [BN - 1798]

Lusim, Atë, një fat më të mirë,
Na i shkri ëndrrat ngurosur në erë,
Kjo dritë që digjet është gjaku yt,
Dashuria, fryma Jote eterne ...

Timo Flloko [BN - 1792]

Mos i pyet zogjtë në pyje
Ku kam qenë e ku s'kam qenë
Gjurmë më gjurmë do le ca yje,
Të më gjesh kudo, moj nënë.

Hysni Milloshi [BN - 1799]

Rreh zemra jonë te zemra e tokës mëmë,
çdo rrahje e saj e bukur sa tingëllon,
o, sa ëndrra në gji na zgjon.

Arben Duka [BN - 1800]

Ai kish dashurinë
dhe një zemër të mirë,
dhe kaq, besoj, mjafton
ta ndiesh veten të dëlirë.

Teodor Keko [BN - 1793]

Nga dhimbja e djeshme jo nuk hidhërohem
Dhe nuk kam, jo, nostalgji
Për çfarë kaloi në jetën time
Gëzimit që shkoi nuk i gëzohem
se ikën në harresë
të kthehet jo nuk pres

Alqi Boshnjaku [BN - 1801]

Po bota jeton. Jeton njeriu.
Me dhembje, dhe më i lumtur.
Unë dua të jetoj.

Teodor Keko [BN - 1794]

Të sotmen shijo,
Të ardhmen kërko.

Alqi Boshnjaku [BN - 1802]

Qielet dhe qiell i kaltër, i pamasë,
syrin e trembin kufijtë.

Teodor Keko [BN - 1795]

Nëse në jetë, unë di të bëj veç mirë,
atë e bëj, se ndihem mirë edhe vetë.

Alqi Boshnjaku [BN - 1803]

Do vdesin disa në këtë udhë
të gjatë, po jo pa mbarim.
Drejt jetës shtegtofsa gjithmonë edhe unë,
dhe si zog le të vdes në udhëtim.

Teodor Keko [BN - 1796]

Nëse unë kurrë s'kam dashur të bëj keq,
nuk dua jetën të ma bëjnë harram.

Alqi Boshnjaku [BN - 1804]

Hipokrizia le të vejë në dreq,
unë mëkatin frikë e kam.

Alqi Boshnjaku [BN - 1805]

“Zog, yll, qiell, dritë
zoti na la të lirë të duam
e t’i vemë emra dashurisë.”

Natasha Bega [BN - 1806]

Në do që për gjithë jetën
Asnjë prej teje mos vuaj,
Mirësinë dhe të vërtetën
Në tabelë të zemrës shkruaj.

Arben Duka [BN - 1807]

Tani ti do të ikësh qiejve.
Por ende fluturimi yt rrin në duart e mia.
Mos i harro duart e mija!
Në një çerdhe të tillë njerëzore s’ke për t’u
prehur kurrë.

Frederik Rreshpja [BN - 1808]

Se unë e di, s’jam pemë e fortë
e shumta mund të jem një frutë
kam lindur për të qenë kafshata juaj,
kam lindur e butë.

Rudina Madani [BN - 1809]

Tokësore jam, baltore, shkëmbore
prej njeri-kafshës bërë
lehonë dhe vejushë,
lehonë: kur më gjenden agime dhe miq,
vejushë: kur më vdesin a m’i merr dikush.

Rudina Madani [BN - 1810]

Sepse mendoj se shpirti i vvarë
do t’i ngjitet rruzullit si sëmundje fryme,
s’do të rrjedhë më ujë, por vetëm lot paskëtaj,
s’do të mbijnë më pemë, por vetëm gulçime.

Preç Zogaj [BN - 1811]

Së fundi, dashuria është ajo që del tepër,
Ajo do t’u bëhet kurban zakoneve,
detyrave, nevojave, hyjve të vegjël.

Preç Zogaj [BN - 1812]

Po thosha:
“A vlen
të përsëris jetën
siç përsëris ngrënien, rënien apo zgjimin ...?”
Mijëra vjet më duhen
të pikas ndryshimin.

Preç Zogaj [BN - 1813]

Tani fundi të vijë kur të dojë.
Unë jam përtej tij
në këtë jetë.

Preç Zogaj [BN - 1814]

Çfarë do ta bëja një jetë tjetër
po të ma linte në derë fati?
Çastet e mia shkrepën,
kureshtja ime kaloi.

Preç Zogaj [BN - 1815]

Fjalë mirësije
shqiptari të qenë,
që shpirtrat të na ndihen
sikur një të jenë.

Kujtim Stana [BN - 1816]

Dhe vërtetë vdiq, në mes të ditës me diell
në funeralin e saj erdhën të gjithë të njohurit:
Gënjeshtria, Hipokrizia, Epshi, Interesi,
Burracakëria
të veshur që të gjithë
me rroba zie.

Luljeta Leshanaku [BN - 1817]



Harroj përse, e si, e nga kam ardhë.
Harroj të flas, të lëviz. Harroj pa parë
e ndër gërmadha bëhem një copë gërmadhë,
një gur mbi gur që gurit s'don të ndarë.

Azem Shkreli [BN - 1818]

Në asnjë dorë të botës nuk më zë gjumi.
Isha mësuar me kokën në duart e tua.
E ke ditur që kam diçka nga deti;
Breg me breg dhe gjumi s'më zë.

Frederik Rreshpja [BN - 1819]

Dua të shtrihem dhe të vdes
Por vjen ti edhe nga balta më ngre:
Kur male të tërë dot s'na ndanë,
Si do na ndajnë dy grushta dhe?

Frederik Rreshpja [BN - 1820]

Ah, isha mësuar në duart e tua;
Tani edhe brigjet më gjumi nuk i zë.

Frederik Rreshpja [BN - 1821]

O ajër i mbrëmbjes mbështillmë, erdhi ora
të vdes përsëri.

Frederik Rreshpja [BN - 1822]

Në do që për gjithë jetën
Asnjë prej teje mos vuaj,
Mirësinë dhe të vërtetën
Në tabelë të zemrës shkruaj.

Arben Duka [BN - 1823]

Të kam shok nga koh' e vjetër
Shok prej zemre-edhe prej gjaku...
Shok të ri me besë plaku
Nuku kam, nuku ke tjetër.

Lasgush Poradeci [BN - 1824]

Se ç'do gas e mall të shkretë
M'i ke thënë-emër me emër,
Unë-i mbylla mun në zemër
Gjer sa zemra të mos jetë.

Lasgush Poradeci [BN - 1825]

Se ti mban në kraharuar
Shentërinë-e një dhurate:
Mban në fund të zemrës s'ate
Ç'të kam thënë-i llaftaruar.

Lasgush Poradeci [BN - 1826]

Ish e bardhë-e nuku kishte
Dredhëri zemra bujare:
Bënte botën zilitare
Zemr'e bukur shokërishte.

Lasgush Poradeci [BN - 1827]

Si zogjt' e shqipes kur fluturojnë,
Për her' të parë lart në qiell
dhe shqipja nënë me krahë të fortë,
flut'rimin bashk' me bij' ajo merr
Pranvera erdhi dalëngadalë,
dhe lule çeli pem' e liris',
flut'rimin morën shqipe të reja,
me ju o këngë zjarr të rinisë. [BN - 1828]





Q'atë ditë që zemrën në kraharorin tim
e ndjeva duke rrahur për herë të parë,
n'mendje krijova t'bukur e fisnike
një figurë femre e atë unë dashurova.
Nuk do të dija t'them se cila ishte,
di vetëm se n'këtë tokë ajo nuk rronte.

Pashko Vasa [BN - 1829]



Shpirt, zemër, zgjuarsi:
çdo gjë te ti shkëlqen,
po s'ndjeve dashuri,
pse, vallë, feja të vlen?

Pashko Vasa [BN - 1830]



Mbreti rrij me mbretëreshën
me një dashuri të zjartë,
dh'e vështronte pëllumbeshën
q'ishte posi moll' e artë.
Ra në dett të bukurisë,
mëndjenë vala ja mori,
ju afrua Perëndisë,
se vala atje e nxori.

Naim Frashëri [BN - 1831]

Shumë herë bukuria
e ngre njerinë përpjetë,
e shpije te Perëndija,
i rrëfen Zotn' e vërtetë.

Naim Frashëri [BN - 1832]

Mëndja kishte fluturuar
me krahë të lehtë shumë,
Skënderbeu ish qetuar
as xgjuar' ish as në gjumë.

Naim Frashëri [BN - 1833]

Nëpër mest të gjithësisë
duke ikurë si lumë,
pa dritën' e Perëndisë,
drit' e madh' e shumë' e shumë!

Naim Frashëri [BN - 1834]

Bukurin' e Perëndisë,
që ndrin soje gjithësisja,
Perëndin' e gjithësisë,
q'është vetë bukurija.

Naim Frashëri [BN - 1835]

Bukuri pa funt, pa anë
dhe për jetë e pashuar,
brënda në të gjithë ç'janë
dhe soje kanë buruar.
Duke parë këtë dritë
mëndij' e thell' e shumë' e xgjuar,
fare faqez' atë ditë,
pa kurrë s'i ish mërguar,
gjeti burimn' e vërtetë,
që del soje gjithësisja,

dhe gjithësisja 'shtë vetë,
vetë fjeshtë Perëndija.

Naim Frashëri [BN - 1836]

“O Bukurija pa anë!
o burim' i mirësisë!
gjithë ty të kemi pranë!
je afërë njerëzisë”.

Naim Frashëri [BN - 1837]

Ti, që n'atë vel të brishtë
flakë ëngjëllore t'ndrin,
drejtoi sytë në qiell,
foli për dashurinë.

Pashko Vasa [BN - 1838]

Kështu ato ndjenja të larta
të dashurisë s'kulluar,
ëndërrat që i do vetë shpirti,
n'zemër kanë për të qëndruar;
si një ide mirëbërëse
do rrosh gjithmonë pranë meje.
Psherëtima e një të mërguari
gjithmonë do t'vij drejt teje.

Pashko Vasa [BN - 1839]

Tashti je nuse! Po, ndryshe je,
po ai shpirt i bukur nuk ka ndryshuar,
buzëqeshja e ëmbël, që n'gjak e ke,
në buzën e bukur prapë ka qëndruar.

Pashko Vasa [BN - 1840]

Kështu kushdo që ty të kundron
kujton se ende gëzon virgjërinë,
dhe kënga ime, që ti e frymëzon,
dëshmon se n'shpirt ruan bardhësinë.

Pashko Vasa [BN - 1841]

Shpreso! Nëse ai i pafajshmi,
ai prilli i rinisë sate,
filloi me ngashërime
që padrejtësisht ti i pate,

do t'përfundojë n'gëzime
t'hyjnore dashuri,
që fuqimisht jetë t're
gjithë shekujve u dikton;
njeriun, që e ndien dhe e do,
e fal edhe e bekon.

Pashko Vasa [BN - 1842]

E bukur, po, është toka, ku u përkunda,
të hijshme kodra e fusha e ai bregdet
dhe dielli i bukur shumë, por mbi të gjitha
këto bukuri, që mbledh natyra e arti,
i bukur m'ngjau virtyti që stolis
zemrën e femrës, pamja e s'cilës është
pasqyrë e dashurisë, që rrjedh nga qielli.

Pashko Vasa [BN - 1843]

Dhe ti je e tillë, sa qielli t'ka dalluar
me veti t'veta e këtu t'ka sjellë
si shenjë t'mëshirës s'vet për t'përtëritur
paktin e asaj marrëdhënie të amshuar,
të fshehtë, që pati lidhur mes dheut dhe qiellit.

Pashko Vasa [BN - 1844]

Andaj unë, duke i fshirë pak çaste lotët,
po e prek përsëri telin e ndjeshëm t'zembrës,
n'kërkesë t'një harmonie aq bujare
sa t'përngajë ty e t'flasë e të tregojë
nderimin që ti i fal seksit të hijshëm.

Pashko Vasa [BN - 1845]

T'falem fisnike! Që t'i pyesim yjet,
hije nuk ka në kët' epokën tonë,
por nga orakulli i lustreve të shuar
provohet jeta, fatet dhe dëmet,
se yjet s'janë përveçse bijt e qiellit,
që s'mendojnë tjetër, veç të vallëzojnë hareshëm,
kurse ato të tjerat kuje e gjëmë të thella
koha i gëlltiti e përfunduan n'asgjë.

Pashko Vasa [BN - 1846]

Ne q'një shekull më fisnik e t'urtë
ndjekim një rrymë, medet, tepër të vrullshme
edhe ngremë sytë edhe krenarë sodisim
në rritje qytetërimin, ne që s'ngopim
ndërgjegjen tonë me fjalë të rënda e boshe
pa shije e pa kuptim, ne që me t'madhe
thërresim n'mbrojtje tonë emrin e shenjtë
t'lirisë s'mendimit ashtu edhe të kultit;
ne nga shenja t'tjera më të vërteta
e gjykojmë jetën.

Pashko Vasa [BN - 1847]

Tepër deri sot
të prapët shpërdoruan besimin tonë.
Mjaft më. E drejta e arsyeja ulur n'fron
duhet të diktojë ligje; kush nuk u bindet
armik është me njeriun, e do t'ndëshkohet.

Pashko Vasa [BN - 1848]

Në rast se qielli na lejon në tokë
shpirtra të bardha, të ngjashme krejt me ty,
është shenjë se dhe njeriu s'ka dalë krejt baltë
as fare i ulët prej duarve t'naturës,
por mban në gji të ndezur atë shkëndijë,
që, duke dalë nga Hyu, vjen e përhapet
nëpër gjithë rruzullin edhe pa u parë
shpërndan ndikimet nëpër t'brishtën lëndë.

Pashko Vasa [BN - 1849]

Këto janë ..., dhe asgjë tjetër
përgjigjet e s'vërtetës. Vetë natyra
të dha një bukuri aq të kulluar:
një dashuri qiellore t'ndrin ndër sy,
fjalën e paqes ke aty te buza;
mirëpo veti më t'ndritshme e më të larta
sesa ato të brishtat e fytyrës
dhe që si xhevahire, gdhendë n'visar,
shkëlqejnë krenare dhe për këngën time
bëhen subjekt e shenjë, janë mendja e zemra.

Pashko Vasa [BN - 1850]



Njërën ta dha ty qielli krejt të pastër
si një buzëqeshje engjëjsh, që i gëzon
të gjithë të lumturit n'selinë e tyre
edhe e kënaq Krijuesin për atë vepër;
tjetrën ta dha të zgjuar e të stolisur
me ide fisnike e me studime t'zgjedhura:
andaj nga zotërimi i dy vetive
lidhur me hallkë prej ndjenjash, të shpërthen
afsh dashurie i tillë, që n'tokë shënon
ndjenjën e parë, se Hyu fill prej asgjëje
nxori në dritë kaq e kaq gjëra t' bukura.

Pashko Vasa [BN - 1851]

Oh, lum si ti dhe lum si ai, të cilit
buzëqeshja jote i hap në tokë visar
të gjerë haresh qiellore! Por një shpresë
të tillë s'mund ta ushqejë ai që s'e ka
dhoratën e viryeteve të larta
as ai i cili endet poshtë e lart,
sikurse unë nëpër krahina t'huaja,
për t'i harruar t'zezat hidhërime.

Pashko Vasa [BN - 1852]

Ti model hiri, me tërë atë butësi,
gjithë zemrave ua ke çelësin në dorë
dhe lumenj dije t'ëmbël përtej mjalitit
kullon, po, buza jote, po e lëvize;
si lirë e harmonishme, që e kënaq
dhe e bën të lumtur krejt selinë e qiellit
duket ai zëri yt, që është një mjeshtër
bisedash të larmishme dhe të rralla;
ti shembull bardhësie, ti e sjellshme,
vajzat e pastra t'gjitha i bind të t'ndjekin.

Pashko Vasa [BN - 1853]

Ç'të them më tepër? Ty asgjë s't'mungon,
dhe mund të thuhet se një shpirt qiellor
i tillë siç është yti arrin t'nderojë
dhe deri tokën përveç seksit t'vet.

Pashko Vasa [BN - 1854]

Megjithatë, kur fati t'më dëbojë
larg teje e n'mendjen time t'më kujtohet
ai zëri yt aq shumë i dëshiruar
dhe i qarë me lot, që si një vesë e prita
kushdi sa herë bash brenda kësaj zemre,
t'paktën kujtoje atë që t'admiron
dhe që gjithmonë për ty ka për t'i folur
qiellit e dheut e n'qoftë se vjen një ditë
që për atë ti merr një lajm të zi,
atherë dhe ti, duke treguar mëshirë,
për fatkeqësitë, oh, falja një psherëtimë! ...

Pashko Vasa [BN - 1855]

Nsa nga mendimi i lehtë
t'gjithave zemra u vuan,
ti me atë shpirt të qetë
helm dashurinë e quan.

Pashko Vasa [BN - 1856]

Q'atë ditë që zemrën në kraharorin tim
e ndjeva duke rrahur për herë të parë,
n'mendje krijova t'bukur e fisnike
një figurë femre e atë unë dashurova.
Nuk do të dija t'them se cila ishte,
di vetëm se n'këtë tokë ajo nuk rronte.

Pashko Vasa [BN - 1857]

Oh, si s'dallonin mirë këta sytë e mi,
kur fluturim ti endeshe gjithnjë
n'viset qiellore e kur buzëqeshjen tënde
gjithmonë ti e përzierje me buzëqeshjen
e Iridës hyjnore dhe gjithnjë
vallëzimin tënd fisnik bukur e thurje
me valle t'yjeve e gjithnjë më thoshe
në gjuhën tënde t'ëmbël: Ah jo, jo,
mos u dëshpëro, jeto edhe shpreso.
Dhe unë jetova, sepse zëri yt
për mua që urdhër edhe pata shpresë
së fundi t'zbrisje n'tokë dhe të m'i fshije
me dorë të trëndafiltë lotët e mi.

Pashko Vasa [BN - 1858]

Duke psherëtirë, t'kërkoj veç një vështrim,
një buzëqeshje, 'i fjalë plot ëmbëlsi,
po s'deshe, s'kam asgjë në zotërim:
Jetën s'e dua as tjetër ndjesi,
se përmbi tokë s'shoh tjetër pasurim
veç zemrës sate t'largë mbi çdo veti.

Pashko Vasa [BN - 1859]

Të dija gjuhët e gjithë botës
E të mos ndieja dashuri
Do të isha si një gur i heshtur
Këmbanë, harruar në vetmi.

Enrieta Sina [BN - 1860]

Të gjithë pasurinë e ndaja,
Në botë të mos kishte, jo , varfëri.

Enrieta Sina [BN - 1861]

Të jepja trupin tim të digjej
E le të bëhesha hi.

Enrieta Sina [BN - 1862]

Se ëndrra e shpresa
Pa dashuri janë vetëm iluzion.

Enrieta Sina [BN - 1863]

Ndaj dua, o njeri,
Të fal pak dashuri.
Pa te çfarë është kjo botë,
A e kupton?

Enrieta Sina [BN - 1864]

Se lumi do të shteronte,
E deti do thahej krejt,
Dielli rrezon s'do ta dhuronte
Pa dashurinë:
Çfarë është kjo jetë?

Enrieta Sina [BN - 1865]

Se loti që pikon,
Në zemër rëndon,
I vogël na duket,
I madh sa një glob.

Enrieta Sina [BN - 1866]

O botë, e di ç'të mundon
Se ka njerëz sot, që duan vetëm lot.
S'e njohin dashurinë
S'e njohin mirësinë.

Enrieta Sina [BN - 1867]

Dashuria, ëndrra, shpresa
Kë të zgjidhja nga të trija,
Dhe një natë lotin pyeta
M'u përgjigj: dashuria.

Enrieta Sina [BN - 1868]

"Sot bota është përplot barëra për sëmundje të
ndryshme, por ajo që mungon është dashuria"

Gonxhe Bojaxhiu [BN - 1869]

Ai që dashurinë shiti
dhe një grua zgjodhi për karrierë,
për shpërdorim të postit njerëzor akuzohet
nga ne dhe brezat e tjerë.

Bardhyl Londo [BN - 1870]

Ai që me llogaritë meskine
njollosoi të pastrën dashuri,
për fytyrje të njeriut akuzohet
nga ne dhe nga brezat që vijnë.

Bardhyl Londo [BN - 1871]

Do të vdisnja me shumë gas,
Të paskështa pakë shpresë,
Se do të thuash ti më pas:
Vdiq, për mua, pastë ndjesë!

Naim Frashëri [BN - 1872]

Shëko lisi si më flet,
Fjalë t'ëmbra si më ushton,
Degët unj e më thërret:
Dashuro, se koha shkon!

Asdreni [BN - 1873]



Maj' e plepit gjithënjë,
Kur tunt kryet më qërton,
Përpjek fletët më çon zë,
Djalë ç'pret e s'dashuron!

Asdreni [BN - 1874]

Er' e malit me një ushtim
Dhe burimi që kullon,
Gjith më thonë plot gëzim:
Dashuro, se koha shkon!

Asdreni [BN - 1875]

Kopshti vasha që po pret,
Si zog pylli që këndon,
Buzëqeshur më thërret,
Djalë ç'pret e s'dashuron!

Asdreni [BN - 1876]

Mua zëmra gjith më rreh
Brenda gjaku më valon,
Ma ndes mallin më vë re:
Dashuro, se koha shkon.

Asdreni [BN - 1877]

Çdo gjë rrotull më pyet:
Djalë ç'pret e s'dashuron,
Ditët shkojnë, jeta shket,
Dashuro, se koha shkon!

Asdreni [BN - 1878]

Edhe brenda strehës ftohtët,
kur në gji të trimit ndrit
flakë e dlirtë e dashurisë,
as shigjetë, as edhe e zezë,
në një gjoks të dashuruar
nuk zhduk dot jetën e re!

De Rada [BN - 1879]

Isha në valle, ti erdhe i murrëtuar;
më shtyre sytë e jeta m'u errësua.

Keq të mos vijë, o diell, në kjo re e mjerë
Dhe para teje llamburit një herë.

De Rada [BN - 1880]

Çohu zemrë, shteri lotët,
Bjeri tingullit ledhatar,
Se gjësendi s'vlejnë motet,
Sa vlen çasti magjistar.

Asdreni [BN - 1881]

Di të shtrëngoje një dorë që zgjatet.
Dorën ma zgjat veç zbrazëtia.

Një ndjellamirë
nuk ia lë shtrirë.

Një dorë e shtrirë drejt zbrazëtisë
si të mos zgjatet drejt dashurisë?

Xhevahir Spahiu [BN - 1882]

Dhe mbetën të dy mbi barin me brymë,
Toka e madhe nën ta merrte frymë ...

Dritëro Agolli [BN - 1883]

Kuj ka m'i a folun goja e pamësue
fjalët ma t'para qi dhuron dashnija
kur befas shpërthen n'shpirit me hov hyjnuer?

Ernest Koliqi [BN - 1884]

O mik i shtrenjtë! Shkuan kaqë vjetë,
Po ty nga shpirti dhembja nuk t'u nda;
S'të qeshi buza, qysh nga ditë e shkretë
Kur një syzezë iku dhe të la.

Po pse, i dashur, vitet që na shkuan
Me brengë t'i kujtojmë e me mërzi,
Kur ne me gjithë zemër ia kushtuam
Çdo hov rinor së dlirës bukuri?

Në vitet tona, s'duhet ta gënjejmë
Me lotë shpirtin, se s'ia vlen, vëlla,
Që dashurinë e vogël ta shpërblejmë,
Kështu si ti, me dhembje të mëdha!

Jorgo Bllaci [BN - 1885]

Vajz'e valëve
Zëmëra s'ia mban,
mbi një gurë, anës detit,
qan e zeza, qan,
e mjera, qan e zeza, qan.

Pret atë që pret,
dhe një dhëmbje ndjen,
gjithë bota ven' e vinë,
po ai nuk vjen,
e mjera, po ai nuk vjen.
Pranvera arriu
një mëngjes të qetë,
shkojn' e vinë dallandishet,
vajza u thërret,
e mjera, vajza u thërret:

- Ju të bukur, zoq,
tek ju kam një shpresë,
ju që shkoni det' e male,
dua t'iu pijes,
e mjera, dua t'iu pijes:
Mos e patë ju,
rron apo nuk rron,
ndonjë lajm, ndonjë letër,
vallë, më kujton,
e mjera, vallë më kujton?!
Një jetime jam,
pa nën' e baba,
një që kisha, një që doja,
iku dhe më la,
e mjera, iku dhe më la.
N'ëndërr seç pa,
djalin në vapor,
sikur shkoj dhe i hodhi
vajzës një kurorë.

Letrazeza vjen
dhe, me të vërtetë,
djali kishte udhëtuar
pa kthime për jetë,
e mjera, pa kthime për jetë.

“Vajz'e valave,
- thosh, i mjeri djalë, -,
mere këtë letër e qamë,
tjetër vend më pret,
e mjera, tjetër vend më pret.”

Na u ndamë këtu,
qielli atje lartë,
do të na bashkoj', o djalë,
prit se vij për pak,
e mjera, prit se vij për pak.

Lamtumir', o gurë,
mbeçi me shëndet,
vuajte dhe ti me mua,
mERM', o val' e det,
e mjera, mERM', o val' e det.

Himarë [BN - 1886]

Këmbëzbathur ullinjëtë,
brigjeve vetmojnë,
Asnjë fjalë, asnjë lajm,
veç zogj që vijnë e shkojnë.
Vajzë e valëve qe prët...

Xhevahir Spahiu [BN - 1887]

Ku je , ku je, o ëndërr e mërguar,
Malli po prët dhe loti u tret...
Eja me diellin, eja,
Eja dhe përpije detin,
Mere botën, falma qiellin.

Xhevahir Spahiu [BN - 1888]

Dashuria, tungjatjeta,
midis çiftit të selitur
dhe me besën ton' të situr,
është e ëmbël shumë e shkreta,
është gosti nga qielli zbritur!

Ali Asllani [BN - 1889]



E këndoi Adami Evën, e këndoi dhe bleta lulen
dhe poetët – besnik’ qielli – vajzave në gjunj’ iu
ulën,
zogu zogën, fladi fletën, vala valën e vijoj ...
Lër’ ta kapi, ler ‘ta puthi, ler ta pi e ta shijoj!

Ali Asllani [BN - 1890]

Këtij urdhri kaq të ëmbël i paudhi s’iu përkul,
dhe në tru të fanatizmës ngrehu fronin e u ngul;
duke folur me fjal’feje përmes gojës së një
murgu!
na ka bër’ kuben e qiellit si tavanin e një burgu!

Ali Asllani [BN - 1891]

Çdo të bardh’ e bën të zezë, çdo të zezë, më të
zezë,
na i plasi sy e zemra po sa nisën e u ndezë;
e na bëri sa i flakëm gjith’ hyjnit e bukurisë
e u çmendëm tej përtje, i bëm luftë dashurisë!

Ali Asllani [BN - 1892]

“Sakën vajzën mos e puth, sakën verën mos e pi!
Bota jonë qënka burg, këtu s’paska prokopi”.
Kur të vdesëm e pastaja poezija që na thuri –
shtatëdhjet’ e dy mij vajza qënka pjesa e një
burri!

Ali Asllani [BN - 1893]

Kupa, çupa, kënga, qeji çdo dëfrim është’ gjynah!
uj’ i ftohtë ësh’ hallall, vajz’ e ngrohtë është
haram!
Që të kemi gjith’ parajset me ferman e me tapi,
vajzën kur mos e puth edhe verën mos e pi!

Ali Asllani [BN - 1894]

Me të tilla thashetheme,
shkoj e vajti koh’ e rremel!
Po tani që zbrazet kupa me shëndet e me dolli
dhe në mes të dy gjithëtrinjve thyhet vajza
meskali;
lumthi ju mor shok’ e shoqe, tani jeta është’ e juaj,
nga këto gostira lulesh tetëdhjet’bukshi është’ i
huaj,

Ali Asllani [BN - 1895]

Emri tija bosh një emër
shih me sy e plas me zemër!

Ali Asllani [BN - 1896]

E ç’t’ju them, o shokë
ç’është dashuria,
ajo është mjaltë, moj,
vetë Perëndia.

Labe [BN - 1897]

Mos u mërzit, more djalë,
janë ethe dashurie,
me to do ecur ngadalë,
po nxitove shi se bie.

Polifonia labe [BN - 1898]

Jam burimi e shtoj lumin,
jam ëndrra e prish gjumin.

Polifonia labe [BN - 1899]

Rinia jetën zbukuron
për ty shkëlqejnë yjet me aq zjarr
Më përqafo i dashur, me pasion,
pushtomë ti me afshin djaloshar.

Dionis Bubani [BN - 1900]

Kjo moshë e bardhë, mosha e rinisë,
Ditët i çel në gji të lumturisë.

Arben Duka [BN - 1901]

Ku shkuan fjalët që m'i thoshje me aq zjarr,
 Ku shkuan lulet që m'i sillje plot me vesë
 Ku fluturoi dashuria jonë e parë,
 Ku shkoi motivi që më zgjonte çdo mëngjes?

Jorgo Papingji [BN - 1902]

Një këngë e vetme jo nuk është rinia
 Por veç një dhimbje kam e do ta them,
 Dhe një prej këngëve është dhe dashuria
 Dhe këngë e saj ushton si një refren.

Jorgo Papingji [BN - 1903]

Jo nuk e besoj nuk është e lehtë që ta mohoj
 Kurrë dashurinë e parë, jo nuk e harroj.

Jorgo Papingji [BN - 1904]

Dashurinë e parë kush nuk e provoi
 Dhimbjen që la pas kush nuk e këndoi.

Jorgo Papingji [BN - 1905]

Më së fundi i dhash'lotin, kryepajën time pajë,
 i dhash' lotët që pikonin ku i shkelte këmbë e saj.

Ali Asllani [BN - 1906]

Ndaj hoqa rëndë-ashtu,
 Gjer në greminë,
 Llaftarën që më zu
 Për dashurinë;

Lasgush Poradeci [BN - 1907]

Për dashurinë-o Zot,
 Që shemb një burrë,
 Që s'e pat ndjerë dot
 Gruaja kurrë;

Lasgush Poradeci [BN - 1908]

Që lind e ndritur krejt,
 Bukuriplote!
 Me dritën drejt-për-drejt
 Nga drita jote!

Lasgush Poradeci [BN - 1909]

Që qesh e qan e zjen,
 E s'jep të qetë,
 E zjen e bren e shfren,
 E s'vdes përjetë.

Lasgush Poradeci [BN - 1910]

Dashurinë e parë dhurova,
 Për të njohur një njeri.

Jorgo Papingji [BN - 1911]

Me puthje gënjeshtare
 Ma mësove dashurinë
 E pastër isha fare
 E nuk e njihja pabesinë.

Jorgo Papingji [BN - 1912]

Por ja që nisi era
 Ranë fletët një nga një
 Jeta ëndrra s'ka ngahera
 Ka dhe lot e tradhëti.

Jorgo Papingji [BN - 1913]

Veten time e lëndova,
 E plagosa në rini,
 Por pranvera sërish do vijë
 Do më sjellë tjetër dashuri.

Jorgo Papingji [BN - 1914]

O dashuri, sekret i moshës
 Që na rinon,
 Ti papritur vjen
 Dhe krejt papritur si era shkon.

Jorgo Papingji [BN - 1915]

O eja, eja, eja dashuri,
 Eja, eja përsëri
 Merrma dhimbjen time
 E më ndiz një zjarr të ri.

Jorgo Papingji [BN - 1916]

Kur vjen në shpirt një dashuri
 Sa e çuditshme të duket vetja
 E ndjehesh krejt tjetër njeri
 E sa e shtrenjt' të duket jeta.

Agim Doci [BN - 1917]



Fjet bri votrës; e kur shkëndija
Shdritte at fëtyrë të patravajë,
Ejll prej qiellit ulë te shpija
Dukej faret fëtyra e sajë.

Ndre Mjeda [BN - 1918]

Herë n'at gjumë tuj qeshun dukej,
Si m'u falë herë dorën çote;
Herë përmallshëm n'vedi strukej
E n'fytyrë gjaku t'tanë i vëloje.

Ndre Mjeda [BN - 1919]

Bashkë me lule len dashtnia,
Me kangë t'shpendit që galdon;
E prendverës bukuria
Bashkë prej gjumit t'tanë i zgjon.

Ndre Mjeda [BN - 1920]

Del, o bijë, prej shpijës sate,
Del prej t'vorfënit katund;
Njajo flakë që n'zemër pate
Do t'përcjellin tjetërkund.

Ndre Mjeda [BN - 1921]

T'pret një zemër flakë e shkëndija,
Pret me tanden m'u ba një;
Sa jetë t'apin Perëndia
Mos m'u damun kurr prej 'si.

Ndre Mjeda [BN - 1922]

Të lutem, o perëndi,
për një simfoni –
plot dashuni
të nxehtë si te vasha gjithë
kur vlojnë ndijesitë.

Migjeni [BN - 1923]

Dashuria është një rrjetë
Që e thur vetë Zoti.
Një ditë në rrjetë do mbetesh,
Mos u fshi kot së koti!

Arben Duka [BN - 1924]

Rini, thueja kangës ma të bukur që di!
Thueja kangës sate që të vlon në gji.
Nxirre gëzimin tand, të shpërthejë me vrull ...
Mos e freno kangën! Le të marri udhë.

Migjeni [BN - 1925]

Thueja kangës, rini, pash syt e tu ...
Të rroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu
me zjarrm tand rini ... Dhe të na mbysi dallga
prej ndjenjash të shkumbzume q'i turbullon
kanga.

Migjeni [BN - 1926]

Rini, thueja kangës dhe qeshu si fëmi!
Kumbimi i zanit të përplaset për qiellë
dhe të kthejë prap te na – se hyjt ta kanë zili
e na të duem fort si duem një diell.

Migjeni [BN - 1927]

Thueja kangës, Rini! Thuaja kangës gëzimplotë!
Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote.

Migjeni [BN - 1928]

CEREMONIA MARTESORE

Faltorja Shqiptare ofron edhe shërbimin e ceremonisë së fejesës apo të martesës për bujarët e Faltores.

Njerëzit e të dy të fejuarve apo të martuarve marrin pjesë në ceremoni.

Gjatë kohës së ndërrimit të unazave që secili nga bashkëshortët ia vendos partnerit, bujar i ngarkuar i faltores thotë këto lutje:

Hapja:

Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qoft' i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Falna, Zot, i math ne njerëzinë,
Edhe të mirat' e dashurinë,
Vëllazërinë, zemrën' e qëruar,
Mëndjenë pa faj, shpirt të uruar,
Bëna të drejtë në këtë jetë,
T'urt'e të mirë dhe të vërtetë. (Naim Frashëri)

Pas ndërrimit të unazave, të dashuruarit thonë:

Dhëndëri:

Mëshirë o Zot, mos ki për mua
Në s'jam i ndershëm të rroj nuk dua. (Pano Taçi)

Nusja:

Mëshirë o Zot, mos ki për mua
Në s'jam e ndershme të rroj nuk dua. (Pano Taçi)

Të dy bashkë:

Falna Zot' i math! uratë,
Të mos bijem në mëkatë!
Me vëllazëri të shkojmë,
Jetënë ta trashëgojmë.
Nga çdo mënxyrë shpëtona,
Udhën e drejtë tregona.
Mos na lërë kurrë shkretë!
Zot i math e i vërtetë! (Naim Frashëri)

Vijon Bujari i Faltores:

Dhe t'imtë, të pastër si n'ag vere vesojnë
Të valët lot rrjedhin qetë, me mall,
Që betimin për Ty prore e madhërojnë
Për të madhin blatim që tani u shpall.

(Gonxhe Bojaxhiu)

Fëmijë nga dy familjet recitojnë (ose këndojnë):

O ju, o krushqit tanë,
krushqia na qoftë e mbarë,
bukë e ëmbël e pandarë,
dalçi me faqe të bardhë! (Sarandë)

Bujari i Madh qeras çiftin dhe u dhuron lutjen e Profetit Naim Frashëri në një kornizë të bukur lejla që brenda ka lutjen e Naimit dhe foton e tij.

Zot' i math e i vërtetë!
emri yt qoft' i lëvduar,
të qofshim falë për jetë,
mos qofshim teje mërguar
Falna, Zot, i math ne njerëzinë,
Edhe të mirat' e dashurinë,
Vëllazërinë, zemrën' e qëruar,
Mëndjenë pa faj, shpirt të uruar,
Bëna të drejtë në këtë jetë,
T'urt'e të mirë dhe të vërtetë.



Lerini gjithë të vinë
Të vegjëlthitë ndaj meje
Se edhe vetë Perëndinë
Ndër ata donja ta gjeje,

Naim Frashëri [BN - 1929]



Do mundohem që fëmijët të mos shohin varfëri
e të rriten të gëzuar, me shëndet e lumturi.

Mitrush Kuteli [BN - 1930]



Lerini gjithë të vinë
Të vegjëlhithë ndaj meje
Se edhe vetë Perëndinë
Ndër ata donja ta gjeje,

Naim Frashëri [BN - 1931]

Janë ëngjëj të vërtetë,
Xbriturë nga Perëndija,
Posi luletë në jetë,
Q'u ngjajnë nga miturija,

Naim Frashëri [BN - 1932]

Ah! mos i bëni të qajnë,
Kurrë të mos mallëngjehen,
Syt' unjur të mos i mbajnë,
Dhe të meken' e të ndehen;

Naim Frashëri [BN - 1933]

Po të qeshin të nxitojnë,
Të bredhin' e të gëzohen,
Të prëhen' e të këndojnë,
E kurrë të mos mejtohen,

Naim Frashëri [BN - 1934]

Më vjen keq t'u mardhnjë dora,
E faqeza bukuroshe,
Kur bij' e shkreta dëborë,
Dhe këmbëza vogëloshe.

Naim Frashëri [BN - 1935]

O foshnjazët' e uruar!
U kam mall' e dashurinë,
Më k'ënda t'u mbanj nër duar,
U dua si Perëndinë.

Naim Frashëri [BN - 1936]

Zot'i math e i vërtetë!
N'atë sy kurrë mos shtjerë
Lotn' e hidhur e të shkretë,
Dhe mos e lërë të bjerë,

Naim Frashëri [BN - 1937]

Po falu në buzët gazë,
Dhe në sythit bukurinë,
E rriti cazë-nga-cazë,
Duke dhënë urtësinë;

Naim Frashëri [BN - 1938]

Epu jetëzën' e gjatë,
Edhe mos i lerë kurrë
Pa mëmëzë e pa atë,
Dhe në breng e të sëmurë,

Naim Frashëri [BN - 1939]

S'munt t'i shoh të mallëngjyer,
A të varfër' e të mjerë!
Dhe të grisur' e të çqyer!
Kurrë, kurrë mos i lerë!

Naim Frashëri [BN - 1940]

Falu gjithë mirësitë,
Të rrojnë me nder në jetë,
Të mësojnë dituritë,
Të bëhenë të vërtetë;

Naim Frashëri [BN - 1941]

Të nderojnë mëmëdhenë,
Vjeftënë t'ia lartësojnë,
Mbi gjithë botët t'a ngrenë,
Si lule t'a zbukurojnë.

Naim Frashëri [BN - 1942]

Ditën e Shëngjergjit, më njëzet e tri,
se ç'u doq dhe Frashëri,
Digjeni të shkretin dhe e bëni hi;
u doq, u shkretua për këtë Shqipri
dhe foshnjat qajnë lajthi më lajthi.

Frashër, Përmet [BN - 1943]

E kandshme asht hana
Kur del me zana,
E n'tokë me dritë përndaret.
Hyjzit që shndrisin
E që shëtisin
Npër qiell, janë t'bukur faret.
Kur del agimi
E rruzullimi
Me 'j dritë kuqloshe mbëlohet,
E përmbi kashta
Shndrit pika lashta,
Zemra me mall gazmohet.
Asht i madh shendi,
Kur ndihet shpendi
Ndër pyje tuj pingrue;
E knaqshme a'j lule
Kur ju përkule,
O flad i let, me e lmue.
Por s'i giet qielli,
Nuk i giet prilli
As flad që shëtit lulet
E me erna veshet,
Foshnjës që i qeshet,
Nanës kur mbi të përkulet.

Ndre Mjeda [BN - 1944]

“Perëndi, lemë të gjallë,-
Po lutetë mëm' e mjerë,-
Të mund të rrit këtë djalë,
S'ka një javë që ka lerë.
Kush do ta marrë ta rrijë?
Jetimi që do të rrojë?
Kush do t'i apë të pijë?
Si unë kush do ta dojë?

Çajupi [BN - 1945]

Engjëlli me këto fjalë,
Nga jet' e rrëme shpëtoi,
La baban' e zi me djalë
Dhe ndë Qiell fluturoi.

Çajupi [BN - 1946]

NDERA E FËMIJËVE PËR MJESHTRA

Te ju, që lodheni me ne gjith' ditën,
Kjo mende e vorfën, kjo zemër shkon;
E sa t'kem shpirtin, sa t'shofim dritën
Dashtnin' e nderen gja s'na pakon.

Ndre Mjeda [BN - 1947]

Nji bim' e vogël, lanun n'shkreti,
E pamir'rritet, pa fuqi t'vet;
Por me e lmue dora e bulkut t'ri,
Sa lule t'bukura e shuemja qet!

Ndre Mjeda [BN - 1948]

Na jena t'vorfën ... si me e pague
Kët' far'kujdesit, gjith'kët' trazim?
Por kena 'j zemër; ani, kët' ju,
O mjeshtra t'dashtun, ju falim shqim.

Ndre Mjeda [BN - 1949]

Ju cen' ndër këndime, ju ndigjes' doni,
Kët' nder' për t'mira lypni peshqesh.
E na mbas këndimesh, mbas punësh, që mësoni
Do t'shkojmë', si zemra ju don prej nesh.

Ndre Mjeda [BN - 1950]

MOS THUEJ RRENA

Mos thuej rrena kurr, o fëmi,
E gjithmonë t'i kesh në mëni.
Nji ndëshkim a fort ma mirë
Se rrenacak ndokush me t'thirrë.

Ndre Mjeda [BN - 1951]

Mos t'shkojë mendja se me rrena
Fajin tand e fsheh përbrenda;
S'vonon dita, gja s'e ndal,
E n'fushë rrena ka me dalë.

Ndre Mjeda [BN - 1952]

Por veç marrja ka me t'mbetë
E kund besë nuk ke për t'gjetë.
Edhe t'drejtën n'qoftë se thue,
Për rrenacak kanë me t'kujtue.

Ndre Mjeda [BN - 1953]



MOS I BJE SHOQIT

Po pse me dorë katile
Un'shokut due me i ra?
O zemër, pse iu çile
Nji mnis' që s'don m'u da?

Ndre Mjeda [BN - 1954]

E krahit tem fuqia
A kështu do t'përdorohet,
E forca kambve t'mia
Me shqelma do t'turpnohet?

Ndre Mjeda [BN - 1955]

A thue jam shtazë me brina?
Po shpirti a thue m'ka ikë,
Që n'kët sahat un'mbrina
Shokun t'mendoj m'e fikë?

Ndre Mjeda [BN - 1956]

DASHTNIA NDAJ PRINDES

Me sy çilun afër djepit,
Me kujdes e me dashtni,
Për vaj tem tuj hjekun zi,
Tuj shendue kur m'shifshi n'shend.

Ndre Mjeda [BN - 1957]

Bab' e nan' sa kemi derdhë
Mbi shteg tem e hire e dritë.
Ah! Sa mirë m'keni gatitë
Për çdo kohë' e për çdo vend.

Ndre Mjeda [BN - 1958]

Ju ma ndezt' nji flakë në zemër
Për pun' t'nalta e për lumni;
Për ju, pra, o prindt e mi,
Mend e zemër më lakmon.

Ndre Mjeda [BN - 1959]

NDERONI PLEQTË

Vesh' me t'arta e zhele t'shkreta
Nderen plaku e meriton;
Dhun' e kore, po, i shkoft' jeta
Faqeziut që s'e nderon.

Ndre Mjeda [BN - 1960]

MËSONI

Librat rrinë radhë-radhë,
Presin dorën që t'i marrë,
Presin dorën t'i shfletojë,
presin syrin t'i lexojë.
Sa përralla rrinë aty;
eja t'i këndojmë të dy!
Sa figura, sa tregime,
duan të hyjnë në botën time.
Librat rrinë krah për krah;
cili radhën sonte ka?
Thotë i pari: merrmë mua;
siç më do dhe unë të dua.
Flet i dyti poshtë në xham:
po unë radhën kur e kam?
Librat rrinë radhë-radhë,
presin dorën që t'i marrë ...

Xhevahir Spahiu [BN - 1961]

Firmojnë për paqe fëmijët,
Po hedhin të parënë firmë.
Ngadalë shtrëngojn' gishtërinjtë,
Ngadalë marrin frymë.
Do rriten ata e në jetë
Shum firma do hedhin më vonë.
Por ndoshta kjo firmë do mbetet
M'e bukura për gjithmonë.

Imail Kadare [BN - 1962]

NDERONI TË RËNËT

O nipa!
Në kohën e ardhëshme kur
Të bridhni në pyjet me fletë
Kujtoni ata që na ranë dikur
Kujtoni, o nipa, për jetë!

Imail Kadare [BN - 1963]

DASHURIA E BABAIT

Fli, o shpirti i mamit.
E di pse sonte qan.
Ke lodra, çokollata,
por babin s'e ke pranë.

Alqi Boshnjaku [BN - 1964]

Mbylli syçkat zemër,
kujto ti sytë e tij.
Në ëndërr puthe pak
në mëngjes të vijë ai.

Alqi Boshnjaku [BN - 1965]

I MBETUNI
Për dhe t'vet tuj dal n'ushtri
Rrebtë qëndroi i ati e diq;
Sot i vorfni askund një shpi,
Nji copë buk' s'e gjen ndër miq.

Babai pinte ditën dhe natën bënte sherr me
nënë,
vogëlushi lemerisej, dënesë kishte këngën,
kruspullosur në kuvertë dridhej nëpër lot
derisa vinte gjumi i madh e shpëtimplot.
Një ditë babai s'piu. Qetësi e madhe ra,
vogëlushi deri vonë iu përkëdhel në krah,
i lumtur s'desh të flinte, "O ba, nuk kam gjumë
fare!",
po ba-ja e çoi hopa në shtratin nën dritare.
Vogëlushi qeshte vetëm në errësirë me zë,
kjo mbrëmje ish dhe lodër dhe përrallë për atë.

Teodor Keko [BN - 1966]

Ndre Mjeda [BN - 1969]

Ah! Ti njome, o njome e mjera,
Dit' e natë që po vajton;
Kund ndër miq nuk t'çilet dera,
Kurrkush vajin s'ta pajton.

Ndre Mjeda [BN - 1970]

Dit' e natë pa bukë e shpi
Shkote i vorfni andej e këndej,
E prej t'pasunish zotni
Nji fjalë t'mirë kurrkush s'ia kthej.

Ndre Mjeda [BN - 1971]

Mirëpo ai zot që botën kish ujdishur,
e njohu n'fytyrë të vet atë Bukuri
dhe pa se n'tokë një engjëll kishte nisur.
F.B – mik i Pashko Vasës [BN - 1967]

Ku ke babën me t'ndihmue?
Ku ke nanën me derdh lot?
Ty gjith'robi t'ka harrue,
Kurrkush s'do me t'dalun zot.

LYPËSI I VOGËL

Dhe – dje lyps i vogël,
por sot diçka tjetër –
si ahmarrës i vjetër,
një fjalë të randë mendonte
botës t'ia dedikonte ...
Fytin e gërdhishte
fjalën për me nxjerrun
që mnia e kish shterun
dhe që në gjuhë vdiste ...
Por i hutuem, mbet ndejun
në kryqzimin e udhve.
Rrotat e autve
shpejt mbi te kaluen
dhe e ... qetsuen.

Migjeni [BN - 1968]

Ndre Mjeda [BN - 1972]

Tuj ra borë, tuj fry murrhani,
Mjet dy vorreve si 'j lis,
Afër gropës që vet e bani
Djali i vorfën u molis.

Ndre Mjeda [BN - 1973]

Afër nanës u shtrua fjetun,
Afër babës kërkoi pushim;
Kurrqja t'ngritin s'ka me e gjetun,
T'nxet; e t'ftohtë s'kan' me pasë ndrrim.

Ndre Mjeda [BN - 1974]



Dhe m'u duk n'ëndërr, m'tha: "Hidh një vështrim,
o atë, sa e bukur jam, edhe shikoi
trëndafilat: stoli e ballit tim
t'përvuajtur. Falndero atë që shkroi
kaq bukurira n'vargje" dhe n'largim
ballin e vet mbi buzën time afroi!
Pashko Vasa [BN - 1975]

Por m'kapi mue idhnimi. M'u ndye frota
e njerzve qi han mirë e veshen mirë
e për t'mjeruem s'ndien mshirë;
mniva vetveten q'ishem si gjith bota,
m'erdh turp për gjell'qi m'pritte n'shpin e ime,
për zjarrmin ngushullues qi m'digjej n'votër ...
E, tuj e vrue at motër
arbnore e at foshnje, u rrmbeva vrik n'mendime.
Ernest Koliqi [BN - 1976]

- Ndoshta n'gjakun fisnik q'i rreh te delli
ky fmi kroje ndiesish vigane ruen,
dikur ndoshta tash bluen
shllime t'thella ndër tru qi lypa kndelli.
Ernest Koliqi [BN - 1977]

Unshëm, zhelan po i dijshëm n'shkoll'tash rritet,
msheftas tu'ushqye në zemër t'vet një ide;
e befas n'gji koh't're
mbi turm't'paemen me ball t'rir tash ngritet,
Ernest Koliqi [BN - 1978]

e, tue njoftë un q'i vueti rrugash nana,
vajin qi ia përkundi djepin n'baltë,
tash pref' menden e naltë
me lypë dritë e drejtsi për fiset t'tana
Ernest Koliqi [BN - 1979]

qi n'mal banojnë. E psimin n'mosh'fminiye,
marres e s'amës lypse ndër qytete,
tue përkujtue n'vetete,
ai s'ka me i shndrruemun në shestime mniye,
por rritun shtatit m'copa ri prej lotit,

nji buk'lumnije e lavdi tash orvatet
me nxjerr' nga moti e fatet
për vllazën qi zben uja n'dhe t'Kastrjotit.
Ernest Koliqi [BN - 1980]

O nanë, o nanë e re, pinjolle mali
irnue prej skamit e prej acarimit,
qindroj, qindroj mjerimit:
mos u deshpro der sa t'rritet djali.
Ernest Koliqi [BN - 1981]

Shtrije dorën pa turp ndër kalimtarë,
lyp për at foshnje e ushqaje e n'shkolla msoje,
pse ndoshta ai do t'largoje
namën qi n'male shpraz' djepat shqiptarë.
Ernest Koliqi [BN - 1982]

Mos ua prishni ëndërrat!
Janë të vegjël shumë.
Mos lëndoni nënat
Syrin e pagjumë!
Agim Doci [BN - 1983]

Foshnja fle, qepallat mbyllur.
Ëndrra e tij bredh lëndinave të blerta,
mbushur plot hapësirë për të ardhmen.
Dritan Zaimi [BN - 1984]

PËRRALLËTARJA

S'do që s'do të bjerë qepalla,
s'më zë gjumi pa përralla;
pa arush, ujk e të tjerë
s'mbyllet syri që të flerë.
Xhevahir Spahiu [BN - 1985]

Asnjë zë s'ndihet në dhomë:
-Mami, mami, hë, tregomë!
Një përrallë për zonjën dhelpër,
po s'desh dhelpëra, për një ketër.
Xhevahir Spahiu [BN - 1986]

- Kafshët, -thotë,- dhe fik dritën –
porsa panë gjahtarët, ikën...

Xhevahir Spahiu [BN - 1987]

- O moj mami, përralltare,
Çdo përrallë një dritare.
Ti kallzon, kallzon kaq bukur,
Në çdo fjalë rri një flutur.

Xhevahir Spahiu [BN - 1988]

Në çdo fjalë trokon kali,
vret e pret kuçedrën djali;
del qerosi mendjemprehtë
bukuroshen e merr vetë.

Xhevahir Spahiu [BN - 1989]

Ja, qepalla zë e ulet,
mami thotë diçka për lulet.
Mijëra lule, buzë një lumi...
Mua, trak më zuri gjumi.

Xhevahir Spahiu [BN - 1990]

BALADA E ZOGUT TË VOGËL TË DALLËNDYSHES
Sa e bukur është toka, sa i ndritur është dielli,
porse zogut të uritur sterrë e pus i duket qielli.

Mitrush Kuteli [BN - 1991]

Ku më është nëna ime? A mos vallë më harroi?
Nuk e di se jam i mitur, krahë s'kam të fluturoj?"

Mitrush Kuteli [BN - 1992]

Ku ta dinte zogu i mitur, se në çastin kur mbaroi,
zemra e nënës ditëzezë porsi gjëmë utroi.
Jo për veten, po për foshnjën, që e linte pas
jetim
rrahu zemra e saj e djegur si buçim që
vrungullin.

Mitrush Kuteli [BN - 1993]

Erdhi nata, shkrepën yjtë, edhe prapë u bë
mëngjes.
"Do të vdes! – tha zogu i vogël – Po pa rrojtur
qysh të vdes?"

Mitrush Kuteli [BN - 1994]

Jeta është kaq e ëmbël, bota plot me bukuri,
dhe në bar, në lule e drurë gjenden kaqë
ëmbëlsi ...

Mitrush Kuteli [BN - 1995]

Ah, sikur të dal në botë, nënën time të kërkoj!
Të hap krahët ... Po s'kam pendë e nuk mund të
fluturoj!

Mitrush Kuteli [BN - 1996]

Po kështu, siç jam, do nisem: nënës do t'i vete
pas,
të më sjellë rishtas në jetë, të më japë rishtas
gas!"

Mitrush Kuteli [BN - 1997]

Si ato që hiqen zvarrë dhe ato që fluturojnë,
si ato që çajnë ujrat – nënën kurrë s'e harrojnë.

Mitrush Kuteli [BN - 1998]

"Po tani? – pyeti zogu – Ç'do të bëj unë tani?"
"Do të bësh siç bëjnë të gjithë: do të nxjerrësh
zogj dhe ti!"

Mitrush Kuteli [BN - 1999]

Unë e di, moj shoqe fqinjë: vogëloshi do ushqim,
jam i rrahur nga e zeza, se kam qenë e jam
jetim.

Mitrush Kuteli [BN - 2000]

Do mundohem që fëmijët të mos shohin varfëri
e të rriten të gëzuar, me shëndet e lumturi.

Mitrush Kuteli [BN - 2001]

Ja, kështu vazhdon kjo jetë, dit për ditë e ças
për ças:
ka mjerime, dëshpërime – po na ka dhe jetë e
gaz.

Mitrush Kuteli [BN - 2002]



CEREMONIA E LINDJES

Lindja e fëmijës është një gëzim familjar, por duhet të jetë e tillë edhe për të tërë komunitetin e bujarëve shqiptarë. Fëmijët e komunitetit mblidhen në faltore për t'i uruar mirëseardhjen. Në këtë çast vijnë familjarët për t'u treguar shokun apo shoqen e tyre të re dhe festojnë së bashku. Kjo vendoset në një ditë të përshtatshme pasi fëmija njih prindërit e tij.

Njëri nga fëmijët thotë fjalët e Naimit.

Lerini gjithë të vinë
Të vegjëlhithë ndaj meje
Se edhe vetë Perëndinë
Ndër ata donja ta gjeje, (Naim Frashëri)

Të tjerët vazhdojnë Lutja e radhës që realizohet nga të gjithë duke e ndarë në strofa:

Janë ëngjëj të vërtetë,
Xbriturë nga Perëndija,
Posi luletë në jetë,
Q'u ngjajnë nga miturija, (Naim Frashëri)

Ah! mos i bëni të qajnë,
Kurrë të mos mallëngjehen,
Syt' unjur të mos i mbajnë,
Dhe të meken' e të ndehen; (Naim Frashëri)

Po të qeshin të nxitojnë,
Të bredhin' e të gëzohen,
Të prëhen' e të këndojnë,
E kurrë të mos mejtohen, (Naim Frashëri)

Më vjen keq t'u mardhnjë dora,
E faqeza bukuroshe,
Kur bij' e shkreta dëborë,
Dhe këmbëza vogëloshe. (Naim Frashëri)

O foshnjazët' e uruar!
U kam mall' e dashurinë,
Më k'ënda t'u mbanj nër duar,
U dua si Perëndinë. (Naim Frashëri)

Zot'i math e i vërtetë!
N'atë sy kurrë mos shtjerë
Lotn' e hidhur e të shkretë,
Dhe mos e lërë të bjerë, (Naim Frashëri)

Po falu në buzët gazë,
Dhe në sythit bukurinë,
E rriti cazë-nga-cazë,
Duke dhënë urtësinë; (Naim Frashëri)

Epu jetëzën' e gjatë,
Edhe mos i lerë kurrë
Pa mëmëzë e pa atë,
Dhe në breng e të sëmurë, (Naim Frashëri)

S'munt t'i shoh të mallëngjyer,
A të varfër' e të mjerë!
Dhe të grisur' e të çqyer!
Kurrë, kurrë mos i lerë! (Naim Frashëri)

Falu gjithë mirësitë,
Të rrojnë me nder në jetë,
Të mësojnë dituritë,
Të bëhenë të vërtetë; (Naim Frashëri)

Të nderojnë mëmëdhenë,
Vjeftënë t'ia lartësojnë,
Mbi gjithë botët t'a ngrenë,
Si lule t'a zbukurojnë. (Naim Frashëri)

Prindërit e fëmijës ëmbëlsojnë fëmijët.
Vijon festa në mënyra të ndryshme.



.. Pse t'ka ruejtun fati
t'njomë edhe virgjin? Egërsija e jote
mos mban n'at gji, q'i hueji nuk peçati,
stinën e fundme t'poezis s'ksaj bote?

Ernest Koliqi [BN - 2003]

Faltore shqiptare,
Faltore bujare,
Faltore me besë,
Faltore për shpresë.

Artur Shkurti [BN - 2004]



FALTORJA SHQIPTARE

STATUTI

Neni 1 [BN - 2005]

Përkufizimi i Faltoreve Shqiptare

Gjithë ç’jemi shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Mëmë kemi Shqipërinë
Edhe besë Perëndinë. (Naim Frashëri)

a. Kuptimi *i parë* i termit FALTORE SHQIPTARE është bashkësia e të tërë Bujarëve Shqiptarë kudo në botë që besojnë në Zot dhe që praktikojnë “Besën”.

Besojmë se Perëndija
është vetë gjithësija
fletore kemi njerinë,
dhe mendjen’ e urtësinë
sepo udh’e Perëndisë
s’është jashtë urtësisë. (Naim Frashëri)

b. Kuptimi *i dytë* i termit FALTORE SHQIPTARE ka të bëjë me një bashkësi bujarësh shqiptarë që formojnë një njësi vepruese dhe përfaqësojnë një subjekt juridik të njohur nga shteti dhe me pavarësi për të vepruar.

c. Kuptimi *i tretë* i termit FALTORE SHQIPTARE ka të është vetë ndërtesa ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre bujarët shqiptarë.

Sipas kontekstit, ose me citim të këtij neni, do të kuptohet me cilin kuptim të termit kemi të bëjmë.

Neni 2 [BN - 2006]

Përkufizimi i “Besës”

a. Me “Besë” do të kuptohet tërësia e ideve dhe riteve fetare të shpallura në Librin e Shenjtë “BESA, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë”.

b. Shkronja **B** simbolizon besën, bujarinë, bujarët dhe babain dhe përdoret në simbolikën që përdorin bujarët shqiptarë për t’u identifikuar.

Neni 3 [BN - 2007]

Përkufizimi i “bujarisë”

Bujari quhet gatishmëria për të dhënë para, ndihmë ose kohë pa u detyruar nga ndokush dhe pa interes. Bujari do të quhet edhe fisnikëria e sjelljes. Një akt i veçantë bujarie është ndihmesa për ngritjen e Faltoreve Shqiptare.

Neni 4 [BN - 2008]

Përkufizimi i Bujarit Shqiptar

“*Bujar Shqiptar*” quhet personi (femër ose mashkull) që praktikon *Besën* si fe të të vet dhe që bëhet anëtar i regjistruar i një *Faltoreje Shqiptare*.

Neni 5 [BN - 2009]

Bujari i Madh

Botës’ i dhanë lirinë,
duke ngrehur parësinë,
të xgjedhënë një të parë,
dhe të urtë, jo të marrë. (Naim Frashëri)

a. *Bujari i Madh* është drejtuesi shpirtëror i një *Faltoreje Shqiptare* dhe përfaqësues i saj.

b. *Bujari i Madh*, është personi që është zgjedhur prej një grupi bujarësh shqiptarë që janë anëtarë të një *Faltoreje Shqiptare*.

c. Askush nuk mund të jetë *Bujari i Madh* i më shumë se një *faltoreje shqiptare*.

Neni 6 [BN - 2010]**Adhurimi Profetit Naim Frashëri**

a. *Naim Frashëri*, për bujarët shqiptarë është profeti, shpalljet e të cilit janë interpretime të urdhëresave të Zotit për kombin shqiptar.

b. Dita 25 maj e çdo viti, përvjetori e lindjes së Profetit Naim Frashërit, është ditë feste dhe pushimi për bujarët shqiptarë. Ata kërkojnë që, kur është e mundur, kjo gjë të respektohet nga të tjerët.

c. Imazhi, familja, objektet, vendlindja e tij Frashëri janë objekte adhurimi dhe trajtohen si të shenjta nga bujarët shqiptarë.

ç. Shkronja N me të cilën fillon emri i Naimit, është simbol tregues për (1) profetin, (2) nënën dhe (3) nderin. Bujarët shqiptarë e përdorin këtë shkronjë në objektet e tyre të adhurimit për të identifikuar besën e tyre.

d. Të gjithë ata shqiptarë që dhanë kontributet e tyre sipas Besës Shqiptare janë personazhe të adhurimit prej bujarëve shqiptarë.

dh. Vendlindja e Naimit, Përmeti dhe Frashëri janë vende të shenjta dhe çdo bujar shqiptar shkon në këto vende të paktën një herë në jetën e tij.

Si ty o Vidhehem, e Mek' e Arabisë
Që kini lerë Muhamet, e Krisht të krishterisë
Është për mua Frashëri, vent i Perëndisë
Atje ku lerë Naim beu, zemr' e Shqipërisë!
(Mihal Grameno)

Sikur të shoh, i tmerrshmë Frashër,
Tek po mban zi përgjithmonë,
Ti: më besniku trashëgonjës
I dashuris' së vendit t'onë.
(Lasgush Poradeci)

Këtu mbaj erë trëndafil,
dhe fjalët i kam këngë.
Më mbushet gjoksi me tërfil,
selvitë më bëhen këmbë.

Këtu kam qejf të kthehem tokë
me drurin, lumin, erën, bilbilin,
ta kem hollaken hënë mbi kokë –
qiriri i Naimit.

Kam qejf një plis të jem në Frashër,
një gur i fortë që mban qoshet.
Kur dielli të më ngrohë krahët
të ngrihem e të shkoj poet.

Teodor Keko

Neni 7 [BN - 2011]**Adhurimi i Ditës së Kombit Shqiptar**

Nga gjithë bota më parë
Të nderojmë Shqipërinë.
Të duamë shqipëtarë

Dhe shqipen si Perëndinë. (Naim Frashëri)

a. Dita e *Kombit Shqiptar* është data 10 qershor e çdo viti, dita përkujtimore e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (10/06/1878).

b. Kjo ditë është ditë feste dhe pushimi për Faltoret Shqiptare dhe ky fakt kërkohet të respektohet edhe nga të tjerët, kur është e mundur.

c. Numri 10 për bujarët shqiptarë bëhet tjetër simbol i identifikimit për atë që ata adhurojnë, kombin e tyre. Ky simbol tregon kombin e tyre dhe njëkohësisht dhe shkëlqimin.

ç. Të gjitha ato ngjarje pararendëse që ndihmuan që të arrihej 10 qershori 1878 dhe të gjithë ato ngjarje të mëpasme që u bënë sipas logjikës së 10 qershorit 1878 janë objekte adhurimi për bujarët shqiptarë.

d. Qyteti i Prizrenit është vend i shenjtë. Çdo bujar shqiptar duhet të shkojë të paktën një herë në jetën e tij në Prizren në datën 10 qershor.

FLAMURI

U duk në Prizren, i bukur dhe krenar,
ende i çjerrë dhe i pluhurosur
Dhe ngjan atëherë se brofi nga varri i thellë
Heroi ynë, shkëlqimtar si diell.

Zef Serembe

**Neni 8** [BN - 2012]**Pavarësia e faltoreve**

a. *Faltorja Shqiptare (neni 1/a)* është një institucion i decentralizuar. Kjo do të thotë se çdo grup bujarësh shqiptarë mund të hapë faltoren e vet (n1/b) dhe ta quajnë vetveten *Faltore Shqiptare*, me kusht që të respektojnë të tëra kërkesat e *Librit të Shenjtë "BESA"* dhe pikat e këtij *Statuti*.

b. *Faltorja shqiptare (neni 1/b)* nuk mund të ketë faltore të tjera në varësi dhe as mund të jetë e varur prej ndonjë institucioni tjetër. E vetmja varësi e tyre është e drejtpërdrejtë nga *Libri i Shenjtë "Besa"*.

c. Askush nuk detyrohet të paguajë diku për të hapur një *Faltore Shqiptare*, përveç detyrimeve ligjore për një gjë të tillë.

Neni 9 [BN - 2013]**Kuvendi i Përgjithshëm i Faltoreve Shqiptare**

a. Ka vetëm një organizëm të vetëm të faltoreve shqiptare (n1/b) që quhet *Kuvendi i Përgjithshëm i Faltoreve Shqiptare*, i cili mbledhet rregullisht një herë në tre vjet, duke filluar nga viti 2012.

b. *Kuvendi* miraton dokumente këshilluese për *Faltoret Shqiptare*.

c. Jo më vonë se gjashtë muaj përpara, *Faltoret Shqiptare* i dhurojnë *Kuvendit* të tyre fonde për realizimin e punës së tij.

ç. Punën për organizimin e *Kuvendit të Parë* e organizojnë 10 *faltoret* e para shqiptare (10 *Bujarët* e tyre të *Mëdhenj*) të cilat interesohen në të gjitha trojet shqiptare për gjendjen e faltoreve shqiptare, adresat, ftesat etj.

d. Katër muaj para mbajtjes së *Kuvendit* organizatorët lajmërojnë përmes tri gazetave më të shitura, përmes internetit dhe përmes radiove e televizioneve me shtrirje deri në emigracion.

Neni 10 [BN - 2014]**Objektivat e Faltores Shqiptare**

a. Çdo *Faltore Shqiptare* është një institucion i pavarur që ka për synim të afrojë besimtarët me Zotin, të realizojë ritet fetare dhe të edukojë sipas përmbajtjes së *Librit të Shenjtë "BESA"*. *Faltoret Shqiptare* janë institucione edukative dhe shërbese lutjesh që synojnë të kënaqin dëshirën e besimtarëve në një Zot të vetëm për të qenë bashkë, për t'u lutur dhe për të ndarë gëzimet dhe hidhërimet me njëri-tjetrin në një komunitet dhe për të edukuar brezin e ri me moralin e shëndoshë. Përvoja e faltoreve shqiptare mbledhet, diskutohet dhe koncentrohet si orientim për të ardhmen nga *Kuvendi i Përgjithshëm i Faltoreve Shqiptare*.

b. *Faltoret shqiptare* shfrytëzojnë të tërë përvojën e tyre dhe kapacitetet intelektuale të bujarëve shqiptarë për të thelluar idetë e "Besës".

c. *Faltoret Shqiptare* nuk janë në asnjë rast institucione që praktikojnë *mrekullinë* dhe as *sugjestionimin* për një gjë të tillë. Në mënyrë të veçantë ato nuk ofrojnë vetë asnjëherë shërbimin e *shërimit fizik* apo *mendor*, në atë kuptim që këtë shërbim e kryen sistemi shëndetësor i organizuar shteti.

ç. Por *Faltoret Shqiptare* kanë për detyrë të ndihmojnë njerëzit që të gjejnë një mbështetje bujare të fuqishme për hallet e çdo bujari dhe të familjes së tij.

d. Në mënyrë të veçantë *Faltorja Shqiptare* aftësohet të punojë për dekurajimin e dukurisë së vrasjes, gjakmarrjes dhe sidomos të vetëvrasjes.

Neni 11 [BN - 2015]**Paanshmëria e Faltoreve Shqiptare**

a. *Faltoret Shqiptare* (n1/b) ndjekin një veprimtari të kujdesshme në angazhimin e tyre në jetën publike në deklaratimet e tyre në publik, dhe në mjetet e informimit publik, për të mos u bërë aktorë pa patur me të vërtetë nevojë për interesa

vërtet të larta të komunitetit apo të kombit sipas shpalljeve të “Besës”.

b. *Faltorja Shqiptare (n1/b)* e ka rreptësisht të ndaluar përkrahjen e drejtpërdrejtë ose fshehtas përmes veprimeve apo deklaratave të hapura apo me nënkuptim të kandidatëve apo të partive të caktuara që synojnë të marrin pushtetin qëndror apo pushtetin lokal si edhe çdo lloj tjetër njëanësie në punët e shqiptarëve. Detyra e saj mbaron me edukimin e *bujarëve shqiptarë* sipas përmbajtjes së Librit të Shenjtë “Besa”. Më tutje ajo nuk mund t’u imponojë atyre zgjedhje të caktuara. Gjithashtu ajo duhet të tregojë të gjithë pjekurinë e saj për të ndaluar edhe të tjerët që të tentojnë ta futin atë në rrugën e njëanshmërisë pa vullnetin e saj.

c. Por *Faltorja Shqiptare (n1/a)* mund të shprehet hapur kur shkelen *parimet* dhe *idetë* e “Besës”.

Neni 12 [BN - 2016]

Ndërtesa e Faltores Shqiptare

a. Për të ushtruar veprimtarinë e saj *Faltorja Shqiptare* përdormjedise pronë e *bujarëve shqiptarë* ose ndërton godinat e saj duke u mbështetur në financimet e dhuruesve të ndryshëm.

b. Ndërtimi i një *faltoreje shqiptare (n1/c)* duhet të respektojë: i) Ndarjen fëmijë – i rritur; ii) për të rriturit respektohet ndarja femra – meshkuj. iii) Në ballë qëndron Naim Frashëri në imazhin e një prej arteve (foto, skulpturë, mozaik, etj). iv) Në një vend afër Naim Frashërit vendoset flamuri kombëtar. Zbukurimet e mureve dhe orendive do të nxirren nga përmbajtja e librit “BESA”. Madhësia e *faltore* është e ndryshme në varësi të burimeve financiare të atyre që e hapin atë.

Neni 13 [BN - 2017]

Emërtimi i Faltores Shqiptare

a. *Faltoret Shqiptare (n1/b)* mund të kenë emra të përveçëm të tillë: *Faltorja Shqiptare “Bujar Andon Zako Çajupi”, “Faltorja Shqiptare “Bujar*

Gjergj Fishta”, ose Faltorja Shqiptare e Dëshnicës etj. Emri Naim Frashëri nënkuptohet për të gjitha *faltoret*, ndaj ato nuk mund të mbajnë të tillë emër.

b. Çdo *faltore* kujdeset që të mos ketë përsëritje të emrit.

Neni 14 [BN - 2018]

Periudha e qëndrimit në detyrë e Bujarit të Madh

Periudha e ushtrimit të detyrës nga ana e *Bujarëve të Mëdhenj* përputhet me atë të Presidentit të Shqipërisë. Zgjedhjet e reja për *Bujarët e Mëdhenj* bëhen gjatë një periudhe 3 mujore pas zgjedhjes së Presidentit të Shqipërisë. [Kjo referencë caktohet për të shmangur dykuptimësitë në periudhat zgjedhore]

Neni 15 [BN - 2019]

Procedura e zgjedhjes së Bujarit të Madh

Gjatë periudhës tremujore të zgjedhjeve të *Bujarit të Madh, Faltorja Shqiptare (n1/b)* garanton: (a) botimin një muaj para votimit të listës së bujarëve shqiptarë me të drejtë vote (gjatë kësaj periudhe bëhen edhe saktësimet nga anëtarët e Faltores Shqiptare); (b) botimin e një fletëpalosje (apo gazete apo stende) kunë një hapësirë të barabartë për çdo kandidat jepet CV e çdo kandidati dhe projektprogrami i tij për *Faltoren Shqiptare*. (c) shpërndarjen e fletëpalosjeve (apo gazetës a broshurës) për çdo bujar votues; (në mungesë të fondeve, të paktën dy javë para votimit, në një kënd jashtë Faltores vendosen profilet jetësore të çdo kandidati dhe programet e tyre); (ç) Njoftimin një muaj para ditës së zgjedhjeve të tre noterëve kujdestarë të dokumentacionit të Faltores për të formuar komisionin zgjedhor.



Neni 16 [BN - 2020]

Komisioni Zgjedhor

Për të organizuar të tërë procesin zgjedhor, Bujari i Madh, një muaj para datës së zgjedhjeve njofton tri noterë shqiptarë, që mund të jenë ata që mbajnë në ruajtje dokumentacionin e Faltores. Noterët mblidhen, caktojnë kryetarin ndërmjet tyre dhe ditën e votimit.

Në emigracion, Komisioni Zgjedhor është prej pesë vetësh dhe zgjidhet me short nga radhët e bujarëve të Faltores më të vjetër në anëtarësi.

Neni 17 [BN - 2021]

Procedura e kandidimit për Bujar të Madh

Për t'u regjistruar si kandidat për *Bujar të Madh* duhet të paraqitet në *faltore* (a) një kërkesë-propozim e noterizuar me firmat e 5 *bujarëve shqiptarë* (jo më shumë), të cilët deklarojnë se e kanë njoftuar kandidatin për dëshirën e tyre dhe njëkohësisht japin një përshkrim të shkurtër të vetive të tij morale. Në këtë kërkesë bashkë me propozimin dorëzohen edhe këto dokumenta: (b) certifikatë familjare, (c) një CV e detajuar dhe e firmuar nga kandidati, e cila jep hollësi për çdo pjesëtar të familjes së kandidatit si edhe për formimin e tij kulturor dhe gjendjen pasurore. Kandidatit nuk i lejohet të bëjë shpenzime të veçanta për propagandimin e kandidaturës jashtë atyre të parashikuara në mënyrë të barabartë nga *faltorja* dhe njëkohësisht nuk i lejohet të takohet me grupe bujarësh për të bindur ata në zgjedhjen e tij. Të tëra anët e tij pozitive si edhe programin e zhvillimit të *Faltores* ai e paraqet në CV-në e vet e cila botohet e plotë në formatin e paracaktuar nga *Faltorja Shqiptare* për çdo kandidat në një gazetë, fletëpalosje ose broshurë ose paraqitet në një kënd të jashtëm të *Faltores*. (ç) një të dielë para zgjedhjeve *Faltorja Shqiptare* siguron një mbledhje të zgjeruar të *bujarëve shqiptarë* ku çdo kandidati i lejohet të flasë 5- 10

minuta. Lihet edhe një kohë e caktuar e barabartë për çdo kandidat edhe për pyetjet e bujarëve.

Neni 18 [BN - 2022]

Votimi

a. Dita e votimit duhet të jetë e Dielë ose e Shtunë.

b. Votimi zhvillohet në mjediset e Faltores.

c. Komisioni zgjedhor përgatit fletët e votimit me firmat e të tre komisionerëve. Çdo fletë votimi përmban emrat e kandidatëve dhe dy shifrat 1 dhe 2 pranë çdo kandidati. Nëse qarkohet 1, kandidati merr 1 pikë dhe nëse rrethohet numri 2, kandidati merr dy pikë.

ç. Votimi është i fshehtë. Secili voton vetëm për veten e vet dhe për askënd tjetër.

d. Në listat e votimit do të futen vetëm bujarët shqiptarë që janë anëtarë të Faltores Shqiptare prej të paktën një viti.

dh. Fleta e votimit është e vlefshme nëse rrethohet vetëm një numër 1 ose një numër 2. Rrjedhime: Lejohet që tek një kandidat të rrethohet edhe nr.1 dhe nr.2 dhe atëherë kandidati merr 3 pikë. Lejohet që të rrethohet nr.1 tek një kandidat dhe nr.2 tek kandidati tjetër.

e. Që një kandidat të zgjidhet Bujar i Madh duhet të marrë pikë më shumë se të tjerët dhe të jetë me mbi 35% të pikëve të mundshme (pikët e mundshme = vota të vlefshme x 3 pikë).

ë. Në rast se pas votimit, asnjë nga kandidaturat nuk siguron pikët e mjaftueshme për t'u zgjedhur, kandidatët e parë që kanë grumbulluar së bashku të paktën 80% të pikëve mblidhen për të caktuar ata vetë një nga dy kandidaturat me më shumë pikë të bujarëve shqiptarë. Edhe në këtë rast, vendoset me votim të fshehtë. Në rast të barazimit votave, hidhet short. Komisioni zgjedhor shpall Bujarin e Madh, i cili fillon detyrën një ose dy javë më pas, periudhë e domosdoshme për t'u njohur me praktikat dhe dokumentacionin që do të merret në dorëzim.

Neni 19 [BN - 2023]**Ceremoniali i parë i Bujarit të Madh**

a. Të dielën e radhës që vjen pas zgjedhjeve, organizohet ceremonia e marrjes së detyrës nga *Bujari i Madh i Faltores Shqiptare*.

b. *Bujari i Madh* që merr detyrën reciton tri lutjet e Profetit Naim Frashërit: për veten; për atdheun dhe për fëmijët duke mbajtur dorën mbi *Librin e Shenjtë "Besa"* me fytyrë nga portreti i *Profetit Naim Frashëri* dhe pastaj mban fjalën e rastit.

c. *Faltorja Shqiptare*, sipas mundësive të saj, kujdeset që atmosfera të jetë festive.

Neni 20 [BN - 2024]**Tiparet e Bujarit të Madh**

Po njeri themi njerinë
që ka gjithë urtësinë,
ka dritën' e diturisë,
dhe të tëra mirësitë,
ka me vehte Perëndinë,
duke pasur njerëzinë
edhe Perëndija vetë!

të njeriu 'sht e vërtetë! (Naim Frashëri)

a. Çdo Bujar i Madh duhet të dëshmojë një zotërim të mirë të ideve dhe praktikave fetare të *Librit të Shenjtë "BESA"*. Në përputhje me këtë përmbajtje, ai realizon ritet e "*Besës*", këshillon, edukon, organizon veprimtari dhe mban të bashkuar *Faltoren Shqiptare*. Me kalimin e viteve dhe grumbullimin e përvojës, organizimi i *Faltoreve Shqiptare* do të bëjë të mundur edhe kualifikimin e personelit shërbyes në to.

Ndaj njeriut të uruar,
që nuk'është' i djallëzuar,
q'është pa faj e mirë
e ka në zëmrë mëshirë,
të këqija s'bën në jetë,
është'i drejt' e i vërtetë
pa ka të lartë vetijë
të bukurë vetëdijë
atje është vetë Zoti,
si kanë thënë qëmoti. (Naim Frashëri)

b. *Bujari i Madh*, i ndërgjegjshëm për rëndësinë e shembullit që jep me sjelljen e tij, dëshmon një kujdes të madh që përmbajtja dhe paraqitja e veprimeve të tij të jetë në përputhje me atë që kërkohet nga "*Besa*".

c. Sidoqoftë formimi i Bujarit të Madh, me zgjedhjen e tij, ai i premtton *Faltores* se në një kohë të shkurtër do të lexojë, përveç *Librit të Shenjtë "Besa"*, edhe, të paktën, *Historinë e Kombit Shqiptar*, një libër filozofie, pedagogjie të përgjithshme dhe një libër psikologjie të përgjithshme.

Neni 21 [BN - 2025]**Këshilltarët e Bujarit të Madh**

a. Çdo *Bujar i Madh* vetë cakton nga radhët e bujarëve të *Faltores Shqiptare* pesë këshilltarë të tij (asnjë familjar me të) dhe i shpall ata para bujarëve të *Faltores Shqiptare*. Një prej këshilltarëve, duhet të jetë personi që del i dyti në votimin për Bujarin e Madh.

b. Emrat e këshilltarëve të *Bujarit të Madh* futen në *Dokumentacionin e Faltores*. Bujari shfrytëzon ndihmën e këshilltarëve individualisht ose kolektivisht për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë si me realizimin e detyrave të *Faltores Shqiptare*.

c. Një këshilltar duhet të paraqitet në *Faltoren Shqiptare* për të paktën 6 orë në muaj.

Neni 22 [BN - 2026]**Detyrat e Bujarit të Madh**

(a) Të kryejë shërbimet në *Faltoren Shqiptare* me kohë të pjesshme ose të plotë sipas nevojave ose mundësive të *Faltores Shqiptare*;

(b) të përfaqësojë *Faltoren* e tij në të gjitha ballafaqimet e saj me institucionet dhe personat e tjerë;

(c) të kujdeset për realizimin e detyrave që *Faltorja Shqiptare* i ka vënë vetes;

(ç) *Bujari i Madh* e ka për detyrë t'i kushtojë të



paktën 12 orë në muaj *Faltore Shqiptare*.

(d) *Bujari i Madh* plotëson në dy kopje ditarin e *Faltore Shqiptare* (në formë kompjuterike dhe të printuar) ku mbahen shënime gjithçka ndodh me *Faltoren Shqiptare*. Një kopje mbetet në *Faltore* dhe i dorëzohet vetëm *Bujarit të Madh* që e zëvendëson dhe një kopje është personale.

Neni 23 [BN - 2027]

Regjistrimi i bujarëve shqiptarë

a. *Bujarët Shqiptarë* regjistrohen në një regjistër të veçantë të *Faltore Shqiptare*.

b. Për regjistrim duhet të depozitohet në *Faltore* (1) një çertifikatë personale dhe (2) dy fotografi së bashku me (3) një kërkesë nga ana e besimtarit drejtuar *Bujarit të Madh* ku shënohen edhe të dhëna personale të tilla si adresa, telefoni, adresa e postës elektronike.

c. Përgjithësisht kërkesa nuk refuzohet, vetëm në raste të një arsye me të vërtetë të madhe.

ç. Pasi bëhet anëtar i një *Faltoreje Shqiptare*, *bujari shqiptar* quhet se është anëtar edhe i faltoreve të tjera shqiptare që janë ngritur ose ngrihen, por të drejtën e votës për zgjedhjen e *Bujarit të Madh* dhe disa të drejta të tjera që kanë të bëjnë me ndihmën për administrimin e *Faltore Shqiptare* e ushtron vetëm në *Faltoren Shqiptare* ku është bërë regjistrimi i tij për herë të parë.

d. Regjistri i *bujarëve shqiptarë* të një *Faltoreje* mbahet në katër kopje, nga të cilat një të mban vetë *Faltorja* dhe tri të tjerat shpërndahen në tri noterë të qytetit, të cilët paraprakisht kanë rënë dakort përmes një kontrate që të kryejnë këtë shërbim.

dh. Regjistri rinovohet tek tre noterët një herë në gjashtë muaj (muaji qershor dhe dhjetor).

e. Kundrejt pagesës, çdokush mund të marrë një vërtetim për vete nëse bën ose jo pjesë në regjistrin e bujarëve shqiptarë të një *Faltoreje Shqiptare* të caktuar. Me një vërtetim të tillë ai

paraqitet ditën e zgjedhjeve ose çdo herë që i kërkohet nga *Faltorja Shqiptare* një gjë e tillë, ose pranë faltoreve të tjera.

ë. Në rast të ndërrimit të vendbanimit bëhet ç' regjistrimi nga një *Faltore* në një *Faltore* tjetër.

f. Çregjistrimi nuk mund të bëhet pa dëshirën e vet *bujarit shqiptar*. Në rast të shpërnguljes për në një *Faltore* tjetër, sillet një fletë pranimit nga *Faltorja* e re dhe pastaj bëhet ç' regjistrimi në të gjitha kopjet e regjistrave.

Neni 24 [BN - 2028]

Sjellja e bujarit shqiptar

a. *Bujari Shqiptar* i kushton të paktën 2 orë në muaj *faltore shqiptare* (brenda ose jashtë saj).

b. *Bujari Shqiptar* interesohet që *Faltore* së tij të mos i mungojë gjë.

c. *Bujari Shqiptar* derdh në arkën e *Faltore* 1% të të ardhurave të tij mujore. Megjithatë ai nuk detyrohet me ndonjë sjellje të veçantë të *Faltore Shqiptare* që ta bëjë një gjë të tillë.

ç. Në asnjë mënyrë ai nuk duhet të shkelë rregullin që dhurimet sado të pakta duhet të kalojnë përmes llogarisë bankare të *Faltore Shqiptare*. Nëse e shkel këtë dhe jep para në dorë, do të quhet se shkel "Besën". [Transparenca e fondeve është mënyra e jetëgjatësisë së *faltore* dhe e mospërforjes së administrimit të saj.]

Neni 25 [BN - 2029]

Shpërblimi i Bujarit të Madh

Paga mujore që *Bujari i Madh* merr nga *Faltorja* (nëse burimet e mundësojnë) për shërbimin e tij në *Faltore* nuk është asnjëherë më e madhe se paga mujore që merr një mësues në shkollat publike të arsimit parauniversitar, të vendbanimit ku është *Faltorja*. Pagat për personelin ndihmës u referohen gjithnjë të njëjtave punë në sektorin publik, por këto paga nuk janë asnjëherë më të larta se ajo e *Bujarit të Madh*.

Neni 26 [BN - 2030]**Financat**

a. Financat e *Faltores Shqiptare* mbahen në një nga bankat me shtrirje kombëtare.

b. 100% e arkëtimeve dhe e pagesave bëhen prej numrit të llogarisë.

c. Çdo gjashtë muaj depozitohen tek tre noterët që mbajnë dokumentet e *Faltores Shqiptare* nga një kopje e arkëtimeve dhe pagesave të bëra prej numrit të llogarisë së faltores (dokument i lëshuar nga banka).

ç. Çdo *bujar shqiptar* (noteri ka regjistrin e bujarëve të *Faltores Shqiptare*) mund të marrë një kopje të dokumentave financiarë të *Faltores Shqiptare*, kundrejt një pagese të arsyeshme ndaj noterit. Vërejtjet e tij ose propozimet ai mund t'ia përcjellë njërit prej këshilltarëve të *Bujarit të Madh* ose vetë *Bujarit të Madh*.

d. Financat e *Faltores* mbikqyren përmes prej një eksperti kontabël të Shoqatës më të Madhe të Ekspertëve Kontabël.

dh. Eksperti çdo vit ndryshon dhe caktohet me llotari të sigurtë për paanshmëri nga një listë që ka jo më pak se 8 vetë (të cilët paraprakisht kanë pranuar kushtet e pagesës).

e. Eksperti Kontabël jep (a) një përshkrim rreth rregullsisë së mbajtjes së llogarive sipas ligjeve në fuqi dhe njëkohësisht jep edhe (b) vërejtje dhe sugjerime për mbarëvajtjen më të mirë të financave të *Faltores*.

ë. Raporti i ekspertit kontabël jepet në katër kopje, nga të cilat një rri në *Faltore* dhe tre të tjerat u jepen tre noterëve kujdestarë të Dokumentacionit të *Faltores*.

c. *Faltorja Shqiptare* nuk merr asnjëherë kredi as në para as në mall.

ç. Hapja e veprimtarive ekonomike me synim sigurimin e të ardhurave për *Faltoren* është një mundësi vetëm për *Faltoret* që kanë mbi 100 bujarë shqiptarë. Miratimi për hapjen e veprimtarisë ekonomike bëhet përmes organizimit të një

referendumi me votim të fshehtë të përgjithshëm të bujarëve të faltores. Kjo nismë duhet të sigurojë miratimin e të paktën 60% e të gjithë numrit të bujarëve shqiptarë të asaj *Faltorje* dhe jo më pak se 60 të tilla në numër. Referendumi nuk mund të organizohet pa u dhënë më përpara një plan-biznesi të imtësishëm të miratuar edhe nga Eksperti Kontabël i autorizuar që mban financat e *Faltores*.

Neni 27 [BN - 2031]**Dhurimet**

Po s'bëre një të mirë në botë,
Jetën' e bëre dëm, vate kotë.

(Naim Frashëri)

a. Dhurimet për *faltoret shqiptare*, kur janë para, bëhen vetëm në llogaritë bankare dhe asnjëherë në mjediset e faltores.

b. Askush prej personelit të *Faltores Shqiptare* nuk mund të marrë para në dorë prej besimtarëve të ndryshëm; as t'i hedhë ato në llogarinë bankare të *Faltores* në emër të besimtarëve të ndryshëm.

c. *Organizimi i bujarive*. Çdo dhurim paraje për një nismë të caktuar bujarie bëhet në numrin e llogarisë së *Faltores Shqiptare* me komentin përkatës se për çfarë veprë bujarie duhet shpenzuar. Çdo dhurim sendi që bëhet pranë *Faltores* regjistrohet në një tabelë e cila ekspozohet për jo më pak se një muaj në hyrje të *Faltores*. *Bujari i Madh* cakton mënyrën e shpërndarjes së dhuratave, pasi është këshilluar me këshilltarët e tij.

Neni 28 [BN - 2032]**Shërbim ndaj të gjithëve**

Çdo njeri vëllath e kemi,
gjithë nga një baltë jemi,
kemi një shpirt në vetijë,
jemi gjithë një fëmijë,
një mëm'e një atë kemi,
në një fytyrë po jemi. (Naim Frashëri)



Faltorja Shqiptare edhe pse ka anëtarë të regjistruar, mbetet përsëri e hapur ndaj çdo vizitori që kërkon të njihet me *Faltoren Shqiptare* ose edhe të ushtrojë *Besën* e tij.

Faltorja i përmbahet shpalljes së Naimit:

Besa është në kraharuar
nuk është në kartë shkruar.

Neni 29 [BN - 2033]

Harmonia fetare

a. Çdo *Faltore Shqiptare* e ka të ndaluar të realizojë haptas ose në fshehtësi një “politikë” diskriminuese ndaj bujarëve shqiptarë të faltoreve të tjera.

b. Sidoqoftë, gjithsekush çdo besim ta repektojë.
(Naim Frashëri)

Neni 30 [BN - 2034]

Ritet, ceremonitë dhe veprimtaritë kryesore të Faltores Shqiptare

a. Ritet dhe ceremonitë që realizon *Faltorja Shqiptare*: (a) lutja, (b) orët edukative për fëmijët ose të rinjtë që janë zberthime të ideve të Librit të Shenjtë “Besa”, (c) veprimtari bujarie për realizimin e kërkesave të “Besës”; (ç) ceremonia e lindjes së fëmijës së një bujari shqiptar; (dh) ceremonia e martesës së një bujari shqiptar; (e) ceremonia në ndërrimin e jetës së një bujari shqiptar; (ë) ceremonia e ditëlindjes së *Profetit Naim Frashërit*; (f) ceremonia e 10 qershorit, ditës së Kombit Shqiptar; (g) ceremonia e Vitit të Ri; ceremonitë me rastin e festave kombëtare siç janë 17 shkurti dhe 28 nëntori etj.; (gj) ceremonia e përjavshme për çdo ditë të djelë. *Faltorja Shqiptare* organizon gjithashtu veprimtari argëtuese (si p.sh. ekskursione) kryesisht me të rinjtë dhe fëmijët dhe me të moshuarit, por edhe me moshat e tjera. Kompaktësia e *Faltores Shqiptare* dhe gatishmëria e saj për të qenë bujare do të jetë rezultati i

dëshiruar prej saj prej të gjitha veprimtarive.

b. *Faltorja Shqiptare* e ka të ndaluar të kryejë shërbimin e dëgjimit të rrëfimit të mëkateve. Sidoqoftë ajo që thuhet në mirëbesim nuk duhet thënë tek të tjerë nga ana e personelit të *Faltores Shqiptare* dhe as të diskutohet ndërmjet tyre:

Njeriu, që s’mba besën, dhe fjalënë që thotë,
Është shumë i panderçim dhe i frikshim në botë.
(Naim Frashëri)

c. Asnjë ceremoni apo shërbim i *Faltores* nuk kryhet kundrejt ndonjë pagese. *Faltorja* ndjek një metodikë ceremonish e cila garanton barazinë ndërmjet të pasurve dhe të varfërve. Kështu, p.sh. ajo nuk lejon që organizimi i ceremonisë së martesës, lindjes apo mortore për një të pasur të jetë më e kujdesshme apo më e gëzuar se ajo e një të varfri.

Neni 31 [BN - 2035]

Pjesmarrja e fëmijëve në Faltore

Lerini gjithë të vinë
Të vegjëlthitë ndaj meje
Se edhe vetë Perëndinë
Ndër ata donja ta gjeje. (Naim Frashëri)

Fëmijët marrin pjesë në veprimtarinë e faltoreve me lejen e prindërve të tyre.

Neni 32 [BN - 2036]

Dokumentacioni i Faltores Shqiptare

a. Me *Dokumentacion të Detyrueshëm* e të *Përhershëm të Faltores Shqiptare* do të kuptojmë dokumentacionin që mbahet detyrimisht në katër kopje: një prej të cilëve ruhet në faltore dhe tre të tjerat në tre noterë kujdestarë të këtij dokumentacioni: (a) *akti i themelimit*, (b) *statuti*, (c) *vendimi i regjistrimit në gjykatë*, (ç) *regjistri i bujarëve të faltores* i rinovuar çdo gjashtë muaj, (d) *dokumentat vjetorë të financave të hartuar nga një*

ekspert kontabël i autorizuar, (dh) *procesverbalet* e zgjedhjes së Bujarit të Madh; (e) dokumenti i regjistrimit në zyrën e tatim taksave; (ë) kontratat e rëndësishme.

b. *Dokumentat Ndhmës* do të quhen të tëra dokumentet që shërbejnë për formulimin e dokumentave kryesore: p.sh. fletët e votimit; faturat e blerjeve dhe shitjeve; fletëpalosjet etj. Dokumentat ndihmës ruhen vetëm në faltore, për një periudhë pesëvjeçare, nga dita e përpilimit të tyre. Sidoqoftë asgjësimi i tyre bëhet në prani të Bujarit të Madh dhe të këshilltarëve të tij.

c. Çdo faltore shqiptare kujdeset që në hapat e para të saj të krijojë fondin e saj të historikut: shkrime, foto, video, regjistrime dhe kujtime e çdo gjë me vlerë historike. Çdo Bujar i Madh ka një vend të veçantë në historikun e faltores.

Neni 33 [BN - 2037]

Ruajtja e dokumentacionit të Faltores Shqiptare

a. *Bujari i Madh* i parë i një *faltoreje* cakton 3 noterëve kujdestarë për dokumentacionin e *Faltores Shqiptare*, sipas një kontrate që bëhet me secilin dhe që përmban parasysh kërkesat e këtij statuti. Kontrata nënshkruhet nga *Bujari i Madh* dhe nga të paktën 3 këshilltarët e tij, bujarë shqiptarë.

b. Tërheqja e tërësishme e dokumentacionit në ruajtje nga një noter, bëhet në prani të dy noterëve të tjerë dhe të Bujarit të Madh dhe gjithmonë përgatitet dokumentacioni i plotë për t'u depozituar tek një noter tjetër që të plotësohet numri 3 i noterëve kujdestarë.

c. Noterët paguhen sipas një marrëveshje të dyanshme për punën e tyre.

ç. Dokumentacioni që ruhet nëpër noterët kujdestarë është pronë e Faltores Shqiptare dhe mund të tërhiqet në çdo kohë nga një noter i caktuar, por asnjëherë nga të tre noterët njëkohësisht.

d. Një Bujar i Madh ka të drejtë të zhvendosë

vetëm një nga të tre noterët, kujdestarë të dokumentacionit, gjatë mandatit të tij.

dh. Asnjë nga noterët dhe asnjë pjesëtar i familjes së tij nuk mund të bëhet Bujar i Madh i faltores, regjistrin e së cilës mban, por mund të jetë bujar shqiptar i asaj faltoreje.

e. Dokumentacioni i Faltores që mban një noter është pronë e Faltores Shqiptare.

ë. Në rast dëmtimi ose humbjeje të qëllimshme të këtij dokumentacioni, noteri mban përgjegjësi ligjore. Në një rast të tillë Faltorja interesohet të bëjë zhvendosjen e dokumentacionit në një noter tjetër duke siguruar prej ballafaqimit të tre kopjeve të mbetura, një kopje tjetër të katërt e cila i jepet një noteri të ri.

Neni 34 [BN - 2038]

Papajftueshmëria me postin e Bujarit të Madh

a. Posti i Bujarit të Madh të Faltores Shqiptare është i papajftueshëm me atë të përfaqësuesit politik të ndonjë partie apo organizate politike të ngjashme, dhe me poste të tjera të larta shtetërore. Në rast të një angazhimi të tillë, Bujari i Madh, zëvendësohet me një person tjetër, me të njëjtën procedurë që është zgjedhur vetë ai. Për Bujarët e Mëdhenj nuk ka kufizim në kohë.

b. Sidoqoftë, Faltorja Shqiptare bën më të mirën për zgjedhjen e bujarit të duhur për ta drejtuar.

Neni 35 [BN - 2039]

Ndihma e ndërsjelltë ndërmjet Faltoreve Shqiptare

a. Bujarët e Faltoreve Shqiptare ndihmojnë njëri – tjetrin dhe angazhohen në veprimtari të përbashkëta.

b. Bujarët Shqiptarë mund të kryejnë shërbime në një Faltore Shqiptare tjetër me ftesën e vetë kësaj faltoreje.

**Neni 36** [BN - 2040]**Publikimet**

- a.** Faltoret Shqiptare kanë faqen e tyre zyrtare të internetit.
- b.** Nëse fondet ua lejojnë, Faltoret Shqiptare bëjnë botime të ndryshme, spote ose emisione radiotelevizive.
- c.** Deklarimet e një faltoreje shqiptare nëse janë të drejta nderojnë të gjitha faltoret kudo që janë dhe nëse janë jo të vërteta, nuk janë të ndershme, nuk janë të urta, nuk kanë efekt mbi faltoret e tjera.

Neni 37 [BN - 2041]**Agjërimi**

- a.** Agjërimi është mosngrënia e ushqimit nga ora 7:00 e mëngjesit deri më 19:00. Synimi i agjërimit është forcimi i besimit dhe vetedukimi përmes sakrificës.
- b.** Agjërimi kryhet çdo herë një ditë para ditëve të shenjta.

Datat e agjërimit janë:

- c.** 24 maj (një ditë para 25 majit, ditëlindjes së profetit të bujarëve shqiptarë Naim Frashërit). Kjo sakrificë i kushtohet Zotit, profetit, njeriut në përgjithësi.
- ç.** 9 qershor (një ditë para 10 qershorit, Ditës së Kombit Shqiptar). Kjo sakrificë i kushtohet kombit shqiptar, është ditë reflektimi për detyrën ndaj kombit dhe ndaj shtetit shqiptar.
- d.** Një ditë para ditëlindjes së babait. Kjo sakrificë i kushtohet nderimit të babait, sjellësi në jetë. Dita është ditë reflektimi për prindërit dhe sidomos për babain (tëndin dhe të të tjerëve).

Atë që i bën t'yt eti,

Ta preç nga yt bir edhe ti.

(Naim Frashëri)

- dh.** Një ditë para ditëlindjes së nënës. Sakrificë për nënën, si dhuruese e jetës, familjen, prindin.

Reflektim për kryerjen e detyrimeve ndaj prindërve.

Duaj atën' edhe mëmën,
Të jesh fatbardhë në jetë,
Se po të t'apinë nëmën,
Kurrë nukë bën përpjetë. (Naim Frashëri)
E mir' e mëmës kurrë s'çpërblehet,
Si mjer' ajoy q'e bën të pshonjë,
Mos e bëj kurr të mallëngjehet,
Dhe të të nëmnjë e të të mallkonjë.

(Naim Frashëri)

- e.** Një ditë para ditëlindjes vetjake. Kjo ditë është ditë reflektimi për veten, për të gjetur forcë për të jetuar, për të pastruar shpirtin për të falur e për të kërkuar të falur. Kodi i komunikimit me ata që do të falen, apo u kërkohet e falur është "Sot është dita ime".

Faltorja Shqiptare ndihmon secilin për t'i dhënë sa më shumë kuptim sakrificës së agjërimit.

Neni 38 [BN - 2042]**Ditët e shenjta**

25 maj, 10 qershor, 1 janari, ditëlindja e babait, ditëlindja e nënës dhe ditëlindja e vetë personit,

Neni 39 [BN - 2043]**Identifikimi i Faltoreve Shqiptare**

Identifikimi i Faltoreve Shqiptare realizohet përmes këtyre simboleve:

- a.** Përmes mbajtjes në krye të Faltores Shqiptare të Profetit Naim Frashëri.

b. – Logoja (stema) është një trekëndësh dybrinjëshëm i kuq, ku baza dhe lartësia janë në raportin 2/3, brenda trekëndëshit brendashkruhet një rreth që në mes ka shkronjën **Ŋ**. Mbi shkronjën **Ŋ** ndodhet një rreth me diametër sa gjysma e gjerësisë së shkronjës **Ŋ** (shih kopertinën).

ç. Komenti i logos është i shumëfishtë:

- Trekëndëshi paraqet Faltoren që, kur ndërtohet nga e para, ka gjithmonë një çati.

- shkronja **Ŋ** përfaqëson Profetin Naim Frashëri, rrethi i madh përfaqëson gjithësinë. Pika sipër **Ŋ** përfaqëson pikësyzimin (Zotin).

- Të para bashkë, dy elementet **Ŋ** dhe pika sipër japin idenë e njeriut që është edhe ideja kryesore rreth së “Besës”

Se je ti mëkëmbësi i tij në jetë

Vendi prej nga del në shesh thesari i fshehtë.

Naim Frashëri

- Shkronja **Ŋ** ngjan me portën e faltores dhe të paraqës që ruhet nga Zoti (pika sipër). Ky fakt respektohet edhe në ndërtimin e portës hyrëse të faltores shqiptare e cila ka formën e shkronjës **Ŋ** dhe sipër një dritare rrethore.

d. Indeksi BN është indeksi i frymëzimeve hyjnore shqiptare (Besë, Bujari, Baba, Naim, Nënë, Nder). Ky indeks fillon me Librin e Shenjtë “BESA” dhe vijon me frymëzimet hyjnore që do të mbledhin Faltoret Shqiptare dhe që do të shtohen në Kuvendin e Parë të Faltoreve Shqiptare më 2012.

Neni 40 [BN - 2044]

Miratimi ligjor

a. Në rast se është e nevojshme, ky statut duhet paraqitur në organet përkatëse shtetërore nga çdo grupim bujarësh shqiptarë që dëshiron të hapë një Faltore Shqiptare.

b. Përcaktimet shtesë që mund të bëjnë nismëtarët për hapjen e një Faltoreje Shqiptare nuk duhet të bien ndesh me frymën e përgjithshme të këtij Statuti si edhe me përmbajtjen e Librit të Shenjtë “Besë”.

c. Sidoqoftë bujarët shqiptarë janë të lirë dhe duhet të shprehin gjithë urtësinë e tyre për të bërë më të mirën për Faltoren Shqiptare.

Njeriu po pati dëshirë,
E gjen punëzën’ e mirë.

(Naim Frashëri)

Perëndia, zotëri,
vetëm jep atë që ti
jo e do e dëshëron
po vepron, vepron, vepron.

Ali Asllani

Neni 41 [BN - 2045]

Përhapja e Librit të Shenjtë “Besë”

Në formën e librit dhe në formë elektronike, Libri i Shenjtë përhapet vetëm nga shkolla dhe botuesi “**Udha e shkronjave**”.

Artur Shkurti

bujar shqiptar

Drejtor i shkollës

“UDHA E SHKRONJAVE”

www.udhaeshkronjave.edu.al



Sot sheklli mbarë prir synin prej Shqyptarvet,
Me pa si perkujdesmi per Atdhe;
E si u dishmojm me punë na kundershhtarvet
Se jemi t'zott me u lidhe me besë e fe
Edhe vetë me sundue vendin e t'Parvet

Gjergj Fishta [BN - 2046]

Rroftë feja e shqiptarëve, Shqiptaria!

Gazmend Leka

Tiranë, 25 maj 2009



udha e shkronjave

"Udha e shkronjave"
www.udhaeshkronjave.edu.al
2 234 017 - 2 267 048
cel. 0692076068
arturshkurti@gmail.com

ISBN: 978-99956-755-0-9



CMIMI 900 LEKE